DHJETË MITE MBI IZRAELIN

Nga:

ILAN PAPPE

Përktheu:

Genc Mustafa Çurgu

Botuar nga Verso

2017


ISRAELI SETTLEMENTS ON THE WEST BANK
LEBANON
Damascus
SYRIA
Mediterranean Sea
Akka
Haifa
Galilee
Sea of Galilee
Nazareth
Tulkarm
Nablus
Taybeh
Qalqilya
Tel Aviv
Jaffa
West Bank
River Jordan
Amman
Ramallah
Jerusalem
Silwan
Hebron
Gaza
Gaza Strip
Khan Yunis
Dead Sea
STATE OF ISRAEL
JORDAN
EGYPT
Naqab-Negev
SINAI
Palestinian territory de facto annexed by settlements and wall
Area remaining for Palestinian state
The Separation Barrier
0 20 40 60 kilometres
0 10 20 30 40 miles

PARATHËNIE

Historia gjendet në thelb të çdo konflikti. Një kuptim i vërtetë dhe i paanshëm i së kaluarës ofron mundësinë e paqes. Nga ana tjetër, shtrembërimi ose manipulimi i historisë, mbjell vetëm fatkeqësi. Siç e tregon shembulli i konfliktit izraelito-palestinez, shtrembërimi i historisë, bile edhe i së shkuarës më të afërt, mund të shkaktojë një dëm të tmerrshëm. Ky keqkuptim i qëllimshëm i historisë mund të përkrahë shtypjen dhe mund të mbrojë një regjim kolonializmi dhe pushtimi. Ndaj, nuk duhet të habitemi që politikat e dezinformimit dhe shtrembërimit vazhdojnë edhe sot dhe luajnë një rol të rëndësishëm në përjetësimin e konfliktit, duke lënë shumë pak shpresë për të ardhmen.

Idetë e gabuara të sajuara për të shkuarën dhe të sotmen në Izrael dhe Palestinë na pengojnë që të kuptojmë zanafillën e konfliktit. Ndërkohë, manipulimi i vazhdueshëm i fakteve të rëndësishme punon kundër interesave të të gjithë atyre që kanë rënë viktimë e gjakderdhjes dhe dhunës që vazhdon. Çfarë duhet bërë?

Rrëfimi historik sionist se si toka e kontestuar u bë shteti i Izraelit është e bazuar mbi një sërë mitesh që mjeshtërisht hedhin dyshim mbi të drejtën morale të palestinezëve mbi tokën. Shpesh, mediat kryesore perëndimore dhe elitat politike e pranojnë këtë grup mitesh si një të vërtetë të pamohueshme, si dhe justifikimin e veprimeve të Izraelit në këto 60 vitet e fundit. Në shumicën e rasteve, pranimi i heshtur i këtyre miteve shërben si shpjegim për mosndërhyrjen e qeverive perëndimore në mënyrë efikase në një konflikt që po vazhdon që nga themelimi i kombit.

Ky libër i sfidon këto mite, të cilat shfaqen në publik si të vërteta të padiskutueshme. Për mua, këto deklarata janë shtrembërime dhe fabrikime që mund dhe duhet të hidhen poshtë përmes një shqyrtimi të afërt të të dhënave historike. Filli i përbashkët që e përshkon këtë libër është ballafaqimi ndërmjet perceptimit popullor dhe realitetit historik. Duke e vendosur çdo mit përballë së vërtetës, çdo kapitull ve në dukje dobësitë e tyre përmes shqyrtimit të hulumtimeve më të fundit historike.

Libri mbulon dhjetë mite themelore ose grupe mitesh, të cilat janë të zakonshëm dhe të njohur për cilindo që është i angazhuar, në një mënyrë apo një tjetër, me çështjen izraelito-palestineze. Mitet dhe kundërargumentet ndjekin një radhë kronologjike.

Kapitulli i parë paraqet Palestinën në prag të mbërritjes së sionizmit në fund të shekullit XIX. Miti është portretizimi i Palestinës si një vend bosh, i thatë gati si shkretëtirë, që u kultivua nga sionistët që mbërritën. Kundërargumenti zbulon një shoqëri ekzistuese të lulëzuar të përfshirë në proceset e përshpejtuara të modernizimit dhe nacionalizimit.

Miti i Palestinës si një vend pa popull lidhet me mitin e famshëm të popullit pa tokë, tema e kapitullit të dytë. A ishin hebrenjtë me të vërtetë banorët origjinalë të Palestinës, që meritonin të mbështeteshin me çdo mënyrë të mundshme për “rikthimin” në “atdheun” e tyre? Miti këmbëngul që hebrenjtë që mbërritën në vitin 1882 ishin pasardhësit e hebrenjve të dëbuar nga romakët rreth vitit 70 e.s. Kundërargumenti ngre pikëpyetje mbi këtë lidhje kronologjike. Një mund shumë i madh dijetarësh ka treguar se hebrenjtë e Palestinës romake qëndruan në vend dhe u konvertuan fillimisht në të krishterë dhe më pas, në muslimanë. Se kush ishin këta hebrenj është akoma një çështje e hapur, që nuk i jep ndonjë përgjigje kësaj pyetjeje: ndoshta hazarët që u konvertuan në hebraizëm në shekullin IX ose ndoshta një përzierje racash përgjatë një mijëvjeçari. Ç’është më e rëndësishmja, në këtë kapitull, unë argumentoj se në periudhën para sionizmit, lidhja mes bashkësive hebreje nëpër botë dhe Palestinës ishte fetare dhe shpirtërore, por jo

politike. Përpara shfaqjes së sionizmit, deri në shekullin XVI, shoqërimi i kthimit të hebrenjve me shtetformimin ishte një projekt i krishterë dhe më pas, një projekt krejtësisht protestant, veçanërisht anglikan.

Kapitulli i 3-të shqyrton imtësisht mitin që e barazon sionizmin me hebraizmin, duke bërë që antisionizmi të portretizohet si antisemitizëm. Unë mundohem ta hedh poshtë këtë barazim përmes një vlerësimi historik të qëndrimeve hebreje ndaj sionizmit dhe një analize të manipulimit sionist të hebraizmit për qëllime kolonialiste dhe më pas, strategjike.

Kapitulli i 4-t merret me pretendimin se nuk ka asnjë lidhje ndërmjet kolonializmit dhe sionizmit. Miti është që sionizmi është lëvizje liberale nacional-çlirimtare, ndërsa kundërargumenti e tregon atë si një projekt kolonialist, bile kolonizues, të ngjashëm me ato që shihen në Afrikën e Jugut, të dyja Amerikat dhe Australi. Rëndësia e këtij refuzimi është se ai reflekton mënyrën se si mendojmë për rezistencën palestineze ndaj sionizmit dhe më vonë, Izraelit. Nëse Izraeli është një demokraci që po vetëmbrohet, atëhere del se organizatat palestineze si OÇP-ja janë thjesht terroriste. Megjithatë, nëse lufta e tyre është kundër një projekti kolonialist, atëherë ato janë një lëvizje antikolonialiste dhe imazhi i tyre ndërkombëtar do të jetë shumë i ndryshëm nga ai që Izraeli dhe mbështetësit e tij mundohen t'i imponojnë opinionit publik botëror.

Kapitulli i 5-të rishikon mitologjitë e mirënjohura të vitit 1948 dhe në veçanti, synon t'i përkujtojë lexuesit se përse pretendimi i ikjes vullnetare të palestinezëve është demaskuar me sukses nga historiografia profesioniste. Në këtë kapitull diskutohen edhe mite të tjera të lidhura me ngjarjet e vitit 1948.

Kapitulli i fundit historik diskuton nëse ju imponua apo jo Izraelit lufta e vitit 1967, duke e bërë atë si të vetmen zgjedhje. Unë deklaroj se kjo ishte pjesë e dëshirës së Izraelit për ta plotësuar marrjen e të gjithë Palestinës, gjë që gati kishte përfunduar në luftën e vitit 1948. Planifikimi i pushtimit të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës filloi që në vitin 1948 dhe nuk pushoi derisa ju dha shansi historik si pasojë e një vendimi të pamatur egjiptian në qershor të vitit 1967. Më tej, unë argumentoj se politikat izraelite menjëherë pas pushtimit provojnë se Izraeli ishte i përgatitur që më parë për këtë luftë dhe nuk u përfshi aksidentalisht në të.

Kapitulli i 7-të na sjell në të tashmen. Unë shtroj pyetjen: a është apo jo Izraeli një shtet demokratik? Unë argumentoj për të dytën, duke shqyrtuar statusin e palestinezëve brenda Izraelit dhe në territoret e pushtuara, të cilët së bashku përbëjnë gati gjysmën e popullsisë së qeverisur nga Izraeli.

Kapitulli i tetë merret me procesin e Oslos. Pas gati një çerek shekulli që nga nënshkrimi i marrëveshjes, ne kemi një perspektivë të mirë të ideve të gabuara në lidhje me këtë proces dhe mund të shtrojmë pyetjen nëse ai ishte një marrëveshje paqeje që dështoi apo një dredhi e suksesshme izraelite për të thelluar akoma më shumë pushtimin?

Një perspektivë e ngjashme mund të zbatohet tani edhe për Rripin e Gazës dhe mitin akoma gjerësisht të pranuar se mjerimi i njerëzve atje vjen si pasojë e natyrës terroriste të Hamasit. Në kapitullin e nëntë, unë kundërshtoj dhe paraqes një interpretim tjetër të asaj që ka ndodhur në Gaza që nga fundi i shekullit të shkuar.

Së fundmi, në kapitullin e dhjetë, sfidoj mitin që zgjidhja e dy shteteve është e vetmja rrugëdalje. Kemi fatin të kemi shumë vepra të shkëlqyera të veprimtarëve dhe dijetarëve që e kritikojnë këtë formulë dhe ofrojnë zgjidhje alternative. Ata përbëjnë një sfidë të stërmadhe ndaj këtij miti të fundit.

Gjithashtu, libri përfshin një shtrirje kohore si shtojcë, e cila do t'i ndihmojë lexuesit për t'i kontekstualizuar

më tej argumentet.

Shpresoj që ky libër të jetë një mjet i dobishëm për cilindo lexues: si për atë të sapoardhur në këtë fushë, ashtu edhe për studiuesin e vjetër të saj. Ai i drejtohet kryesisht cilitdo që e gjen vetveten në vorbullën e diskutimit të temës gjithmonë aktuale të çështjes izraelito-palestineze. Ky nuk është një libër i drejtpeshuar, por një përpjekje tjetër për të ndrequr peshoren e fuqisë në interes të palestinezëve të kolonizuar, të pushtuar dhe të shtypur në tokën e Izraelit dhe Palestinës. Do të ishte një dhuratë e vërtetë sikur mbrojtësit e sionizmit ose përkrahësit besnikë të Izraelit të kishin dëshirën që të përfshiheshin në diskutimin e argumenteve të paraqitura këtu. Në fund të fundit, libri është shkruar nga një hebre izraelit, i cili interesohet për shoqërinë e tij, po aq sa edhe për atë palestineze. Hedhja poshtë e mitologjive që mbështesin padrejtësinë duhet të jetë e dobishme për cilindo që jeton në atë vend apo dëshiron të jetojë atje. Kjo krijon një bazë, mbi të cilën të gjithë banorët e tij mund të gëzojnë arritjet e mëdha, që tani i gëzon vetëm një grup i privilegjuar.

Për më tepër, shpresoj që libri të jetë një mjet i dobishëm për veprimtarët që e pranojnë se njohja e Palestinës është po aq e nevojshme sa ç'është përkushtimi ndaj kauzës. Ai nuk është zëvendësues i punës së pabesueshme të bërë nga shumë dijetarë ndër vite, kontributi i të cilëve e ka bërë të mundur një libër si ky, por është një pikë hyrjeje në atë botë dijeje.

Studiuesit dhe dijetarët mund ta cekin këtë libër nëse e kanë shëruar vetveten nga sëmundja më e madhe e botës akademike në kohën tonë: ideja se përkushtimi minon përsosmërinë në kërkimin shkencor. Studentët më të mirë universitarë dhe ata pasuniversitarë që kam pasur kënaqësinë t'iu jap mësim dhe t'i drejtoj ishin të përkushtuarit. Ky libër është vetëm një ftesë modeste për dijetarët e ardhshëm që t'i braktisin kullat e tyre të fildishta dhe të lidhen me shoqëritë, për interes të të cilave po i kryejnë kërkimet e tyre, qofshin ata studiues të ngrohjes globale, varfërisë apo Palestinës. Ata duhet ta veshin përkushtimin e tyre mbi veshjet akademike. Dhe nëse universitetet e tyre nuk janë akoma gati për këtë, ata duhet të jenë aq të zgjuar sa të luajnë lojën e "kërkuesit akademik të paanshëm dhe objektiv" në këto çështje të diskutueshme, duke e pranuar plotësisht shtirjen e tyre të rremë.

Për publikun e gjërë, ky libër përfaqëson një version të thjeshtë të një teme që shpesh mund të duket jashtëzakonisht e ndërlikuar (siç janë në fakt disa aspekte të saj), por që mund të shpjegohet dhe lidhet lehtë nga perspektiva universale e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut.

Së fundmi, shpresoj që ky libër të sqarojë disa keqkuptime të thella që qëndrojnë në thelb të problemit izraelito-palestinez, në të shkuarën dhe të tashmen. Për sa kohë që këto shtrembërime dhe hamendje të trashëguara të mos vihen në dyshim, ato do të vazhdojnë të përbëjnë një mburojë imuniteti për regjimin e sotëm çnjerëzor në tokën e Palestinës. Duke i shqyrtuar këto hamendje nën dritën e hulumtimeve më të fundit, mund të shohim se sa larg janë ato nga e vërteta historike dhe pse ndreqja e të dhënave historike mund të ketë një ndikim në shanset për paqe dhe pajtim në Izrael dhe Palestinë.

PJESA E PARË

IDETË E GABUARA TË SË SHKUARËS

KREU I

PALESTINA ISHTE NJË VEND BOSH

Hapësira gjeopolitike që sot quhet Izrael apo Palestinë ka qenë një vend i njohur që në kohën e Romës. Statusi dhe gjendja në të shkuarën e largët janë tema për një debat të ndezur ndërmjet atyre që besojnë se burime të tilla si Bibla nuk kanë vlerë historike dhe atyre që e konsiderojnë librin e shenjtë si një rrëfim historik. Rëndësia e historisë pararomake të vendit do të trajtohet në këtë libër në kapitujt e mëpasëm. Megjithatë, duket se ka një konsensus të gjërë mes dijetarëve se ishin romakët ata që i dhanë vendit emrin Palestinë, fakt që daton më parë se të gjitha përmendjet e ngjashme të vendit me emrin Palestinë. Gjatë periudhës romake dhe më vonë, sundimit bizantin, ajo ishte një provincë perandorake dhe fati i saj varej shumë nga fati i Romës dhe më vonë, Konstandinopojës.

Nga mesi i shekullit VII dhe në vazhdim, historia e Palestinës u lidh ngushtë me botën arabe dhe muslimane, me një ndërprerje të shkurtër në periudhën mesjetare, kur ra në duart e kryqtarëve. Perandori dhe dinasti të ndryshme muslimane nga veriu, lindja dhe jugu aspironin për ta kontrolluar, sepse ishte vendi i dytë më i shenjtë në fenë islame pas Mekës dhe Medinës. Natyrisht që ajo ofronte edhe atraksione të tjera, për shkak të pjellorisë dhe vendndodhjes së saj strategjike. Pasuria kulturore e disa prej këtyre sunduesve të së shkuarës mund të shihet akoma në pjesë të Izraelit dhe Palestinës, ndonëse arkeologjia vendase i jep përparësi trashëgimisë romake dhe asaj hebreje, ndaj trashëgimia e memlukëve dhe selxhukëve, atyre dinastive islame mesjetare pjellore dhe të lulëzuara, nuk është gërmuar akoma.

Akoma më e rëndësishme për kuptimin e Izraelit dhe Palestinës bashkëkohore është periudha osmane, duke filluar me pushtimin e tyre të vitit 1517. Osmanët qëndruan atje për 400 vjet dhe trashëgimia e tyre ndjehet akoma edhe sot në shumë aspekte. Sistemi ligjor i Izraelit, regjistrat e gjykatës fetare (sixhil-li), regjistri i tokës (tapu) dhe disa kryevepra arkitekturore dëshmojnë që të gjitha për rëndësinë e pranisë osmane. Kur osmanët mbërritën, ata gjetën një shoqëri që ishte kryesisht muslimane sunite dhe rurale, por me elita të vogla urbane që flisnin arabisht. Më pak se 5% e popullsisë ishte hebreje dhe 10-15% ishte e krishterë. Siç komenton Xhonatan Mendel (Jonathan Mendel):

"Përqindja e saktë e hebrenjve përpara shfaqjes së sionizmit nuk dihet. Megjithatë, ka gjasa të vërtitej nga 2-5%. Sipas defterëve osmanë, në atë që sot është Izraeli/Palestina, në vitin 1878 banonte një popullsi e përgjithshme prej 462.465 personash. Nga ky numër, 403.795 (87%) ishin muslimanë, 43.659 (10%) ishin të krishterë dhe 15.011 (3%) ishin hebrenj.[1]*"*

Bashkësitë hebreje nëpër botë e shikonin Palestinën në atë kohë si vendin e shenjtë të Biblës. Pelegrinazhi në hebraizëm nuk ka të njëjtin rol që ai ka në fenë e krishterë dhe atë islame, por megjithatë, disa hebrenj e shohin atë si detyrë dhe në numër të vogël, e vizitojnë vendin si pelegrinë. Siç do të tregohet në një nga kapitujt e librit, përpara shfaqjes së sionizmit ishin kryesisht të krishterët ata që dëshironin, për arsye kishtare, t'i ngulitnin hebrenjtë në Palestinë në mënyrë të përhershme.

Ju nuk mund ta mësoni dot se kjo ishte Palestina në 400 vitet e sundimit osman nga vizita në faqen zyrtare në internet të ministrisë së jashtme izraelite, që flet për historinë e Palestinës që nga shekulli XVI:

[1] Jonathan Mendel, *The Creation of Israeli Arabic: Political and Security Considerations in the Making of Arabic Language Studies in Israel,* London: Palgrave Macmillan, 2014, fq. 188.

"Pas pushtimit osman në vitin 1517, Toka u nda në katër distrikte, të bashkëngjitura nga ana administrative me provincën e Damaskut dhe të sunduara nga Stambolli. Në fillim të epokës osmane, në vend jetonin rreth 1.000 familje, kryesisht në Jeruzalem, Nablus (Shehem), Hebron, Gaza, Safed (Cfat) dhe fshatrat e Galilesë. Bashkësia përbëhej nga pasardhësit e hebrenjve që kishin jetuar gjithmonë në vend, si dhe nga emigrantë nga Afrika e Veriut dhe Evropa.

Qeverisja e rregullt, deri në vdekjen e sulltan Sulejmanit të Madhërishëm (1566), solli përmirësime dhe nxiti emigrimin hebre. Disa të sapoardhur u ngulitën në Jeruzalem, por shumica shkoi në Safed, ku nga mesi i shekullit XVI, popullsia hebreje ishte rritur në rreth 10.000 dhe qyteti ishte bërë një qendër e lulëzuar e tekstilit.[2]"

Palestina e shekullit XVI na del se ishte kryesisht hebreje dhe se arteria kryesore komerciale e rajonit ishte e përqëndruar në bashkësitë hebreje në ato qytete. Po çfarë ndodhi më pas? Sipas faqes së ministrisë së jashtme:

"Me rënien graduale të cilësisë së sundimit osman, vendi vuajti nga lënia pas dore e përhapur gjërësisht. Nga fundi i shekullit XVIII, shumica e tokës ishte pronë e çifligarëve, që nuk ishin të pranishëm dhe ia jepnin me qira atë bujqve të varfëruar, ndërkohë që taksimi ishte po aq dëmtues, sa ç'ishte tekanjoz. Pyjet e mëdha të Galilesë dhe vargmalit Karmel u shpyllëzuan, ndërsa tokat bujqësore u kthyen në moçale dhe shkretëtirë."

Sipas kësaj historie, nga viti 1800 Palestina ishte bërë shkretëtirë, ku bujqit që nuk i përkitnin kësaj toke, kultivonin parcela që nuk ishte të tyret. Po kjo tokë paraqitet si një ishull me një popullsi të konsiderueshme hebreje, e sunduar që nga jashtë prej osmanëve dhe që vuante nga projektet intensive perandorake, të cilat po i rrëmbenin tokës pjellorinë e saj. Çdo vit që kalonte, toka bëhej më shterpë, shpyllëzimi rritej dhe tokat e punueshme shndërroheshin në shkretëtirë. E promovuar përmes një faqeje zyrtare shtetërore, kjo tabllo e fabrikuar është e paprecedent.

Është një ironi e hidhur që për përpilimin e këtij rrëfimi, autorët nuk u mbështetën në diturinë izraelite. Shumë dijetarë izraelitë do të ngurronin ta pranonin vlefshmërinë e këtyre deklarimeve apo mbështetjen e një rrëfimi të tillë. Disa prej tyre si David Grossman (demografi dhe jo autori i famshëm), Amnon Kohen dhe Jehushua Ben-Arieh, i kanë sfiduar me sukses ato. Hulumtimet e tyre tregojnë që gjatë shekujve, Palestina, jo vetëm që nuk ka qenë një shkretëtirë, por ka qenë një shoqëri e lulëzuar arabe, me shumicë muslimane, kryesisht rurale, por me qendra urbane që vlonin nga jeta.

Pavarësisht kundërshtimit të këtij rrëfimi, ai akoma propagandohet nëpërmjet programeve mësimore izraelite, si edhe në media, nga dijetarë të një rangu të ulët, por me një ndikim të madh në sistemin arsimor.[3] Jashtë Izraelit, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara, supozimi se toka e premtuar ishte bosh, e shkretë dhe shterpë përpara mbërritjes së sionizmit është akoma i gjallë dhe aktiv, ndaj ja vlen të ndiqet.

Duhet të shqyrtojmë faktet. Rrëfimi i kundërt historik na zbulon një histori të ndryshme, në të cilin Palestina gjatë sundimit osman ishte një shoqëri si të gjitha shoqëritë e tjera arabe përreth saj. Ajo nuk ndryshonte aspak nga të gjitha vendet e tjera të Mesdheut Lindor. Jo vetëm që nuk ishin të rrethuar dhe të izoluar, por populli palestinez ndërvepronte me kulturat e tjera, si pjesë e Perandorisë së gjërë Osmane.

[2] Nga faqja zyrtare në internet e Ministrisë së Punëve të Jashtme në mfa.gov.il

[3] Një shembull i mirë i kësaj është programi aktual i shkollave të mesme për historinë osmane të Jeruzalemit, që mund të gjendet në cms.education.gov.il

Së dyti, duke qenë e hapur ndaj ndryshimit dhe modernizimit, Palestina filloi të zhvillohej si komb shumë kohë përpara mbërritjes së lëvizjes sioniste. Në duart e sunduesve energjikë vendas si Dahir El-Umer (1690-1775), qytetet e Hajfas, Shefamrit, Taberijes dhe Akkas u ripërtërinë dhe u rigjallëruan. Rrjeti bregdetar i porteve dhe qyteteve lulëzoi nga lidhjet e tij tregtare me Evropën, ndërsa zonat e brendshme bënin tregti me rajonet fqinjë. Krejt e kundërt me shkretëtirën, Palestina ishte një pjesë e lulëzuar e Biladush-Sham (Vendeve të Shamit) ose Orientit të asaj kohe. Në të njëjtën kohë, një industri e pasur bujqësore, qytetet e vegjël dhe qytetet historikë i shërbenin një popullsie prej gjysëm milioni në prag të mbërritjes së sionizmit.[4]

Në fund të shekullit XIX, kjo ishte një popullsi e konsiderueshme, nga e cila, siç përmendëm më lart, vetëm një përqindje e vogël ishte hebreje. Vihet re se kjo pakicë, në atë kohë, i kundërshtonte idetë e promovuara nga lëvizja sioniste. Shumica e palestinezëve jetonin në fshat, të cilët numëronin rreth 1.000. Ndërkohë, një elitë e lulëzuar urbane ishte ngulitur përgjatë bregdetit, në rrafshnaltat e brendshme dhe në male.

Tani kemi krijuar një kuptim më të mirë të mënyrës se si njerëzit që jetonin atje e përcaktonin vetveten në prag të kolonizimit sionist të vendit. Si kudo në Lindjen e Mesme dhe më tej, shoqëria palestineze u njoh me konceptin më të fuqishëm përcaktues të shekujve XIX dhe XX: kombin. Ishin dinamika vendase dhe të jashtme ato që nxitën këtë mënyrë të re të vetëreferimit, siç ndodhi kudo nëpër botë. Idetë nacionaliste u importuan në Lindjen e Mesme pjesërisht nga misionarët amerikanë, që mbërritën në fillim të shekullit XIX, si me dëshirën për prozelitizëm, ashtu edhe me dëshirën për të përhapur nocionet e reja të vetëvendosjes. Si amerikanë, ata e ndjenin se përfaqësonin jo vetëm fenë e krishterë, por gjithashtu edhe shtetin më të ri të pavarur në hartën e botës. Elita e arsimuar në Palestinë iu bashkua të tjerëve në botën arabe në absorbimin e këtyre ideve dhe formulimin e një doktrine autentike kombëtare, që i çoi ata të kërkonin më shumë autonomi të brendshme dhe në fund, pavarësinë nga Perandoria Osmane.

Nga fundi i shekullit XIX, elita intelektuale dhe politike osmane adoptoi ide nacionaliste romantike që barazonin osmanizmin me turqizmin. Kjo prirje kontribuoi në ftohjen e nënshtetasve joturq, shumë prej tyre arabë, me Perandorinë Osmane. Vetë në Turqi, procesi i nacionalizimit u shoqërua me prirje sekularizuese në gjysmën e dytë të shekullit XIX, gjë që e zvogëloi rëndësinë e Stambollit si autoritet dhe fokus fetar.

Edhe në botën arabe, sekularizimi ishte pjesë e nacionalizimit. Nuk duhet të habitemi që ishin kryesisht pakicat si të krishterët, ata që e përqafuan fort idenë e një identiteti kombëtar sekular të bazuar në një territor, gjuhë, histori dhe kulturë të përbashkët. Në Palestinë, të krishterët që u angazhuan me nacionalizmin, gjetën aleatë të zellshëm mes elitës muslimane, gjë që çoi në lulëzimin e shoqatave muslimano-kristiane në të gjithë Palestinën nga fundi i Luftës së Parë Botërore. Në botën arabe, hebrenjtë u futën në këto lloj aleancash ndërmjet veprimtarëve nga fe të ndryshme. E njëjta gjë do të kishte ndodhur edhe në Palestinë, sikur sionizmi të mos kishte kërkuar besnikëri absolute nga bashkësia e vjetër hebreje atje.

Një studim i plotë dhe gjithëpërfshirës se si nacionalizmi palestinez u shfaq përpara mbërritjes së sionizmit mund të gjendet në veprat e historianëve palestinezë si Muhammed Muslih dhe Rashid Halidi.[5] Ato

[4] Për një studim të fokusuar të lidhjeve të tilla tregtare shih Beshara Doumani, *Rediscovering Palestine: Merchants and Peasants in Jabal Nablus, 1700–1900*, Berkeley: University of California Press, 1995

[5] Rashid Khalidi, *Palestinian Identity: The Construction of Modern National Consciousness*, New York: Columbia University Press, 2010, and Muhammad Muslih, *The Origins of Palestinian Nationalism*, Institute for Palestine Studies, 1989.

tregojnë qartë se pjesët elitare dhe joelitare të shoqërisë palestineze u përfshinë në zhvillimin e një lëvizjeje dhe ndjenje kombëtare që në vitin 1882. Veçanërisht Halidi tregon se si ndjenjat patriotike, besnikëritë vendase, arabizmi, ndjenjat fetare dhe nivelet e larta të edukimit dhe shkollimit ishin përbërësit kryesorë të nacionalizmit të ri dhe se si vetëm vonë rezistenca ndaj sionizmit luajti një rol kryesor shtesë në përcaktimin e nacionalizmit palestinez.

Halidi, mes të tjerash, tregon se si modernizimi, rënia e Perandorisë Osmane dhe grykësia evropiane për territore në Lindjen e Mesme kontribuoi në solidifikimin e nacionalizmit palestinez përpara se sionizmi të linte gjurmë në Palestinë me premtimin britanik për një atdhe hebre në vitin 1917. Një nga shfaqjet më të qarta të këtij vetëpërcaktimi ishte referimi i tokës së Palestinës si entitet gjeografik dhe kulturor, dhe më vonë, politik. Ndonëse nuk kishte një shtet palestinez, vendndodhja kulturore e Palestinës ishte shumë e qartë. Ekzistonte një ndjenjë njësuese e përkatësisë. Që në fillim të shekullit XX, gazeta *"Filistin"* pasqyronte mënyrën se si populli e quante vendin e tij.[6] Palestinezët flisnin në dialektin e tyre, kishin zakonet dhe ritualet e tyre dhe u shfaqën në hartën e botës si banorë të një vendi të quajtur Palestinë.

Gjatë shekullit XIX, Palestina, ashtu si vendet fqinjë të saj, u përcaktua edhe më qartë si një njësi gjeopolitike në prag të reformave administrative të filluara nga Stambolli, kryeqyteti i Perandorisë Osmane. Për pasojë, elita vendase palestineze filloi të kërkojë pavarësi brenda një Sirie të bashkuar ose edhe një shteti të bashkuar arab, diçka e ngjashme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo shtysë kombëtare panarabe u quajt në arabisht *"kaumijjeh"* dhe ishte popullore në Palestinë dhe pjesën tjetër të botës arabe.

Pas së famshmes ose më mirë, ogurzezës marrëveshje Sajks-Piko (Sykes-Picot), të nënshkruar në vitin 1916 mes Britanisë dhe Francës, dy fuqitë koloniale e ndanë rajonin në shtete të reja kombëtare. Me ndarjen e rajonit, u zhvillua një ndjenjë e re: një lloj më vendas i nacionalizmit, i quajtur në arabisht *"vatanijjeh"*. Si rezultat, Palestina filloi ta shihte veten si një shtet të pavarur arab. Pa shfaqjen e sionizmit në pragun e derës, Palestina mund të kishte ndjekur të njëjtën rrugë si Libani, Jordania apo Siria dhe mund të kishte zgjedhur një proces modernizimi dhe rritjeje.[7] Në të vërtetë, kjo tashmë kishte filluar në vitin 1916, si rezultat i politikave osmane në fund të shekullit XIX. Në vitin 1872, kur qeveria e Stambollit themeloi Sanxhakun (njësi administrative) e Jeruzalemit, ata krijuan një hapësirë gjeopolitike të lidhur në Palestinë. Për një çast të shkurtër, autoritetet në Stamboll luajtën me mundësinë e zmadhimit të sanxhakut, i cili përfshinte shumicën e Palestinës që njohim sot, si dhe nënprovincat e Nablusit dhe Akkas. Sikur ta kishin bërë, osmanët do të kishin krijuar një njësi gjeografike, siç ndodhi në Egjipt, në të cilën një nacionalizëm i veçantë mund të kishte dalë më herët.[8]

Megjithatë, edhe me ndarjen e saj administrative në veri, të qeverisur nga Bejruti, dhe jug, të qeverisur nga Jeruzalemi, kjo ndarje e ngriti krejt Palestinën mbi statusin e saj të mëparshëm periferik, kur kishte qenë e ndarë në nënprovinca të vogla rajonale. Në vitin 1918, me fillimin e sundimit britanik, ndarjet e veriut dhe jugut u unifikuan. Në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtin vit, britanikët vendosën bazat për Irakun e sotëm, kur shkrinë tre provincat osmane të Mosulit, Bagdadit dhe Basrës në një shtet modern kombëtar. Në Palestinë, ndryshe nga Iraku, lidhjet familjare dhe kufinjtë gjeografikë (lumi Litani në veri,

[6] Për të mësuar më shumë për gazetën dhe rolin e saj në lëvizjen kombëtare, shih Rashid Khalidi, *Palestinian Identity*.
[7] Modernizimi alternativ i mundshëm i Palestinës është diskutuar shkëlqyeshëm në përmbledhjen e artikujve të Salim Tamari, *The Mountain Against the Sea: Essays on Palestinian Society and Culture*, Berkeley: University of California Press, 2008.
[8] Shih: Butrus Abu-Manneh, "The Rise of the Sanjaq of Jerusalem in the Nineteenth Century," in Ilan Pappe (ed.), *The Israel/Palestine Question*, London and New York: Routledge, 2007, fq. 40–50.

lumi Jordan në lindje dhe Deti Mesdhe në perëndim) punuan së bashku për të shkrirë tre nënprovincat e Bejrutit Jugor, Nablusit dhe Jeruzalemit në një njësi shoqërore dhe kulturore. Kjo hapësirë gjeopolitike kishte dialektin e saj kryesor, si dhe zakonet, folklorin dhe traditat e saj.[9]

Nga viti 1918, Palestina ishte më e bashkuar se në periudhën osmane, por do të përjetonte ndryshime të mëtejshme. Ndërkohë që pritej miratimi përfundimtar ndërkombëtar i statusit të Palestinës në vitin 1923, qeveria britanike rinegocioi kufinjtë e vendit, krijoi një hapësirë gjeografike të përcaktuar më mirë për të cilën të luftonin mes tyre lëvizjet kombëtare dhe një ndjenjë më të qartë përkatësie për popullin që jetonte në të. Tani ishte e qartë se çfarë ishte Palestina. Ajo që ishte e paqartë ishte se kujt i përkiste: palestinezëve vendas apo kolonistëve të rinj hebrenj? Ironia e fundit e këtij regjimi administrativ ishte që riformatimi i kufinjve ndihmoi lëvizjen sioniste për të konceptuar gjeografikisht "Erec Izraelin", Tokën e Izraelit, ku vetëm hebrenjtë kishin të drejta mbi tokën dhe burimet e saj.

Pra, Palestina nuk ishte një vend bosh. Ajo ishte pjesë e një bote të pasur dhe pjellore mesdhetare lindore, e cila në shekullin XIX, kaloi nëpër proceset e modernizimit dhe nacionalizimit. Ajo nuk ishte një shkretëtirë që po priste të lulëzonte, por një vend bujqësor në prag të hyrjes në shekullin XX si një shoqëri moderne, me të gjitha të mirat dhe të këqijat e një transformimi të tillë. Kolonizimi i saj nga lëvizja sioniste e shndërroi këtë proces në një fatkeqësi për shumicën e popullsisë vendase që jetonte atje.

[9] Për një analizë më të hollësishme, shih Ilan Pappe, *A History of Modern Palestine: One Land, Two Peoples*, Cambridge: Cambridge University Press, 2006, fq. 14–60.

KREU II

HEBRENJTË ISHIN NJË POPULL PA TOKË

Pretendimi në kreun e mëparshëm, se Palestina ishte një vend pa popull, shkon krah për krah me pretendimin se hebrenjtë ishin një popull pa tokë. Po a ishin kolonistët hebrenj një popull? Studimet e fundit kanë përsëritur dyshimet e shprehura shumë vite më parë në lidhje me këtë. Tema e përbashkët e këtij këndvështrimi kritik përmblidhet më së miri në veprën e Shlomo Sandit: *Shpikja e popullit hebre.*[10] Sandi tregon se bota e krishterë, për interesin e saj dhe në një çast të caktuar në historinë moderne, mbështeti idenë e hebrenjve si një komb që duhej të rikthehej një ditë në tokën e shenjtë. Në këtë rrëfim, ky rikthim do të ishte pjesë e skemës hyjnore të fundit të botës, së bashku me ringjalljen e të vdekurve dhe ardhjen e dytë të Mesias.

Përmbysjet teologjike dhe fetare të Reformimit, nga shekulli XVI dhe në vazhdim, prodhuan një shoqërim të qartë, veçanërisht mes protestantëve, mes nocionit të fundit të mijëvjeçarit dhe konvertimit të hebrenjve dhe kthimit të tyre në Palestinë. Tomas Brajtmen (Thomas Brightman), një klerik anglez i shekullit XVI, i paraqiti këto nocione, kur shkroi: *"A do të kthehen ata përsëri në Jeruzalem? Nuk ka asgjë më të sigurtë: profetët e konfirmojnë këtë kudo dhe e rikonfirmojnë."*[11] Brajtmeni nuk shpresonte vetëm që premtimi hyjnor të përmbushej, por, si shumë të tjerë pas tij, ai dëshironte që hebrenjtë, ose të konvertoheshin në të krishterë, ose të largoheshin që të gjithë nga Evropa. Njëqind vjet më pas, Henri Oldenburg (Henry Oldenburg), një teolog dhe filozof natyror gjerman, shkruante: *"Nëse rasti paraqitet mes ndryshimesh, për të cilët janë përgjegjës punët e njeriut, (hebrenjtë) mund edhe të ngrenë perandorinë e tyre përsëri dhe.... Zoti mund të zgjedhë për ta një herë të dytë."*[12] Karl-Jozef fon Lign (Charles-Joseph von Lign), një feldmareshall austro-hungarez, deklaronte në gjysmën e dytë të shekullit XVIII:

"Unë besoj se hebreu nuk është në gjendje të asimilohet dhe se vazhdimisht do të përbëjë një komb brenda kombit, kudo që të ndodhet. Për mendimin tim, gjëja më e thjeshtë që duhet bërë është rikthimi i tyre në atdheun e tyre, nga i cili janë dëbuar."[13]

Nga ky tekst, shfaqet qartë se ka një lidhje mes këtyre ideve formuese të sionizmit dhe një antisemitizmi të kahershëm. Fransua-René dë Shatobrian (Francois-Rene de Chateaubriand), shkrimtari dhe politikani i famshëm francez, shkruante gati në të njëjtën kohë se hebrenjtë ishin *"të zotët e ligjshëm të Judesë"*. Ai ndikoi tek Napoleon Bonaparti, i cili shpresonte të fitonte përkrahjen e bashkësisë hebreje në Palestinë, si dhe të banorëve të tjerë të vendit, në përpjekjet e tij për të pushtuar Lindjen e Mesme në fillimin e shekullit XIX. Ai ju premtoi atyre "kthimin në Palestinë" dhe krijimin e një shteti.[14] Pra, siç mund të shohim, sionizmi ishte një projekt kolonizimi i krishterë përpara se të ishte projekt hebre.

Shenjat ogurzeza se si këto besime, në dukje fetare dhe mitike, mund të ktheheshin në një program të

[10] Shlomo Sand, *The Invention of the Jewish People*, London and New York: Verso, 2010.
[11] Thomas Brightman, *The Revelation of St. John Illustrated with an Analysis and Scholions [sic]*, 4th edn, London, 1644, fq. 544.
[12] Nga një letër që ai i shkruante Spinozës më 4 dhjetor 1665, cituar në Franz Kobler, *The Vision was There: The History of the British Movement for the Restoration of the Jews to Palestine,* London: Birt Am Publications, 1956, fq. 25–6.
[13] Hagai Baruch, *Le Sionisme Politique: Precurseurs et Militants: Le Prince De Ligne,* Paris: Beresnik, 1920, fq. 20.
[14] Suja R. Sawafta, *"Mapping the Middle East: From Bonaparte's Egypt to Chateaubriand's Palestine,"* PhD thesis submitted to the University of North Carolina at Chapel Hill, 2013.

vërtetë kolonizimi dhe shpronësimi, u shfaqën në Britaninë viktoriane që në vitet 1820. Një lëvizje e fuqishme teologjike dhe perandorake u shfaq, e cila do ta vendoste kthimin e hebrenjve në Palestinë në zemër të një plani strategjik për të shtënë në dorë Palestinën dhe për ta shndërruar atë në një entitet të krishterë. Në shekullin XIX, kjo ndjenjë u bë gjithnjë e më popullore në Britani dhe ndikoi në politikën zyrtare perandorake. *"Dheu i Palestinës..... pret kthimin e fëmijëve të tij të dëbuar dhe përdorimin e industrisë, konform mundësive bujqësore, për të shpërthyer përsëri në begati dhe për të qenë përsëri ajo që ka qenë në ditët e Solomonit."*[15]

Kështu shkruante fisniku dhe komandanti ushtarak skocez Xhon Lindsej (John Lindsay). Kësaj ndjenje ju bë jehonë nga Dejvid Hartli (David Hartley), një filozof anglez, i cili shkruante: *"Ka mundësi që hebrenjtë do të rikthehen në Palestinë."*[16]

Procesi nuk qe plotësisht i suksesshëm deri në çastin kur mori mbështetjen e Shteteve të Bashkuara. Edhe këtu kishte një histori të sanksionimit të idesë së një kombi hebre, që kishte të drejtë të rikthehej në Palestinë dhe të ndërtonte një Sion. Në të njëjtën kohë që protestantët në Evropë artikulonin këto pikëpamje, ata u shfaqën në një formë të ngjashme edhe përtej Atlantikut. Presidenti amerikan Xhon Adams (John Adams) (1735-1826) deklaronte: *"Unë dëshiroj me gjithë zemër që hebrenjtë të rikthehen përsëri në Jude si një komb i pavarur."*[17] Një histori e thjeshtë idesh të çon drejpërdrejt nga etërit predikues të kësaj lëvizjeje tek ata me pushtet për të ndryshuar fatet e Palestinës. Më i spikaturi prej tyre ishte lordi Shaftesberi (Shaftesbury) (1801-85), një politikan dhe reformator i shquar britanik, i cili bëri një fushatë aktive për një atdhe hebre në Palestinë. Argumentat e tij për një prani më të madhe britanike në Palestinë ishin si fetare, ashtu edhe strategjike.[18]

Siç do ta tregoj tani, kjo përzierje e rrezikshme e afshit fetar dhe zellit reformist, do të çonte nga përpjekjet e Shaftesberit në mesin e shekullit XIX në Deklaratën e Balfurit në 1917. Shaftesberi e kuptoi se nuk mjaftonte vetëm mbështetja e rikthimit të hebrenjve, por ata duhet të ndihmoheshin aktivisht nga Britania në fillimin e kolonizimit të tyre. Ai pohonte se një aleancë e tillë duhej të fillonte duke u dhënë një ndihmë materiale hebrenjve për të udhëtuar në Palestinën osmane. Ai e bindi qendrën peshkopale anglikane dhe katedralen në Jeruzalem që të siguronin financimin fillestar për këtë projekt. Ndoshta kjo nuk do të kishte ndodhur aspak sikur Shaftesberi të mos kishte rekrutuar vjehrrin e tij, ministrin e jashtëm britanik dhe më vonë kryeministrin, lordin Palmerston, për këtë kauzë. Në ditarin e tij, më 1 gusht 1838, Shaftesberi shkruante:

"Darkova me Palmerstonin. Pas darkës qëndrova vetëm me të. Propozova planet e mia, të cilat ngjallën kureshtjen e tij. Më bëri pyetje dhe u tregua i gatshëm që ta merrte atë parasysh (programin e ndihmimit të hebrenjve për t'u kthyer në Palestinë dhe shtënien e saj në dorë). Sa i çuditshëm që është rregulli i Perëndisë! I çuditshëm, nëse e krahason me mënyrat e njerëzve. Palmerstoni ishte zgjedhur tashmë nga Zoti për të qenë një instrument i së mirës për popullin e Tij të lashtë, për të respektuar trashëgiminë e tyre dhe për të njohur të drejtat e tyre pa menduar për fatin e tyre. Duket se ai do të bëjë akoma më shumë. Ndonëse motivi është i mirë, ai nuk është i shëndoshë. Jam i detyruar të argumentoj politikisht,

[15] A. W. C. Crawford, *Lord Lindsay, Letters on Egypt, Edom and the Holy Land*, Vol. 2, London, 1847, fq. 71.
[16] Cituar nga Anthony Julius, *Trials of the Diaspora: A History of Anti-Semitism in England*, Oxford: Oxford University Press, 2010, fq. 432.
[17] *"Jews in America: President John Adams Embraces a Jewish Homeland"* (1819), at jewishvirtuallibrary.org.
[18] Donald Lewis, *The Origins of Christian Zionism: Lord Shaftesbury and Evangelical Support for a Jewish Homeland,* Cambridge: Cambridge University Press, 2014, fq. 380.

financiarisht, komercialisht. Ai nuk loton, si Zoti i tij, për Jeruzalemin, dhe as lutet që tani, më në fund, ajo mund të veshë rrobat e saj të bukura."[19]

Si hap të parë, Shaftesberi e bindi Palmerstonin të caktonte shokun e tij rikthyes (besimtar në rikthimin e Palestinës tek hebrenjtë) Uilliam Jang (William Young), si nënkonsullin e parë britanik në Jeruzalem. Pas kësaj, ai shkroi në ditarin e tij: *"Çfarë ngjarje e këndshme që është! Qyteti i lashtë i popullit të Zotit po bëhet gati të marrë vendin e tij në mesin e kombeve dhe Anglia e para e mbretërive johebreje që ndalon "së shkeluri atë."*[20] Një vit më vonë, më 1839, Shaftesberi shkroi një artikull prej 30 faqesh për *"The London Quarterly Review"*, të titulluar *"Shteti dhe restaurimi i hebrenjve,"* në të cilin parashikonte një erë të re për popullin e zgjedhur të Zotit. Ai këmbëngulte që:

"Hebrenjtë duhen inkurajuar që të rikthehen në numra gjithnjë e më të mëdhenj dhe të bëhen përsëri burri i Judesë dhe Galilesë... ndonëse padyshim një popull kokëfortë, zemërzi dhe i zhytur në shthurje morale, shpirtngushtësi dhe mosnjohje të Ungjillit, ata, jo vetëm që ja vlen të shpëtohen, por edhe janë jetikë për shpresën e shpëtimit të krishtërimit."[21]

Lobimi i ëmbël i Shaftesberit tek Palmerstoni rezultoi i suksesshëm. Më shumë për shkaqe politike se sa fetare, edhe Palmerstoni u bë një mbështetës i rikthimit të hebrenjve në Palestinë. Mes faktorëve të tjerë që luajtën rol në vendimet e tij ishte edhe *"pikëpamja që hebrenjtë mund të ishin të dobishëm, duke ndihmuar në rrëzimin e Perandorisë Osmane dhe duke arritur kështu në realizimin e objektivit kyç të politikës së jashtme britanike në atë rajon."*[22]

Palmerstoni i shkroi ambasadorit britanik në Stamboll më 11 gusht 1840, në lidhje me përfitimet e dyanshme të osmanëve dhe britanikëve nga lejimi i hebrenjve për t'u rikthyer në Palestinë. Për ironi, rikthimi i hebrenjve shihej si një mjet i rëndësishëm për ruajtjen e status-kuosë dhe shmangien e shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Palmerstoni shkruante:

"Sot, në mesin e hebrenjve të shpërndarë nëpër Evropë, ekziston një ndjenjë e fuqishme, se po vjen koha që kombi i tyre të rikthehet në Palestinë... Do të ishte në interesin e sulltanit që të inkurajonte hebrenjtë për t'u rikthyer dhe ngulitur në Palestinë, sepse pasuria që ata do të sjellin me vete do të rrisë burimet në zotërimet e sulltanit dhe nëse populli hebre kthehet nën mbrojtjen dhe ftesën e sulltanit, kjo do të frenojë çdo plan të ardhshëm djallëzor të Mehmet Aliut ose pasardhësit të tij... Më duhet ta udhëzoj Shkëlqesinë Tuaj që t'ia rekomandojë fuqimisht (qeverisë osmane) që t'i japë inkurajimin e duhur hebrenjve të Evropës për t'u kthyer në Palestinë."[23]

Mehmet Aliu, që njihet më shumë si Muhammed Aliu, ishte guvernatori i Egjiptit, i cili u shkëput nga Perandoria Osmane në gjysmën e parë të shekullit XIX. Kur Palmerstoni i shkroi këtë letër ambasadorit të tij në Stamboll, kishte kaluar një dekadë që nga koha kur sundimtari egjiptian për pak sa nuk përmbysi vetë sulltanin. Ideja që pasuria hebreje e eksportuar në Palestinë do ta forconte Perandorinë Osmane kundër

[19] Anthony Ashley, *Earl of Shaftesbury,* faqet e ditarit siç citohen nga Edwin Hodder, *The Life and work of the Seventh Earl of Shaftesbury,* London, 1886, Vol. 1, fq. 310–11; shih gjithashtu Geoffrey B. A. M. Finlayson, *The Seventh Earl of Shaftesbury,* London: Eyre Methuen, 1981, fq. 114; The National Register Archives, London, Shaftesbury (Broadlands) MSS, SHA/PD/2, August 1, 1840.

[20] Citohet në Gertrude Himmelfarb, *The People of the Book: Philosemitism in England, From Cromwell to Churchill,* New York: Encounter Books, 2011, fq. 119.

[21] *The London Quaterly Review,* Vol. 64, fq. 104–5.

[22] Po aty.

[23] Po aty.

armiqve të saj të jashtëm dhe të brendshëm, konfirmon se sionizmi u shoqërua me antisemitizëm, imperializëm britanik dhe teologji.

Pak ditë pasi Palmerstoni e dërgoi letrën, një kryeartikull në "The Times" bëri thirrje për një plan *"për t'i vendosur hebrenjtë në tokën e baballarëve të tyre"*, duke deklaruar se kjo po merrej *"nën një shqyrtim serioz politik"* dhe duke lavdëruar përpjekjet e Shaftesberit si autor i planit, i cili, sipas tij, ishte *"praktik dhe i zgjuar."*[24]

Edhe zonja Palmerston e mbështeti qëndrimin e të shoqit. Ajo i shkruante një miku: *"Në anën tonë kemi elementët fanatikë dhe fetarë, dhe ju e dini mirë se sa pasues kanë ata në këtë vend. Ata janë absolutisht të vendosur që Jeruzalemi dhe e gjithë Palestina duhet t'iu rezervohen hebrenjve për t'u rikthyer aty. Kjo është dëshira e tyre e vetme: rikthimi i hebrenjve."* [25] Kështu konti i Shaftesberit përshkruhej si: *"Kryepropozuesi i sionizmit të krishterë në shekullin XIX dhe politikani i parë i spikatur që provoi t'i hapë rrugën hebrenjve për të ngritur një atdhe në Palestinë."*[26]

Ky moment i entuziazmit të establishmentit britanik ndaj idesë së rikthimit duhet të përshkruhet më saktë si protosionizëm. Ndërsa duhet të jemi të kujdesshëm në lidhje me leximin e brendshëm të ideologjisë bashkëkohore në këtë dukuri të shekullit XIX, duhet të jemi të vetëdijshëm që ajo i kishte të gjithë përbërësit që do t'i shndërronin këto ide në të ardhmen në justifikime për heqjen dhe mohimin e të drejtave themelore të popullsisë vendase palestineze. Natyrisht që pati kisha dhe klerikë që u identifikuan me vendasit palestinezë. Ndër ta spikat Xhorxh Frensis Pophëm Blith (George Francis Popham Blyth), një klerik i Kishës së Anglisë, që bashkë me disa kolegë anglikanë të rangut të lartë, shprehën simpati të thellë për aspiratat dhe të drejtat e palestinezëve. Më 1887, Blith themeloi Kolegjin e Shën Gjergjit, i cili edhe sot është një nga shkollat më të mira në Jeruzalemin Lindor, në të cilin studiuan fëmijët e elitës vendase, që do të luanin një rol vendimtar në politikën palestineze të gjysmës së parë të shekullit XX. Megjithatë, pushtetin e patën ata që mbështetën kauzën hebreje, e cila më vonë do të bëhej kauza sioniste.

Konsullata e parë britanike në Jeruzalem u hap në vitin 1838. Detyra e saj përfshinte inkurajimin jozyrtar të hebrenjve për të ardhur në Palestinë, duke ju premtuar mbrojtje dhe në disa raste, duke u përpjekur që t'i konvertonte ata në të krishterë. Më i njohuri i konsujve të parë ishte Xhejms Fin (James Finn) (1806-1872), karakteri dhe qasja e tij e drejtpërdrejtë e bënë të pamundur që ta fshihte implikimin e tij nga palestinezët vendas. Ai shkruante haptas dhe ndoshta ishte i vetmi që veproi kështu, për lidhjen që ekzistonte mes rikthimit të hebrenjve në Palestinë dhe zhvendosjes së palestinezëve, si rezultat i këtij veprimi.[27] Kjo lidhje do të ishte në zemër të projektit kolonial dhe kolonizues sionist në shekullin tjetër.

Fini qëndroi në Jeruzalem mes viteve 1845-1863. Ai është lavdëruar nga historianët e mëvonshëm izraelitë për ndihmën që ju dha hebrenjve për t'u ngulitur në atdheun e tyre stërgjyshor dhe kujtimet e tij janë përkthyer në hebraisht. Ai nuk është e vetmja figurë historike që shfaqet në panteonin e një kombi dhe në galerinë e maskarenjve të kombit tjetër. Fini e urrente Islamin në tërësi dhe parinë e Jeruzalemit në veçanti. Ai nuk mësoi kurrë të fliste arabisht dhe komunikonte nëpërmjet një përkthyesi, gjë që nuk bëri asgjë për

[24] *The Times of London*, 17 gusht 1840
[25] Cituar nga Geoffrey Lewis, *Balfour and Weizmann: The Zionist, The Zealot and the Emergence of Israel*, London: Continuum books, 2009, fq. 19.
[26] Deborah J. Schmidle, *"Anthony Ashley-Cooper, Seventh Earl of Shaftsbury,"* in Hugh D. Hindman (ed.), *The World of Child Labour: An Historical and Regional Survey,* London and New York: M. E. Sharpe, 2009, fq. 569.
[27] Unë e kam zhvilluar këtë ide në librin tim, *The Rise and Fall of a Palestinian Dynasty: The Husaynis, 1700–1948,* London: Saqi Books, 2010, fq. 84, 117.

të zbutur marrëdhëniet e tij me popullsinë vendase palestineze.

Fini u ndihmua nga përurimi i peshkopatës anglikane në Jeruzalem në vitin 1841, e kryesuar nga Majkëll Solomon Aleksander (Michael Solomon Alexander), një hebre i konvertuar, dhe përurimi i Kishës së Krishtit, kisha e parë anglikane, pranë portës së Jafës, në Jeruzalem, në vitin 1843. Ndonëse këto institucione më vonë zhvilluan një afërsi të fuqishme me të drejtën palestineze të vetëvendosjes, në atë kohë ato mbështetën aspiratat protosioniste të Finit. Fini punoi me më shumë zell se sa çdo evropian tjetër për të ngritur një prani të përhershme perëndimore në Jeruzalem, duke organizuar blerjen e tokave dhe pronave të patundshme për misionarë, interesa tregtare dhe institucione qeveritare.

Një fill i rëndësishëm që lidh këto sythe të hershme sioniste të krishtera, kryesisht britanike, me sionizmin ishte lëvizja gjermane e Tempullarëve të Devotshëm, të njohur më vonë si Tempullarët, aktive në Palestinë nga vitet 1860 deri në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore. Kjo lëvizje doli nga lëvizja luterane në Gjermani, që u përhap kudo në botë, duke përfshirë Amerikën e Veriut, ku ndikimi i saj në fazën e hershme të kolonizimit ndjehet edhe sot e kësaj dite. Interesi i saj për Palestinën evoluoi rreth viteve 1860. Dy klerikë gjermanë, Kristof Hofman (Christoph Hoffman) dhe Georg David Hardeg (Georg David Hardegg), themeluan në vitin 1861 Shoqërinë e Tempullit. Ata kishin lidhje të forta me lëvizjen e të Devotshmëve në Vyrtemburg, Gjermani, por zhvilluan idetë e tyre se si mund të avanconin versionin e tyre të krishtërimit. Për ta, rindërtimi i një tempulli hebre në Jeruzalem ishte një hap thelbësor në planin hyjnor për shlyerjen dhe faljen e mëkateve. Ç'është më e rëndësishme, ata ishin të bindur se nëse vetë ata do të ngulitheshin në Palestinë, kjo gjë do të shkaktonte ardhjen e dytë të Mesisë.[28] Ndonëse jo çdokush në kishat dhe organizatat e tyre kombëtare e mirëpriti mënyrën e tyre të përkthimit të devocionit në kolonializëm në Palestinë, anëtarë të lartë të Oborrit Mbretëror të Prusisë dhe disa teologë anglikanë në Britani e mbështetën me entuziazëm dogmën e tyre.

Ndërkohë që lëvizja e Tempullit fitonte rëndësi, ajo filloi të përndiqej nga shumica e kishave të mëdha në Gjermani. Por ata i lëvizën idetë e tyre në një skenë më praktike dhe u ngulitën në Palestinë, duke luftuar gjatë rrugës me njëri-tjetrin, si dhe duke shtuar anëtarë të rinj. Ata themeluan koloninë e tyre të parë në malin Karmel në Hajfa më 1866 dhe u shtrinë në pjesë të tjera të vendit. Ngrohja e marrëdhënieve mes kajzer Vilhelmit II dhe sulltanit nga fundi i shekullit XIX e zmadhoi më tej projektin e tyre kolonizues. Tempullarët qëndruan në Palestinë nën Mandatin Britanik deri në vitin 1948, kur u dëbuan me shkelma nga shteti i ri hebre.

Kolonitë e Tempullarëve dhe metodat e tyre të kolonizimit u imituan nga sionistët e parë. Ndërsa historiani gjerman Aleksander Sholh (Alexander Scholch) i përshkruante përpjekjet kolonizuese të tempullarëve si "Kryqëzata e Heshtur", kolonitë e para sioniste të ngritura nga viti 1882 e në vazhdim nuk ishin aspak të heshtura.[29] Në kohën kur Tempullarët u ngulitën në Palestinë, sionizmi tashmë ishte bërë një lëvizje e spikatur politike në Evropë. Shkurtimisht, sionizmi ishte një lëvizje që deklaronte se problemet e hebrenjve të Evropës do të zgjidheshin nga kolonizimi i Palestinës dhe krijimi i një shteti hebre atje. Këto ide mbinë në vitet 1860 në disa vende të Evropës, të frymëzuara nga Iluminizmi, "Pranvera e Kombeve" e vitit 1848 dhe më pas, nga socializmi. Sionizmi u shndërrua nga një lëvizje intelektuale dhe kulturore në një projekt

[28] Helmut Glenk, *From Desert Sands to Golden Oranges: The History of the German Templers Settlement of Sarona in Palestine*, Toronto: Trafford, 2005, është një nga veprat e pakta në anglisht. Shumica e veprave mbi Tempullarët janë në gjermanisht ose hebraisht.

[29] Alexander Scholch, *Palestine in Transformation*, 1856–1882: Studies in Social, Economic, and Political Development, washington: Institute of Palestine Studies, 2006.

politik nëpërmjet vizioneve të Teodor Herclit (Theodor Herzl), në përgjigje të një vale jashtëzakonisht të turpshme të përndjekjeve antihebreje në Rusi, në fund të viteve 1870 dhe fillimin e viteve 1880, si dhe shfaqjes së nacionalizmit antisemit në Evropën Perëndimore, ku gjyqi i turpshëm i Drejfysit (Dreyfus) tregoi se sa rrënjë të thella kishte antisemitizmi në shoqëritë franceze dhe gjermane.

Përmes përpjekjeve të Herclit dhe udhëheqësve të tjerë hebrenj që mendonin si ai, sionizmi u bë një lëvizje ndërkombëtarisht e njohur. Në fillim të pavarur, një grup hebrenjsh lindorë zhvilluan nocione të ngjashme për zgjidhjen e çështjes hebreje në Evropë dhe nuk pritën për njohje ndërkombëtare. Ata filluan të nguliten në Palestinë në vitin 1882, pasi përgatitën terrenin, duke punuar së bashku në vendet e tyre të qëndrimit. Në zhargonin sionist, ata quhen "Alijah e Parë", vala e parë e emigrimit sionist që zgjati deri në vitin 1904. Vala e dytë (1905-1914) ishte e ndryshme, sepse përbëhej kryesisht nga komunistë dhe socialistë të pashpresë, të cilët e shihnin sionizmin, jo vetëm si një zgjidhje për problemin hebre, por edhe si mjet për përhapjen e komunizmit dhe socializmit nëpërmjet ngulimeve kolektive në Palestinë. Në të dyja valët, shumica preferonte që të ngulitej nëpër qytetet palestineze, me vetëm një numër të vogël që u përpoqën që të kultivonin tokën e blerë nga palestinezët dhe çifligarët arabë, duke u mbështetur fillimisht tek industrialistët hebrenj në Evropë, para se të kërkonin një ekzistencë më të pavarur ekonomike.

Ndërsa lidhja sioniste me Gjermaninë doli pa shumë vlerë, ajo me Britaninë u bë vendimtare. Në fakt, lëvizja sioniste kishte nevojë për mbështetje të fuqishme, sepse populli i Palestinës filloi ta kuptonte se kjo formë emigrimi nuk do të sillte asnjë të mirë për të ardhmen e tyre në vend. Udhëheqësit vendas e ndjenë se kjo gjë do të kishte një ndikim shumë negativ mbi shoqërinë e tyre. Një figurë e tillë ishte myftiu i Jeruzalemit, Tahir El-Husejni, i cili e lidhi emigrimin hebre në Jeruzalem me një sfidë evropiane që i bëhej shenjtërisë muslimane të qytetit. Disa prej parisë së tij e kishin pikasur se ishte ideja e Xhejms Finit që ta lidhte ardhjen e hebrenjve me rikthimin e lavdisë kryqtare. Ndaj nuk duhet të habitemi, që myftiu udhëhoqi kundërshtimin ndaj këtij emigrimi, duke e vendosur theksin mbi nevojën për të ndaluar shitjen e tokës për projekte të tilla. Ai e kuptonte që zotërimi i tokës përligjte pretendimet e pronësisë, ndërsa emigrimi pa ngulim mund të konceptohej si një pelegrinazh kalimtar.[30]

Kështu, në shumë mënyra, impulsi strategjik perandorak i Britanisë për të përdorur kthimin e hebrenjve në Palestinë si një mjet të thellimit të përfshirjes së Londrës në "Tokën e Shenjtë" përkoi me shfaqjen e vizioneve të reja kulturore dhe intelektuale të sionizmit në Evropë. Ndaj, si për të krishterët, ashtu edhe për hebrenjtë, kolonizimi i Palestinës shihej si një veprim kthimi dhe shlyerje. Koinçidenca e të dy impulseve prodhoi një aleancë të fuqishme, që e shndërroi idenë antisemite dhe mijëvjeçare të transferimit të hebrenjve nga Evropa në Palestinë në një projekt të vërtetë kolonizimi në kurriz të popullsisë vendase të Palestinës. Kjo aleancë u shfaq hapur me shpalljen e Deklaratës së Balfurit më 2 nëntor 1917, një letër që sekretari i jashtëm britanik i drejtoi bashkësisë anglo-hebreje, në të cilën në fakt ju premtonte mbështetje të plotë për krijimin e një atdheu hebre në Palestinë.

Falë mundësisë së hyrjes dhe strukturës efikase të arkivave britanike, sot kemi në dispozicion shumë vepra të shkëlqyera shkencore që eksplorojnë prapaskenat e kësaj deklarate. Ndër më të mirat vazhdon të mbetet një ese e vitit 1970 nga Majer Verte (Mayer Verte) i Universitetit Hebre në Jeruzalem.[31] Ai tregon në veçanti se si zyrtarët britanikë pohuan gabimisht se anëtarët hebrenj në lëvizjen bolshevike kishin aspirata të njëjta me sionistët, ndaj një deklaratë prosioniste do të shtronte rrugën për marrëdhënie të

[30] Pappé, *The Rise and Fall of a Palestinian Dynasty*, p. 115.
[31] Artikulli i Verte-s u ribotua si *"The Balfour Declaration and Its Makers"* in N. Rose (ed.), From Palmerston to Balfour: Collected Essays of Mayer Verte, London: Frank Cass, 1992, fq. 1–38.

mira me pushtetin e ri politik në Rusi. Për më tepër, këta politikëbërës mendonin se një gjest i tillë do të mirëpritej nga hebrenjtë amerikanë, për të cilët britanikët dyshonin se kishin një ndikim të madh në Uashington. Ekzistonte gjithashtu një përzierje milenarianizmi dhe islamofobie: Dejvid Llojd Xhorxh (David Lloyd George), kryeministri i asaj kohe dhe një i krishterë i devotshëm, përkrahte rikthimin e hebrenjve mbi baza fetare dhe nga ana strategjike, ai dhe kolegët e tij preferonin më mirë një koloni hebreje se sa një muslimane, siç i konsideronin palestinezët në Tokën e Shenjtë.

Kohët e fundit, kemi arritur të kemi akses në një analizë akoma më gjithëpërfshirëse, të shkruar në vitin 1939, por që kishte humbur për shumë vjet, përpara se të rishfaqej në vitin 2013. Kjo është vepra e gazetarit britanik J. M. N. Jeffries *"Palestina: Realiteti"*, që përbëhet nga më shumë se 700 faqe dhe në të cilën shpjegohet se çfarë fshihet pas Deklaratës së Balfurit.[32] Ajo zbulon, nëpërmjet lidhjeve personale të Xhefrizit dhe aksesit të tij në një sërë dokumentash tashmë të zhdukur, se kush në admiraliatin, ushtrinë dhe qeverinë britanike po punonte për deklaratën dhe përse. Del që të krishterët sionistë në këtë histori ishin shumë më entuzistë se sa vetë sionistët në lidhje me idenë e sponsorizimit britanik të procesit të kolonizimit të Palestinës.

Përfundimi i të gjitha hulumtimeve të kryera deri tani në lidhje me deklaratën është se vendimmarrës të shumtë në Britani e shihnin idenë e një atdheu hebre në Palestinë si në pajtim të plotë me interesat strategjike britanike në atë rajon. Sapo Britania pushtoi Palestinën, kjo aleancë iu lejoi hebrenjve që të ndërtonin infrastrukturën për një shtet hebre nën kujdesin britanik dhe nën mbrojtjen e bajonetave të qeverisë së Madhërisë së Tij.

Por Palestina nuk u mor lehtësisht. Fushata britanike kundër turqve zgjati gjatë gjithë vitit 1917. Ajo filloi mirë, me forcat britanike që depërtuan nëpërmjet gadishullit të Sinait, por u frenuan nga një luftë masakruese llogoresh ndërmjet Rripit të Gazës dhe Bir Sebas. Kur kjo pengesë u kapërcye, u bë më e lehtë që Jeruzalemi të dorëzohej pa luftë. Pushtimi ushtarak që pasoi i solli të tria proceset e ndara: shfaqjen e sionizmit, milenarianizmin protestant dhe imperializmin britanik, në brigjet palestineze si një bashkim i fuqishëm ideologjish që e shkatërruan vendin dhe popullin e tij në 30 vitet në vazhdim.

Ka prej atyre që do të donin të pyesnin nëse hebrenjtë që u ngulitën pas vitit 1918 në Palestinë si sionistë ishin më të vërtetë pasardhësit e hebrenjve që ishin dëbuan nga Roma 2.000 vjet më parë. Kjo filloi me dyshimet e para popullore të hedhura nga Artur Këstler (Arthur Koestler) (1905-1983), i cili shkroi "Fisi i trembëdhjetë" (1976), në të cilin hidhte teorinë se kolonistët hebrenj rridhnin nga hazarët, një komb turk nga Kaukazi që u konvertua në hebraizëm në shekullin VIII dhe që më vonë u detyrua të zhvendosej drejt perëndimit.[33] Shkencëtarët izraelitë janë munduar që atëherë që të provojnë se ka një lidhje gjenetike mes hebrenjve të Palestinës romake dhe atyre të Izraelit të sotëm. Sidoqoftë, debati vazhdon edhe sot.

Analiza më serioze që vijnë nga dijetarë biblikë që nuk janë ndikuar nga sionizmi si Keith Uajtlëm (Keith Whitelam), Tomas Tompson (Thomas Thompson) dhe dijetari izraelit Izrael Finkelshtajn (Israel Finkelstein), e hedhin poshtë që të gjithë Biblën si një rrëfim faktik me ndonjë farë rëndësie.[34] Uajtlëm dhe Tompson dyshojnë gjithashtu edhe për ekzistencën e diçkaje të tillë si kombi në kohërat biblike dhe si të tjerët, kritikojnë atë që e quajnë *"shpikja e Izraelit modern"* si vepër të teologëve të krishterë prosionistë. Hedhja

[32] J. M. N Jeffries, *Palestine: The Reality*, Washington: Institute of Palestine Studies, 2013

[33] Libri është rishtypur si Arthur Koestler: *The Khazar Empire and its Heritage*, New York: Random House, 1999.

[34] Keith Whitelam, në *The Invention of Ancient Israel*, London and New York: Routledge, 1999, dhe Thomas L. Thompson, në *The Mythical Past: Biblical Archaeology and the Myth of Israel*, London: Basic Books, 1999, krijuan Shkollën e Kopenhagenit të minimalizmit biblik që ndjek argumentat dhe hulumtimet kryesorë mbi këtë çështje.

poshtë më e fundit dhe më e përditësuar e kësaj ideje erdhi nga dy librat e Shlomo Sandit: *"Shpikja e popullit hebrej"* dhe *"Shpikja e tokës së Izraelit"*.[35] E respektoj dhe e çmoj këtë përpjekje shkencore. Megjithatë, politikisht, mendoj se është më pak e rëndësishme se supozimi që mohon ekzistencën e palestinezëve, ndonëse e plotëson atë supozim. Njerëzit kanë të drejtë të shpikin vetveten, siç kanë bërë shumë lëvizje kombëtare në momentin e ngjizjes së tyre. Por problemi bëhet i mprehtë nëse rrëfimi i zanafillës çon tek projekte politike si genocidi, spastrimi etnik dhe shtypja.

Në rastin e veçantë të pretendimeve të sionizmit të shekullit XIX, nuk është saktësia historike e atyre pretendimeve që na intereson. Ajo që na intereson nuk është nëse hebrenjtë e sotëm në Izrael janë pasardhësit e vërtetë të atyre që jetonin në periudhën romake, por këmbëngulja e shtetit të Izraelit se ai përfaqëson të gjithë hebrenjtë në botë dhe se çdo gjë që ai bën, e bën për të mirën e tyre dhe në emër të tyre. Deri në vitin 1967, ky pretendim ishte shumë i dobishëm për shtetin e Izraelit. Hebrenjtë kudo në botë, në veçanti në SHBA, u bënë mbështetësit e tij kryesorë sa herë që politikat e tij viheshin në diskutim. Në shumë raste, kjo ndodh akoma edhe sot në Shtetet e Bashkuara. Megjithatë, edhe atje, si edhe në bashkësitë e tjera hebreje, ky shoqërim i qartë po sfidohet në ditët tona.

Sionizmi, siç do ta shohim në kreun tjetër, në zanafillë ishte një mendim i pakicës në mesin e hebrenjve. Për të dëshmuar se hebrenjtë ishin një komb që i përkiste Palestinës, ndaj duhej ndihmuar për t'u rikthyer, atyre ju duhej të mbështeteshin tek zyrtarët britanikë dhe më pas, në fuqinë ushtarake. Hebrenjtë dhe bota dukej se nuk ishin të bindur se hebrenjtë ishin një popull pa tokë. Shaftesberi, Fini, Balfuri dhe Llojd Xhorxhi e pëlqyen idenë, sepse ajo e ndihmonte Britaninë të vendoste këmbët në Palestinë. Kjo u bë e parëndësishme, pasi britanikët e morën me forcë Palestinën dhe ju desh të vendosnin nga një pikënisje e re, nëse toka ishte hebreje ose palestineze, një pyetjeje që nuk mund t'i jepnin përgjigjen e duhur, ndaj ua lanë të tjerëve të vendosin pas 30 vitesh sundimi zhgënjyes.

[35] Shlomo Sand, *The Invention of the Jewish People*, dhe *The Invention of the Land of Israel: From Holy Land to Homeland*, London and New York: Verso, 2014.

KREU III

SIONIZMI ËSHTË HEBRAIZËM

Me qëllim që të shqyrtojmë siç duhet pretendimin se sionizmi është i njëjtë me hebraizmin, duhet të fillojmë me kontekstin historik në të cilin ai lindi. Që nga ngjizja e tij në mesin e shekullit XIX, sionizmi ishte vetëm një shprehje e parëndësishme e jetës kulturore hebreje. Ai lindi nga dy shtysa ndërmjet bashkësive hebreje në Evropën Qëndrore dhe atë Lindore. E para ishte kërkesa për siguri brenda një shoqërie që refuzonte t'i integronte hebrenjtë si të barabartë dhe që me raste, i përndiqte ata, si nëpërmjet legjislacionit, ashtu edhe nëpërmjet trazirave të organizuara ose të inkurajuara nga pushteti, për t'iu shmangur krizave ekonomike ose përmbysjeve politike. Shtysa e dytë ishte dëshira për të imituar lëvizjet e tjera kombëtare që lulëzonin në Evropën e asaj kohe, gjatë asaj që historianët e quajnë Pranvera Evropiane e Kombeve. Ata hebrenj që kërkonin ta shndërronin hebraizmin nga një fe në një komb nuk ishin të vetëm në mesin e shumë grupeve etnike dhe fetare brenda dy perandorive në shembje: asaj austro-hungareze dhe asaj osmane, që donin të vetëpërcaktoheshin si kombe.

Rrënjët e sionizmit modern mund të gjenden që në shekullin XVIII, në atë që quhej lëvizja iluministe hebreje. Ajo përbëhej nga një grup shkrimtarësh, poetësh dhe rabinësh, që e rigjallëruan gjuhën hebreje dhe i shtynë kufinjtë e edukimit tradicional dhe fetar hebre drejt studimit më universal të shkencës, letërsisë dhe filozofisë. Në të gjithë Evropën Qëndrore dhe Lindore, filluan të lulëzojnë gazetat dhe fletushkat në hebraisht. Nga ky grup spikatën disa individë, që njihen në historiografinë sioniste si "lajmëtarët e sionizmit", të cilët shfaqën prirje të mëdha nacionaliste dhe në shkrimet e tyre e lidhën rigjallërimin e hebraishtes me nacionalizmin. Ata avancuan dy ide të reja: ripërcaktimin e hebraizmit si lëvizje kombëtare dhe nevojën për të kolonizuar Palestinën, me qëllim rikthimin e hebrenjve në atdheun e lashtë, nga i cili ishin dëbuar nga romakët në viti 70 e.s. Ata mbronin "rikthimin" nëpërmjet asaj që ata e përcaktonin si "koloni bujqësore". Në shumë pjesë të Evropës, hebrenjtë nuk lejoheshin të zotëronin apo kultivonin tokën, ndaj kjo është arsyeja e magjepsjes së tyre nga fillimi si një komb bujqish dhe jo vetëm si qytetarë të lirë.

Këto ide u bënë popullore pas një vale brutale pogromesh në Rusi në vitin 1881, që i shndërroi ato në një program politik të propaganduar nga një lëvizje e quajtur "Dashnorët e Sionit", e cila dërgoi disa qindra të rinj hebrenj entuziastë për të ndërtuar kolonitë e para në Palestinë në vitin 1882. Në historinë e sionizmit, kjo fazë e parë kulmon me veprat dhe veprimet e Teodor Herclit. I lindur në Pest të Perandorisë Austro-Hungareze në vitin 1860, por rezident në pjesën më të madhe të jetës së tij në Vjenë, Hercli e filloi karrierën e tij si dramaturg i interesuar për gjendjen dhe problemet e hebrenjve në shoqërinë e tij dhe në fillim deklaronte se thelbi i predikimit të tij ishte asimilimi i plotë i hebrenjve në shoqëritë vendase. Në vitet '90, ai u bë gazetar dhe sipas versionit të tij të jetës, ishte pikërisht në këtë kohë që ai e kuptoi se sa i fuqishëm ishte antisemitizmi. Ai doli në përfundimin se nuk kishte asnjë shpresë për asimilim dhe në vend të tij, zgjodhi themelimin e një shteti hebre në Palestinë si zgjidhjen më të mirë të asaj që ai e përcaktonte si "problemi hebre".

Ndërkohë që këto ide të hershme sioniste përhapeshin në mesin e bashkësive hebreje në vende si Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara, rabinë dhe udhëheqës të spikatur në këto bashkësi e hodhën poshtë këtë qasje. Udhëheqës fetarë e kundërshtuan sionizmin si një formë sekularizimi dhe modernizimi, ndërsa

hebrenjtë sekularë frikësoheshin se idetë e reja do ta vinin në dyshim besnikërinë e hebrenjve ndaj shteteve kombëtare të tyre dhe do të rrisnin antisemitizmin. Që të dy grupimet kishin ide të ndryshme se si duhej përballuar përndjekja e hebrenjve në Evropë. Disa besonin se hendekëzimi i mëtejshëm pas fesë dhe traditës hebreje ishte zgjidhja (pikërisht siç do të kishin vepruar fundamentalistët islamikë në të njëjtën kohë të ndodhur përballë modernizimit evropian), ndërsa të tjerë mbronin idenë e asimilimit të mëtejshëm në jetën johebreje.

Kur idetë sioniste u shfaqën në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara mes viteve 1840 dhe 1880, shumica e hebrenjve e praktikonin hebraizmin në dy mënyra të ndryshme. Njëra përbëhej nga hendekëzimi: jetesa brenda bashkësive shumë të ngushta fetare, shmangia e ideve të reja si nacionalizmi dhe konsiderimi i modernizimit si një kërcënim i papëlqyer ndaj mënyrës së tyre të jetesës. Mënyra tjetër përfshinte jetesën sekulare, e cila ndryshonte shumë pak nga ajo e bashkësive të tjera johebreje: festimin e disa festave, frekuentimin e sinagogave në ditët e premte dhe ndoshta mosngrënia në publik gjatë agjërimit të ditës së faljes (Jom Kippur). Gershom Sholem (Gershom Scholem), i cili ishte një hebre i tillë, risjell në kujtesë në kujtimet e tij *"Nga Berlini në Jeruzalem"* se si ai, si një anëtar i një grupi të ri hebre në Gjermani, darkonte me miqtë e tij në të njëjtin restorant në Berlin gjatë Jom Kippurit. Sapo mbërrinin, pronari i njoftonte se *"dhoma e posaçme për zotërinjtë agjërues në restorant ishte gati".*[36] Individët dhe bashkësitë u gjendën ndërmjet këtyre dy poleve të sekularizimit, nga njëra anë, dhe jetës ortodokse, nga ana tjetër. Por, le t'i hedhim një sy më nga afër qëndrimeve që ata mbajtën ndaj sionizmit në gjysmën e dytë të shekullit XIX.

Natyrisht, sekularizmi hebre është një koncept pak i çuditshëm, siç është sekularizmi i krishterë apo ai musliman. Hebrenjtë sekularë, siç u përshkrua më lart, ishin njerëz me shkallë të ndryshme lidhjeje me fenë, tamam si një i krishterë sekular në Britani që feston Pashkët dhe Krishtlindjet, dërgon fëmijët e tij në shkollat e Kishës së Anglisë apo merr pjesë në meshën e së dielës me raste apo disi më shpesh. Në gjysmën e fundit të shekullit XIX, kjo formë moderne e praktikimit të hebraizmit u bë një lëvizje e fuqishme e njohur si Lëvizja Reformiste, e cila kërkonte mënyra përshtatjeje të fesë me jetën moderne pa iu dorëzuar aspekteve anakronike të saj. Kjo lëvizje ishte veçanërisht popullore në Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara.

Kur reformistët takuan për herë të parë sionizmin, ata e kundërshtuan furishëm idenë e ripërcaktimit të hebraizmit si nacionalizëm dhe krijimin e një shteti hebre në Palestinë. Megjithatë, qëndrimi i tyre antisionist ndryshoi pas krijimit të shtetit të Izraelit në vitin 1948. Në gjysmën e dytë të shekullit XX, shumica e tyre krijoi një lëvizje të re reformiste në Shtetet e Bashkuara, e cila u bë një nga organizatat më të fuqishme hebreje në vend, ndonëse duhet të vinte viti 1999 që kjo lëvizje e re të betohej zyrtarisht për besnikëri ndaj Izraelit dhe sionizmit. Megjithatë, një numër i madh hebrenjsh u larguan nga lëvizja e re dhe ngritën Këshillin Amerikan të Hebraizmit (American Council of Judaism – ACJ), i cili i rikujtoi botës në vitin 1993 se sionizmi ishte akoma një mendim pakicë mes hebrenjve dhe i qëndroi besnik nocioneve të vjetra reformiste mbi sionizmin.[37]

Përpara kësaj skizme, lëvizja reformiste në Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara kishte mbajtur një qëndrim të fortë dhe të njëzëshëm kundër sionizmit. Në Gjermani, ata e kishin refuzuar publikisht idenë e një kombi hebre dhe e shpallën veten si "gjermanë me besim moisian". Një prej veprimeve të para të reformistëve gjermanë ishte heqja nga ritualet e lutjeve të tyre të çdo referimi të rikthimit në "Erec Izrael" ose

[36] Gershom Scholem, *From Berlin to Jerusalem: Youth Memoirs,* Jerusalem: Am Oved, 1982, fq. 34, (në hebraisht).

[37] Citimet nga reformistët janë marrë nga një vlerësim i qëndrimit të tyre kritik dhe prosionist, por sidoqoftë informues, i cili përfshin dokumentin e plotë. Shih Ami Isserof, *"Opposition of Reform Judaism to Zionism: A History,"* 12 gusht 2005, në zionism-israel.com

rindërtimit të një shteti atje. Që në vitin 1869, edhe reformistët amerikanë deklaruan në një nga kuvendet e tyre të para:

"...se qëllimi mesianik i Izraelit (dmth popullit hebre) nuk është ringritja e një shteti hebre nën udhëheqjen e një pasardhësi të Davidit, që do të thotë një ndarje e dytë nga kombet e tokës, por bashkimi i fëmijëve të Zotit në rrëfim të njëshmërisë së Zotit, për të arritur unitetin e të gjitha krijesave me arsye dhe për t'i thirrur ata drejt shenjtërimit moral."

Në vitin 1885, një konferencë tjetër reformiste deklaronte: *"Ne nuk e konsiderojmë më veten tonë si një komb, por si një bashkësi fetare, ndaj ne nuk presim as një rikthim në Palestinë, as një adhurim flijues nën bijtë e Aronit dhe as rikthimin e ndonjë ligji në lidhje me shtetin hebre."*

Në lidhje me këtë, një udhëheqës i famshëm, rabini Kaufman Koler (Kaufman Kohler), hodhi poshtë idenë *"që Judea është shtëpi e hebreut, një ide që i lë pa shtëpi të gjithë hebrenjtë anembanë botës së gjërë."* Një udhëheqës tjetër i lëvizjes në fund të shekullit XIX, Isak Majer Uajs (Isaac Mayer Wise), shpesh tallej me udhëheqës sionistë si Hercli, duke i krahasuar ata me alkimistët sharlatanë që pretendonin se jepnin kontribut për shkencën. Në Vjenë, qytetin e Herclit, Adolf Jelinek (Adolf Jellinek) argumentonte se sionizmi do të rrezikonte pozitën e hebrenjve në Evropë dhe deklaronte se shumica e tyre i kundërshtonin idetë e tyre. *"Ne jemi në shtëpi në Evropë,"* deklaronte ai.

Përveç reformistëve, edhe hebrenjtë liberalë të asaj kohe e kundërshtonin pretendimin se sionizmi ofronte të vetmen zgjidhje për antisemitizmin. Siç na tregon Uollter Laker (Walter Lacquer) në librin e tij: *"Historia e sionizmit"*, hebrenjtë liberalë e konsideronin sionizmin si një lëvizje ëndërrimtare që nuk i jepte asnjë përgjigje problemeve të hebrenjve në Evropë. Ata bënin thirrje për atë që e quanin një "ringjallje" të hebrenjve, që përfshinte shprehjen e besnikërisë së plotë ndaj atdheve të tyre dhe një gadishmëri për t'u asimiluar plotësisht në to si qytetarë.[38] Ata shpresonin që një botë më liberale mund t'i zgjidhte problemet e përndjekjes dhe antisemitizmit. Historia kishte treguar se liberalizmi i kishte shpëtuar ata hebrenj që kishin lëvizur apo jetonin në Britani dhe SHBA. Ata që besuan se kjo gjë mund të ndodhte edhe në pjesën tjetër të Evropës, doli se e kishin gabim. Por edhe sot, shumë hebrenj liberalë nuk e shohin sionizmin si përgjigjen e duhur, as në atë kohë dhe as sot.

Socialistët dhe hebrenjtë ortodoksë filluan t'i shprehin kritikat e tyre për sionizmin vetëm në vitet '90, kur sionizmi u bë një forcë politike më e njohur nga fundi i dekadës, falë punës së palodhur të Herclit. Hercli i kuptonte politikat bashkëkohore dhe shkroi histori utopike, trakte politike dhe raporte gazetareske që përmblidhnin idenë se ishte në interesin e Evropës që të ndihmonte ndërtimin e një shteti modern hebre në Palestinë. Udhëheqësit botërorë nuk u impresionuan, po ashtu as osmanët, që ishin sunduesit e Palestinës. Arritja më e madhe e Herclit ishte tubimi i të gjithë veprimtarëve në një konferencë në vitin 1897 dhe ndërtimi i dy organizatave bazë: një kongresi botëror për të promovuar nëpër botë idetë e sionizmit dhe organizatat lokale sioniste në terren që zgjeronin kolonizimin hebre të Palestinës.

Kështu, me kristalizimin e ideve sioniste, kritikimi i hebrenjve që ishin kundër sionizmit u bë më i hapur. Përveç lëvizjes reformiste, kritika erdhën nga e majta, udhëheqësit laikë të bashkësive të ndryshme dhe hebrenjtë ortodoksë. Në vitin 1897, në të njëjtin vit që u mblodh në Bazel konferenca e parë sioniste, një lëvizje socialiste hebreje lindi në Rusi: Bundi. Ajo ishte njëkohësisht një lëvizje politike dhe një sindikatë hebreje. Anëtarët e Bundit besonin se një revolucion socialist, bile edhe bolshevik, do të ishte një zgjidhje shumë më e mirë për problemet e hebrenjve në Evropë se sa sionizmi. Ata e konsideronin këtë të fundit si

[38] Walter Lacquer, *The History of Zionism*, New York: Tauris Park Paperback, 2003, fq. 338–398

një formë ikjeje nga realiteti. Ç'është më e rëndësishmja, kur nazizmi dhe fashizmi ishin në rritje në Evropë, bundistët e ndjenë se sionizmi kishte kontribuar për këtë lloj antisemitizmi, duke vënë në dyshim besnikërinë e hebrenjve ndaj atdheve të tyre. Bile edhe pas Holokaustit, bundistët ishin të bindur se hebrenjtë duhej të kërkonin një vend në shoqëritë që mbronin të drejtat civile dhe ato të njeriut, duke mos e parë idenë e një shteti kombëtar hebre si një ilaç të probleme të tyre. Megjithatë, kjo bindje e fuqishme antisioniste filloi të zbutej dalëngadalë rreth mesit të viteve '50 dhe mbetjet e kësaj lëvizjeje dikur të fuqishme vendosën të mbështesin hapur shtetin e Izraelit, bile kishin edhe një degë të tyren në shtetin hebre.[39]

Reagimi i Bundit nuk e shqetësoi aq shumë Herclin sa përgjigja e vakët e elitave politike dhe ekonomike hebreje në Britani dhe Francë. Ata e panë Herclin, ose si sharlatan, idetë e të cilit ishin të shkëputura nga realiteti, ose më keq, si një person që mund të minonte jetën hebreje në shoqëritë e tyre ku, për shembull në Britani, ata kishin bërë përparim të jashtëzakonshëm për sa i përket emancipimit dhe integrimit. Hebrenjtë viktorianë ishin të shqetësuar nga thirrja e tij për sovranitet hebre mbi një vend të huaj me një status të barabartë me shtetet e tjera sovrane në botë. Për shtresat më të stabilizuara të hebraizmit në Evropën Qëndrore dhe atë Lindore, sionizmi ishte një vizion provokues që vinte në dyshim besnikërinë e hebrenjve anglezë, gjermanë dhe francezë ndaj atdheve të tyre. Falë mospërkrahjes së tyre për Herclin, lëvizja sioniste nuk ja doli të bëhej një aktor i fuqishëm përpara Luftës së Parë Botërore. Vetëm pas vdekjes së Herclit në vitin 1904, udhëheqësit e tjerë të lëvizjes, në veçanti Haim Vajcmani (Chaim Weizmann), i cili emigroi në Britani në po atë vit që vdiq Hercli dhe u bë një shkencëtar i spikatur atje, duke dhënë një kontribut për përpjekjet luftarake britanike në Luftën e Parë, ndërtuan një aleancë të fortë me Londrën që i shërbeu mirë sionizmit, siç do të shpjegohet në vazhdim të këtij kreu.[40]

Kritika e tretë ndaj sionizmit në ditët e tij të para erdhi nga establishmenti hebre ultra-ortodoks. Edhe sot e kësaj dite, shumë bashkësi hebreje ultra-ortodokse e kundërshtojnë ashpër sionizmin, ndonëse janë shumë më të vogla se ç'ishin në fund të shekullit XIX dhe disa prej tyre lëvizën në Izrael, duke u bërë pjesë e sistemit të tij politik. Megjithatë, ashtu si në shkuarën, ata përbëjnë një mënyrë tjetër josioniste të të qënit hebre. Kur sionizmi u shfaq për herë të parë në Evropë, shumë rabinë tradicionalë i ndaluan pasuesit e tyre që të kishin kontakte me veprimtarët sionistë. Ata e konsideronin sionizmin si futje hundësh në vullnetin e Zotit për t'i mbajtur hebrenjtë në mërgim deri në ardhjen e Mesias. Ata e hidhnin plotësisht poshtë idenë që hebrenjtë duhet të bënin gjithçka që kishin mundësi për t'i dhënë fund "mërgimit". Përkundrazi, ata duhet të prisnin fjalën e Zotit për këtë gjë dhe ndërkohë, duhet të praktikonin mënyrën tradicionale të jetesës. Ndërsa individët lejoheshin të vizitonin Palestinën si pelegrinë dhe të studionin në të, kjo nuk duhej interpretuar si lejim për një lëvizje masive. Rabini i madh hasidit gjerman i Xikoverit e përmblidhte me ironi këtë qasje, kur thonte se sionizmi kërkon prej tij që të këmbejë shekuj diturie dhe ligji hebre për një leckë, pak dhé dhe një këngë (flamur, tokë dhe himn).[41]

Megjithatë, jo të gjithë rabinët e shquar e kundërshtuan sionizmin. Ishte një grup i vogël figurash me famë dhe autoritet si rabinët Al-Kalaj (Al-Qalay), Gutmaher (Gutmacher) dhe Kalisher (Qalisher), që e mbështetën programin sionist. Ata ishin një grup i vogël, por i rëndësishëm, sepse vendosën themelet e krahut fetar nacionalist të sionizmit. Akrobacitë e tyre fetare janë tepër mbresëlënëse. Në historiografinë

[39] Vepra më e fundit mbi këtë lëvizje është ajo e Yoav Peled, *Class and Ethnicity in the Pale: The Political Economy of Jewish Workers' Nationalism in Late Imperial Russia*, London: St. Martin's Press, 1989.
[40] M. W. Weisgal dhe J. Carmichael (eds.), *Chaim Weizmann: A Biography by Several Hands*, New York: Oxford University Press, 1963.
[41] Elie Kedourie, *Nationalism*, Oxford: Blackwell, 1993, fq. 70.

izraelite, ata quhen "Etërit e sionizmit fetar". Sionizmi fetar është një lëvizje shumë e rëndësishme në Izraelin bashkëkohor, si shtëpia ideologjike e lëvizjes kolonizuese mesianike, Gush Emunim, e cila ka kolonizuar Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës që nga viti 1967 dhe në vazhdim. Këta rabinë, jo vetëm që i bëjnë thirrje hebrenjve për t'u larguar nga Evropa, por edhe e shpallin atë si një detyrim fetar, jo vetëm kombëtar, të hebrenjve për të kolonizuar Palestinën përmes kultivimit të tokës (nuk duhet të çuditemi se pse banorët vendas të tokës nuk përmenden në shkrimet e tyre). Ata pretendojnë se një veprim i tillë nuk është futje hundësh në vullnetin e Zotit, por përkundrazi, është plotësim i profecive të profetëve dhe i paraprin faljes së plotë të popullit hebre dhe ardhjes së Mesias.[42]

Shumica e dritave udhëheqëse në hebraizmin ortodoks e hodhën poshtë këtë plan dhe interpretim. Ata kishin edhe diçka personale me sionizmin. Lëvizja e re, jo vetëm që donte ta kolonizonte Palestinën, por ajo shpresonte të sekularizonte edhe popullin hebre, të shpikte "hebreun e ri" në antitezë me hebrenjtë ortodoksë fetarë të Evropës. Kjo gjë arriti kulmin në imazhin e një hebreu të ri evropian, që nuk mund të jetonte më në Evropë për shkak të antisemitizmit, por duhet të jetonte si evropian jashtë kontinentit. Kështu, ashtu si shumë lëvizje gjatë asaj periudhe, sionizmi u vetëpërkufizua në terma kombëtarë, por ndryshonte krejtësisht prej tyre, sepse ai zgjodhi një tokë të re për këtë konvertim. Sionistët talleshin me hebrenjtë ortodoksë dhe i konsideronin ata si persona që mund të shpëtonin vetëm nëpërmjet punës së rëndë në Palestinë. Ky transformim përshkruhet shumë bukur nga romani futuristik dhe utopik i Herclit: *"Altnueland"*, i cili rrëfen historinë e një ekspedite turistike gjermane që mbërrin në shtetin hebre, shumë kohë pasi ai ishte ngritur.[43] Përpara se të mbërrinin në Palestinë, njëri nga turistët kishte hasur në një djalosh lypës hebre ortodoks, të cilin e has përsëri në Palestinë, tashmë sekular, të arsimuar dhe jashtëzakonisht të pasur dhe të kënaqur.

Roli i Biblës brenda jetës hebreje ofron një dallim akoma më të qartë ndërmjet hebraizmit dhe sionizmit. Në botën hebreje parasioniste, Bibla nuk mësohej si një tekst i veçantë, që bart ndonjë domethënie politike apo edhe kombëtare, në qendrat e shumta të arsimimit hebre, si në Evropë, ashtu edhe në botën arabe. Rabinët kryesorë e trajtonin historinë politike në Bibël, si dhe idenë e sovranitetit hebre mbi tokën e Izraelit, si tema anësore në botën e tyre shpirtërore të dijes. Ata ishin më shumë të përqëndruar, siç është në përgjithësi vetë hebraizmi, mbi shkrimet e shenjta që fokusohen tek marrëdhëniet ndërmjet besimtarëve dhe në veçanti, tek marrëdhëniet me Zotin.

Duke filluar nga "Dashnorët e Sionit" në vitin 1882 deri tek udhëheqësit sionistë në prag të Luftës së Parë Botërore, të cilët i bënë thirrje Britanisë që të mbështeste pretendimin hebre mbi Palestinën, referimet tek Bibla bëhen gjithnjë e më të shpeshtë. Të nisur nga interesat e tyre, udhëheqësit sionistë i kundërshtuan plotësisht interpretimet tradicionale biblike. Për shembull, "Dashnorët e Sionit", e lexonin Biblën si një rrëfim të një kombi hebre të lindur në tokën e Palestinës si një popull i shtypur nën zgjedhën e një regjimi kanaanit. Këta të fundit e dëbuan në mërgim në Egjipt popullin hebre, derisa u kthyen përsëri në atë tokë dhe e çliruan atë nën udhëheqjen e Joshuait. Në ndryshim prej tij, interpretimi tradicional fokusohet tek Abrahami dhe familja e tij si një grup njerëzish që zbuluan një Zot monoteist dhe jo një komb dhe atdhe. Shumica e lexuesve janë të njohur me këtë rrëfim konvencional të abrahamitëve që zbulojnë Zotin dhe përmes sprovave dhe vuajtjeve e gjejnë veten në Egjipt[44], që nuk ngjan me historinë e një kombi të shtypur të përfshirë në luftën për çlirim. Megjithatë, ky i fundit është interpretimi i preferuar i sionizmit,

[42] Shlomo Avineri, *The Making of Modern Zionism: Intellectual Origins of the Jewish State*, New York: Basic Books, 1981, fq. 187–209.
[43] Mund ta shkarkoni librin falas në jewishvirtuallibrary.org
[44] Shih Eliezer Shweid, *Homeland and the Promised Land*, Tel Aviv: Am Oved, 1979, fq. 218 (në hebraisht).

që pi ujë akoma edhe sot në Izrael.

Një nga përdorimet më intriguese të Biblës në sionizëm është ai që zbatohet nga krahu socialist i lëvizjes. Shkrirja e socializmit me sionizmin filloi me vrull pas vdekjes së Herclit në vitin 1904, kur fraksionet e ndryshme socialiste u bënë partitë udhëheqëse në lëvizjen botërore sioniste si dhe në terren, në Palestinë. Siç thotë njëri prej tyre, për socialistët, Bibla ofronte *"mitin e të drejtës sonë mbi tokën"*.[45] Në Bibël, ata lexonin histori për bujq, barinj, mbretër dhe luftëra hebreje, që ata i përvetësuan sikur përshkruanin epokën e artë dhe të lashtë të lindjes së kombit të tyre. Rikthimi në atë tokë do të thonte që ata të bëheshin përsëri bujq, barinj dhe mbretër. Kështu ata u gjetën përballë një paradoksi sfidues, sepse ata donin të sekularizonin jetën hebreje dhe ta përdornin Biblën si një justifikim për kolonizimin e Palestinës. Me fjalë të tjera, ndonëse ata nuk besonin në Zot, dilte se, pavarësisht kësaj, Zoti ju kishte premtuar atyre Palestinën.

Për shumë udhëheqës sionistë, referimi që i bëhet në Bibël tokës së Palestinës ishte vetëm një mjet për të justifikuar qëllimet e tyre dhe jo thelbi i sionizmit. Kjo shfaqet qartë, në veçanti, në shkrimet e Teodor Herclit. Në artikullin e tij të famshëm në "The Jewish Cronicle" (10 korrik 1896), ai e bazonte kërkesën hebreje për Palestinën mbi Bibël, por shprehte dëshirën që shteti i ardhshëm hebre të qeverisej sipas filozofive politike dhe morale evropiane të kohës. Ndoshta Hercli ishte më sekular se grupi i udhëheqësve që e zëvendësoi. Ky profet i lëvizjes kishte shqyrtuar seriozisht alternativa të tjera përveç Palestinës, si për shembull Ugandën, për të qenë atdheu i premtuar i Sionit. Gjithashtu ai kishte parë edhe destinacione të tjera në Amerikën e Veriut dhe atë të Jugut, si edhe në Azerbajxhan.[46] Me vdekjen e Herclit në vitin 1904 dhe shfaqjen e pasardhësve të tij, sionizmi gjeti shtëpi në Palestinë dhe Bibla u bë akoma më shumë se më parë një burim për të provuar të drejtën hyjnore të hebrenjve mbi tokën.

Fiksimi i ri i pas vitit 1904 mbi Palestinën, si i vetmi territor, në të cilin mund të zbatohej sionizmi, u imponua nga pushteti gjithnjë e në rritje i sionizmit të krishterë në Britani dhe Evropë. Teologë që studionin Biblën dhe arkeologë evangjelistë që gërrmonin "Tokën e Shenjtë" e mirëpritën ngulimin e hebrenjve si konfirmim të besimit të tyre fetar se "rikthimi i hebrenjve" do të shërbente si lajmëtar i shpalosjes së premtimit hyjnor për fundin e botës. Rikthimi i hebrenjve ishte pararendësi i rikthimit të Mesias dhe ringjalljes së të vdekurve. Projekti sionist i kolonizimit të Palestinës përfitoi shumë nga ky besim fetar ezoterik.[47] Megjithatë, pas këtyre vizioneve fetare, fshihen ndjenjat klasike antisemite. Sepse shtyrja e bashkësive hebreje në drejtim të Palestinës nuk ishte vetëm një imperativ fetar, por ndihmoi edhe në krijimin e një Evrope pa hebrenj. Kjo gjë përfaqëson një përfitim të dyfishtë: heqjen qafe të hebrenjve nga Evropa dhe në të njëjtën kohë, plotësimin e skemës hyjnore, në të cilën Ardhja e Dytë do të përshpejtohej nga rikthimi i hebrenjve në Palestinë (dhe për rrjedhojë, konvertimi i tyre në krishtërim ose djegia në Ferr, nëse kundërshtonin).

Që nga ky moment dhe në vazhdim, Bibla u përdor si justifikim dhe plan për kolonizimin sionist të Palestinës. Historikisht, Bibla i shërbeu mirë sionizmit që nga ngjizja e tij dhe deri në krijimin e shtetit të Izraelit në vitin 1948. Ajo luajti një rol të rëndësishëm në narrativën dominuese izraelite, qoftë për qëllime

[45] Micha Yosef Berdichevsky, *"On Both Sides,"* cituar në Asaf Sagiv, *"The Fathers of Zionism and the Myth of the Birth of the Nation,"* Techelt, 5 (1998), fq. 93 (në hebraisht).
[46] Një diskutim i mirë mbi këto opcione mund të gjendet në Adam Rovner, *In the Shadow of Zion: Promised Lands Before Israel*, New York: NYU Press, 2014.
[47] Një përmbledhje të shkëlqyer të kësaj pike me referencat përkatëse mund ta gjeni në artikullin e Stephen Sizer *"The Road to Balfour: The History of Christian Zionism,"* në balfourproject.org

të brendshme, ashtu edhe për qëllime të jashtme, duke pretenduar se Izraeli ishte e njëjta tokë që Zoti i kishte premtuar Abrahamit në Bibël. Në këtë narrativë, Izraeli kishte ekzistuar deri në vitin 70 p.e.s, kur romakët e shkatërruan dhe dëbuan popullin e tij. Përkujtimi fetar i asaj date, kur Tempulli i dytë u shkatërrua, ishte një ditë zije. Në Izrael, kjo datë është bërë një ditë zije kombëtare, në të cilën të gjithë bizneset e industrisë së zbavitjes, përfshirë këtu edhe restorantet, duhet të mbyllen që në mbrëmjen e ditës së mëparshme.

Prova kryesore shkencore dhe sekulare e kësaj narrative është siguruar në vitet e fundit me ndihmën e të ashtuquajturës arkeologji biblike, e cila vetë është një koncept kontradiktor, duke qenë se Bibla është një vepër e madhe letrare e shkruar nga shumë njerëz në periudha të ndryshme dhe zor se mund të merret si tekst historik.[48] Sipas kësaj narrative, pas vitit 70 p.e.s, toka mbeti pak a shumë e zbrazur deri në rikthimin sionist. Megjithatë, udhëheqësit sionistë e dinin se referimi tek autoriteti i Biblës nuk do të ishte i mjaftueshëm. Kolonizimi i Palestinës tashmë të banuar do të kërkonte një politikë sistematike kolonizimi, shpronësimi dhe bile spastrimi etnik. Për këtë qëllim, portretizimi i shpronësimit të Palestinës si përmbushje e një skeme hyjnore të krishterë nuk kishte të çmuar kur binte fjala për të siguruar mbështetjen globale të krishterë për sionizmin.

Siç kemi parë, sapo opcionet e tjera territoriale u përjashtuan dhe sionizmi u fokusua në rimarrjen e Palestinës, udhëheqësit që pasuan pionierët e hershëm filluan të injektonin një ideologji socialiste, bile edhe marksiste, në lëvizjen sekulare gjithnjë e në rritje. Tani qëllimi ishte realizimi (me ndihmën e Zotit) i një projekti hebre sekular, socialist dhe kolonialist në Tokën e Shenjtë. Vendasit e kolonizuar e mësuan shumë shpejt, se fati i tyre ishte vulosur, pavarësisht nga fakti se kolonistët sollën me vete Biblën, shkrimet e Marksit apo traktatet e Iluminizmit Evropian. Rëndësi kishte nëse ishe i përfshirë në vizionin e kolonistëve për të ardhmen dhe si. Ndaj është shumë domethënës fakti se, në shënimet e mbajtura nga udhëheqësit dhe kolonistët e parë sionistë, vendasit spikasin si pengesë, të huaj dhe armiq, pavarësisht se kush ishin apo çfarë aspiratash kishin.[49]

Citimet e para antiarabe në këto shënime u shkruan kur kolonistët ishin akoma nën mikpritjen e palestinezëve, rrugës për në kolonitë e vjetra ose në qytete. Ankesat e tyre rridhnin nga përvojat e tyre formuese, kërkimi i punës dhe mjeteve për jetesë. Kjo gjëndje e vështirë duket se i preku të gjithë ata, si ata që shkuan në kolonitë e vjetra, ashtu edhe ata që provuan fatin në qytete. Kudo që shkuan, për të mbijetuar, ata punuan krah për krah me bujqit apo punëtorët palestinezë. Përmes këtij kontakti të ngushtë, edhe kolonët më të paditur dhe më kokëfortë e kuptuan se Palestina ishte krejtësisht një vend arab në tabllonë e saj njerëzore.

David Ben-Gurion, udhëheqësi i bashkësisë hebreje gjatë periudhës së Mandatit dhe kryeministri i parë i Izraelit, i përshkruante punëtorët dhe bujqërit palestinezë si *"beit mihush"* ("një vatër e infektuar dhimbjeje"). Kolonë të tjerë flisnin për palestinezët si të huaj. *"Njerëzit këtu janë më të huaj për ne se fshatari rus apo polak,"* shkruante njëri prej tyre, duke shtuar se *"nuk kemi asgjë të përbashkët me shumicën e njerëzve që jetojnë këtu."*[50] Ata ishin çuditur që kishin gjetur njerëz në Palestinë, sepse ju ishte

[48] Ingrid Hjelm and Thomas Thompson (eds.), *History, Archaeology and the Bible, Forty Years after "Historicity,"* London and New York: Routledge, 2016.
[49] Ilan Pappe, *"Shtetl Colonialism: First and Last Impressions of Indigeneity by Colonised Colonisers," Settler Colonial Studies*, 2:1 (2012), fq. 39–58.
[50] Moshe Bellinson, *"Rebelling Against Reality,"* në *The Book of the Second Aliya,* Tel Aviv: Am Oved, 1947 (hebraisht), fq. 48. Ky libër është koleksioni më i madh i botuar i ditarëve, letrave dhe artikujve të Aliya-s së Dytë.

thënë se toka ishte e zbrazët. *"Më erdhi neveri kur zbulova se në Hadera (një koloni e hershme sioniste e ndërtuar në vitin 1882) një pjesë e shtëpive ishin të zëna nga arabët,"* raportonte një kolonist, ndërsa një tjetër njoftonte njerëzit e tij në Poloni se ishte tmerruar kur shihte shumë burra, gra dhe fëmijë arabë që kalonin nëpër Rishon LeZion, një tjetër koloni ndërtuar në vitin 1882.[51]

Duke qenë se vendi nuk ishte bosh dhe të duhej të duroje praninë e vendasve, ishte mirë ta kishe Zotin në anën tënde, ndonëse ishe një ateist. Si David Ben-Gurion, ashtu edhe miku dhe kolegu i tij i ngushtë, Jichak Ben-Zvi (Yitzhak Ben-Zvi), i cili bashkë me Ben-Gurionin udhëhoqën fraksionet socialiste sioniste në Palestinë dhe më vonë u bë presidenti i dytë i Izraelit, e përdornin premtimin biblik si justifikimin kryesor për kolonizimin e Palestinës. Kjo gjë vazhdoi edhe me ideologët që i pasuan ata në Partinë Laburiste në mesin e viteve 1970 dhe deri në biblizmin shumë të cekët të Partisë Likud dhe degëzimeve të saj të viteve të fundit.

Interpretimi i Biblës si një justifikim hyjnor për sionizmin i ndihmonte socialistët të pajtonin besnikërinë e tyre ndaj vlerave universale të solidaritetit dhe barazisë me projektin kolonizues të shpronësimit. Me të vërtetë, duke qenë se kolonizimi ishte objektivi kryesor i sionizmit, ngrihet pyetja se çfarë lloj socializmi ishte ai. Në fund të fundit, në kujtesën kolektive të shumë njerëzve, periudha e artë e sionizmit shoqërohet me jetën kolektive dhe egalitariane të mishëruar në institucionin e kibucit (Kibbutz). Kjo formë jetese zgjati shumë gjatë pas themelimit të Izraelit dhe tërhoqi të rinj nga e gjithë bota, që erdhën për të shërbyer vullnetarisht dhe për të shijuar komunizmin në formën e tij më të pastër. Shumë pak prej tyre e kuptuan ose mund ta kenë mësuar, se shumica e kibuceve u ndërtuan mbi fshatrat e shkatërruar palestinezë, popullsia e të cilëve ishte dëbuar në vitin 1948. Për t'u justifikuar, sionistët pretendonin se këto fshatra ishin vende të vjetra hebreje të përmendur në Bibël, ndaj shpronësimi i tyre nuk ishte pushtim, por thjesht çlirim. Një komision i posaçëm "arkeologësh biblikë" futej në një fshat të shkretë dhe përcaktonte çfarë emri kishte pasur në kohët biblike. Zyrtarët e zellshëm të Fondit Kombëtar Hebre ngrinin më pas kolovinë me emrin e tij të saporizbuluar.[52] Një metodë e ngjashme u përdor pas vitit 1967 nga ministri i atëhershëm i punës, Jigal Alon (Yigal Alon), një hebre socialist sekular, për ndërtimin e një qyteti të ri pranë Hebronit, sepse sipas Biblës, ai "i përkiste" popullit hebre.

Disa dijetarë kritikë izraelitë, ku shquhen Gershon Shafir dhe Zeev Sternhell, si dhe amerikani Zakari Lokman (Zachary Lockman), kanë shpjeguar se si shpronësimi kolonial i tokës e kishte njollosur të ashtuquajturën periudhë të artë të sionizmit socialist. Siç tregojnë këta historianë, socializmi brenda sionizmit, si praktikë dhe mënyrë të jetuarit, ka qenë gjithmonë një version i kushtëzuar dhe i kufizuar i ideologjisë universale. Vlerat dhe aspiratat universale që karakterizojnë lëvizjet e ndryshme ideologjike të së majtës perëndimore shpejt u nacionalizuan apo sionistizuan në Palestinë. Ndaj nuk duhet të habitemi se përse socializmi e humbi tërheqjen e tij për brezin tjetër të kolonistëve.[53]

Megjithatë feja mbeti një aspekt i rëndësishëm i procesit, bile edhe pasi toka ju mor palestinezëve. Në emër të saj mund të shpallësh dhe kërkosh një të drejtë të lashtë morale mbi Palestinën që sfidon çdo pretendim tjetër të jashtëm mbi tokën në këto ditë të fundit të imperializmit. Kjo e drejtë zëvendëson edhe

[51] Yona Hurewitz, *"From Kibush Ha-Avoda to Settlement,"* në *The Book of the Second Aliya*, fq. 210.

[52] Ilan Pappe, *"The Bible in the Service of Zionism,"* në Hjelm and Thompson, *History, Archaeology and the Bible*, fq. 205–18.

[53] Për një diskutim të këtyre veprave dhe paraqitjen e hershme të paradigmës kolonialiste tek hulumtimet për sionizmin, shih Uri Ram, *"The Colonisation Perspective in Israeli Sociology,"* në Ilan Pappe (ed.), *The Israel/Palestine Question*, London and New York: Routledge, 1999, fq. 53–77.

pretendimet morale të popullsisë vendase. Një nga projektet më socialiste dhe më sekulare të shekullit të njëzetë kërkoi ekskluzivitet në emër të një premtimi të pastër hyjnor. Mbështetja mbi tekstin e shenjtë rezultoi me shumë përfitim për kolonistët sionistë dhe shumë e kushtueshme për popullsinë vendase. Libri i fundit i të ndjerit Majkëll Prajër (Michael Prior), *"Bibla dhe kolonializmi"*, tregon se si të njëjtat lloje projektesh u zbatuan kudo në botë në mënyra shumë të ngjashme me kolonizimin e Palestinës.[54]

Pasi Izraeli pushtoi Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës në vitin 1967, Bibla vazhdoi të përdorej për të njëjtin qëllim. E përmenda më lart Jigal Alonin, që e përdori Biblën për të justifikuar ndërtimin e qytetit hebre të Kirjat Erbas (Qiryat Arba), mbi tokat e shpronësuara të banorëve të Hebronit, qytetit të afërt palestinez. Shpejt Kirjat Erba u bë vatër për njerëz që e marrin Biblën edhe më seriozisht si një guidë për veprim. Në mënyrë përzgjedhëse, ata marrin ata kapituj dhe fraza biblike që në sytë e tyre justifikojnë shpronësimin e palestinezëve. Me vazhdimin e viteve të pushtimit, po ashtu vazhdoi edhe regjimi i brutalitetit kundër të shpronësuarve. Ky proces i nxjerrjes së legjitimitetit politik nga një tekst i shenjtë mund të çojë në fanatizëm me pasoja të rrezikshme. Bibla, për shembull, ka referime të genocidit: amalekitët u vranë deri tek njeriu i fundit nga Joshuaja. Sot ka prej atyre, që për fat deri më sot janë veçse një pakicë fanatike, të cilët nuk i referohen vetëm palestinezëve si amalekitë, por edhe atyre që për ta nuk janë hebrenj siç duhet.[55]

Referime të ngjashme për genocid në emër të Zotit shfaqen në Haggadah-un hebre për festën e Pesakut (Pashkëve). Rrëfimi kryesor i Sederit të Pashkëve, ku Zoti dërgon Moisiun dhe izraelitët në një tokë të pabanuar nga të tjerë, për ta bërë atë të tyren si t'iu pëlqejë, natyrisht nuk është një çështje imperative për shumicën e hebrenjve. Ai është një tekst letrar, jo një manual lufte. Megjithatë ai mund të shfrytëzohet nga rryma e re e mendimit mesianik hebre, siç ndodhi me vrasjen me atentat të Jichak Rabinit (Yitzhak Rabin) në vitin 1995 dhe në verën e vitit 2015, së pari me djegien për së gjalli të një adoleshenti në një incident dhe më pas, të dy prindërve dhe fëmijës së tyre. Ministria e re e drejtësisë së Izraelit, Ajelet Shaked (Ayelet Shaked), ushqen ide të ngjashme, deri tani vetëm për palestinezët që kanë vdekur në përpjekje për t'i rezistuar Izraelit: e gjithë familja e tyre, tha ajo, duhet *"të pasojë të bijtë, asgjë nuk do të ishte më e drejtë. Ata duhet të shkojnë, bashkë më ta edhe shtëpitë e tyre, në të cilat ata kanë rritur gjarpërinj. Përndryshe, shumë gjarpërinj të vegjël do të rriten atje."*[56] Tani për tani, ky është vetëm një paralajmërim për të ardhmen. Siç kemi parë, që nga viti 1882, Bibla është përdorur si justifikim për shpronësimin. Megjithatë, në vitet e para të shtetit të Izraelit, nga viti 1948 deri në 1967, referimi ndaj Biblës ra shumë dhe përdorej vetëm nga ekstremi i krahut të djathtë të lëvizjes sioniste për të justifikuar portretizimin e palestinezëve si qenie inferiore dhe si armiqtë e përjetshëm të popullit hebre. Pas pushtimit të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës në vitin 1967, këta hebrenj mesianikë dhe fundamentalistë, të rritur në gjirin e Partisë Fetare Kombëtare (MAFDAL), shfrytëzuan rastin për t'i shndërruar haluçinacionet e tyre në veprime reale në terren. Ata u ngulitën kudo në territoret e pushtuara, me ose pa pëlqimin e qeverisë. Krijuan ishuj të jetës hebreje brenda territorit palestinez dhe filluan të sillen si pronarë të gjithçkaje.

Fraksionet më militante të Gush Emunimit, lëvizjes koloniste të pas vitit 1967, përfituan nga rrethanat shumë të veçanta të krijuara nga sundimi izraelit mbi Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës për ta përdorur pa kufinj lejen e tyre për të shpronësuar dhe abuzuar në emër të teksteve të shenjta. Ligji izraelit nuk vepron në territoret e pushtuara, të cilat janë të qeverisura nga rregullat e emergjencës ushtarake.

[54] Michael Prior, *The Bible and Colonialism: A Moral Critique*, London: Bloomsbury 1997.

[55] Këto tema janë diskutuar gjatë në një libër të shkëlqyer, i cili për fat të keq ekziston vetëm në hebraisht: Sefi Rachlevski, *The Messiah's Donkey*, Tel Aviv: Yeditot Achronot, 1998.

[56] Kjo u shfaq në faqen e saj zyrtare në Facebook më 1 korrik 2014 dhe u citua gjërësisht nga shtypi izraelit.

Megjithatë, ky regjim ligjor ushtarak nuk zbatohet mbi kolonistët, që faktikisht janë imunë ndaj dënimit në të dy sistemet ligjorë. Ngulitja e tyre me forcë në mesin e lagjeve palestineze në Hebron dhe Jeruzalem, shkulja e drunjve të ullirit të palestinezëve dhe vënia e zjarrit në arat e palestinezëve justifikohen të gjitha si pjesë e detyrës hyjnore të ngulitjes në "Erec Izrael."

Por interpretimi i dhunshëm i kolonistëve i mesazhit biblik nuk u kufizua vetëm në territoret e pushtuara. Ata filluan të shtyhen në zemër të qyteteve të përziera arabo-hebreje në Izrael si Akka, Jafa dhe Remle, me qëllim prishjen e "modus vivendit" të brishtë të vendosur atje prej vitesh. Lëvizja e kolonistëve në këto pika të ndjeshme brenda kufinjve të Izraelit para vitit 1967 ka potencial të minojë, në emër të Biblës, marrëdhëniet tashmë të ndera mes shtetit hebre dhe pakicës palestineze në të.

Arsyeja e fundit e ofruar nga reklamimi sionist i Tokës së Shenjtë, siç përcaktohet nga Bibla, ishte nevoja e hebrenjve anekënd botës për të gjetur një strehë të sigurtë, veçanërisht pas Holokaustit. Edhe sikur kjo të ishte e vërtetë, mund të kishte qenë e mundur që të gjendej një zgjidhje e pakufizuar nga harta biblike dhe që nuk shpronësonte palestinezët. Ky qëndrim u shpreh nga disa personalitete të njohura si Mahatma Gandi dhe Nelson Mandela, të cilët u munduan të sugjerojnë që palestinezët duhet t'iu kërkohej që të ofronin një strehë të sigurtë për hebrenjtë e përndjekur krahas popullsisë vendase dhe jo një vend në të. Por lëvizja sioniste i konsideroi këto propozime si një herezi.

Ndryshimi ndërmjet ngulitjes përkrah popullsisë vendase dhe thjesht zhvendosjes së tyre u arsyetua nga Mahatma Gandi, kur ju kërkua nga filozofi hebre Martin Buber të jepte mbështetjen e tij për projektin sionist. Në vitin 1938, Buberit ju kërkua nga Ben-Gurioni që të ushtronte trysni mbi disa figura të njohura morale që të shprehnin mbështetjen e tyre publike për sionizmin. Ata mendonin se miratimi nga Gandi, si udhëheqës i një lufte kombëtare jo të dhunshme kundër imperializmit, do të ishte tepër i dobishëm dhe ishin përgatitur të shfrytëzonin respektin e tij për Buberin, me qëllim që ta arrinin këtë gjë. Deklarata kryesore e Gandit mbi Palestinën dhe çështjen hebreje u shfaq në editorialin e tij shumë popullor në *"Harijan"* më 11 nëntor të vitit 1938, në mesin e një revolte të madhe nga palestinezët vendas kundër politikave prosioniste të qeverisë britanike. Gandi e filloi artikullin e tij duke thënë se kishte simpati për hebrenjtë, si një popull që i ishin nënshtruar një trajtimi jonjerëzor dhe përndjekjeje gjatë shekujve. Por ai shtoi:

"Simpatia ime nuk më verbon aq sa të mos shoh kërkesat e drejtësisë. Thirrja për një shtëpi kombëtare për hebrenjtë nuk më tërheq shumë. Sanksionimi i saj është kërkuar në Bibël dhe me kokëfortësinë me të cilët hebrenjtë digjen për t'u rikthyer në Palestinë. Përse nuk duhet që ata, ashtu si popujt e tjerë të botës, ta bëjnë atë vend ku kanë lindur dhe ku fitojnë jetesën shtëpinë e tyre?"[57]

Kështu Gandi vuri në dyshim logjikën më themelore të sionizmit politik, duke hedhur poshtë idenë e një shteti hebre në tokën e premtuar dhe duke treguar se *"Palestina e konceptit biblik nuk ishte një vendndodhje gjeografike."* Në këtë mënyrë, Gandi nuk e aprovoi projektin sionist për hir të arsyetimit politik dhe atij fetar. Miratimi i këtij projekti nga qeveria britanike veçse e armiqësoi akoma më shumë Gandin. Ai nuk kishte pikë dyshimi se kujt i përkiste Palestina:

"Palestina i përket arabëve në po të njëjtin kuptim që Anglia i përket anglezëve apo Franca francezëve. Është e gabuar dhe aspak njerëzore t'ia imponosh hebrenjtë arabëve... Sigurisht do të ishte një krim kundër

[57] Cituar në Jonathan K. Crane, *"Faltering Dialogue? Religious Rhetoric of Mohandas Ghandi and Martin Buber,"* Anaskati Darshan, 3:1 (2007), fq. 34–52. Shih gjithashtu A. K. Ramakrishnan, *"Mahatma Ghandi Rejected Zionism,"* The Wisdom Fund, August 15, 2001, në twf.org.

njerëzimit t'i nënshtrosh arabët vetëm e vetëm që Palestina t'iu rikthehet hebrenjve, pjesërisht apo tërësisht, si atdheu i tyre kombëtar."[58]

Përgjigja e Gandit ndaj çështjes së Palestinës përmban disa shtresa kuptimi, që nga pikëpamja etike deri në realizmin politik. Është interesante se, ndonëse ai besonte fort në pandashmërinë e fesë nga politika, vazhdimisht dhe me shumë forcë, ai e kundërshtoi nacionalizmin kulturor dhe fetar të sionizmit. Justifikimi fetar për të pretenduar një shtet-komb nuk e tërhoqi aspak atë. Buberi iu përgjigj artikullit të tij, duke u munduar ta justifikonte sionizmin, por me sa duket, Gandit i kishte ardhur në majë të hundës dhe korrespondenca u ndërpre.

Në të vërtetë, hapësira që lëvizja sioniste kërkonte për vete nuk përcaktohej nga nevoja për të shpëtuar hebrenjtë e përndjekur, por nga dëshira për të marrë sa më shumë nga Palestina dhe me sa më pak banorë që të ishte e mundur. Dijetarë të matur dhe sekularistë hebrenj u përpoqën që të qëndronin "shkencorë" në përkthimin e një premtimi të mjegullt nga e kaluara e lashtë në një fakt të tanishëm. Projekti tashmë ishte filluar nga kryehistoriani i bashkësisë hebreje në Palestinën e Mandatit, Ben-Zion Dinaburg (Dinur) dhe u vazhdua intensivisht pas krijimit të shtetit në vitin 1948. Produkti i tij final paraqitet nga citimi i marrë nga faqja në internet e ministrisë së jashtme izraelite, që e kam përmenduar në kapitullin e parë. Detyra e Dinurit në vitet '30-të, ashtu si edhe ajo e pasardhësve të tij, ishte të provonin shkencërisht se në Palestinë kishte pasur një prani hebreje që nga kohët e romakëve.

Jo se dikush dyshonte për këtë. Pavarësisht argumentit historik se hebrenjtë që jetonin në Palestinën e shekullit XVIII e kundërshtuan nocionin e një shteti hebre, siç bënë hebrenjtë ortodoksë në fund të shekullit XIX, kjo gjë u hodh poshtë në shekullin XX. Dinuri dhe kolegët e tij e përdorën statistikën se hebrenjtë nuk përbënin më shumë se 2% të popullsisë së Palestinës së shekullit XVIII për të provuar vlefshmërinë e premtimit biblik dhe kërkesës moderne sioniste për Palestinën.[59] Kjo narrativë është bërë standard, histori e pranuar. Një nga profesorët më të shquar britanikë të historisë, sër Martin Gilbert, shkroi shumë vjet më parë *"Atlasin e konfliktit arabo-izraelit"*, të botuar në disa edicione nga Shtypshkronja Universitare e Kembrixhit.[60] Atlasi fillon me historinë e konfliktit në kohërat biblike, duke e marrë si të mirëqenë se territori ishte një mbretëri hebreje, në të cilin hebrenjtë ishin kthyer pas 2000 vitesh mërgimi. Hartat e tij e tregojnë krejt historinë: e para është e Palestinës biblike; e dyta e Palestinës nën romakët; e treta e Palestinës gjatë kohës së kryqëzatave dhe katërta, e Palestinës në vitin 1882. Pra, asgjë e rëndësishme nuk ka ndodhur ndërmjet periudhës mesjetare dhe mbërritjes së sionistëve të parë. Vetëm kur të huajt janë në Palestinë: romakë, kryqtarë, sionistë, atëherë ajo vlen të përmendet.

Tekstet shkollore izraelite tashmë bartin të njëjtin mesazh të së drejtës mbi tokën, të mbështetur mbi një premtim biblik. Në një letër, që ministria e arsimit ia dërgonte të gjitha shkollave në Izrael në vitin 2014, thuhet: *"Bibla përbën infrastrukturën kulturore të shtetit të Izraelit. Në të bazohet e drejta jonë mbi tokën."*[61] Studimet biblike janë tashmë një përbërës thelbësor dhe i zgjeruar i kurrikulës, me një fokus të veçantë mbi Biblën, e cila rrëfen një histori të lashtë që justifikon të drejtën mbi tokën. Historitë biblike dhe mësimet kombëtare që nxirren prej tyre janë shkrirë së bashku me studimin e Holokaustit dhe krijimin

[58] Cituar në Avner Falk, *"Buber and Ghandi,"* Ghandi Marg, 7th year, tetor 1963, fq. 2. Ka disa faqe si *"Ghandi Archives"* që e kanë dialogun të plotë.
[59] Ben-Zion Dinaburg's *The People of Israel in their Land: From the Beginning of Israel to the Babylonian Exile* u botuan në hebraisht në vitin 1936 dhe një vëllim i dytë, *Israel in Exile*, në vitin 1946.
[60] Martin Gilbert, *The Atlas of the Arab-Israeli Conflict*, Oxford: Oxford University Press, 1993.
[61] Letra u publikua ne faqen zyrtare në internet, me datë 29 nëntor 2014.

e shtetit të Izraelit në vitin 1948. Një vijë e drejtpërdrejtë e lidh këtë letër të vitit 2014 me evidencën e dhënë nga David Ben-Gurioni në vitin 1937 para Komisionit Mbretëror Peel (Royal Peel Commission), komisionit hetimor britanik të ngritur për t'i gjetur një zgjidhje konfliktit që kishte plasur. Në diskutimet publike për të ardhmen e Palestinës, Ben-Gurioni iu tundi anëtarëve të komisionit një kopje të Biblës, duke bërtitur: *"Ky është Kushani ynë (prova e kadastrës osmane), e drejta jonë mbi Palestinën nuk rrjedh nga Karta e Mandatit, Bibla është Karta jonë e Mandatit."*[62]

Natyrisht, nga ana historike nuk ka kuptim ta mësojmë Biblën, atë që ju ndodhi hebrenjve të Evropës dhe luftën e vitit 1948 si një kapitull historik. Por nga ana ideologjike, të tre çështjet janë të lidhura së bashku dhe të indoktrinuara si justifikimi bazë për shtetin hebre në kohën tonë. Diskutimi i rolit të Biblës në Izraelin e sotëm na çon tek një pyetje tjetër: A është sionizmi një lëvizje kolonizuese?

[62] Tom Segev, *One Palestine*, e plotë, London: Abacus, 2001, fq. 401.

KREU IV

SIONIZMI NUK ËSHTË KOLONIALIZËM

Toka e Palestinës nuk ishte bosh kur kolonët e parë sionistë mbërritën atje në vitin 1882. Ky fakt ishte i njohur për udhëheqësit sionistë që para mbërritjes së kolonëve të parë hebrenj atje. Një delegacion i dërguar në Palestinë nga organizatat e hershme sioniste i raportonte kolegëve: *"Nusja është e bukur, por është e martuar me një burrë tjetër."*[63] Megjithatë, kur mbërritën për herë të parë, kolonët e hershëm u befasuan kur takuan vendasit, të cilët i konsideronin pushtues dhe të huaj. Sipas pikëpamjes së tyre, palestinezët vendas kishin pushtuar atdheun e tyre. Atyre ju ishte thënë nga udhëheqësit se vendasit nuk ishin autoktonë dhe se nuk kishin të drejtë mbi tokën, por ishin një problem që duhej dhe mund të zgjidhej.

Ky rebus nuk ishte unik: sionizmi ishte një lëvizje ngulitëse kolonizuese, e ngjashme me lëvizjet e evropianëve që kishin kolonizuar dy Amerikat, Afrikën e Jugut, Australinë dhe Zelandën e Re. Kolonializmi ngulitës ndryshon nga kolonializmi klasik në tre aspekte. I pari është që kolonitë ngulitëse mbështeten vetëm fillimisht dhe përkohësisht mbi perandorinë për të mbijetuar. Në fakt, në shumë raste, si në Palestinë, ashtu edhe në Afrikën e Jugut, kolonët nuk i përkasin të njëjtit komb si pushteti perandorak, duke e ripërcaktuar veten si një komb i ri, disa herë nëpërmjet një lufte për çlirim kundër vetë perandorisë që i kishte përkrahur, siç ndodhi për shembull me revolucionin Amerikan. Ndryshimi i dytë është që kolonializmi ngulitës motivohet nga një dëshirë për të zaptuar toka të një vendi të huaj, ndërsa kolonializmi klasik lakmon burimet natyrore në zotërimet e reja gjeografike të tij. Ndryshimi i tretë ka të bëjë me mënyrën se si e trajtojnë ata destinacionin e ri të ngulimit. Ndryshe nga projektet koloniale konvencionale të zbatuar në shërbim të një perandorie ose një vendi mëmë, kolonialistët ngulitës ishin refugjatë të një lloji që nuk kërkonin vetëm një shtëpi, por një atdhe. Problemi ishte që "atdhetë" e rinj ishin të banuar tashmë nga popuj të tjerë. Në përgjigje të tij, bashkësitë koloniste argumentonin se toka e re ishte e tyre, sepse gëzonin të drejtë hyjnore apo morale, edhe nëse, si në shumë raste të tjera përveç sionizmit, ata nuk pretendonin të kishin jetuar atje mijëra vjet më parë. Në shumë raste, metoda e pranuar e kapërcimit të këtyre pengesave ishte genocidi kundër banorëve vendas.[64]

Një nga dijetarët kryesorë të kolonializmit ngulitës, Patrik Uollf (Patrick Wolfe), argumenton se projektet koloniale ngulitëse ishin të motivuara nga ajo që ai e quan "logjika e eliminimit." Kjo do të thotë që kolonistët zhvilluan justifikimet e nevojshme morale dhe mjetet praktike për të dëbuar vendasit. Siç tregon Uollf, nganjëherë kjo logjikë përfshin genocidin aktual, herë të tjera, spastrim etnik ose një regjim shtypës që ju mohon vendasve çdo të drejtë.[65] Unë do të shtoja që kishte edhe një logjikë tjetër pas logjikës së eliminimit: logjika e çnjerëzimit. Duke qenë vetë një viktimë e përndjekjeve në Evropë, ty të duhet së pari të çnjerëzosh një komb të tërë vendas apo një shoqëri, para se të jesh i gatshëm t'i bësh të njëjtën gjë, apo edhe më keq, njerëzve të tjerë.

Si rezultat i këtyre dy logjikave, kombe dhe qytetërime të tëra u fshinë nga faqja e dheut nga lëvizja kolonialiste ngulitëse në të dy Amerikat. Amerikanët vendas, në jug dhe në veri, u masakruan, u

[63] Benjamin Beit-Hallahmi, *Original Sins: Reflections on the History of Zionism and Israel*, London: Palgrave Macmillan, 1992, fq. 74.
[64] Patrick wolfe, *"Settler Colonialism and the Logic of Elimination of the Native," Journal of Genocide Research*, 8:4 (2006), fq. 387–409.
[65] Po aty.

konvertuan me dhunë në krishtërim dhe në fund, u mbyllën nëpër rezervate. Një fat të njëjtë patën aborigjenët në Australi dhe deri-diku edhe maorët në Zelandën e Re. Në Afrikën e Jugut, këto procese përfunduan me imponimin e sistemit të aparteidit mbi popullsinë vendase, ndërsa një sistem më kompleks ju imponua algjerianëve për rreth një shekull.

Ndaj sionizmi nuk është "sui generis", por një shembull i një procesi më të gjërë. Kjo është e rëndësishme, jo vetëm për të kuptuar makinacionet e projektit kolonialist, por edhe për të interpretuar rezistencën palestineze ndaj tij. Nëse deklarojmë se Palestina ishte një tokë pa popull në pritje të një populli pa tokë, atëherë ju kemi hequr palestinezëve çdo argument për t'u vetëmbrojtur. Të gjithë përpjekjet e tyre për t'u kapur fort pas tokës së tyre bëhen veprime të pabazuara dhe të dhunshme kundër pronarëve të ligjshëm. Kështu është e vështirë të ndash diskutimin e sionizmit si kolonializëm nga çështja e palestinezëve si një popull vendas i kolonizuar. Të dy janë të lidhur bashkë në të njëjtën analizë.

Rrëfimi zyrtar izraelit ose mitologjia themeluese refuzon që t'iu lejojë palestinezëve as të drejtën më të vogël morale për t'i rezistuar kolonizimit hebre të atdheut të tyre që filloi në vitin 1882. Që në fillimet e saj, rezistenca palestineze u portretizua si e motivuar nga urrejtja për hebrenjtë. Ajo u akuzua se po promovonte një fushatë terrori antisemit, që kishte filluar me mbërritjen e kolonëve të parë dhe kishte vazhduar deri në krijimin e shtetit të Izraelit. Ditarët e sionistëve të hershëm tregojnë një histori të ndryshme. Ato janë plot me anekdota që zbulojnë se sa mirë u pritën kolonët nga palestinezët, që ju ofruan strehë dhe në shumë raste, ju mësuan se si të punonin tokën.[66] Vetëm kur u bë e qartë se kolonët nuk kishin ardhur për të jetuar krahas popullsisë vendase, por për ta zëvendësuar atë, filloi rezistenca palestineze, duke marrë shpejt formën e çdo lufte tjetër kundër kolonializmit.

Idea se hebrenjtë e varfëruar meritonin një strehë të sigurtë nuk u kundërshtua nga palestinezët dhe ata që i mbështetnin ata. Por udhëheqësit sionistë nuk vepruan në të njëjtën mënyrë. Ndërsa palestinezët ju ofruan strehë dhe punësim kolonëve të hershëm, duke mos kundërshtuar që të punonin krah për krah me ta nën çdo pronësi, ideologët sionistë ishin shumë të qartë në lidhje me nevojën për t'i nxjerrë palestinezët jashtë tregut të punës në vend dhe për t'i dënuar ata kolonë që akoma punësonin palestinezë apo punonin bashkë me ta. Kjo ishte idea e *"avoda ivrit"* (Puna Hebreje), që nënkuptonte kryesisht nevojën për t'i dhënë fund *"avoda aravit"* (Punës Arabe). Në veprën e tij bazë mbi Alijahun e Dytë, valën e dytë të emigrimit sionist (1904-1914), Gershon Shafir e shpjegon mirë se si u zhvillua dhe u praktikua kjo ideologji.[67] Udhëheqësi i asaj vale, David Ben-Gurioni, i cili u bë udhëheqës i bashkësisë dhe më pas, kryeministër i Izraelit, vazhdimisht i referohet punës arabe si një sëmundje, ilaçi i vetëm për të cilën ishte puna hebreje. Në letrat e tij dhe të kolonistëve të tjerë, punëtorët hebrenj karakterizohen nga gjaku i shëndoshë që do ta imunizojë kombin nga kalbëzimi dhe vdekja. Gjithashtu Ben-Gurioni shkruan se punësimi i arabëve i kujtonte atij një histori të vjetër hebreje për një budalla që kishte ringjallur një luan të ngordhur, i cili më pas e vrau dhe hëngri atë.[68]

Reagimi i parë pozitiv palestinez i hutoi disa kolonistë gjatë periudhës së sundimit britanik (1918-1948). Prirja kolonialiste ishte të injorohej popullsia vendase dhe të krijoheshin bashkësi të mbyllura. Por jeta të ofron mundësi të ndryshme. Ekzistojnë prova të shumta të bashkëekzistencës dhe bashkëpunimit ndërmjet hebrenjve të sapombërritur dhe popullsisë vendase gati kudo. Kolonët hebrenj, veçanërisht në

[66] Shih Pappe, *"Shtetl Colonialism."*

[67] Për një diskutim të këtyre veprave dhe një prezantim të hershëm të paradigmës kolonialiste në hulumtimin e sionizmit, shih Ram, *"The Colonisation Perspective in Israeli Sociology."*

[68] Natan Hofshi, *"A Pact with the Land,"* in *The Book of the Second Aliya*, fq. 239.

qendrat urbane, nuk mund të mbijetonin pa u angazhuar, të paktën ekonomikisht, me palestinezët. Megjithë përpjekjet e shumta të udhëheqjes sioniste për t'i prishur këto ndërveprime, qindra biznese të përbashkët u krijuan ndër ato vite, krahas bashkëpunimit sindikalist dhe atij bujqësor. Por pa një mbështetje politike nga lart, kjo nuk mund t'i hapte rrugën një realiteti të ndryshëm në Palestinë.[69]

Në të njëjtën kohë me shtimin e agresivitetit të lëvizjes sioniste, edhe udhëheqësit politikë palestinezë filluan të tregohen më armiqësorë ndaj këtyre nismave të përbashkëta. Kuptimi i ngadaltë në mesin e elitës politike, shoqërore dhe kulturore palestineze se sionizmi ishte një projekt kolonialist, e forcoi identitetin e përbashkët kombëtar në kundërvënien ndaj kolonëve. Përfundimisht, pati edhe një trysni palestineze nga lart për t'i dhënë fund bashkëpunimit dhe ndërveprimit. Lëvizjes politike palestineze ju desh kohë që të shfaqej, duke u zhvilluar nga një grup i vogël, shoqëria muslimano-kristiane, në disa qytete palestineze. Parimet udhëheqëse të shoqërisë që ishin kryesisht moderne dhe sekulare, ju shtuan shqetësimeve të dyfishta të botës arabe: një këndvështrim panarab i ngjizur me një patriotizëm vendas që u bë gjithnjë e më i fortë pas Luftës së Dytë.

Shpërthimi i parë i nacionalizmit panarab kishte ndodhur në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Ai solli me vete shpresën për shndërrimin e botës osmane në një republikë të pavarur arabe, pak a shumë si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ose një perandori arabo-osmane si ajo Austro-Hungareze. Kur u bë e qartë se kjo shtytje nuk mund t'i bënte ballë interesave imperialiste të Britanisë dhe Francës, që donin t'a ndanin mes vetes Lindjen e Mesme osmane, atëherë u zhvillua një version nacionalizmi më vendor, i kapur fort pas hartës së krijuar nga kufinjtë administrativë osmanë dhe ndarjes së zonës nga fuqitë koloniale. Siç është përmendur në kapitullin e parë, shtytja e parë nacionaliste arabe quhet *"kaumijjeh"*, ndërsa versioni i mëvonshëm vendor mori emrin *"vatanijjeh"*. Bashkësia palestineze luajti rol në të dyja. Intelektualët e saj u angazhuan dhe ishin anëtarë të organizatave dhe lëvizjeve të ndryshme që kërkonin bashkim, pavarësi dhe vetëvendosje arabe. Në të njëjtën kohë, bile para se Britania të përcaktonte, me ndihmën e fuqive të tjera evropiane, hapësirën gjeopolitike të quajtur Palestinë, kishte një ekzistencë të veçantë palestineze të shfaqur në zakonet e njerëzve, dialektin e tyre arab dhe historinë e përbashkët.

Kur sionistët mbërritën në Palestinë në fund të shekullit XIX, të dyja shtytjet ishin akoma aktive në mesin e bashkësisë palestineze. Shumë prej intelektualëve dhe veprimtarëve të saj po ëndërronin për një republikë arabe të bashkuar. Të tjerë ishin të dhënë pas idesë së një Sirije të Madhe, ku Damasku do të ishte qendra e një shteti të ri, me Palestinën si pjesë të tij. Me mbërritjen e britanikëve dhe kur bashkësia ndërkombëtare, nëpërmjet Lidhjes së Kombeve, filloi diskutimin e së ardhmes së Palestinës, palestinezë të shquar botuan një gazetë me emrin *"Siria Jugore"* dhe bile po mendonin të krijonin një parti me të njëjtin emër.[70] Në vitin 1919, kur presidenti amerikan Udrou Uillson (Woodrow Wilson) dërgoi një komision hetimor, Komisionin King-Krejn (King-Crane), për të parë më mirë dëshirat e palestinezëve, doli se shumica donte që territori të ishte i pavarur.

Si ata që ishin panarabë, si patriotët vendas apo ata që donin të ishin pjesë e Sirisë së madhe, që të gjithë palestinezët i bashkonte dëshira për të mos qenë pjesë e një shteti hebre. Udhëheqësit e tyre ishin kundër çdo zgjidhjeje politike që do t'ia dorëzonte, qoftë edhe një pjesë të vendit të tyre të vogël, bashkësisë së kolonistëve. Siç e shprehën qartë në negociatat e tyre me britanikët në fundin e viteve '20, ata ishin gati ta ndanin vendin bashkë me ata që kishin mbërritur tashmë, por nuk pranonin më shumë se kjo.[71] Zëri i

[69] Unë i kam shqyrtuar me hollësi këto marrëdhënie në *A History of Modern Palestine*, fq. 108–16.
[70] Khalidi, *Palestinian Identity*, fq. 239.
[71] Shih Pappe, *A History of Modern Palestine*, fq. 109–16.

përbashkët i palestinezëve u kristalizua në trupën ekzekutive të Konferencës Kombëtare Palestineze, që u mblodh çdo vit gjatë një dhjetëvjeçari, duke filluar nga viti 1919. Ky organ i përfaqësoi palestinezët në negociatat e tyre, si me qeverinë britanike, ashtu edhe me lëvizjen sioniste. Megjithatë, para se kjo të ndodhte, britanikët u munduan që më parë të arrinin në një marrëveshje barazije mes të dyja palëve. Në vitin 1928, udhëheqja palestineze, pa marrë parasysh dëshirat e shumicës dërrmuese të popullit palestinez, ra dakord që t'i lejonte kolonëve hebrenj përfaqësim i barabartë në të gjitha organet e ardhshme të shtetit. Udhëheqja sioniste ishte në favor të kësaj ideje për sa kohë që ajo dyshonte se palestinezët do ta refuzonin atë. Përfaqësimi i përbashkët binte ndesh me gjithçka që sionizmi mishëronte. Kështu, kur propozimi u pranua nga pala palestineze, ai u hodh poshtë nga sionistët. Kjo çoi në trazirat e vitit 1929, që përfshinë masakrën e hebrenjve në Hebron dhe një numër shumë më të madh viktimash nga bashkësia palestineze.[72] Por kishte edhe arsye të tjera për valën e dhunës, më seriozja që nga fillimi i Mandatit. Ajo shpërtheu si pasojë e shpronësimit të qiramarrësve të tokave të çifligarëve që mungonin dhe parisë vendore, që ishin blerë nga Fondi Kombëtar Hebre. Qiramarrësit kishin jetuar për shekuj në ato toka, por tani u detyruan të jetojnë nëpër lagjet e varfëra të qyteteve. Në një lagje të tillë të varfër në verilindje të qytetit të Hajfas, predikuesi i mërguar sirian Izzuddin El-Kassam rekrutoi pasuesit e tij të parë për një xhihad islam kundër britanikëve dhe lëvizjes sioniste në fillim të viteve '30. Trashëgimia e tij u përjetësua, kur emrin e tij e mori krahu ushtarak i lëvizjes Hamas.

Pas vitit 1930, udhëheqja palestineze u institucionalizua në formën e Komitetit të Lartë Arab, një organ që përfaqësonte të gjitha partitë dhe lëvizjet politike në bashkësinë palestineze. Deri në vitin 1937, ai vazhdoi përpjekjet për të arritur në një kompromis me qeverinë britanike, por në atë kohë sionistëve dhe imperialistëve nuk ju interesonte më pikëpamja palestineze dhe njëanshmërisht vazhduan punën për të përcaktuar të ardhmen e territorit. Këtë rradhë lëvizja kombëtare palestineze e konsideroi sionizmin si një projekt kolonialist që duhej mundur. Megjithatë, edhe në vitin 1947, kur Britania vendosi t'ia referonte çështjen Kombeve të Bashkuara, me kështillimin e vendeve të tjera arabe, palestinezët propozuan një shtet të bashkuar në Palestinë që do të zëvendësonte Mandatin. Kombet e Bashkuara e diskutuan fatin e Palestinës për shtatë muaj dhe duhej të vendosnin të zgjidhnin mes dy opcioneve: atij të propozuar nga palestinezët të një shteti të bashkuar, që do të përthithte kolonët hebrenj ekzistues, por nuk do të lejonte kolonizim sionist të mëtejshëm dhe tjetrit që propozonte ndarjen e tokës në një shtet arab dhe një shtet hebre. Kombet e Bashkuara preferuan opcionin e dytë, kështu që mesazhi për palestinezët ishte i qartë: nuk mund të jetoni në një vend me kolonët, gjithçka që mund të shpresoni është të shpëtoni gjysmën e Palestinës dhe t'ia jepni gjysmën tjetër kolonëve.

Kështu çdokush e kupton se sionizmi është një lëvizje ngulitëse koloniale dhe se lëvizja kombëtare palestineze është një lëvizje antikolonialiste. Në këtë kontekst, mund ta kuptojmë sjelljen dhe politikat e udhëheqësit të bashkësisë palestineze, haxhi Emin El-Husejnit, para dhe pas Luftës së Dytë Botërore, në një dritë të ndryshme nga rrëfimi që normalisht serviret si një fakt historik. Shumë lexues mund ta dinë se një nga akuzat e përhapura pa u ndalur nga izraelitët është se udhëheqësi palestinez ishte simpatizant i nazizmit. Myftiu i Jeruzalemit nuk ishte engjëll. Në moshë të re, ai ishte zgjedhur nga paria e Palestinës dhe nga britanikët për të mbajtur postin më të rëndësishëm fetar në bashkësi. Posti, të cilin El-Husejni e mbajti gjatë gjithë periudhës së Mandatit (1922-1948), i dha atij pushtet politik dhe një pozitë të lartë shoqërore. Ai u mundua ta udhëheqë bashkësinë përballë kolonizimit sionist dhe kur në vitet '30, njerëz të tillë si Izzuddin el-Kassami shtynin drejt luftës së armatosur, ai ja doli që ta shmangte shumicën nga opcioni i dhunshëm. Megjithatë, kur mbështeti idenë e grevave, demonstratave dhe rrugëve të tjera në

[72] Shih Ilan Pappe, *The Ethnic Cleansing of Palestine*, Oxford: Oneworld, 2006, fq. 29–39.

përpjekje për të ndryshuar politikën britanike, ai u bë armiku i perandorisë dhe ju desh të largohej nga Jeruzalemi në vitin 1938.[73] Në këto rrethana, ai u detyrua të binte në krahët e armikut të armikut të tij, në këtë rast Italisë dhe Gjermanisë. Gjatë dy viteve të strehimit politik në Gjermani, ai ra nën ndikimin e doktrinës naziste dhe filloi të ngatërronte dallimin ndërmjet hebraizmit dhe sionizmit. Gatishmëria e tij për të shërbyer si radiokomentator për nazistët dhe ndihma e tij për rekrutimin e muslimanëve të Ballkanit në shërbim të luftës së Gjermanisë, pa dyshim që e njollosin karrierën e tij. Por ai nuk veproi ndryshe nga udhëheqësit sionistë në vitet '30, që kërkuan të bëjnë aleancë me nazistët kundër Perandorisë Britanike, apo lëvizjet e tjera antikolonialiste, që donin të hiqnin qafe perandorinë nëpërmjet aleancash me armiqtë e saj kryesorë.

Kur lufta përfundoi në vitin 1945, myftiu erdhi në vete dhe u mundua t'i organizonte palestinezët në prag të Nekbes, por tashmë ai nuk kishte pushtet dhe bota së cilës i përkiste, ajo e parisë arabo-osmane, kishte shkuar me kohë. Nëse meriton të kritikohet, ai nuk duhet kritikuar për gabimet që bëri në lidhje me sionizmin, por për mungesën e simpatisë për gjendjen e vështirë të fshatarëve në Palestinë dhe për mosmarrëveshjet e tij me parinë vendore, që e dobësuan lëvizjen antikolonialiste. Asgjë që ai bëri nuk e justifikon referimin e tij në projektin amerikano-sionist "Enciklopedia e Holokaustit", i cili është i dyti më i gjati pas atij të Hitlerit.[74] Përfundimisht, as gabimet dhe as arritjet e tij, nuk patën shumë ndikim në rrjedhën e historisë palestineze. Ai nuk u trajtua si kriminel lufte nga aleatët dhe në fund të luftës, u lejua të kthehej në Egjipt, por jo në Palestinë.

Megjithë gabimet e tij para se të ikte nga Palestina në vitin 1938 dhe deri diku edhe në mërgim, ai udhëhoqi një lëvizje çlirimtare antikolonialiste. Fakti që ishte myfti, njeri që besonte se feja duhej vënë në shërbim të luftës kundër një lëvizjeje kolonialiste që lakmonte atdheun e tij dhe kërcënonte ekzistencën e popullit të tij, nuk është relevant. Lëvizje antikolonialiste si Fronti për Çlirimin Kombëtar (FLN) në Algjeri dhe shumë lëvizje të tjera çlirimtare në botën arabe që luftonin për pavarësi nga Italia, Britania dhe Franca, kishin lidhje të fortë me Islamin. As përkushtimi i myftiut ndaj dhunës dhe as ai i udhëheqësve të tjerë si Izzuddin El-Kassam (i vrarë nga britanikët në vitin 1935 dhe i varrosur pranë Hajfas), nuk është diçka e veçantë në historinë e luftërave antikolonialiste. Lëvizjet çlirimtare në Amerikën Jugore dhe në Azinë Juglindore nuk ishin organizata pacifiste dhe besonin tek lufta e armatosur, po aq sa edhe tek procesi politik. Sikur myftiu të kishte qenë në gjendje të kthehej në Palestinë, do ta kishte kuptuar se jo vetëm që sionizmi ishte një projekt i suksesshëm i kolonializmit ngulitës, por ç'është më e rëndësishmja që ai ishte në prag të projektit të tij qenësor më vendimtar.

Deri në vitin 1945, sionizmi kishte tërhequr më shumë se gjysëm milioni kolonë në një vend, popullsia e të cilit ishte gati dy milionë. Disa erdhën me lejen e qeverisë së Mandatit, disa pa leje. Popullsia vendase nuk u pyet fare dhe as që u mor parasysh kundërshtimi i saj ndaj projektit të kthimit të Palestinës në një shtet hebre. Kolonët ia dolën të ngrenin një shtet brenda shtetit, duke ndërtuar të gjithë infrastrukturën e nevojshme, por dështuan në dy gjëra. Ata ia dolën të blenin vetëm 7% të tokës, që nuk mjaftonte për një shtet të ardhshëm. Gjithashtu, ata ishin akoma një pakicë, një e treta në një vend, në të cilin donin të ishin kombi ekskluziv.

Ashtu si edhe me lëvizjet e mëparshme koloniale ngulitëse, përgjigja e këtyre problemeve ishte logjika binjake e asgjësimit dhe çnjerëzimit. E vetmja rrugë për kolonët që të rritnin kontrollin mbi tokën përtej

[73] Shih Pappe, *The Rise and Fall of a Palestinian Dynasty*, fq. 283–7.
[74] Për një analizë më të hollësishme, shih Ilan Pappe, *The Idea of Israel: A History of Power and Knowledge*, London and New York: Verso, 2010, fq. 153–78.

shifrës 7% dhe sigurimin e një shumice ekskluzive demografike ishte dëbimi i vendasve nga atdheu i tyre. Kështu që sionizmi është një projekt kolonial ngulitës dhe që akoma nuk ka përfunduar. Nga ana demografike, Palestina nuk është një vend krejtësisht hebre dhe ndonëse Izraeli e kontrollon atë politikisht nëpërmjet mënyrave të ndryshme, shteti i Izraelit akoma kolonizon dhe ndërton koloni të reja në Galile, Negev dhe Bregun Perëndimor, me qëllim rritjen e numrit të hebrenjve atje, duke shpronësuar palestinezët dhe duke ju mohuar vendasve të drejtën për të pasur atdheun e tyre.

KREU V

PALESTINEZËT U LARGUAN VULLNETARISHT NGA ATDHEU I TYRE NË VITIN 1948

Lindin dy pyetje në lidhje me këtë pretendim dhe të dyja do të shqyrtohen këtu. Së pari: a ekzistonte një dëshirë për t'i dëbuar palestinezët? Së dyti: në prag të luftës së vitit 1948, a ju bë thirrje palestinezëve që vullnetarisht të largoheshin nga shtëpitë e tyre, siç thotë mitologjia sioniste?

Thelbi i idesë së transferimit në mendimin sionist është analizuar, për mendimin tim në mënyrë shumë bindëse, në librin e Nur Masalhas *"Dëbimi i palestinezëve"*.[75] Këtu unë do të shtoj vetëm disa citime për të theksuar idenë se udhëheqja dhe ideologët sionistë nuk mund të përfytyronin një zbatim të suksesshëm të projektit të tyre pa hequr qafe më parë popullsinë vendase, qoftë me marrëveshje, ashtu edhe me forcë. Kohët e fundit, pas vitesh të tërë mohimi, historianë sionistë si Anita Shapira e kanë pranuar se heronjtë e tyre, udhëheqësit e lëvizjes sioniste, e kishin paramenduar seriozisht transferimin e palestinezëve. Megjithatë, ata kapen fort dëshpërimisht pas faktit se ekzistonte një konfuzion ndërmjet transferimit "të detyrueshëm" dhe atij "vullnetar".[76] Është e vërtetë se në tubimet publike të gjithë udhëheqësit dhe ideologët sionistë flisnin për transferim me marrëveshje, por edhe ato fjalime zbulojnë një të vërtetë të hidhur: nuk ekziston diçka e quajtur transferim vullnetar. Është semantikë dhe jo praktikë.

Berl Kacnelson (Berl Katznelson) ka qenë ndoshta një nga ideologët më të rëndësishëm sionistë në vitet '30. Ai njihej si ndërgjegja morale e lëvizjes. Mbështetja e tij për transferimin ishte tepër e qartë. Në konferencën e 20-të sioniste të mbledhur pak kohë pasi britanikët bënë propozimin e tyre të parë dhe të rëndësishëm për paqe, ai shprehu fuqimisht mbështetjen e tij për këtë ide, duke ju drejtuar të pranishmëve:

"Ndërgjegja ime është krejt e pastër. Një fqinj i largët është më i mirë se një armik i afërt. Ata nuk do të humbasin nga transferimi i tyre dhe po ashtu as ne. Në analizën përfundimtare, kjo është një reformë politike e përfitimit për të dyja palët. Për një kohë të gjatë kam qenë i bindur se kjo është zgjidhja më e mirë... dhe kjo duhet të ndodhë në një prej këtyre ditëve."[77]

Kur dëgjoi se qeveria britanike po konsideronte mundësinë e lëvizjes së palestinezëve brenda Palestinës, ai u zhgënjye shumë: *"Transferimi brenda Palestinës do të thotë në zonën e Shekemit (Nablusit). Unë besoj se e ardhmja e tyre gjendet në Siri dhe Irak."*[78]

Në atë kohë, udhëheqës si Kacnelsoni shpresonin se britanikët do ta bindnin apo nxitnin popullsinë vendase që të largohej. Në një letër të turpshme të Ben-Gurionit për të birin Amos, në tetor të vitit 1937, ai e kishte kuptuar se mund të ishte e nevojshme që kjo gjë të bëhej me forcë.[79] Në të njëjtin vit, Ben-Gurioni e mbështeti publikisht Kacnelsonin, duke thënë:

---

[75] Nur Masalha, *Expulsion of the Palestinians: The Concept of "Transfer" in Zionist Political Thought, 1882–1948*, Washington: Institute for Palestine Studies, 1992.
[76] Shih Anita Shapira, *Land and Power*, New York: Oxford University Press, 1992, fq. 285–6.
[77] Cituar në David Ben-Gurion, *The Roads of Our State*, Am Oved: Tel Aviv, 1938, fq. 179–180 (në hebraisht).
[78] Po aty.
[79] Lexoje letrën të përkthyer në palestineremembered.com.

"Transferimi i detyrueshëm i arabëve nga luginat e shtetit të propozuar hebre mund të na japë diçka që kurrë nuk e kemi pasur, bile as kur ishim të pavarur në ditët e tempujve të parë dhe të dytë... Na është dhënë shansi që nuk kemi guxuar ta ëndërrojmë as në imagjinatën tonë më të shfrenuar. Ky është më shumë se një shtet, qeveri dhe sovranitet; ky është konsolidim kombëtar në një atdhe të lirë."[80]

Në një mënyrë po kaq të qartë, ai i tha asamblesë sioniste në vitin 1937: *"Në shumë pjesë të vendit nuk do të jetë e mundur të ngulitemi pa transferuar më parë fshatarët arabë,"* të cilën ai shpresonte se do ta bënin britanikët.[81] Por, me apo pa britanikët, Ben-Gurioni e artikuloi qartë vendin e dëbimit në të ardhmen e projektit sionist në Palestinë, kur po atë vit shkruante: *"...Unë e mbështes trasferimin e detyruar. Nuk shoh asgjë jomorale në të."*[82]

Në vitin 2008, një gazetar izraelit, duke rishqyrtuar këto deklarime nga e shkuara, erdhi në përfundimin se edhe pas 70 vjetësh, ato ishin akoma të pranueshme për shumë izraelitë. Me të vërtetë, që nga viti 1937, dëbimi i palestinezëve ka qenë pjesë e ADN-së sioniste të shtetit modern hebre.[83] Megjithatë, procesi nuk ishte i hapur. Ben-Gurioni dhe udhëheqës të tjerë ishin të kujdesshëm për atë që duhej bërë nëse dilte që ishte e pamundur të bindeshin palestinezët për t'u larguar. Përtej kësaj, ata nuk ishin të prirur për të artikuluar ndonjë politikë. Gjithçka që Ben-Gurioni donte të thonte ishte se ai nuk e kundërshtonte transferimin e detyruar, por nuk e konsideronte atë të nevojshëm në ato rrethana historike.

Kjo ambivalencë i ra në sy Kacnelsonit. Në një tubim publik në vitin 1942, ai u pyet në lidhje me këtë nga disa udhëheqës majtistë sionistë, që mendonin se Ben-Gurioni kishte hequr dorë nga ideja e transferimit të palestinezëve. Ai u përgjigj: *"Për aq sa e njoh unë ideologjinë sioniste, ky (transferim) është pjesë e zbatimit të sionizmit. Kuptimi i këtij sionizmi është transferimi i njerëzve nga një vend në një tjetër, një transferim me marrëveshje."*[84] Në publik, Ben-Gurioni, udhëheqësi i lëvizjes, dhe ideologë të tjerë si Kacnelsoni, ishin në favor të asaj që ata e quanin transferim vullnetar. Ben-Gurioni thonte: *"Transferimi i arabëve është më i lehtë se çdo transferim tjetër, sepse zona është plot me shtete arabe";* duke shtuar se transferimi për palestinezët do të ishte përmirësim, por pa e shpjeguar se përse. Ai propozonte që ata të transferoheshin në Siri, duke vazhduar të flasë edhe për transferimin vullnetar.[85]

Megjithatë, ky nuk ishte një qëndrim i ndershëm dhe as që mund të ishte i tillë. Në fakt, kolegët e këtyre udhëheqësve dhe ideologëve nuk mund ta mendonin se si ky transferim të mund të ishte gjithçka, por jo një transferim i detyruar. Në një mbledhje të mbyllur të ekzekutivit të Agjencisë Hebreje në qershor të vitit 1938 të kushtuar transferimit, duket se të gjithë anëtarët e mbledhur, duke përfshirë Ben-Gurionin, Kacnelsonin, Sharetin (Sharett) dhe Usishkinin (Ussishkin), ishin në favor të transferimit të detyruar. Kacnelsoni u mundua të shpjegonte se ç'donte të thonte më termin *"i detyruar"*: *"Ç'duhet kuptuar me transferim të detyruar? A është transferim kundër dëshirës së Shtetit Arab? Kundër kësaj dëshire, asnjë forcë në botë nuk mund ta zbatojë një transferim të tillë."*[86] Ai shpjegoi se me "transferim të detyruar" nënkuptohej mposhtja e rezistencës së vetë palestinezëve:

[80] Yosef Gorny, *The Arab Question and the Jewish Problem*, Am Oved: Tel Aviv, 1985, fq. 433 (në hebraisht).
[81] Benny Morris, *Righteous Victims: A History of the Zionist-Arab Conflict*, 1881–1999, New York: Random House, 2001, fq. 142.
[82] Masalha, *Expulsion of the Palestinians*, fq. 117.
[83] Shih raportin e Eric Bender në Maariv, 31 mars 2008.
[84] Berl Katznelson, *Writings*, Tel Aviv: Davar, 1947, Vëllimi 5, fq. 112.
[85] *Central Zionist Archives, Minutes of the Jewish Agency Executive*, May 7, 1944, fq. 17–19.
[86] *Central Zionist Archives, Minutes of the Jewish Agency Executive*, June 12, 1938, fq. 31–2.

"Nëse të duhet të bësh marrëveshje transferimi me çdo fshat dhe çdo individ arab, nuk do ta zgjidhësh kurrë këtë problem. Ne vazhdimisht bëjmë transferime të individëve arabë, por problem do të jetë transferimi i një numri të madh arabësh me një marrëveshje me Shtetin Arab."[87]

Ky ishte mashtrimi. Biseda ishte për një transferim vullnetar dhe strategjia ishte në rritje deri sa erdhi shansi për një transferim masiv në vitin 1948. Edhe sikur ta pranosh tezën e Beni Morrisit (Benny Morris) në librin e tij *"Lindja e problemit të refugjatit palestinez"*, se praktikisht transferimi ishte në rritje dhe jo masiv, pasi u arrit një farë numri, prapë se prapë, sado në rritje që të ishte, përfundimi është një spastrim masiv etnik, për të cilin do të flitet më shumë më pas.

Nga promemoriet e takimit të qershorit të vitit 1938 mësojmë se gjuha e transferimit vullnetar në fakt do të thonte transferim i detyruar. Ben-Gurioni deklaronte se zbatimi i një transferimi të detyruar, veçanërisht nëse bëhej nga britanikët, *"do të ishte arritja më e madhe në historinë e kolonizimit sionist në Palestinë."* Ai shtonte: *"Unë favorizoj transferimin e detyruar, nuk shoh asgjë joetike në të."* Menahem Usishkini (Menachem Ussishkin), një udhëheqës dhe ideolog i shquar, shtonte se *"më etike ishte t'i transferoje arabët jashtë Palestinës dhe t'i ringulitje ata në kushte më të mira."* Ai linte të kuptohej se ndoshta kjo ishte edhe logjika që qëndronte pas Deklaratës së Balfurit. Për më tepër, ata nuk humbën kohë të fillonin një diskutim mbi shifrat dhe mjetet për arritjen e tyre. Këto çështje do të finalizoheshin vetëm në vitin 1948, por themelet u hodhën në atë takim të vitit 1938. Vetëm një pakicë shumë e vogël e pjesëmarrësve të pranishëm e kundërshtuan transferimin e detyruar. Siria ishte destinacioni i preferuar dhe shpresohej që të ishin në gjendje të lëviznin të paktën 100.000 palestinezë në valën e parë.[88]

Diskutimi për transferimin u la në pritje gjatë Luftës së Dytë Botërore, sepse bashkësia u fokusua në rritjen e numrit të emigrantëve hebrenj dhe ngritjen e shtetit të ardhshëm. Biseda u rindez kur u bë e qartë se Britania ishte në prag të largimit nga Palestina. Vendimi britanik u shpall në shkurt të vitit 1947, që përkon me intensifikimin e diskutimit mbi transferimin e detyruar. Në librin tim *"Spastrimi etnik i Palestinës"*, kam shqyrtuar mënyrën se si këto diskutime nga viti 1947 evoluan në një masterplan për dëbimin masiv të palestinezëve në mars të vitit 1948 (Plani D), të cilit do t'i rikthehem më vonë në këtë kapitull. Megjithatë, vija zyrtare izraelite nuk ka ndryshuar prej vitesh: palestinezët u bënë refugjatë, sepse udhëheqësit e tyre dhe ata të botës arabe ju thanë që të largohen nga Palestina para se ushtritë arabe të sulmonin dhe dëbonin hebrenjtë, pas së cilës mund të ktheheshin. Por nuk ka pasur kurrë një thirrje të tillë. Është vetëm një mit i shpikur nga ministria e jashtme izraelite. Qëndrimi i ministrisë së jashtme izraelite mbi përpjekjen jetëshkurtër të OKB-së për të vendosur paqe menjëherë pas luftës së vitit 1948 ishte se refugjatët ia kishin mbathur. Megjithatë, ai proces i veçantë paqeje, i cili zgjati pak muaj në gjysmën e parë të vitit 1949, ishte aq i shkurtër sa që Izraelit nuk ju kërkua të sillte prova në lidhje me pretendimin e tij dhe për shumë vite, problemi i refugjatëve u fshi nga axhenda ndërkombëtare.

Nevoja për të sjellë prova u shfaq në fillimin e viteve 1960, siç kemi mësuar së fundmi nga puna e palodhur e Shaj Hazkanit (Shay Hazkani), një reporteri freelance që punon për gazetën Haaretz.[89] Sipas hulumtimit të tij, gjatë ditëve të para të administratës Kenedi në Uashington, qeveria amerikane filloi të ushtronte trysni mbi Izraelin që të lejonte rikthimin në Izrael të refugjatëve të vitit 1948. Që nga viti 1948, qëndrimi zyrtar amerikan kishte qenë në mbështetje të së drejtës së palestinezëve për t'u rikthyer. Në fakt, që në vitin 1949, amerikanët kishin ushtruar trysni mbi Izraelin për të riatdhesuar refugjatët dhe i kishin

[87] Po aty.
[88] Po aty.
[89] Shay Hazkani, *"Catastrophic Thinking: Did Ben-Gurion Try to Re-write History?," Haaretz*, 16 maj 2013.

vendosur sanksione shtetit hebre për shkak të kundërshtimit të tij për t'iu përmbajtur kësaj kërkese. Megjithatë, kjo ishte një trysni afatshkurtër dhe me intensifikimin e Luftës së ftohtë, amerikanët e humbën interesin për këtë problem deri në ardhjen në pushtet të Xhon Ficxherald Kenedit (J. F. Kennedy), i cili ishte i fundmi president amerikan që refuzoi t'i jepte Izraelit ndihmë të gjerë ushtarake. Pas vrasjes së tij, rubineta u hap deri në fund, gjë që e shtyu Oliver Stounin (Oliver Stone) që të aludonte për një lidhje të Izraelit me vrasjen e presidentit në filmin e tij *"JFK"*.

Një nga veprimet e para të administratës Kenedi në këtë front ishte marrja pjesë aktivisht në një diskutim të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi këtë temë, në verën e vitit 1961. Kryeministrin Ben-Gurion e kapi paniku. Ai ishte i bindur se, me bekimin amerikan, Kombet e Bashkuara mund ta detyronin Izraelin që të riatdhesonte refugjatët. Ben-Gurioni deshi që akademikët izraelitë të kryenin hulumtime që do të provonin se palestinezët u larguan me vullnetin e tyre dhe për këtë qëllim ju drejtua Institutit Shiloah, asokohe qendra udhëheqëse akademike izraelite mbi studimet e Lindjes së Mesme. Kjo detyrë ju ngarkua Roni Gabait (Ronni Gabai), një hulumtuesi të ri. Me lejen për të pasur akses në dokumentat e klasifikuara, ai arriti në përfundimin se dëbimet, frikësimi dhe kërcënimet ishin shkaqet kryesore të eksodit palestinez. Ai nuk gjeti asnjë provë për një thirrje nga udhëheqja arabe drejtuar palestinezëve që të largoheshin për t'i hapur rrugë ushtrive sulmuese. Megjithatë këtu ka një enigmë. Përfundimi i sapopërmendur u shfaq në doktoraturën e Gabait mbi këtë temë dhe përmendet prej tij si ai që ai i dërgoi ministrisë së jashtme.[90] E megjithatë, në hulumtimin e tij nëpër arkiva, Hazkani gjeti një letër nga Gabai për ministrinë e jashtme, ku përmblidhte hulumtimin e tij dhe citonte thirrjen arabe për t'u larguar si shkakun kryesor për eksodin.

Hazkani e intervistoi Gabain, i cili edhe sot e kësaj dite ngul këmbë që nuk është ai që e ka shkruar atë letër dhe se ajo nuk pasqyron hulumtimin që ai kishte bërë. Dikush, që akoma nuk e dimë se kush është, dërgoi një përmbledhje të ndryshme të hulumtimit. Sidoqoftë, Ben-Gurioni nuk u gëzua. Ai e ndjeu se përmbledhja, të cilën nuk e lexoi të gjithën, nuk ishte shumë prekëse, ndaj kërkoi një hulumtues që njihte, Uri Lubranin, më vonë një ekspert i Mosadit për Iranin, që të ndërmerrte një studim të dytë. Lubrani ja kaloi stafetën Moshe Maozit, sot një nga orientalistët më të mëdhenj izraelitë. Maozi e kreu detyrën si duhej dhe në shtator të vitit 1962, Ben-Gurioni mori në dorë atë që ai e përshkroi si libri ynë i bardhë që provonte përtej çdo dyshimi se palestinezët kishin ikur, sepse ashtu ju ishte thënë të vepronin. Moazi më vonë bëri një doktoraturë në Oksford nën të ndjerin Albert Hurani (Albert Hourani) mbi një temë që nuk ka lidhje me këtë, por tha në një intervistë se hulumtimi i tij ishte ndikuar pak nga dokumentat dhe shumë nga detyra politike që i ishte dhënë.[91]

Dokumentat që Gabai shqyrtoi në fillimin e vitit 1961 u deklasifikuan në fundin e viteve '80 dhe disa historianë, mes tyre Beni Morris dhe unë, panë për herë të parë dëshminë për atë që i shtyu palestinezët të largoheshin nga Palestina. Ndonëse Morrisi dhe unë nuk biem dakord mbi atë se sa i paramenduar dhe planifikuar ishte dëbimi, përsëri jemi dakord se nuk kishte asnjë thirrje nga udhëheqësit arabë dhe palestinezë për popullsinë që të largohej. Hulumtimi ynë, i përshkruar si vepër e "historianëve të rinj", riafirmoi përfundimin e Gabait që palestinezët e humbën atdheun dhe shtëpitë kryesisht si pasojë e dëbimit, kërcënimit dhe frikësimit.[92]

Morisi mbron pikëpamjen se fillimi i luftës ndërmjet Izraelit dhe ushtrive arabe që hynë në vend ditën kur përfundoi Mandati Britanik, më 15 maj 1948, ishte shkaku kryesor për atë që ai e quan *"Lindja e problemit*

[90] Po aty.
[91] Po aty.
[92] I pari që i hodhi poshtë këto thirrje ishte gazetari irlandez Erskine Childs në *The Spectator*, 12 maj 1961.

të refugjatëve palestinezë". Unë kam argumentuar se shkaku nuk ishte vetë lufta, sepse gjysma e atyre që u bënë refugjatë, pra qindra mijëra palestinezë, ishin dëbuar pa filluar akoma lufta. Veç kësaj, unë kam argumentuar se lufta u fillua nga Izraeli, me qëllim shfrytëzimin e shansit historik për t'i dëbuar palestinezët.[93]

Ideja që palestinezët u larguan vullnetarisht nuk është i vetmi pretendim i rremë i shoqëruar me luftën e vitit 1948. Janë edhe tre të tjerë që shpesh përmenden në përpjekje për të shpjeguar ngjarjet e atij viti. I pari është që palestinezët e kishin fajin për atë që ju ndodhi, sepse e hodhën poshtë planin e OKB-së për ndarje në nëntor të vitit 1947. Ky pretendim injoron natyrën kolonialiste të lëvizjes sioniste. Është e qartë se spastrimi etnik i palestinezëve në asnjë mënyrë nuk mund të justifikohet si "ndëshkim" për hedhjen poshtë prej tyre të një plani paqeje të OKB-së, i cili ishte thurur pa asnjë këshillim me vetë palestinezët.

Dy pretendimet e tjera të shoqëruar me vitin 1948 janë që Izraeli ishte një David në luftë me një Goliath arab dhe se pas luftës, Izraeli shtriu dorën e pajtimit, por palestinezët dhe bota arabe e kundërshtuan një gjest të tillë. Hulumtimet mbi pretendimin e parë kanë provuar se palestinezët nuk kishin asnjë fuqi ushtarake dhe se shtetet arabe dërguan vetëm një kontingjent relativisht të vogël trupash, shumë më të vogël se forcat hebreje, si dhe shumë më pak të armatosur dhe stërvitur. Veç kësaj, këto trupa u dërguan në Palestinë jo si reagim ndaj shpalljes së themelimit të shtetit të Izraelit, por në përgjigje të operacioneve sioniste që kishin filluar që në shkurt të vitit 1948 dhe veçanërisht pas masakrës së mirëdokumentuar në fshatin Dejr Jasin pranë Jeruzalemit në prill të vitit 1948.[94]

Në lidhje me mitin e tretë që shteti izraelit shtriu dorën e paqes pas konfliktit, dokumentat tregojnë të kundërtën. Në fakt, udhëheqja intransigjente izraelite haptazi refuzoi që të futej në negociata mbi të ardhmen e Palestinës pas Mandatit ose të merrte parasysh kthimin e popullsisë që ishte dëbuar apo arratisur. Në një kohë që qeveritë arabe dhe udhëheqësit palestinezë ishin të gatshëm që të merrnin pjesë në një nismë të re dhe më të arsyeshme paqeje nga OKB-ja, udhëheqja izraelite bëri një sy qorr kur, në shtator të vitit 1948, terroristë hebrenj vranë ndërmjetësuesin për paqe të OKB-së, kontin Bernadot (Bernadotte). Më tej ata kundërshtuan çdo propozim të ri për paqe të miratuar nga organi që zëvendësoi Bernadotin: Këshilli i Pajtimit të Palestinës (Palestine Conciliation Commission – PCC), kur negociatat e reja filluan në fund të vitit 1948. Për rrjedhojë, e njëjta Asamble e Përgjithshme e OKB-së, që kishte votuar me shumicë prej dy të tretash për planin e ndarjes në nëntor të vitit 1947, votoi pa kundërshtime për një plan të ri për paqe në dhjetor 1948. Kjo ishte Rezoluta 194, e miratuar më 11 dhjetor 1948. Ajo kishte tre rekomandime: rinegocimi i ndarjes së Palestinës në një mënyrë që do t'i përshtatej më mirë realitetit demografik në terren; kthimi i plotë dhe pa kushte i të gjithë refugjatëve dhe ndërkombëtarizimi i Jeruzalemit.[95]

Intransigjenca izraelite do të vazhdonte. Siç e tregon historiani Avi Shlaim në librin e tij *"Perdja e hekurt"*, ndryshe nga miti që palestinezët nuk lanë asnjë rast pa e kundërshtuar paqen, ishte Izraeli ai që në mënyrë konstante i kundërshtoi të gjitha ofertat e vëna mbi tryezë.[96] Kjo filloi me kundërshtimin e ofertës për paqe dhe ideve të freskëta mbi refugjatët të propozuara nga sundimtari sirian Husni Ez-Zaim në vitin 1949, për të vazhduar me minimin nga ana e Ben-Gurionit të propozimeve të para për paqe të dërguara nga Xhemal

[93] Ilan Pappe, *"Why Were They Expelled?: The History, Historiography and Relevance of the Refugee Problem,"* në Ghada Karmi dhe Eugene Cortan (eds.), *The Palestinian Exodus, 1948–1988*, London: Ithaca 1999, fq. 37–63.
[94] Shih Pappe, *The Ethnic Cleansing of Palestine*.
[95] Avi Shlaim, *The Iron Wall: Israel and the Arab World*, London: Penguin, 2014.
[96] Po aty.

Abdun-Naseri në fillim të viteve ’50. Dihet mirë se si Izraeli refuzoi që të tregojë fleksibilitet në negociatat me mbretin Husejn në vitin 1972 të ndërmjetësuara nga Henri Kisinxher në lidhje me Bregun Perëndimor dhe nuk pranoi që t’i vinte veshin paralajmërimit të presidentit të Egjiptit, Enver Es-Sadat, në vitin 1971, se nëse nuk do të negocionin ballë për ballë në lidhje me Sinain, ai do të detyrohej që të hynte në luftë për këtë gjë, të cilën e bëri dy vjet më pas, duke i shkaktuar një goditje traumatike ndjenjës së sigurisë dhe pathyeshmërisë së Izraelit.

Të gjithë këto mite që rrethojnë vitin 1948 shkrihen së bashku në imazhin e një shteti hebre që lufton kundër çdo vështirësie, i shtrin dorën e ndihmës palestinezëve, i inkurajon ata të qëndrojnë dhe ju propozon atyre paqe, vetëm për t’u ndodhur para faktit se “nuk ka partner” në anën tjetër. Mënyra më e mirë për t’iu kundërvënë këtij imazhi është t’i ripërshkruajmë, me durim dhe sistematikisht, ngjarjet që ndodhën në Palestinë ndërmjet viteve 1946 dhe 1949.

Në vitin 1946, qeveria britanike në Londër mendoi se mund ta mbante Palestinën edhe për ca kohë. Ajo filloi të lëvizte forca ushtarake nga Egjipti në territorin e Palestinës, ndërkohë që lufta egjiptiane për çlirim kombëtar u intensifikua atë vit. Megjithatë, një dimër i ashpër në fundin e atij viti, tensionet në rritje mes grupeve paraushtarake sioniste, që kishin filluar aksionet kundër forcave britanike dhe, më e rëndësishmja, vendimi për t’u larguar nga India, sollën një ndryshim dramatik në politikën britanike ndaj Palestinës. Të dy bashkësitë: kolonët dhe vendasit, reaguan në mënyrë shumë të ndryshme ndaj këtyre lajmeve. Bashkësia palestineze dhe udhëheqësit e saj menduan se procesi do të ishte i ngjashëm me atë në vendet fqinje arabe. Administrata e Mandatit do ta transferonte gradualisht pushtetin tek popullsia vendase, e cila do të vendoste në mënyrë demokratike për natyrën e shtetit të ardhshëm. Por sionistët ishin shumë më të përgatitur për atë që do të vinte. Menjëherë pas vendimit të Londrës për t’u tërhequr, udhëheqja sioniste u përgatit në dy fronte: diplomatikisht dhe ushtarakisht, duke bërë përgatitje për një përballje të ardhshme.

Në fillim, fokusi kryesor ishte tek diplomacia. Kjo mori formën e gjetjes së rrugëve për të hedhur poshtë pretendimin e mirëargumentuar palestinez për një vendim demokratik në lidhje me të ardhmen e vendit. Një rrugë e veçantë për këtë qëllim ishte lidhja e Holokaustit dhe fatit të hebrenjve nëpër botë me atë të të bashkësisë koloniste hebreje në Palestinë. Kështu diplomatët sionistë u përpoqën që të bindin bashkësinë ndërkombëtare se çështja se kush do ta zëvendësonte Britaninë si fuqi sovrane në Palestinë ishte e lidhur me fatin e të gjithë hebrenjve në botë. Akoma më intensivisht, kjo politikë u lidh me nevojën për ta kompensuar popullin hebre për vuajtjet e tyre gjatë Holokaustit.

Rezultati i kësaj ishte Rezoluta e OKB-së mbi Ndarjen e 29 nëntorit të vitit 1947. Dokumenti u përgatit nga një komitet i posaçëm: UNSCOP, i përbërë nga përfaqësues, që kishin pak ose aspak dijeni për çështjen e Palestinës. Ideja që ndarja e territorit ishte zgjidhja më e mirë erdhi nga vetë lëvizja sioniste. Në fakt, anëtarët e komitetit morën pak mendim nga palestinezët. Komiteti i lartë Arab, institucioni përfaqësues politik i palestinezëve dhe Lidhja Arabe, vendosën ta bojkotojnë UNSCOP-in. Tashmë ishte e qartë se e drejta e palestinezëve për të pasur atdheun e tyre nuk do të respektohej në të njëjtën mënyrë siç kishte ndodhur me irakianët dhe egjiptianët. Menjëherë pas Luftës së Parë Botërore, Lidhja e Kombeve e kishte njohur të drejtën e të gjithë kombeve në Lindjen e Mesme për vetëvendosje. Vendimi i vitit 1947 për t’i përjashtuar palestinezët (ngjashëm me vendimin për të përjashtuar kombin kurd) ishte një gabim i rëndë që është njëri nga shkaqet kryesore të konfliktit të vazhdueshëm në rajon.

Sionistët sugjeruan që 80% e Palestinës duhet të ishte një shtet hebre, ndërsa pjesa që mbetej, ose mund të bëhej një shtet i pavarur arab palestinez, ose të aneksohej dhe t’i dorëzohej Mbretërisë së Jordanisë.

Vetë Jordania ishte me mendje të ndarë më dysh për sa i përket përpjekjeve të OKB-së: nga njëra anë, atyre po ju ofrohej një zgjerim i mundshëm i mbretërisë së tyre të thatë në pjesë të Palestinës pjellore, ndërsa nga ana tjetër, ata nuk donin të shiheshin si tradhtarë të çështjes palestineze. Dilema u bë akoma më e mprehtë kur udhëheqja hebreje i ofroi hashemitëve në Jordani një marrëveshje në lidhje me këtë. Në një farë mënyre, nga fundi i luftës së vitit 1948, Palestina ishte pak a shumë e ndarë mes lëvizjes sioniste dhe Jordanisë.[97]

Megjithatë, nuk ekzistonte një kontrol absolut sionist mbi UNSCOP-in. Komiteti, i cili diskutoi mbi zgjidhjen mes muajve shkurt-nëntor 1947, i rishikoi planet sioniste. Ai e zgjeroi zonën e caktuar për palestinezët dhe nguli këmbë që duhet të kishte dy shtete të pavarura. Padyshim që ata shpresonin se të dy shtetet do të formonin një bashkim ekonomik dhe do të ndanin një politikë të përbashkët emigracioni, në mënyrë që çdo bashkësi të kishte opcionin për të votuar në shtetin tjetër, nëse dëshironin ta bënin këtë gjë. Siç zbulohet në dokumentat e deklasifikuar, udhëheqja sioniste e pranoi hartën e re dhe kushtet e ofruara nga OKB-ja, sepse e dinin se pala tjetër e kishte kundërshtuar këtë plan. Gjithashtu, ata e dinin se ndarja përfundimtare e territorit do të përcaktohej nga veprimet në terren dhe jo nga negociatat në dhomën e komitetit.[98] Rezultati më i rëndësishëm ishte legjitimimi ndërkombëtar i shtetit hebre, duke përfshirë kufinjtë e shtetit të ardhshëm. Në prapavështrim, ne mund të çmojmë se nga perspektiva e udhëheqjes sioniste në vitin 1948, ata ndoqën qasjen e duhur kur bëhet fjalë për ngritjen e shtetit pa përcaktuar kufinjtë.

Kjo udhëheqje nuk ndenji duarkryq ndërmjet planit të ndarjes dhe fundit të Mandatit në maj të vitit 1948. Ata duhej të ishin aktivë. Në botën arabe, trysnia mbi qeveritë për të përdorur forcën kundër shtetit të ri hebre ishte në rritje. Ndërkohë, në tokën e Palestinës, grupet paraushtarake vendase filluan të ndërmerrnin sulme, kryesisht kundër transportit hebre dhe kolonive të izoluara, në përpjekje për t'i dalë para zbatimit të një vendimi ndërkombëtar për ta kthyer atdheun e tyre në një shtet hebre. Këto momente rezistence ishin mjaft të kufizuara dhe shteruan në javët pas shpalljes nga OKB-ja të ndarjes. Në të njëjtën kohë, udhëheqja sioniste po vepronte në tre fronte të veçanta. I pari përfshinte përgatitjen për mundësinë e një invazioni ushtarak nga vendet arabe. Kjo ndodhi dhe e dimë se si forcat ushtarake hebreje përfituan nga mungesa e përgatitjes së vërtetë, motivimit dhe koordinimit të forcave arabe. Elitat politike arabe ishin shumë ngurruese për të ndërhyrë në Palestinë. Kishte një marrëveshje të heshtur me Jordaninë, që ajo do të merrte pjesë të Palestinës, të cilat më vonë do të bëheshin Bregu Perëndimor, në këmbim të një pjesëmarrjeje të kufizuar në luftë. Kjo doli të ishte një faktor vendimtar në balancën e fuqisë. Ushtria jordaneze ishte ushtria më e përgatitur në botën arabe.

Në frontin diplomatik, muajt e shkurtit dhe marsit të vitit 1948 ishin veçanërisht të nderë për lëvizjen sioniste. Shtetet e Bashkuara, nëpërmjet të dërguarve në terren, e kuptuan se plani i OKB-së për ndarje në nëntor 1947 ishte i mangët. Në vend që të sillte qetësi dhe shpresë në vend, vetë plani kishte qenë shkaku kryesor për shpërthimin e dhunës. Kishte raportime për palestinezë që po detyroheshin të largoheshin me forcë nga shtëpitë e tyre dhe vrasje nga të dyja palët. Të dyja palët sulmuan transportin publik të tjetrës dhe përleshjet në vijat ndarëse mes lagjeve arabë dhe hebreje në qytetet me popullsi të përzier vazhduan për disa ditë. Presidenti amerikan Herri Truman ra dakord që ta rishikonte idenë e ndarjes dhe sugjeroi një plan të ri. Nëpërmjet ambasadorit të tij në OKB, ai propozoi një kujdestari ndërkombëtare

[97] Avi Shlaim, *Collusion Across the Jordan: King Abdullah, the Zionist Movement and the Partition of Palestine*, New York: Columbia University Press, 1988.

[98] Kjo gjë është provuar në mënyrë bindëse nga Simha Flapan në *The Birth of Israel: Myths and Realities*, New York: Pantheon, 1988.

mbi të gjithë Palestinën për pesë vjet, për t'i dhënë më shumë kohë kërkimit të një zgjidhjeje.

Kjo lëvizje u ndalua menjëherë nga instrumenta të fshehtë. Ishte hera e parë që lobi hebre në Shtetet e Bashkuara u përdor për të ndryshuar qëndrimin e administratës amerikane. AIPAC-u nuk ekzistonte asokohe, por metoda u vu në veprim për të lidhur skenën politike të brendshme në Amerikë me interesat e sionizmit, dhe më pas të Izraelit, në Palestinë. Sidoqoftë, ajo funksionoi dhe administrata amerikane ju rikthye mbështetjes së saj për planin e ndarjes. Është interesante se Bashkimi Sovjetik ishte shumë më besnik ndaj qëndrimit sionist dhe nuk kishte asnjë dyshim. Me ndihmën e Partisë Komuniste të Palestinës (PKP), ata lehtësuan furnizimin me armë nga Çekosllovakia për forcat hebreje përpara dhe pas majit të vitit 1948. Lexuesit e sotëm mund të ngrenë vetullat për këtë, por mbështetja e PKP për çështjen sioniste ishte e mundur për dy arsye. Së pari: Bashkimi Sovjetik besonte se shteti i ri hebre do të ishte socialist dhe antibritanik, për rrjedhojë më i prirur ndaj Bllokut Lindor në Luftën e Ftohtë që sapo kishte filluar. Së dyti: PKP-ja besonte se çlirimi kombëtar ishte një fazë e nevojshme në rrugën drejt revolucionit të tyre më të plotë shoqëror dhe ata i pranonin si palestinezët, ashtu edhe sionistët, si lëvizje kombëtare (kjo është arsyeja që kjo parti akoma edhe sot mbështet zgjidhjen me dy shtete).[99]

Duke luftuar për të siguruar miratim ndërkombëtar, udhëheqja sioniste ishte e zënë duke përgatitur bashkësinë e saj për luftë, duke imponuar rekrutimin dhe taksimin e detyrueshëm, duke intensifikuar përgatitjet ushtarake dhe duke rritur blerjet e armëve. Gjithashtu ata ishin tepër efikasë në mbledhjen e informacioneve të fshehta që vinin në dukje mungesën e përgatitjes në pjesën tjetër të botës arabe. Puna në dy fronte: ushtarake dhe diplomatike, nuk e cënoi aspak strategjinë sioniste drejt çështjes më të rëndësishme që preokuponte udhëheqësit e lëvizjes: si të krijonin një shtet që të ishte, si demokratik, ashtu edhe hebre, në sa më shumë territore të Palestinës që mund të shtinin në dorë? Ose e thënë më ndryshe: çfarë të bënin me popullsinë palestineze në shtetin e ardhshëm hebre?

Diskutimet e ndryshme mbi këtë çështje përfunduan më 10 maj 1948, kur komanda e lartë prodhoi planin e poshtër Dalet: Planin D, i cili tregonte për fatin e palestinezëve që jetonin në zonat që do të pushtoheshin nga forcat hebreje. Debatet u udhëhoqën nga udhëheqësi i bashkësisë hebreje, David Ben-Gurioni, i cili ishte i vendosur që të siguronte ekskluzivitet demografik për hebrenjtë në çdo shtet të ardhshëm. Ky ishte një obsesion që jo vetëm na informon për veprimet e tij para vitit 1948, por edhe shumë kohë pas krijimit të shtetit të Izraelit. Siç do ta shohim, kjo e shtyu atë që të orkestronte spastrimin etnik të Palestinës dhe në vitin 1967, të kundërshtonte pushtimin e Bregut Perëndimor.

Në ditët e para pas miratimit të Rezolutës së Ndarjes, Ben-Gurioni i tregoi kolegëve të udhëheqjes se një shtet hebre, në të cilin hebrenjtë përbënin vetëm 60% të tij, nuk ishte i realizueshëm. Megjithatë, ai nuk tregoi se ç'përqindje të palestinezëve do ta bënte shtetin e ardhshëm të realizueshëm. Mesazhi që ai i përcolli gjeneralëve të tij dhe përmes tyre, trupave në terren, ishte tepër i qartë: sa më pak palestinezë në një shtet hebre, aq më mirë. Ashtu siç e kanë vërtetuar edhe dijetarë palestinezë si Nur Masalha dhe Ahmed Saadi, kjo është arsyeja se përse ai u mundua t'i hiqte qafe palestinezët që mbetën brenda shtetit hebre pas luftës *("pakica arabe")*.[100]

Në periudhën ndërmjet 29 nëntorit 1947 (kur u miratua rezoluta e OKB-së) dhe 15 majit 1948 (kur

[99] Materiale të reja dhe më të thelluara mbi këtë kthesë janë vënë në dukje në një libër të fundit nga Irene Gendzier, *Dying to Forget: Oil, Power, Palestine, and the Foundations of US Policy in the Middle East*, New York: Columbia University Press, 2015.

[100] Ahmad Sa'di, *"The Incorporation of the Palestinian Minority by the Israeli State, 1948–1970: On the Nature, Transformation and Constraints of Collaboration,"* Social Text, 21:2 (2003), fq. 75–94.

përfundoi Mandati Britanik) ndodhi diçka që e ndihmoi lëvizjen sioniste për t'u përgatitur më mirë për ditët në vijim. Me afrimin e fundit të Mandatit, forcat britanike u tërhoqën në portin e Hajfas. Çdo territor që ata lanë, u mor nga forcat ushtarake të bashkësisë hebreje dhe u spastrua etnikisht nga popullsia vendase, ndonëse Mandati akoma nuk kishte përfunduar. Procesi filloi në shkurt të vitit 1948 me disa fshatra dhe arriti kulmin në prill me spastrimin e Hajfas, Jaffas, Safedit, Bejsanit, Akkas dhe Jeruzalemit Perëndimor. Këto fazat e fundit ishin planifikuar sistematikisht prej kohësh në masterplanin "Plani D", të përgatitur bashkë me komandën e lartë të Haganasë (Haganah), krahut kryesor ushtarak të bashkësisë hebreje. Në plan tregoheshin qartë metodat që do të përdoreshin në procesin e spastrimit të popullsisë:

"Shkatërrimi i fshatrave (djegia, hedhja në erë dhe vendosja e minave në rrënoja), veçanërisht atyre qendrave të banuara që janë të vështira për t'u kontrolluar vazhdimisht...

Ndërmarrja e operacioneve të kërkim-kontrollit sipas udhëzimeve të mëposhtme: rrethimi i fshatit dhe kryerja e kërkimeve brenda në të. Në rast rezistence, forcat e armatosura duhen të shkatërrohen dhe popullsia të dëbohet jashtë kufinjve të shtetit."[101]

Si mundi ushtria e vogël izraelite të ndërmerrte operacione spastrimi etnik në shkallë të gjërë, ndërkohë që, prej 15 majit, ajo po përballej me forca të rregullta nga bota arabe? Pikë së pari, duhet të dimë se popullsia urbane, me përjashtim të tre qyteteve: Ludd, Ramle dhe Bir Seb'a, ishte spastruar prej kohësh, përpara mbërritjes së ushtrive arabe. Së dyti, zonat rurale palestineze ishin tashmë nën kontrollin izraelit dhe përballjet me ushtritë arabe ndodhën në kufinjtë e atyre zonave rurale dhe jo brenda tyre. Në një rast, kur jordanezët mund t'i kishin ndihmuar palestinezët në Ludd dhe Ramle, komandanti britanik i ushtrisë jordaneze, Sër Xhon Gllab (Sir John Glubb), vendosi që t'i tërhiqte trupat dhe të shmangte përballjen me ushtrinë izraelite.[102]

Së fundmi, përpjekjet ushtarake arabe mjerisht ishin joefikase dhe jetëshkurtra. Pas disa sukseseve në tre javët e para, prania e tyre në Palestinë ishte një histori e turpshme humbjesh dhe tërheqjesh me ngut. Pas një ndërprerjeje të shkurtër nga fundi i vitit 1948, spastrimi etnik izraelit vazhdoi pa u ndalur.

Nga këndvështrimi ynë i sotëm, nuk mundemi kurrsesi që t'i shmangemi etiketimit të veprimeve izraelite në fshatrat palestineze si krime lufte, bile si krime kundër njerëzimit. Nëse e injorojmë këtë fakt kokëfortë, kurrë nuk do të mund të kuptojmë se çfarë fshihet pas qëndrimit të Izraelit ndaj Palestinës dhe palestinezëve si sistem politik dhe shoqëri. Krimi i kryer nga udhëheqja sioniste, e cila më pas u bë qeveria e Izraelit, ishte ai i spastrimit etnik. Kjo nuk është retorikë boshe, por një padi me implikime afatgjata politike, ligjore dhe morale. Përkufizimi i krimit u sqarua pas luftës civile të viteve '90 në Ballkan: spastrimi etnik është çdo veprim nga një grup etnik për dëbimin e një grupi tjetër etnik, me qëllim shndërrimin e një rajoni të përzier etnikisht në një rajon të pastër. Një veprim i tillë përbën spastrim etnik, pavarësisht mjeteve të përdorura për ta arritur atë, që nga bindja dhe kërcënimet e deri tek dëbimet dhe vrasjet masive.

Për më tepër, vetë akti përcakton përkufizimin dhe si i tillë, disa politika janë konsideruar si spastrim etnik nga bashkësia ndërkombëtare, edhe nëse nuk është zbuluar ndonjë masterplan për ekzekutimin e tyre. Si rrjedhojë, në viktimat e spastrimit etnik përfshihen njerëzit që janë larguar nga shtëpitë e tyre nga frika

[101] *Walid Khalidi, "Plan Dalet: Master Plan for the Conquest of Palestine," Journal of Palestine Studies*, 18:1 (1988), fq. 4–33.

[102] Benny Morris, *The Birth of the Palestinian Refugee Problem Revisited*, Cambridge: Cambridge University Press, 2004, fq. 426.

dhe ata të dëbuar forcërisht si pjesë e një operacioni në vazhdim. Përkufizimet dhe referencat në lidhje me këtë gjë mund të gjenden në faqet në internet të Departamentit amerikan të Shtetit dhe Kombeve të Bashkuara.[103] Këto janë përkufizimet kryesore që udhëheqin Gjykatën Ndërkombëtare në Hagë, kur ajo ngarkohet me detyrën e gjykimit të personave përgjegjës për planifikimin dhe kryerjen e operacioneve të tilla.

Një studim i shkrimeve dhe mendimeve të udhëheqësve të hershëm sionistë tregon se nga viti 1948, ky krim ishte i paevitueshëm. Qëllimi i sionizmit nuk kishte ndryshuar: ai ishte i përkushtuar për vënien nën kontroll të sa më shumë territoreve të Palestinës së Mandatit që të ishte e mundur dhe zhdukjen e shumicës së fshatrave dhe lagjeve urbane palestineze nga hapësira e gllabëruar për shtetin e ardhshëm hebre. Zbatimi ishte më sistematik dhe përfshirës se sa ç'ishte projektuar në plan. Brenda shtatë muajve, u shkatërruan 531 fshatra dhe u boshatisën 11 lagje urbane. Dëbimi masiv u shoqërua me masakra, përdhunime dhe burgosje të meshkujve mbi moshën 10 vjeçare në kampe pune për periudha mbi një vit.[104]

Implikimi politik është që Izraeli është krejtësisht fajtor për krijimin e problemit të refugjatëve palestinezë, për të cilin mban si përgjegjësi ligjore, ashtu dhe morale. Implikimi ligjor është që, edhe nëse ekziston parashkrimi, pas një periudhe kaq të gjatë, për ata që kanë kryer një vepër të cilësuar si krim kundër njerëzimit, vetë vepra përbën akoma një krim, për të cilin askush nuk ka dalë përpara drejtësisë. Implikimi moral është që shteti hebre lindi nga mëkati, natyrisht si shumë shtete të tjerë, por mëkati apo krimi kurrë nuk është pranuar. Ç'është më e keqja, në mesin e disa qarqeve në Izrael kjo pranohet, por në të njëjtën kohë justifikohet plotësisht si një politikë e ardhshme kundër palestinezëve, kudo që të jenë. Ky krim vazhdon të kryhet edhe sot e kësaj dite.

Që të gjitha këto implikime janë injoruar plotësisht nga elita politike izraelite. Përkundrazi, nga ngjarjet e vitit 1948 është nxjerrë një mësim shumë i ndryshëm: se një shtet mund të dëbojë gjysmën e popullsisë së një vendi dhe të shkatërrojë gjysmën e fshatrave të tij pa u ndëshkuar fare. Menjëherë pas vitit 1948 dhe më pas, pasojat e një mësimi të tillë ishin të pashmangshme: vazhdimi i politikës së spastrimit etnik me çdo mjet. Në këtë proces ka shumë pika referimi të mirënjohura: dëbimi nga vetë Izraeli i shumë fshatarëve ndërmjet viteve 1948-1956; transferimi me forcë i 300.000 palestinezëve nga Bregu Perëndimor dhe Rripi i Gazës gjatë luftës së vitit 1967 dhe spastrimi i matur, por konstant, i palestinezëve nga zona e Jeruzalemit të Madh, që llogariten të jenë më shumë se 250.000 deri në vitin 2000.

Pas vitit 1948, politika e spastrimit etnik mori shumë forma. Në pjesë të ndryshme të territoreve të pushtuara dhe brenda Izraelit, politika e dëbimit u zëvendësua me ndalimin e popullsisë për t'u larguar nga fshatrat apo lagjet e tyre. Kufizimi i palestinezëve në vetëm ato vende ku jetonin i shërbente të njëjtit qëllim si dëbimit të tyre. Kur ata janë të rrethuar në enklava, si në zonat A, B dhe C në Bregun Perëndimor sipas Marrëveshjes së Oslos ose në fshatrat apo lagjet në Jeruzalem që janë shpallur si pjesë të Bregut Perëndimor apo në geton e Gazës, ata nuk llogariten demografikisht, si në rregjistrimet zyrtare, ashtu edhe ato jozyrtare, gjë që i intereson më shumë se çdo gjë tjetër politikanëve izraelitë.

Për aq kohë sa politikat e spastrimit etnik nga ana e Izraelit, në të shkuarën dhe të tashmen, nuk njihen dhe ndalohen nga bashkësia ndërkombëtare, nuk do të ketë asnjë zgjidhje për konfliktin izraelito-palestinez. Injorimi i çështjes së refugjatëve palestinezë vazhdimisht do të minojë çdo përpjekje për t'i

[103] US State Department, *Special Report on Ethnic Cleansing*, 10 maj 1999.
[104] I kam përshkruar hollësisht në *The Ethnic Cleansing of Palestine*.

pajtuar të dyja palët në konflikt. Kjo është arsyeja se përse është kaq e rëndësishme që ngjarjet e vitit 1948 të njihen si operacione spastrimi etnik, në mënyrë që të jemi të sigurtë që zgjidhja politike të mos i shmanget rrënjës së konfliktit, pra dëbimit të palestinezëve. Shmangie të tilla në të shkuarën kanë qenë shkaku kryesor i dështimit të të gjitha marrëveshjeve të mëparshme për paqe.

Nëse nuk nxirren mësime ligjore prej saj, do të ketë gjithmonë impulse ndëshkuese dhe emocione hakmarrëse nga ana palestineze. Njohja ligjore e Nekbas së vitit 1948 si një akt spastrimi etnik do të hapte rrugën për një formë drejtësie. Ky proces do të ishte i njëjtë me atë që ndodhi kohët e fundit në Afrikën e Jugut. Pranimi i të këqijave të së shkuarës nuk bëhet me qëllim sjelljen e kriminelëve përpara drejtësisë, por për sjelljen e vetë krimit përpara vëmendjes dhe gjykimit publik. Vendimi përfundimtar nuk do të jetë ndëshkues, pra nuk do të ketë dënim, por do të jetë rikthyes, pra viktimat do të kompensohen. Kompensimi më i arsyeshëm për rastin e veçantë të refugjatëve palestinezë u deklarua qartë në dhjetor të vitit 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në rezolutën e saj 194: rikthimi i pakushtëzuar i refugjatëve dhe familjeve të tyre në atdheun e tyre, bile edhe në shtëpitë e tyre aty ku është e mundur. Pa një gjë të tillë, shteti i Izraelit do të vazhdojë të ekzistojë si një enklavë armiqësore në zemër të botës arabe, përkujtuesi i fundit i një të kaluare kolonialiste që e ndërlikon marrëdhënien e Izraelit, jo vetëm me palestinezët, por me të gjithë botën arabe.

Megjithatë, është e rëndësishme që të theksojmë se ka hebrenj në Izrael që i kanë kuptuar të gjitha këto mësime. Jo të gjithë hebrenjtë janë indiferentë apo injorantë për Nekban. Ata që nuk janë të tillë, sot janë një pakicë e vogël, por e cila bën që prania e saj të ndjehet, duke treguar se të paktën disa qytetarë hebrenj nuk janë të shurdhër ndaj britmave, dhimbjes dhe shkatërrimit të atyre që u vranë, përdhunuan apo u plagosën gjatë vitit 1948. Ata kanë dëgjuar për mijëra qytetarët palestinezë të arrestuar dhe burgosur në vitet ’50, si dhe dinë për masakrën e Kefr Kasimit në vitin 1956, kur qytetarë të shtetit u vranë nga ushtria vetëm pse ishin palestinezë. Ata i dinë krimet e luftës të kryera gjatë luftës së vitit 1967 dhe bombardimin e pashpirt të kampeve të refugjatëve në vitin 1982. Ata nuk e kanë harruar abuzimin fizik të kryer ndaj të rinjve palestinezë në territoret e pushtuara në vitet ’80 e në vazhdim. Këta hebrenj izraelitë nuk janë të shurdhër dhe i dëgjojnë edhe sot zërat e oficerëve të ushtrisë që urdhërojnë ekzekutimin e njerëzve të pafajshëm dhe të qeshurat e ushtarëve që kalojnë pranë dhe bëjnë sehir.

Ata nuk janë të verbër. Ata i kanë parë rrënojat e 531 fshatrave të shkatërruar dhe lagjeve të rrënuara. Ata shohin atë që çdo izraelit mund ta shohë, por që në shumicën e rasteve zgjedh që të mos e shohë: rrënojat e fshatrave nën shtëpitë e kibuceve (kooperativave bujqësore sioniste) dhe nën drunjtë e pishave të pyjeve të Fondit Kombëtar Hebre (Jewish National Fund). Ata nuk kanë harruar se çfarë ka ndodhur, ndonëse pjesa tjetër e shoqërisë e ka harruar. Ndoshta ky është shkaku që ata e kuptojnë shumë mirë lidhjen ndërmjet spastrimeve etnike të vitit 1948 dhe ngjarjeve që pasuan dhe që vazhdojnë edhe sot. Ata e kuptojnë lidhjen ndërmjet heronjve të luftës së Izraelit për pavarësi dhe atyre që urdhëruan shtypjen mizore të dy intifadave. Ata kurrë nuk i morën Jichak Rabinin dhe Ariel Sharonin për heronj paqeje. Ata nuk pranojnë që të mos shohin lidhjen e qartë ndërmjet ndërtimit të murit dhe politikës më të gjerë të spastrimit etnik. Dëbimet e vitit 1948 dhe burgosjet e njerëzve brenda mureve sot janë pasoja të pashmangshme të së njëjtës ideologji raciste etnike. Ata nuk mund të mos e pranojnë lidhjen ndërmjet sjelljeve çnjerëzore kundër Gazës që nga viti 2006 dhe atyre politikave dhe praktikave të shkuara. Një mizori e tillë nuk lind nga asgjëja. Ajo ka një histori dhe një infrastrukturë ideologjike që e justifikon.

Duke qenë se udhëheqja politike palestineze e ka neglizhuar këtë aspekt të konfliktit, është shoqëria civile palestineze ajo që po kryeson përpjekjet për t’i rivendosur ngjarjet e vitit 1948 në qendër të axhendës

kombëtare. Brenda dhe jashtë Izraelit, organizata joqeveritare palestineze si BADIL, ADRID dhe El-Aude po koordinojnë luftën e tyre për të mbajtur gjallë kujtesën e vitit 1948 dhe po shpjegojnë se përse është kaq e rëndësishme të merresh me ngjarjet e atij viti për hir të së ardhmes.

KREU VI

LUFTA E VITIT 1967 NUK ISHTE NJË LUFTË E PASHMANGSHME

Në qershor të vitit 1982, pas sulmit të Izraelit kundër Libanit, kishte shumë debate në lidhje me deklaratën zyrtare që kombi nuk kishte "zgjedhje" tjetër veçse të ndiqte rrjedhën e dhunshme të veprimeve që kishte ndërmarrë. Asokohe, publiku izraelit ishte i ndarë mes atyre që e konsideronin fushatën si të nevojshme, duke e justifikuar atë, dhe atyre që dyshonin në vlefshmërinë morale të saj. Duke mbrojtur këto këndvështrime, të dyja palët e përdorën luftën e vitit 1967 si pikë referimi, duke e identifikuar konfliktin e mëparshëm si një shembull të pagabuar të një lufte "të pashmangshme". Ky është një mit.[105]

Sipas kësaj narrative të pranuar, lufta e vitit 1967 e detyroi Izraelin që të pushtonte Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës, për t'i mbajtur ato në ruajtje deri sa bota arabe ose palestinezët të shprehnin dëshirë për të bërë paqe me shtetin hebre. Rrjedhimisht, shfaqet edhe një mit tjetër, të cilin do ta diskutoj në një kapitull të veçantë, se gjoja udhëheqësit palestinezë ishin intransigjentë dhe për rrjedhojë paqja ishte e pamundur. Ky argument të krijon përshtypjen se sundimi i Izraelit ishte i përkohshëm dhe se territoret duhet të qëndronin në ruajtje derisa të kishte një qëndrimi "më të arsyeshëm" palestinez.

Me qëllim që të rivlerësojmë luftën e vitit 1967, së pari na duhet të kthehemi pas në luftën e vitit 1948. Elita politike dhe ushtarake izraelite e kanë konsideruar këtë të fundit si një shans të humbur: një moment historik, në të cilin Izraeli mund dhe duhej të kishte pushtuar të gjithë Palestinën historike, nga lumi Jordan deri në detin Mesdhe. Shkaku i vetëm që ata nuk vepruan kështu ishte një marrëveshje që ata kishin me Jordaninë fqinje. Kjo marrëveshje e fshehtë u negociua gjatë ditëve të fundit të Mandatit Britanik dhe kur u finalizua, ajo kufizoi pjesëmarrjen ushtarake të ushtrisë jordaneze në përpjekjen e përgjithshme luftarake arabe në vitin 1948. Në këmbim të kësaj, Jordanisë ju lejua që të aneksonte zonat e Palestinës që përbënë më pas Bregun Perëndimor. David Ben-Gurioni, i cili nuk e shkeli marrëveshjen e para vitit 1948, e quajti vendimin për t'i lejuar Jordanisë marrjen e Bregut Perëndimor si *"bechiya ledorot"*, që fjalë për fjalë do të thotë se brezat e ardhshëm do ta vajtonin këtë vendim. Një përkthim më metaforik mund të ishte: *"një gabim fatal historik".*[106]

Që nga viti 1948, pjesë të rëndësishme të elitave kulturore, ushtarake dhe politike izraelite kanë qenë në kërkim të një shansi për ta ndrequr këtë gabim. Nga mesi i viteve '60 e në vazhdim, me shumë kujdes, ata bënë plane se si të krijonin Izraelin e madh që do të përfshinte Bregun Perëndimor.[107] Në disa rrethana historike, ata gati arritën ta zbatojnë planin për t'u tërhequr në çastin e fundit. Më të famshmet janë ato të viteve 1958 dhe 1960, kur David Ben-Gurioni e ndaloi zbatimin e planit, së pari, nga frika ndaj reagimit ndërkombëtar dhe së dyti, për shkaqe demografike, duke llogaritur se Izraeli nuk mund të përthithte një numër kaq të madh palestinezësh. Shansi më i madh erdhi me luftën e vitit 1967. Më vonë, në këtë kapitull

[105] Jo të gjithë janë dakord mbi këtë gjë. Shih Avi Shlaim, *Israel and Palestine: Reprisals, Revisions, Refutations*, New York and London: Verso, 2010.
[106] Shlaim, *Collusion Across the Jordan*.
[107] Për të mësuar më shumë rreth këtij lobi dhe veprës së tij, shih Tom Segev *1967: Israel and the War That Transformed the Middle East*, New York: Holt and Company, 2008, dhe Ilan Pappe, "The Junior Partner: Israel's Role in the 1958 Crisis," në Roger Louis and Roger Owen (eds.), *A Revolutionary Year: The Middle East in 1958*, London and New York: I. B. Tauris 2002, fq. 245–74.

do të analizoj origjinën e asaj lufte, duke argumentuar se cilado qoftë narrativa historike e shkaqeve të saj, përsëri duhet parë nga afër roli i Jordanisë në të. Për shembull, a ishte e nevojshme të pushtohej dhe mbahej Bregu Perëndimor me qëllim ruajtjen e marrëdhënieve relativisht të mira që Izraeli kishte pasur me Jordaninë që prej vitit 1948? Nëse përgjigja është jo, siç mendoj se është, atëherë lind pyetja se përse Izraeli ndoqi këtë politikë dhe ç'mund të thuhet për mundësinë që Izraeli ta dorëzojë Bregun Perëndimor në të ardhmen? Edhe sikur, siç thuhet në mitologjinë zyrtare izraelite, Bregu Perëndimor të jetë pushtuar si hakmarrje ndaj agresionit jordanez të 5 qershorit të vitit 1967, lind pyetja: përse Izraeli qëndroi në Bregun Perëndimor pasi kërcënimi u zhduk? Në fund të fundit, ka plot shembuj veprimesh agresive ushtarake që nuk përfunduan me një zgjerim territorial të shtetit të Izraelit. Siç do të mundohem të tregoj në këtë kapitull, inkorporimi i Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës brenda Izraelit ishte planifikuar që në vitin 1948, ndonëse u zbatua vetëm në vitin 1967.

A ishte e pashmangshme lufta e vitit 1967? Mund ta fillojmë përgjigjen tonë në vitin 1958, i cili në literaturën shkencore mbi Lindjen e Mesme të kohës sonë përshkruhet si vit revolucionar. Në atë vit, idetë progresive dhe radikale, që sollën në pushtet në Kajro "Oficerët e Lirë Egjiptianë", filluan të lënë gjurmë në të gjithë botën arabe. Kjo prirje u mbështet nga Bashkimi Sovjetik dhe pashmangshmërisht u sfidua nga Shtetet e Bashkuara. Kjo "lojë" e Luftës së Ftohtë në Lindjen e Mesme i dha mundësi atyre në Izrael që të kërkonin pretekst për të korrigjuar "gabimin fatal historik" të vitit 1948. Kjo përpjekje drejtohej nga një lobi i fuqishëm brenda qeverisë dhe ushtrisë izraelite, i udhëhequr nga heronjtë e luftës së vitit 1948: Moshe Dajani (Moshe Dayan) dhe Jigal Alon (Yigal Alon). Kur në Perëndim u arrit një konsensus se "radikalizmi" që lindi në Egjipt mund të përfshinte edhe vendet e tjera, përfshirë Jordaninë, lobi rekomandoi që kryeministri Ben-Gurion t'i qasej NATO-s për të promovuar idenë e një pushtimi parandalues izraelit të Bregut Perëndimor.[108]

Ky skenar u bë më i pëlqyeshëm pasi Iraku ra në duart e disa oficerëve progresivë, bile radikalë. Në korrik të vitit 1958, një grup oficerësh irakianë bënë një grusht shteti që rrëzoi dinastinë hashemite. Hashemitët ishin sjellë në pushtet nga britanikët në vitin 1921 për ta mbajtur Irakun brenda sferës perëndimore të ndikimit. Recesioni ekonomik, nacionalizmi dhe lidhjet e forta me Egjiptin dhe BRSS-në nxitën një lëvizje proteste që solli në pushtet oficerët. Ajo u udhëhoq nga një grup që e quajti veten "Oficerët e Lirë", i udhëhequr nga Abdulkerim Kasim, i cili, duke imituar grupin që kishte përmbysur gjashtë vjet më parë monarkinë në Egjipt, e zëvendësoi monarkinë me Republikën e Irakut.

Në atë kohë, Perëndimi frikësohej se Libani mund të ishte shteti i rradhës që do të merrej nga forcat revolucionare. NATO-ja vendosi që t'i dilte përpara një skenari të tillë, duke dërguar forcat e saj atje: marinsat amerikanë në Liban dhe Forcat Speciale Britanike në Jordani. Nuk pati as nevojë dhe as dëshirë për ta përfshirë Izraelin në këtë luftë të ftohtë që po zhvillohej në botën arabe.[109] Kur u hodh ideja izraelite e "kursimit" të paktën të Bregut Perëndimor, ajo u kundërshtua me forcë nga Uashingtoni. Megjithatë, siç duket, Ben-Gurioni ishte tepër i gëzuar që u paralajmërua në atë fazë. Ai nuk kishte asnjë dëshirë që të minonte arritjen demografike të vitit 1948, pra nuk donte të ndryshonte balancën mes hebrenjve dhe arabëve në një Izrael "të madh", duke inkorporuar palestinezët që jetonin në Bregun Perëndimor.[110] Në ditarin e tij, ai rrëfen se ua kishte bërë të qartë ministrave të tij se pushtimi i Bregut Perëndimor do të përbënte një rrezik të madh demografik: *"Ju tregova për rrezikun e inkorporimit të një milionë arabëve në*

[108] Pappe, "The Junior Partner."
[109] Po aty.
[110] Po aty.

një shtet që e ka popullsinë 1.75 milionë banorë."[111] Për të njëjtën arsye, ai i doli përpara një përpjekjeje tjetër të lobit të skifterëve për të shfrytëzuar një krizë të re dy vjet më pas, në vitin 1960. Për sa kohë që Ben-Gurioni qëndroi në pushtet, ky lob nuk çau dot, siç është përshkruar në mënyrë të shkëlqyer në librin e Tom Segevit *"1967"*. Megjithatë, në vitin 1960, ishte bërë shumë më e vështirë ta përmbaje atë lob. Në fakt, po atë vit, të gjithë përbërësit që më vonë do të shkaktonin krizën e vitit 1967, ishin të pranishëm dhe bartnin të njëjtin rrezik të shpërthimit të një lufte. Por lufta u shmang, ose të paktën, u shty.

Në vitin 1960, aktori më i rëndësishëm në skenë ishte presidenti egjiptian Xhemal Abdunnasir (Naseri), i cili ndiqte një politikë të luajtjes me zjarrin, siç do të bënte gjashtë vjet më pas. Ai e ngriti retorikën e luftës kundër Izraelit, duke kërcënuar se do të lëvizte trupat në Sinain e çmilitarizuar dhe do të bllokonte kalimin e anijeve në qytetin jugor të Eilatit. Motivet e tij për këtë gjë ishin të njëjta në vitin 1960, siç ishin edhe në vitin 1967. Ai frikësohej se mos Izraeli sulmonte Sirinë, e cila ndërmjet viteve 1958-1962 ishte në një bashkim formal me Egjiptin dhe quhej Republika e Bashkuar Arabe. Që kur Izraeli dhe Siria kishin bërë një marrëveshje armëpushimi në verën e vitit 1949, shumë çështje kishin mbetur të pazgjidhura. Ndërmjet tyre ishin disa copa toke, të quajtura nga OKB-ja si "toka të askujt", të cilat të dyja palët i lakmonin. Herë pas here, Izraeli i nxiste anëtarët e kibuceve dhe kolonive ngjitur që të shkonin në ato toka dhe t'i kultivonin, duke e ditur shumë mirë se kjo gjë do të nxiste një kundërpërgjigje siriane nga Lartësitë Golan që ndodheshin mbi to. Pikërisht kështu ndodhi në vitin 1960 dhe pasoi një cikël i parashikueshëm përshkallëzimi dhëmb për dhëmb: forca ajrore izraelite u përdor për të fituar ca përvojë beteje të vërtetë dhe për të treguar supremacinë e saj mbi avionët rusë të përdorur nga forca ajrore siriane. Pasonin luftime të ashpra, shkëmbime zjarri artilerije, i dërgoheshin ankesa komisionit të armëpushimit dhe mbretëronte një farë qetësie e nderë deri në shpërthimin përsëri të dhunës.[112]

Një burim i dytë fërkimesh ndërmjet Izraelit dhe Sirisë ishte ndërtimi nga Izraeli i një transportuesi kombëtar të ujit (ky është emri zyrtar izraelit për një projekt të madh që përfshinte rrugë, tubacione ujësjellësi dhe kanale) ndërmjet grykëderdhjes së lumit Jordan dhe jugut të shtetit. Punimet në këtë projekt filluan në vitin 1953 dhe përfshinin devijimin e disa burimeve ujore që ishin shumë të nevojshëm për Sirinë dhe Libanin. Si kundërpërgjigje, udhëheqësit sirianë ja dolën t'i bindnin aleatët e tyre egjiptianë në Republikën Arabe të Bashkuar se Izraeli mund të ndërmerrte një fushatë gjithëpërfshirëse kundër Sirisë për të shtënë në dorë Lartësitë Golan dhe burimet e lumit Jordan.

Naseri kishte edhe një motiv tjetër për ta përmbysur balancën e pasigurtë brenda dhe përreth Palestinës historike. Ai donte të prishte impasin diplomatik të asaj periudhe dhe të sfidonte indiferencën globale ndaj problemit palestinez. Siç tregon Avi Shlaim në librin e tij *"Muri i hekurt"*, Naseri kishte një farë shprese për të dalë nga situata pa rrugëdalje, kur negocioi me Moshe Sharetin (Moshe Sharett), ministrin e jashtëm izraelit, dhe për një periudhë të shkurtër në mesin e viteve '50, kryeministër i Izraelit.[113] Megjithatë, Naseri e kuptoi se pushteti ishte në duart e Ben-Gurionit dhe sapo ky i fundit u rikthye në zyrën e kryeministrit në vitin 1955, kishte pak shpresë për paqe ndërmjet dy shteteve.

Ndërkohë që zhvilloheshin këto negociata, të dyja palët diskutuan për mundësinë e një kalimi tokësor egjiptian në Negev në këmbim të dhënies fund të këtij impasi. Kjo ishte një ide e parakohshme në axhendë, e cila nuk u zhvillua më tej, ndaj nuk kemi asnjë mënyrë se si ta dimë nëse ajo do të kishte çuar në ndonjë

[111] *Ben-Gurion Archive, Ben-Gurion Dairy*, 19 gusht 1958.
[112] Për një version shumë të ndershëm të atyre ngjarjeve shih David Shaham, *Israel: The First Forty Years*, Tel Aviv: Am Oved 1991, fq. 239–47 (në hebraisht).
[113] Shih Shlaim, *The Iron Wall*, fq. 95–142.

marrëveshje dypalëshe paqeje apo jo. Ajo që dimë është se kishte shumë pak shans për një marrëveshje dypalëshe paqeje ndërmjet Izraelit dhe Egjiptit për sa kohë që Ben-Gurioni të ishte kryeministër i Izraelit. Edhe kur nuk ishte në pushtet, Ben-Gurioni përdori lidhjet e tij me ushtrinë për t'i bindur komandantët e saj që të ndërmerrnin një sërë veprimesh provokuese ushtarake kundër forcave egjiptiane në Rripin e Gazës, ndërkohë që zhvilloheshin negociatat. Preteksti për ato operacione ishte infiltrimi i refugjatëve palestinezë nga Rripi i Gazës në Izrael, i cili gradualisht u bë më i militarizuar dhe për pasojë, përbënte një luftë të vërtetë guerrile kundër shtetit hebre. Izraeli reagoi duke shkatërruar baza ushtarake dhe vrarë trupa egjiptiane.[114]

Praktikisht, përpjekjet për paqe morën fund sapo Ben-Gurioni u rikthye në pushtet dhe u bashkua me Britaninë dhe Francën në një aleancë ushtarake që synonte rrëzimin e Naserit në vitin 1956. Nuk duhet të habitemi që, katër vite më vonë, kur po mendohej për një luftë kundër Izraelit, Naseri i konsideronte manovrat e tij si një lëvizje parandaluese për të shpëtuar regjimin e tij nga një sulm i mundshëm anglo-franko-izraelit. Kështu, në vitin 1960, kur tensionet në kufirin siriano-izraelit u rritën dhe në frontin diplomatik nuk pati asnjë përparim, Naseri provoi një strategji të re, të përmendur më lart si "lojë me zjarrin". Qëllimi i kësaj strategjie ishte që të testoheshin vazhdimisht kufinjtë e mundësisë. Në këtë rast, të provoheshin se sa shumë mund ta ndryshojnë realitetin politik përgatitjet për luftë dhe kërcënimet, por pa shkuar në luftë. Suksesi i një loje të tillë me zjarrin varet jo vetëm nga personi që e fillon, por edhe nga reagimet e paparashikueshme të atyre, kundër të cilëve drejtohet kjo politikë. Për këtë arsye, ajo mund të shkojë edhe jashtëzakonisht keq, siç ndodhi në vitin 1967.

Për herë të parë, Naseri e zbatoi këtë strategji në vitin 1960 dhe e përsëriti në mënyrë të ngjashme në vitin 1967. Ai dërgoi forca në gadishullin e Sinait, i cili supozohej të ishte një zonë e çmilitarizuar sipas marrëveshjes që i dha fund luftës së vitit 1956. Përballë këtij kërcënimi, në vitin 1960 qeveria izraelite dhe Kombet e Bashkuara vepruan me shumë arsye. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Dag Hamarskjëld (Dag Hammarskjöld), mbajti një qëndrim të prerë, duke kërkuar tërheqjen e menjëhershme të trupave egjiptiane. Qeveria izraelite mobilizoi rezervistët, por dërgoi një mesazh të qartë se nuk do të fillonte luftë.[115]

Në prag të luftës së vitit 1967, që të gjithë këto faktorë luajtën rol në shpërthimin e dhunës. Megjithatë, dy personalitete nuk u përfshinë në të: Ben-Gurioni dhe Dag Hamarskjëldi. Ben-Gurioni ishte larguar nga skena politike në vitin 1963. Ironikisht, vetëm pas largimit të tij, lobi i Izraelit të Madh qe në gjendje të planifikonte hapin e tij të rradhës. Deri atëherë, obsesioni demografik i Ben-Gurionit e kishte parandaluar marrjen e Bregut Perëndimor, por kishte prodhuar edhe sundimin ushtarak tashmë familjar që Izraeli imponon mbi grupimet e ndryshme palestineze. Heqja e këtij regjimi në vitin 1966 lejoi që një aparat i gatshëm të kontrollonte si Bregun Perëndimor, ashtu edhe Rripin e Gazës, para se të plaste lufta e qershorit të vitit 1967. Sundimi ushtarak që Izraeli i kishte imponuar pakicës palestineze në vitin 1948 bazohej mbi rregullat e emergjencës së Mandatit Britanik që e trajtonin popullsinë civile si një grup potencial armiqësor, duke e zhveshur atë nga çdo e drejtë themelore njerëzore dhe civile. Guvernatorët ushtarakë u instaluan në të gjitha zonat palestineze me autoritet ekzekutiv, gjyqësor dhe legjislativ. Në vitin 1966, kjo ishte një makineri e mirëvajisur që përfshinte qindra punonjës, të cilët do të shërbenin si bërthama e një regjimi të ngjashëm, kur të imponohej mbi Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës.

[114] Pappe, "The Junior Partner," fq. 251–2.
[115] Ami Gluska, *The Israeli Military and the Origins of the 1967 War: Government, Armed Forces and Defence Policy, 1963–1967*, London and New York: Routledge 2007, fq. 121–2.

Kështu, sundimi ushtarak që u hoq në vitin 1966, u vendos në vitin 1967 në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës, dhe gjithçka ishte gati për një pushtim. Që nga viti 1963, një grup ekspertësh izraelitë nga ushtria, shërbimi civil dhe akademikët kishin bërë plane për tranzicionin, duke përpiluar një manual të detajuar se si duhej të sundohej një territor palestinez sipas rregullave të emergjencës, në rast se krijohej mundësia.[116] Kjo i jepte ushtrisë pushtet absolut mbi çdo sferë të jetës. Shansi për ta lëvizuar këtë aparat nga njëri grupim palestinez (pakica palestineze në Izrael) tek një tjetër (palestinezët në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës) erdhi në vitin 1967, kur Naseri u nxit për të luajtur me zjarrin nga udhëheqja sovjetike, e cila besonte fuqishëm se një sulm izraelit kundër Sirisë pritej në ditët e fundit të vitit 1966.[117] Në verën e atij viti, një grup i ri oficerësh dhe ideologësh (të njohur si Baathi i ri) kishte bërë një grusht shteti dhe kishte shtënë në dorë shtetin sirian. Një nga veprimet e para të regjimit të ri ishte trajtimi më me ashpërsi i planeve izraelite për të shfrytëzuar ujërat e lumit Jordan dhe grykëderdhjen e tij. Ata filluan ndërtimin e rrjetit të tyre kombëtar dhe e devijuan lumin për nevojat e tyre. Ushtria izraelite e bombardoi projektin e ri, gjë që çoi në luftime të shpeshta dhe gjithnjë e më intensive ndërmjet forcave ajrore të dy vendeve. Gjithashtu regjimi i ri në Siri e shihte me sy të mirë lëvizjen nacionalçlirimtare palestineze të sapoformuar. Kjo gjë e inkurajoi Fatahun që të ndërmerrte një luftë guerrile kundër Izraelit në Lartësitë Golan, duke e përdorur Libanin si platformë lëshimi për sulmet. Kjo veçse e rriti tensionin ndërmjet dy shteteve.

Duket se deri në prill të vitit 1967, Naseri akoma shpresonte se shtirjet e tij ishin të mjaftueshme për të sjellë një ndryshim të statukuosë, por pa shkuar në luftë. Ai nënshkroi një aleancë mbrojtjeje më Sirinë në nëntor të vitit 1966, duke deklaruar qëllimin e tij për t'i ardhur në ndihmë kësaj të fundit në rast se sulmohej nga Izraeli. Përkeqësimi i situatës në kufirin izraelito-sirian njohu pikën më të ulët në prill të vitit 1967, kur Izraeli ndërmori një sulm ushtarak kundër forcave siriane në Lartësitë Golan, që sipas shefit të shtabit të përgjithshëm të ushtrisë izraelite asokohe, Jichak Rabin, kishte për qëllim *"të poshtëronte Sirinë."*[118] Në atë fazë dukej sikur Izraeli po bënte gjithçka kishte në dorë që ta shtynte botën arabe në luftë. Vetëm atëherë Naseri u ndje i detyruar që të përsëriste gambitin e tij të vitit 1966, duke dërguar trupa në gadishullin e Sinait dhe duke mbyllur ngushticën e Tiranit, një kalim i ngushtë që lidh Gjirin e Akabasë me Detin e Kuq, që të mund të ndalonte apo pengonte trafikun detar drejt portit izraelit jugor të Eilatit. Ashtu si në vitin 1960, Naseri priti që të shihte se si do të reagonte OKB-ja. Në vitin 1960, Dag Hamarskjëldi nuk u impresionua dhe nuk i tërhoqi trupat e OKB-së që ishin të stacionuara atje që nga viti 1956. Sekretari i ri i Përgjithshëm U Thant qe më pak kategorik dhe i tërhoqi trupat e Kombeve të Bashkuara, kur trupat egjiptiane u futën në gadishull. Kjo gjë veçse e përshkallëzoi akoma më shumë tensionin.

Megjithatë, faktori më i rëndësishëm për nxitimin drejt luftës ishte mungesa e një sfide autoritare ndaj lobit luftënxitës brenda udhëheqjes izraelite të asaj kohe. Kjo mund të ketë sjellë një farë fërkimi të brendshëm që e kishte vonuar prirjen e skifterëve për konflikt, duke e lejuar bashkësinë ndërkombëtare të kërkonte një zgjidhje paqësore. Një përpjekje diplomatike e kryesuar nga Shtetet e Bashkuara ishte akoma në hapat e saj të para kur Izraeli i sulmoi të gjithë fqinjët e tij arabë më 5 qershor 1967. Kabineti qeveritar izraelit nuk kishte ndërmend t'i jepte kohën e nevojshme ndërmjetësuesve për paqe. Ky ishte

[116] E kam diskutuar këtë hollësisht në Ilan Pappe, *"Revisiting 1967: The False Paradigm of Peace, Partition and Parity," Settler Colonial Studies,* 3:3–4 (2013), fq. 341–51.

[117] Në stilin e tij tipik, Norman Finkelshtajn (Norman Finkelstein) e merr narrativën zyrtare të Izraelit siç paraqitet nga një nga artikuluesit e saj më të mirë, Abba Eban, dhe e dërrmon atë. Shih librin e tij *Image and Reality of the Israel-Palestine Conflict*, London and New York: Verso, 2003, fq. 135–45.

[118] Nga një intervistë të dhënë nga Rabini më 12 maj 1967 për shërbimin e lajmeve UPI, në të cilën ai kërcënonte mes të tjerave se do ta përmbyste regjimin sirian. Shih Jeremy Bowen, *Six Days: How the 1967 War Shaped the Middle East*, London: Simon and Schuster UK, 2004, fq. 32–3.

një shans i artë që nuk duhej humbur.

Në disa takime të rëndësishme të kabinetit izraelit përpara luftës, Abba Eban i kishte pyetur me naivitet shefat e shtabeve dhe kolegët e tij se cili ishte ndryshimi ndërmjet krizës së vitit 1960 dhe situatës së vitit 1967, sepse mendonte se kjo e fundit mund të zgjidhej në të njëjtën mënyrë.[119] *"Është çështje nderi dhe përmbajtjeje"* kishte qenë përgjigja. Ebani ishte përgjigjur se humbja e ushtarëve të rinj vetëm për hatër të nderit dhe përmbajtjes ishte një çmim shumë i lartë njerëzor që duhej paguar. Unë dyshoj se atij i janë thënë gjëra të tjera që nuk janë rregjistruar në verbale, ndoshta në lidhje me nevojën e tij për të kuptuar se ky ishte nje shans historik për të ndrequr "gabimin fatal historik" të mospushtimit të Bregut Perëndimor në vitin 1948.

Lufta filloi herët në mëngjesin e 5 qershorit me një sulm izraelit kundër forcës ajrore egjiptiane, i cili gati e shkatërroi krejtësisht atë. Kjo u pasua në të njëjtën ditë me sulme të ngjashme kundër forcave ajrore të Sirisë, Jordanisë dhe Irakut. Gjithashtu Izraeli pushtoi Rripin e Gazës dhe sulmoi gadishullin e Sinait, dhe brenda pak ditësh mbërriti në bregun e Kanalit të Suezit, duke e pushtuar të gjithë gadishullin. Sulmi kundër forcës ajrore jordaneze bëri që Jordania të merrte një zonë të vogël të OKB-së ndërmjet dy pjesëve të Jeruzalemit. Brenda tre ditësh, pas luftimeve të ashpra, ushtria izraelite e kishte marrë Jeruzalemin Lindor (më 7 qershor) dhe dy ditë më vonë, ajo e dëboi ushtrinë jordaneze nga Bregu Perëndimor.

Më 7 qershor, qeveria izraelite ishte akoma e pasigurtë në lidhje me hapjen e një fronti të ri kundër sirianëve në Lartësitë Golan, por sukseset e mëdha në frontet e tjera i bindën politikanët që ta lejonin ushtrinë që të pushtonte edhe Lartësitë Golan. Më 11 qershor, Izraeli ishte bërë një miniperandori që kontrollonte Lartësitë Golan, Bregun Perëndimor, Rripin e Gazës dhe gadishullin e Sinait. Në këtë kapitull, unë do të fokusohem në vendimin izraelit për të pushtuar Bregun Perëndimor.

Në prag të luftës, Jordania ishte futur në një aleancë ushtarake me Egjiptin dhe Sirinë, sipas së cilës, në çastin që Izraeli do të sulmonte Egjiptin, Jordania ishte e detyruar të hynte në luftë. Pavarësisht këtij angazhimi, mbreti Husejn i dërgoi mesazhe të qarta Izraelit se nëse lufta fillonte, ai duhej të bënte diçka, por kjo gjë do të ishte e shkurtër dhe nuk do t'i ngjante një lufte të vërtetë (ky qëndrim ishte i ngjashëm me atë të gjyshit të tij në vitin 1948). Me të vërtetë, përshirja e Jordanisë ishte më se simbolike. Ajo përfshiu një bombardim të rëndë të Jeruzalemit Perëndimor dhe periferisë lindore të Tel Avivit. Megjithatë, është e rëndësishme të përmendim arsyen se përse Jordania po reagonte: forca e saj ajrore ishte shkatërruar plotësisht nga Izraeli dy orë më parë, pasditen e 5 qershorit. Pra mbreti Husejn u ndje i detyruar të reagonte më me forcë se sa ç'kishte ndërmend.

Problemi ishte se ushtria nuk ishte nën kontrollin e tij, por komandohej nga një gjeneral egjiptian. Narrativa e përbashkët e këtyre ngjarjeve bazohet mbi kujtimet e vetë Husejnit dhe ato të Din Raskut (Dean Rusk), sekretarit amerikan të shtetit asokohe. Sipas kësaj narrative, Izraeli i dërgoi një mesazh pajtues Husejnit, duke i bërë thirrje që të qëndronte jashtë luftës (paçka se ai kishte shkatërruar forcën ajrore jordaneze). Ditën e parë, Izraeli nuk deshi të shkonte shumë larg me sulmin kundër Jordanisë, por reagimi i kësaj të fundit ndaj shkatërrimit të forcës së saj ajrore e shtyu Izraelin në një operacion më të gjerë në ditën e dytë. Në kujtimet e tij, Husejni shkruan se ai kishte shpresuar gjithmonë se dikush do ta ndalonte këtë çmenduri, sepse ai nuk mund të mos i bindej egjiptianëve dhe as të rrezikonte të hynte në luftë. Ditën e dytë, ai i bëri thirrje izraelitëve që të qetësoheshin dhe vetëm atëherë, sipas rrëfimeve të tij, Izraeli ndërmori një

[119] Po aty.

operacion më të gjerë.[120]

Ka dy probleme me këtë narrativë. Si mund të pajtohen sulmi kundër forcës ajrore jordaneze me dërgimin e një mesazhi pajtues? Më e rëndësishmja, nëse Izraeli ishte në mëdyshje në lidhje me politikën kundrejt Jordanisë në ditën e parë, nga ky rrëfim del qartë se në ditën e dytë ai nuk dëshironte t'i jepte Jordanisë asnjë shtyrje afati. Siç e ka vërejtur me të drejtë Norman Finkelshtajni, nëse doje ta shkatërroje atë që kishte mbetur nga ushtria jordaneze dhe t'i ruaje marrëdhëniet me një vend arab shumë besnik ndaj Izraelit, do të kishte mjaftuar një operacion i shkurtër në Bregun Perëndimor pa e pushtuar atë.[121] Historiani izraelit Moshe Shemesh ka shqyrtuar burimet jordaneze dhe ka arritur në përfundimin se, pasi Izraeli sulmoi fshatin palestinez të Samuas në nëntor të vitit 1966, në përpjekje për të mundur guerriljet palestineze, komanda e lartë jordaneze ishte bindur se Izraeli kishte ndërmend të pushtonte me forcë Bregun Perëndimor.[122] Dhe nuk ishin gabuar.

Kjo gjë nuk ndodhi, siç pritej, në vitin 1966, por një vit më vonë. Krejt shoqëria izraelite ishte e magjepsur pas projektit mesianik të "çlirimit" të vendeve të shenjta të hebraizmit, me Jeruzalemin si margaritarin mbi kurorën e re të Izraelit të Madh. Sionistët e majtë dhe të djathtë, si dhe mbështetësit e Izraelit në Perëndim, që të gjithë ishin të hutuar dhe të hipnotizuar nga kjo histeri euforike. Për më tepër, ata nuk kishin ndërmend të largoheshin nga Bregu Perëndimor dhe Rripi i Gazës menjëherë pas pushtimit të tyre, në fakt nuk kishte asnjë dëshirë për t'i braktisur. Kjo duhet të shërbejë si një provë e mëtejshme e përgjegjësisë izraelite për përkeqësimin përfundimtar të krizës së majit të vitit 1967 dhe shpërthimit të luftës.

Se sa e rëndësishme ishte kjo fazë historik për Izraelin mund të shihet nga mënyra se si qeveria i bëri ballë trysnisë së madhe ndërkombëtare për t'u tërhequr nga të gjitha territoret e pushtuara në vitin 1967, siç kërkohej nga rezoluta e famshme 242 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së pak pas mbarimit të luftës. Siç mund ta dinë edhe lexuesit, rezoluta e Këshillit të Sigurimit është më e detyrueshme se sa një rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme. Dhe kjo është një nga të paktat rezoluta të Këshillit të Sigurimit, të cilat kritikojnë Izraelin, që Shtetet e Bashkuara nuk i kanë vënë veton.

Sot, ne kemi akses në verbalet e një mbledhjeje të qeverisë izraelite të mbajtur në ditët e para pas pushtimit. Ajo ishte qeveria e trembëdhjetë e Izraelit dhe përbërja e saj ka shumë lidhje me argumentin që do të sjell këtu. Ishte një qeveri uniteti e një lloji të paparë më parë ose më pas në Izrael. Çdo nuancë e spektrit politik hebre dhe sionist ishte e përfaqësuar aty. Me përjashtim të Partisë Komuniste, çdo parti tjetër kishte një përfaqësues në atë qeveri, nga e majta në të djathtë dhe qendër. Parti socialiste si Mapam, parti të krahut të djathtë si Heruti i Menahem Beginit dhe partitë fetare ishin të gjitha të përfshira. Ajo që kuptohet nga leximi i atyre verbaleve është që ministrat e dinin se përfaqësonin një konsensus të gjërë në shoqërinë e tyre. Kjo bindje përforcohej më tej nga atmosfera euforike që kaploi Izraelin pas luftës-rrufe, e cila zgjati vetëm gjashtë ditë. Në këtë sfond, mund t'i kuptojmë më mirë vendimet që këta ministra morën menjëherë pas luftës.

Për më tepër, shumë prej këtyre politikanëve kishin qenë në pritje të këtij çasti që nga viti 1948. Do të shkoja akoma më larg dhe të thoja se marrja veçanërisht e Bregut Perëndimor, me vendet e tij të lashta biblike, kishte qenë një synim sionist shumë më përpara se viti 1948 dhe në tërësi i shkonte për shtat

[120] Shih Avi Shlaim, *"Walking the Tight Rope,"* në Avi Shlaim dhe Wm. Roger Louis (eds.), *The 1967 Arab-Israeli War: Origins and Consequences*, Cambridge: Cambridge University Press, 2012, fq. 114.
[121] Finkelstein, *Image and Reality*, fq. 125–35.
[122] Moshe Shemesh, *Arab Politics, Palestinian Nationalism and the Six Day war*, Brighton: Sussex Academic Press, 2008, fq. 117.

logjikës së projektit sionist. Kjo logjikë mund të përmblidhet si dëshira për të shtënë në dorë sa më shumë që të ishte e mundur nga Palestina me sa më pak palestinezë që të kishte mundësi. Konsensusi, euforia dhe konteksti historik shpjegon se përse asnjë nga qeveritë e mëvonshme izraelite nuk ju shmang vendimeve të marra nga ata ministra.

Vendimi i parë që ata morën ishte që Izraeli nuk mund të ekzistonte pa Bregun Perëndimor. Ministri i bujqësisë Jigal Alon (Yigal Alon) ofroi metoda të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të kontrollimit të rajonit, duke bërë dallimin ndërmjet zonave ku mund të ngriheshin koloni hebreje dhe zonave me popullsi të dendur palestineze, të cilat duheshin sunduar në mënyrë jo të drejtpërdrejtë.[123] Aloni ndërroi mendim pas pak vitesh në lidhje me metodën e sundimit jo të drejtpërdrejtë. Fillimisht, ai shpresonte se jordanezët do të tundoheshin për ta ndihmuar Izraelin që të qeveriste pjesë të Bregut Perëndimor (ndoshta, ndonëse kurrë nuk është thënë haptas, duke ruajtur nënshtetësinë dhe ligjet jordaneze në "zonat arabe" të Bregut Perëndimor). Por një përgjigje e vakët jordaneze ndaj këtij plani e shtyu atë drejt një vetëqeverisje palestineze në ato zona, si mënyra më e mirë për të shkuar përpara.

Vendimi i dytë ishte që banorët e Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës nuk do të përfshiheshin në shtetin e Izraelit si qytetarë të tij. Kjo nuk përfshinte palestinezët që jetonin në atë që Izraeli asokohe e konsideronte si zona e "Jeruzalemit të Madh". Përkufizimi i asaj zone dhe kush prej banorëve të saj kishte të drejtë të merrte qytetarinë izraelite, ndryshonte sa herë që ajo hapësirë zmadhohej. Sa më i madh që bëhej Jeruzalemi i Madh, aq më shumë rritej numri i palestinezëve në të. Sot ka 200.000 palestinezë brenda asaj që përkufizohet si zona e Jeruzalemit të Madh. Për t'u siguruar që jo të gjithë ata të llogariten si shtetas izraelitë, disa prej lagjeve të tyre u shpallën si fshatra të Bregut Perëndimor.[124] Qeveria e kishte të qartë se, mohimi i nënshtetësisë nga njëra anë dhe moslejimi i pavarësisë nga ana tjetër, i dënonte banorët e Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës të jetonin një jetë pa të drejtat më minimale civile dhe njerëzore.

Ndaj çështja tjetër ishte se për sa kohë ushtria izraelite do t'i mbante të pushtuara zonat palestineze. Duket se për shumë ministra përgjigja ishte dhe akoma është: për një kohë shumë të gjatë. Për shembull, Moshe Dajani, ministri i mbrojtjes, në një rast deklaroi një periudhë prej 50 vjetësh. Sot jemi në vitin e pesëdhjetë të pushtimit.

Vendimi i tretë kishte të bënte me procesin e paqes. Siç e përmendëm më parë, bashkësia ndërkombëtare priste që Izraeli të kthente territoret që kishte pushtuar në këmbim të paqes. Qeveria izraelite ishte e gatshme të negocionte me Egjiptin në lidhje me të ardhmen e gadishullit të Sinait dhe me Sirinë në lidhje me Lartësitë Golan, por jo për Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës. Në një konferencë të shkurtër për shtyp në vitin 1967, kryeministri i asaj kohe Levi Eshkol (Levy Eshkol) foli shumë.[125] Por shpejt kolegët e tij e kuptuan se deklarata publike të këtij lloji ishin të padobishme, për ta thënë më butë. Ndaj, ky pozicionim strategjik nuk u pranua kurrë më haptas para publikut. Gjithçka që kemi janë disa deklarime të qarta nga disa individë, më i shquari prej tyre është Dan Bavli, që ishte pjesë e një grupi zyrtarësh të lartë të ngarkuar me përcaktimin e politikës që duhej ndjekur në lidhje me Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës. Bavli rrëfen se mungesa e vullnetit për të negociuar, veçanërisht në lidhje me Bregun Perëndimor, tregon qartë politikën e Izraelit asokohe (dhe do të shtoja: edhe në vazhdim).[126] Bavli e ka përshkruar këtë politikë si

[123] Arkivat Shtetërore të Izraelit, Verbalet e mbledhjeve të qeverisë, 11 dhe 18 qershor 1967.
[124] Valerie Zink, "A Quiet Transfer: The Judaization of Jerusalem," *Contemporary Arab Affairs*, 2:1 (2009), fq. 122-33.
[125] *Haaretz*, 23 qershor 1967.
[126] Dan Bavli, *Dreams and Missed Opportunities, 1967–1973*, Jerusalem: Carmel 2002 (në hebraisht).

"luftënxitëse dhe dritëshkurtër" që zëvendësoi çdo përpjekje për një zgjidhje: *"Qeveritë e ndryshme izraelite kanë folur shumë për paqen, por kanë bërë shumë pak për ta arritur atë."*[127] Ajo që izraelitët sajuan atëherë, por dhe tani, është ajo që Noam Çomski (Noam Chomsky) e ka quajtur *"një farsë e plotë".*[128] Ata e kuptuan se të flasësh për paqen nuk do të thotë se nuk mundesh të kryesh në terren gjëra që bien ndesh me vetë idenë e paqes.

Me të drejtë lexuesit mund të pyesin se a ekzistonte asokohe ndonjë kamp paqeje apo qëndrim liberal sionist, që me të vërtetë kërkonte paqe. Në fakt, ekzistonte dhe ndoshta ekziston akoma edhe sot, por që në fillim, ai ishte i margjinalizuar dhe gëzonte mbështetjen e vetëm një pjese të vogël të elektoratit. Në Izrael, vendimet merren nga një grusht i vogël politikanësh, gjeneralësh dhe strategësh, që përcaktojnë politikën, pa marrë parasysh debatet publike. Veç kësaj, e vetmja mënyrë për të gjykuar, qoftë edhe vonë, se cila mund të jetë strategjia izraelite, nuk bëhet nga fjalimet e politikanëve të shtetit, por nga veprimet e tyre në terren. Për shembull, deklaratat politike të qeverisë së unitetit të vitit 1967 mund të jenë të ndryshme nga ato të qeverive laburiste deri në vitin 1977 dhe ato të qeverive të Likudit, që kanë qeverisur Izraelin pandërprerë deri më sot (me përjashtim të disa viteve, kur partia Kadima, tashmë e zhdukur, kryesoi qeveritë Sharon dhe Olmert në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit XXI), por veprimet e çdo regjimi kanë qenë të njëjta, duke i qëndruar besnikë tre vendimeve strategjike që janë bërë katekizmi i dogmës sioniste në Izraelin e pas vitit 1967.

Veprimi më i rëndësishëm në terren ishte ndërtimi i kolonive hebreje në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës, bashkë me zotimin për t'i zgjeruar ato. Fillimisht, qeveria i vendosi këto koloni në zonat palestineze me popullsi më të pakët në Bregun Perëndimor (që nga viti 1968) dhe në Gaza (që nga viti 1969). Megjithatë, siç përshkruhet bukur në librin e shkëlqyer të Idith Zertal dhe Akiva Eldar *"Zotërit e tokës"*, ministrat dhe planifikuesit u gjunjëzuan para trysnisë së lëvizjes koloniste mesianike Gush Emonim dhe ngritën koloni në zemër të lagjeve palestineze.[129]

Një mënyrë tjetër për të gjykuar se cilat ishin qëllimet e vërteta izraelite që nga viti 1967 është t'i shikosh politikat e tyre nga këndvështrimi i viktimave palestineze. Pas pushtimit, sundimtari i ri i kufizoi palestinezët e Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës në një limbo të pamundur: ata nuk ishin as refugjatë, as qytetarë. Ata ishin dhe janë akoma banorë pa nënshtetësi. Ata ishin të burgosur dhe në shumë aspekte vazhdojnë të jenë, në një burg të madh, në të cilin nuk kanë të drejta civile dhe njerëzore, si dhe asnjë ndikim mbi të ardhmen e tyre. Bota e toleron këtë gjendje, sepse Izraeli pretendon dhe ky pretendim nuk është sfiduar veçse kohët e fundit, se gjendja është e përkohshme dhe do të vazhdojë derisa të këtë një partner të duhur palestinez për paqe. Nuk duhet të çuditemi që ky partner nuk është gjendur akoma. Në kohën që po shkruajmë këto rreshta, Izraeli akoma po e mban të burgosur brezin e tretë të palestinezëve me mjete dhe metoda të ndryshme, duke i përshkruar këto burgje të stërmëdhenj si realitete të përkohshme që do të ndryshojnë sapo paqja të vendoset mes Izraelit dhe Palestinës.

Çfarë mund të bëjnë palestinezët? Mesazhi izraelit është shumë i qartë: nëse ata pajtohen me shpronësimin e tokës, kufizimet e rrepta mbi lëvizjen dhe burokracinë e ashpër të pushtimit, atëherë mund të kenë ca përfitime. Këto mund të jenë: e drejta për të punuar në Izrael, pretendimi i një farë autonomie

[127] *Po aty, në faqen 16.*
[128] Noam Chomsky "Chomsky: Why the Israel-Palestine 'Negotiation' are a Complete Farce," Alternet.org, 2 shtator 2013.
[129] Idith Zertal and Akiva Eldar, *The Lords of the Land: The War Over Israel's Settlements in the Occupied Territories, 1967–2007*, New York: Nation Books, 2009.

dhe që nga viti 1993, bile edhe e drejta për t'i quajtur shtet disa rajone autonome. Ndërsa nëse zgjedhin rrugën e rezistencës, siç kanë bërë herë pas here, ata do të përballen me fuqinë e plotë të ushtrisë izraelite. Veprimtari palestinez Mazin Kumsijeh ka renditur 14 kryengritje të tilla që kanë synuar arratisjen nga ky burg i stërmadh, por që të gjitha janë përballur me një reagim brutal dhe në rastin e Gazës, me një genocid.[130]

Kështu, ne mund të shohim se marrja e Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës përfaqëson përfundimin e punës së nisur në vitin 1948. Asokohe, lëvizja sioniste rrëmbeu 80% të Palestinës, ndërsa në vitin 1967, ata e plotësuan 100%. Frika demografike që kishte Ben-Gurioni: një Izrael pa shumicë hebreje, u zgjidh në mënyrë cinike, duke burgosur popullsinë e territoreve të pushtuara në një burg panështetësie. Ky nuk është thjesht një përshkrim historik, por në mënyra të ndryshme, është akoma realitet akoma edhe në vitin 2017.

[130] Mazin Qumsiyeh, *Popular Resistance in Palestine: A History of Hope and Empowerment*, London: Pluto Press, 2011.

PJESA II

IDETË E GABUARA TË SË SOTMES

KREU VII

IZRAELI ËSHTË E VETMJA DEMOKRACI NË LINDJEN E MESME

Në sytë e shumë izraelitëve dhe mbështetësve të tyre nëpër botë, bile edhe atyre që mund të kritikojnë disa prej politikave të tij, Izraeli është, në fund të fundit, një shtet i mirë demokratik, që kërkon paqe me fqinjët e tij dhe i garanton barazi të gjithë qytetarëve të tij. Ata që e kritikojnë Izraelin pretendojnë se, nëse diçka ka shkuar keq në këtë demokraci, ajo ka qenë për shkak të luftës së vitit 1967. Sipas kësaj pikëpamjeje, lufta prishi një shoqëri të ndershme dhe shumë punëtore, duke ofruar para të lehta në territoret e pushtuara, duke lejuar grupet mesianike të futen në politikën e Izraelit dhe mbi të gjitha, duke e shndërruar Izraelin në një entitet pushtues dhe shtypës në territoret e reja.

Miti që një Izrael demokratik u fut në telashe në vitin 1967, por përsëri mbeti demokraci, është përhapur bile edhe nga disa historianë të shquar palestinezë dhe propalestinezë, por nuk ka asnjë bazë historike. Përpara vitit 1967, sigurisht që Izraeli nuk mund të përshkruhej si demokraci. Siç e kemi parë në kapitujt e mëparshëm, shteti vendosi një të tretën e qytetarëve të tij nën sundim ushtarak të bazuar në rregullat drakoniane të emergjencës së Mandatit Britanik, të cilat i mohonin palestinezëve çdo të drejtë bazë civile dhe njerëzore. Guvernatorët ushtarakë lokalë ishin sundues absolutë të jetëve të qytetarëve të tyre. Ata mund të nxirrnin ligje të posaçme për ta, t'u shembnin shtëpitë dhe mjetet për jetesë, bile mund t'i futnin në burg sa herë që t'iu pëlqente. Vetëm nga fundi i viteve '50, lindi një opozitë e fuqishme hebreje kundër këtyre abuzimeve, e cila solli lehtësimin e trysnisë mbi qytetarët palestinezë.

Për palestinezët që jetonin në Izraelin e paraluftës dhe ata që jetonin në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës së pas vitit 1967, ky regjim i lejonte edhe ushtarit më të thjeshtë në ushtrinë izraelite që t'i sundonte dhe t'iu shkatërronte jetën. Ata nuk kishin se ç'të bënin nëse ky ushtar, njësia e tij apo komandanti i saj vendoste t'iu shembte shtëpitë, t'i mbante me orë të tëra në një postbllok apo t'i burgoste pa asnjë gjyq. Ata nuk mund të bënin asgjë.[131] Në çdo moment, që nga viti 1948 e deri sot, ka pasur gjithmonë grupe palestinezësh që kanë përjetuar një përvojë të tillë. Grupi i parë që ka vuajtur nën një zgjedhë të tillë ka qenë pakica palestineze në Izrael. Ajo filloi në dy vitet e para të shtetit, kur ata u mbyllën në geto, si për shembull bashkësia palestineze e Hajfas që jetonte në malin Karmel, ose u dëbuan nga qytetet ku kishin jetuar prej dekadash, siç ndodhi në Safed. Në rastin e Isdudit, e gjithë popullsia u dëbua në Rripin e Gazës.[132] Nëpër fshatra, situata ishte akoma më e keqe. Lëvizjet e ndryshme të kibuceve i lakmonin fshatrat palestinezë që ishin në toka pjellore. Këtu përfshihej edhe kibuci socialist Hashomer Ha-Zair, i cili pretendonte se ishte i përkushtuar ndaj solidaritetit dykombësh. Shumë kohë pas përfundimit të luftimeve të vitit 1948, fshatarët në Gabsijeh, Ikrit, Birim, Kaidta, Zejtun dhe shumë të tjerë, u mashtruan dhe u larguan nga shtëpitë e tyre për dy javë, sepse ushtria ju tha se tokat e tyre i duheshin asaj [133] për stërvitje ushtarake, por kur u kthyen i gjetën fshatrat e tyre të rrafshuar ose të zënë nga dikush tjetër.

Shembulli më tipik i kësaj gjendjeje terrori ushtarak është masakra e Kefr Kasimit në nëntor të vitit 1956, kur, në prag të operacionit të Sinait, 49 palestinezë u vranë nga ushtria izraelite. Autoritetet pretenduan se ata u kthyen vonë nga puna në ara, kur në fshat ishte vendosur gjendja e shtetrrethimit, por kjo nuk

[131] Një përshkrim i hollësishëm i kësaj jete mund të gjendet në Ilan Pappe, *The Forgotten Palestinians: A History of the Palestinians in Israel*, New Haven and London: Yale University Press, 2013, fq. 46–93.
[132] Morris, *The Birth of the Palestinian Refugee Problem Revisited*, fq. 471.
[133] Shih Pappe, *The Ethnic Cleansing of Palestine*, fq. 181–7.

është arsyeja e vërtetë. Prova të mëvonshme treguan se Izraeli e kishte shqyrtuar seriozisht dëbimin e palestinezëve nga e gjithë zona e quajtur Uadi Ara dhe Trekëndëshi, ku ndodhej fshati. Këto dy zona: e para një luginë që lidh Afulan në lindje dhe Haderan në bregdetin e Mesdheut, ndërsa e dyta që zgjeron hinterlandin lindor të Jeruzalemit, u aneksuan nga Izraeli nën kushtet e marrëveshjes së armëpushimit me Jordaninë të vitit 1949. Siç kemi parë, territoret shtesë ishin gjithmonë të mirëpritura nga Izraeli, ndërsa rritja e popullsisë palestineze jo. Kështu, në çdo situatë, sa herë që shteti i Izraelit zgjerohej, ai gjente mënyra për ta kufizuar popullsinë palestineze në zonat e sapoaneksuara.

Operacioni "Hafarfert" (Urithi) ishte emri i koduar i një sërë propozimesh për dëbimin e palestinezëve, sapo një luftë e re të shpërthente me botën arabe. Shumë historianë sot mendojnë se masakra e vitit 1956 ishte një provë praktike për të parë se a mund të frikësoheshin banorët e zonës që të largoheshin. Ekzekutuesit e masakrës u sollën në gjyq falë zellit dhe këmbënguljes së dy anëtarëve të Knesetit: Teufik Tubit nga Partia Komuniste dhe Latif Dorit nga partia e majtë sioniste Mapam. Megjithatë, komandantët përgjegjës dhe vetë njësia që kreu krimin u dënuan shumë lehtë, duke marrë disa gjoba të vogla.[134] Kjo ishte një provë e mëtejshme se ushtrisë i ishte lënë dorë e lirë të vriste në territoret e pushtuara.

Mizoria sistematike nuk shfaqet vetëm në ngjarje të mëdha si kjo masakër. Mizoritë më të mëdha mund të gjenden edhe në praninë e përditshme të regjimit. Palestinezët në Izrael akoma nuk flasin shumë për periudhën pas vitit 1967 dhe dokumentat e asaj kohe nuk e zbulojnë tabllonë e plotë. Për çudi, është në poezi që gjejmë tregues se si ishte jeta nën sundimin ushtarak. Natan Altermani ishte një nga poetët më të famshëm dhe më të rëndësishëm të brezit të tij. Ai kishte një kolonë të përjavshme të quajtur *"Kolona e shtatë"*, në të cilën komentonte ngjarjet që kishte lexuar apo dëgjuar. Disa herë ai hiqte detaje në lidhje me datën apo vendin e ngjarjes, por i jepte lexuesit informacion të mjaftueshëm për ta kuptuar kujt po i referohej. Shpesh ai i shprehte sulmet e tij në formë poetike:

Lajmet u shfaqën shkurtimisht për dy ditë dhe u zhdukën.

Askujt nuk duket se i intereson dhe askush nuk duket se di.

Në fshatin e largët të Umm El-Fahmit,

Fëmijët, apo duhet të them qytetarët e shtetit, luanin në baltë.

Dhe njëri prej tyre ju duk i dyshimtë njërit prej ushtarëve tanë trima, që i bërtiti: Ndal!

Urdhëri është urdhër.

Urdhëri është urdhër, por djali budalla nuk u ndal,

Ai ja mbathi vrapit,

Kështu që ushtari ynë trim qëlloi, nuk është çudi,

Dhe e qëlloi dhe e vrau djalin.

Dhe askush nuk foli për të.[135]

Në një rast tjetër, ai shkroi një poemë mbi dy qytetarë palestinezë, që u qëlluan në Uadi Ara, ndërsa një

[134] Shira Robinson, *"Local Struggle, National Struggle: Palestinian Responses to the Kafr Qasim Massacre and its Aftermath, 1956–66," International Journal of Middle East Studies*, 35 (2003), fq. 393–416.
[135] Natan Alterman, *"A Matter of No Importance,"* Davar, 7 shtator 1951.

herë, ai rrëfeu historinë e një gruaje shumë të sëmurë palestineze, e cila u dëbua me dy fëmijët e saj, tre dhe gjashtë vjeç, dhe u dërgua përtej lumit Jordan. Kur ajo u përpoq të kthehej, bashkë me fëmijët u arrestua dhe u fut në burgun e Nazaretit. Altermani shpresonte që poema e tij për nënën do të prekte zemrat dhe mendjet, ose së paku do të nxiste një reagim zyrtar. Por një javë më vonë, ai shkroi:

Dhe ky shkrimtar mendoi gabimisht

Se historia, ose do të mohohej, ose do të shpjegohej

Por asgjë, asnjë fjalë.[136]

Kjo është një provë tjetër se Izraeli nuk ishte një demokraci para vitit 1967. Shteti ndoqi politikën "Qëllo për të vrarë" kundrejt refugjatëve që mundoheshin të rimerrnin tokën, të korrat dhe kursimet e tyre, dhe ndërmori një luftë koloniale për të përmbysur regjimin e Naserit në Egjipt. Forcat e tij të sigurisë e kishin të lehtë gishtin e këmbëzës, duke vrarë më shumë se 50 qytetarë palestinezë gjatë periudhës 1948-1967.

Testi matës i një demokracie është niveli i tolerancës që ajo dëshiron të tregojë kundrejt pakicave që jetojnë në të. Në këtë aspekt, Izraeli është shumë larg së qenit një demokraci e vërtetë. Për shembull, pas fitimit të territoreve të reja, u miratuan disa ligje që i siguronin shumicës një pozicion superior: ligjet e nënshtetësisë, ligjet për pronësinë mbi tokën dhe më i rëndësishmi nga të gjithë, ligji i rikthimit. Ky i fundit i jepte nënshtetësi automatike çdo hebreu të botës, kudo që të kishte lindur. Veçanërisht ky ligj është kokë e këmbë jodemokratik, sepse ai shoqërohet nga një mohim i plotë i së drejtës së palestinezëve për t'u rikthyer, e drejtë e njohur ndërkombëtarisht nga rezoluta 194 e vitit 1948 e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. Mohimi i së drejtës së një populli për t'u rikthyer në atdheun e tij dhe në të njëjtën kohë ofrimi i kësaj gjëje të tjerëve që nuk kanë asnjë lidhje me tokën, është model i një praktike jodemokratike.

Gati çdo diskriminim kundër qytetarëve palestinezë të Izraelit justifikohet me faktin se ata nuk shërbejnë në ushtri.[137] Shoqërimi mes të drejtave demokratike dhe detyrimeve ushtarake kuptohet më mirë nëse i heshim një sy viteve formues, gjatë së cilëve politikëbërësit izraelitë po mundoheshin ta ndanin mendjen se si ta trajtonin një të tretën e popullsisë. Pretendimi i tyre ishte që qytetarët palestinezë nuk donin në asnjë mënyrë që të futeshin në ushtri dhe se ky refuzim justifikonte politikën diskriminuese kundrejt tyre. Kjo u vu në provë në vitin 1954, kur ministria izraelite e mbrojtjes vendosi t'i thërrasë nën armë të gjithë ata qytetarë palestinezë që ishin të përshtatshëm për të shërbyer në ushtri. Shërbimi i fshehtë e siguroi qeverinë se do të kishte një kundërshtim masiv ndaj thirrjes nën armë. Për t'u çuditur, që të gjithë ata që ishin thirrur shkuan në zyrën e rekrutimit, me bekimin e Partisë Komuniste, forcës më të madhe dhe më të rëndësishme politike të bashkësisë asokohe. Më vonë, shërbimi i fshehtë e shpjegoi këtë, duke thënë se shkaku kryesor ishte mërzitja e adoleshentëve me jetën në fshat dhe dëshira e tyre për ca aksion dhe aventurë.[138]

Pavarësisht këtij episodi, ministria e mbrojtjes vazhdoi të tregtonte një narrativë që e portretizonte bashkësinë palestineze si të painteresuar për të shërbyer në ushtri. Në kohën e përshtatshme, palestinezët u kthyen kundër ushtrisë izraelite, që ishte bërë shtypësja e tyre e përjetshme, por shfrytëzimi nga qeveria e kësaj gjëje si pretekst për diskriminim hedh shumë dyshim mbi pretendimet e shtetit se është një

[136] Natan Alterman, *"Two Security Measures,"* The Seventh Column, Vol. 1, fq. 291 (në hebraisht).
[137] I kam rradhitur ato në *The Forgotten Palestinians*.
[138] Shih Pappe, *The Forgotten Palestinians*, fq. 65.

demokraci. Nëse je palestinez dhe nuk shërben në ushtri, atëherë të drejtat e tua për ndihmë nga qeveria si punëtor, student, prind ose si pjesë e çiftit janë tepër të kufizuara. Në veçanti, kjo prek strehimin si dhe punësimin, ku 70% e të gjithë industrisë izraelite konsiderohet si e lidhur ngushtë me sigurinë, ndaj është e mbyllur si vend punësimi ndaj këtyre qytetarëve.[139]

Supozimi i ministrisë së mbrojtjes është se jo vetëm që palestinezët nuk dëshirojnë të shërbejnë në ushtri, por ata janë një armik i brendshëm potencial, të cilit nuk mund t'i besohet. Problemi me këtë argument është se në të gjitha luftërat e mëdha ndërmjet Izraelit dhe botës arabe, pakica palestineze nuk u soll siç pritej. Megjithatë, kjo nuk i ndihmoi ata dhe deri sot e kësaj dite, ata shihen si një problem "demografik" që duhet të zgjidhet. Ngushëllimi i vetëm është që, akoma edhe sot, shumë politikanë izraelitë nuk besojnë së rruga e zgjidhjes së këtij "problemi" është transferimi apo dëbimi i palestinezëve (të paktën jo në kohë paqeje).

Pretendimi i të qenit një demokraci del se është i diskutueshëm, kur shqyrton politikën buxhetore që trajton çështjen e tokës. Që nga viti 1948, këshillat lokalë palestinezë dhe bashkitë kanë marrë shumë herë më pak fonde se sa kolegët e tyre hebrenj. Toka e pakët, e shoqëruar me mungesën e shanseve për punësim, krijon një realitet shoqëroro-ekonomik jonormal. Për shembull, bashkësia më e pasur palestineze, fshati i Meiljas në Galilenë e Epërme, është shumë më keq se qytetet eksperimentale hebreje më të varfëra të Negevit. Në vitin 2011, "Jerusalem Post" raportonte se "të ardhurat mesatare të hebrenjve ishin 40-60% më të larta se të ardhurat mesatare të arabëve ndërmjet viteve 1997 dhe 2009."[140]

Sot, më shumë se 90% e tokave janë pronë e Fondit Kombëtar Hebre (JNF). Pronarët e tokës nuk lejohen të kryejnë transaksione me qytetarët johebrenj dhe toka publike është me përparësi për përdorim në projektet kombëtare, që do të thotë se në to ndërtohen koloni të reja hebreje, por jo ato palestineze. Kështu, qyteti më i madh palestinez, Nazareti, ndonëse ka tre herë më shumë banorë se në vitin 1948, nuk është zgjeruar asnjë kilometër katror, ndërkohë që qyteti eksperimental i ndërtuar mbi të, Nazareti i Epërm, ka trefishin e madhësisë së tij dhe ndodhet mbi toka të shpronësuara nga pronarët palestinezë të tokave.[141]

Shembuj të mëtejshëm të kësaj politike mund të gjenden në fshatrat palestineze në të gjithë Galilenë, të cilët rrëfejnë të njëjtën histori: se si janë tkurrur nga 40%, disa herë edhe 60%, që nga viti 1948 dhe se si janë ndërtuar koloni të reja hebreje mbi tokat e shpronësuara. Gjetkë, kjo gjë ka nxitur përpjekje të hapura për hebreizim. Pas vitit 1967, qeveria izraelite ishte e shqetësuar për mungesën e hebrenjve që jetonin në veri dhe në jug të shtetit, ndaj planifikoi rritjen e popullsisë së atyre zonave. Për një ndryshim të tillë demografik duhej të konfiskoheshin tokat palestineze për ndërtimin e kolonive hebreje.

Akoma më i keq ishte përjashtimi i qytetarëve palestinezë nga këto koloni. Kjo goditje brutale ndaj së drejtës së një qytetari për të jetuar kudo që dëshiron, vazhdon edhe sot e kësaj dite dhe të gjitha përpjekjet e organizatave joqeveritare të të drejtave të njeriut në Izrael për ta sfiduar një aparteid të tillë kanë dështuar krejtësisht. Gjykata e lartë në Izrael ka qenë në gjendje vetëm që të vërë në dyshim ligjshmërinë e një politike të tillë në disa çështje individuale, por jo në parim. Paramendoni sikur në Britaninë e madhe apo në Shtetet e Bashkuara, qytetarë hebrenj apo edhe katolikë, të ndaloheshin me ligj që të jetonin në disa fshatra, lagje apo edhe qytete të tëra? Si mundet që një situatë e tillë të pajtohet me nocionin e demokracisë?

---

[139] Shih raportin e Adalah, *"An Anti-Human Rights Year for the Israeli Supreme Court,"* 10 dhjetor 2015, në adalah.org.
[140] *The Jerusalem Post*, 24 nëntor 2011.
[141] Shih Ilan Pappe, *"In Upper Nazareth: Judaisation," London Review of Books,* 10 shtator 2009.

Kështu, duke parë qëndrimin e tij kundrejt dy grupesh palestineze: refugjatëve dhe bashkësisë në Izrael, shteti hebre nuk mundet assesi që të merret për një demokraci. Por sfida më e qartë ndaj këtij supozimi është qëndrimi i pamëshirshëm izraelit kundrejt një grupi të tretë palestinez: atyre që kanë jetuar nën sundimin e tij të drejtpërdrejtë dhe atë jo të drejtpërdrejtë që nga viti 1967, në Jeruzalemin Lindor, Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës. Nga infrastruktura ligjore e ngritur që në fillimin e luftës, përmes pushtetit absolut dhe të padiskutueshëm të ushtrisë brenda dhe jashtë Bregut Perëndimor dhe jashtë Rripit të Gazës, e deri tek poshtërimi i miliona palestinezëve në një rutinë të përditshme, "demokracia e vetme" në Lindjen e Mesme sillet si një diktaturë e llojit më të keq.

Përgjigja kryesore diplomatike dhe akademike izraelite ndaj akuzave të mësipërme është që të gjitha këto masa janë të përkohshme dhe se ato do të ndryshojnë, nëse palestinezët, kushdo qofshin ata, do të sillen "më mirë". Po nëse vetëm hulumton dhe lëre më të jetosh në territoret e pushtuara, e kupton se sa qesharakë janë këto argumenta. Politikëbërësit izraelitë, siç kemi parë, janë të vendosur ta mbajnë gjallë pushtimin për aq kohë sa shteti hebre të qëndrojë i pacënuar. Ai është pjesë e asaj që sistemi politik izraelit e konsideron si statukuo, që gjithmonë është më i mirë se çdo ndryshim. Izraeli do të kontrollojë shumicën e Palestinës dhe, duke qenë se ajo gjithmonë do të përfshijë një popullsi të konsiderueshme palestineze, kjo mund të bëhet vetëm me mjete jodemokratike.

Veç kësaj, megjithë argumentat që tregojnë të kundërtën, shteti izraelit pretendon se pushtimi është pushtim i ndritur. Miti këtu qëndron në pretendimin se gjoja Izraeli erdhi me qëllime të mira për të kryer një pushtim dashamirës, por u detyrua të marrë një qëndrim më të ashpër për shkak të dhunës palestineze. Në vitin 1967, qeveria i ka trajtuar Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës si pjesë të natyrshme të "Erec Izrael", tokës së Izraelit, dhe ky qëndrim ka vazhduar që nga ajo kohë. Nëse vështron debatin ndërmjet partive të majta dhe atyre të djathta në Izrael mbi këtë çështje, vë re se mospajtimet mes tyre janë në lidhje me mënyrën se si të arrihet në këtë objektiv dhe jo në lidhje me vlefshmërinë e tij.

Megjithatë, në mesin e publikut të gjërë, ka pasur një debat të vërtetë mes atyre që mund të quhen "shpëtimtarë" dhe "kujdestarëve". "Shpëtimtarët" besojnë se Izraeli e ka marrë zemrën e lashtë të atdheut të tij dhe nuk mund të mbijetojë pa të në të ardhmen. Ndryshe nga ata, "kujdestarët" argumentojnë se territoret duhen shkëmbyer për paqe me Jordaninë, në rastin e Bregut Perëndimor, dhe me Egjiptin, në rastin e Rripit të Gazës.[142] Megjithatë, ky debat publik ka pasur pak ndikim në mënyrën se si politikëbërësit kryesorë vendosën se si t'i sundonin territoret e pushtuara. Pjesa më e keqe e këtij gjoja "pushtimi të ndritur" kanë qenë metodat e qeverisë për menaxhimin e territoreve. Fillimisht, zona u nda në hapësirat "arabe" dhe ato potencialisht "hebreje". Ato zona të populluara dendur me palestinezë u bënë autonome dhe qeveriseshin nga bashkëpunëtorë vendas nën një sundim ushtarak. Ky regjim u zëvendësua me një administratë civile vetëm në vitin 1981. Zonat e tjera, pra hapësirat hebreje, u kolonizuan me ngulime hebreje dhe baza ushtarake. Kjo politikë kishte për qëllim që ta linte popullsinë, si në Bregun Perëndimor, ashtu edhe në Rripin e Gazës, në enklava të veçuara pa hapësira të gjelbëra dhe as ndonjë mundësi për zgjerim urban.

Gjërat u përkeqësuan akoma më shumë, kur shumë shpejt pas pushtimit, Gush Emonim filloi kolonizimin në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës, duke pretenduar se po ndiqte një hartë biblike kolonizimi dhe jo atë qeveritare. Duke depërtuar në zonat me popullsi të dendur palestineze, hapësira e lënë për vendasit

[142] Shih Amnon Sella, *"Custodians and Redeemers: Israel's Leaders' Perceptions of Peace, 1967–1979," Middle East Studies*, 22:2 (1986), fq. 236–51.

u tkurr akoma më shumë.

Pikë së pari, çdo projekt kolonizimi ka nevojë për tokë. Në territoret e pushtuara, kjo u arrit vetëm nëpërmjet shpronësimit masiv të tokës, deportimit të popullsisë nga vendet ku kishin jetuar për breza të tërë dhe kufizimit të tyre nëpër enklava me habitate të vështirë. Kur fluturon mbi Bregun Perëndimor, sheh qartë rezultatet hartografike të kësaj politike: rripa kolonish që e ndajnë tokën dhe i copëtojnë bashkësitë palestineze në njësi të vogla, të izoluara dhe të shkëputura. Rripat hebreizues ndajnë fshatrat nga fshatrat, fshatrat nga qytetet dhe disa herë ndajnë më dysh edhe një fshat. Kjo është ajo që dijetarët e quajnë gjeografi të shkatërrimit, që kur këto politika rezultuan edhe si një shkatërrim ekologjik: tharje të burimeve ujore dhe shkatërrim të disa prej pjesëve më të bukura të pejsazhit palestinez. Veç kësaj, kolonitë u bënë shtretër të nxehtë, në të cilët ekstremizmi hebre u rrit në mënyrë të pakontrolluar, viktimat kryesore të së cilit ishin palestinezët. Kështu, kolonia në Efrat ka shkatërruar sitin arkeologjik, pronë të njerëzimit, të luginës së Uallaxhas pranë Betlehemit dhe fshati i Xhefnes pranë Ramallahut, i cili ishte i famshëm për kanalet e tij të ujërave të ëmbël, e humbi identitetin e tij si një atraksion turistik. Këto janë vetëm dy shembuj të vegjël nga qindra raste të ngjashëm.

Shembja e shtëpive nuk është një fenomen i ri në Palestinë. Ashtu si shumë nga metodat më barbare të ndëshkimit kolektiv të përdorura nga Izraeli që nga viti 1948, ajo u konceptua dhe u zbatua nga qeveria e Mandatit Britanik gjatë Revoltës së Madhe Arabe të viteve 1936-1939. Kjo ishte kryengritja e parë palestineze kundër politikës prosioniste të Mandatit Britanik dhe ushtrisë britanike ju deshën tre vjet për ta shtypur atë. Gjatë këtij procesi, ata shembën rreth 2000 shtëpi gjatë ndëshkimeve të ndryshme kolektive që ju bënë popullsisë vendase.[143] Izraeli shembi shtëpi që në ditën e parë të pushtimit të tij ushtarak të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës. Ushtria ka hedhur në erë me qindra shtëpi çdo vit në përgjigje të veprimeve të ndryshme të ndërmarrë nga individë të atyre familjeve.[144] Si për shkeljet e vogla të regjimit ushtarak, ashtu edhe për pjesëmarrje në veprime të dhunshme kundër pushtimit, izraelitët dërgonin shpejt buldozerët për të zhdukur nga faqja e dheut jo vetëm një ndërtesë fizike, por edhe një fokus të jetës dhe ekzistencës. Në zonën e Jeruzalemit të Madh, ashtu si edhe brenda Izraelit, shembjet ishin një ndëshkim për zgjerimin pa leje të një shtëpie ekzistuese apo mospagimin e faturave.

Një formë tjetër ndëshkimi, që kohët e fundit është rikthyer në repertorin izraelit, është edhe bllokimi i shtëpive. Paramendoni që të gjitha dyert dhe dritaret në shtëpinë tuaj të bllokohen me beton, llaç dhe gurë, kështu që të mos mundeni të merrni asgjë që nuk keni mundur dot ta nxirrni më parë! Kam kontrolluar shumë në librat e mi të historisë për të gjetur një shembull tjetër, por askund nuk kam gjetur prova të zbatimit të kësaj mase të pashpirt gjetiu.

Së fundmi, nën “pushtimin e ndritur”, kolonët lejohen të formojnë banda hakmarrëse që i bien në qafë njerëzve dhe shkatërrojnë pronat e tyre. Me kalimin e viteve, këto banda e kanë ndryshuar qasjen e tyre. Gjatë viteve ’80, ata ushtruan një terror të vërtetë: që nga plagosja e udhëheqësve palestinezë, njëri nga të cilët humbi këmbët në një sulm të tillë, deri tek planifikimi për të hedhur në erë xhamitë në Haremin e Shenjtë në Jeruzalem. Në këtë shekull, ata janë implikuar në rënien e përditshme në qafë të palestinezëve, duke ju shkulur pemët, shkatërruar të korrat dhe hapur zjarr mbi shtëpitë dhe automjetet e tyre. Që nga viti 2000, ka pasur të paktën 100 sulme të tilla të përmuajshme në disa zona si në Hebron, ku 500 kolonë,

[143] Motti Golani, *Palestine Between Politics and Terror, 1945–1947*, Brandeis: Brandeis University Press, 2013, fq. 201.
[144] Përshkrime të tmerrshme të detajuara të gati çdo shembjeje të tillë mund të gjenden në faqen në internet të Komitetit Izraelit kundër Shembjes së Shtëpive, në ichad.org

me bashkëpunimin e heshtur të ushtrisë izraelite, i bien në qafë brutalisht vendasve që jetojnë aty afër.[145]

Që nga fillimi i pushtimit dhe në vazhdim, palestinezëve u janë dhënë dy opcione: ose të pranojnë realitetin e burgimit të përhershëm në një burg të stërmadh për një kohë të gjatë, ose të përballen me fuqinë e ushtrisë më të fortë në Lindjen e Mesme. Kur palestinezët bënë rezistencë, si në vitet 1987, 2000, 2012, 2014 dhe 2016, ata u shënjeshtruan si ushtarë dhe njësi të një ushtrie konvencionale. Kështu, fshatrat dhe qytetet u bombarduan sikur të ishin baza ushtarake dhe popullsia civile e paarmatosur u qëllua sikur të ishte një ushtri në fushën e betejës. Sot, ne dimë aq shumë për jetën nën pushtim, para dhe pas Oslos, sa ta marrim seriozisht pretendimin se mosrezistenca sjell më pak shtypje. Arrestimet pa gjyq të shumë e shumë të pafajshmëve përgjatë këtyre viteve, shembja e mijëra shtëpive, vrasja dhe plagosja e të pafajshmëve dhe tharja e puseve të ujit, që të gjitha këto janë dëshmi të një prej regjimeve bashkëkohorë më të pashpirt të kohës sonë. Çdo vit, Amnesty International dokumenton në mënyrë të plotë natyrën e pushtimit. Paragrafi i mëposhtëm është shkëputur nga raporti i tyre i vitit 2015:

Në Bregun perëndimor, duke përfshirë Jeruzalemin Lindor, forcat izraelite kryen vrasje të paligjshme të civilëve palestinezë, duke përfshirë fëmijë, dhe ndaluan mijëra palestinezë, që protestuan kundër vazhdimit nga Izraeli të pushtimit ushtarak, duke mbajtur qindra prej tyre në arrest administrativ. Torturat dhe keqtrajtimet e tjera janë të shumta dhe kryhen pa asnjë frikë nga ndëshkimi. Autoritetet vazhduan të promovojnë kolonitë e paligjshme në Bregun Perëndimor dhe të kufizojnë në mënyrë drastike lirinë e lëvizjes së palestinezëve, duke shtuan ndjeshëm kufizimet në mes të një përshkallëzimi të dhunës që nga tetori, që përfshin sulme nga palestinezët kundër civilëve izraelitë dhe ekzekutime të dukshme jashtëgjyqësore nga forcat izraelite. Kolonët izraelitë në Bregun Perëndimor sulmuan palestinezët dhe pronat e tyre gati pa asnjë frikë nga ndëshkimi. Rripi i Gazës mbeti nën një bllokadë ushtarake izraelite, që përbën një ndëshkim kolektiv të banorëve të tij. Autoritetet vazhduan të shembin shtëpitë palestineze në Bregun Perëndimor dhe brenda Izraelit, veçanërisht në fshatrat beduine në rajonin e Negevit/Nakabit, duke i dëbuar me forcë banorët e tyre.[146]

Le ta shqyrtojmë këtë hap pas hapi. Së pari, vrasjet, që raporti i Amnesty International i quan "vrasje të paligjshme": rreth 15000 palestinezë janë vrarë "në mënyrë të paligjshme" nga Izraeli që nga viti 1967. Mes tyre janë 2000 fëmijë. Një tipar tjetër i "pushtimit të ndritur" është burgimi pa gjyq. Një në çdo pesë palestinezë në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës ka kaluar në një përvojë të tillë.[147] Është interesante ta krahasosh këtë praktikë izraelite me politika të ngjashme amerikane në të kaluarën dhe të tashmen, siç pretendojnë kritikët e lëvizjes BDS (Boycott, Divestment and Sanctions) se gjoja praktikat amerikane janë shumë më të këqija. Në fakt, shembulli më i keq amerikan ka qenë burgimi pa gjyq i 100000 qytetarëve japonezë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe më pas, mbajtja në burgje e 30000 personave nën të ashtuquajturën "luftë kundër terrorit". Asnjë nga këto shifra nuk i afrohet numrit të palestinezëve që e kanë përjetuar këtë proces, ku përfshihen të rinjtë, të moshuarit, si dhe të burgosurit me dënime afatgjata.[148] Arrestimi pa gjyq është një përvojë traumatike. Mosnjohja me akuzat kundër teje, mosmarrja e asnjë kontakti me një avokat dhe gati asnjë kontakt me familjen janë vetëm disa nga shqetësimet, me të

[145] Shih raportin e organizatës joqeveritare izraelite Yesh Din, *"Law Enforcement on Israeli Civilians in the West Bank,"* në yesh-din.org.
[146] Shih *"Israel and Occupied Palestinian Territories,"* në amnesty.org.
[147] Një nga raportet më të hollësishëm mbi numrin e të burgosurve mund të gjendet në Mohammad Ma'ri, *"Israeli Forces Arrested 800,000 Palestinians since 1967,"* The Saudi Gazette, 12 dhjetor 2012.
[148] Shih dokumentin në Harry Truman Library, *"The War Relocation Authority and the Incarceration of the Japanese-Americans in the Second World War,"* në trumanlibrary.org.

cilët përballesh si i burgosur. Në mënyrë shumë brutale, shumë nga këto arrestime përdoren si mjete për t'i bërë trysni të arrestuarve që të bashkëpunojnë. Përhapja e thashethemeve apo turpërimi i njerëzve për orientimin e tyre seksual të rremë apo të vërtetë përdoren shpesh si metoda për t'i detyruar ata që të pranojnë bashkëpunimin.

Në lidhje me torturën, faqja e besueshme në internet *Middle East Monitor* botoi një artikull pikëllues, në të cilin përshkruheshin 200 metodat e përdorura nga izraelitët për të torturuar palestinezët. Lista bazohet në një raport të OKB-së dhe një raport të organizatës izraelite për të drejtat e njeriut B'Tselem.[149] Mes metodave të tjera, përfshihen rrahjet, lidhja me zinxhirë në dyer apo karrige për orë të tëra, lagia me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë, nxjerrja nga vendi e gishtërinjve dhe përdredhja e testikujve.

Megjithatë, ajo që duhet të sfidojmë këtu, nuk është vetëm pretendimi i Izraelit se po mban një pushtim të ndritur, por edhe shtirja e tij se është një demokraci. Një sjellje e tillë kundrejt miliona njerëzve nën sundimin e tij e demaskon këtë mashtrim të tillë politik. Megjithatë, ndonëse sektorë të konsiderueshëm të shoqërive civile në të gjithë botën e hedhin poshtë pretendimin e Izraelit se është një demokraci, elitat e tyre politike, për një varg arsyesh, akoma e trajtojnë atë si një anëtar të klubit ekskluziv të shteteve demokratike. Në shumë mënyra, popullariteti i lëvizjes BDS pasqyron frustracionin e këtyre shoqërive ndaj politikave të qeverive të tyre kundrejt Izraelit.

Për shumë izraelitë, këto kundërargumenta janë të parëndësishëm, në rastin më të mirë, dhe keqdashës, në rastin më të keq. Shteti izraelit kapet fort pas pikëpamjes se ai është një pushtues dashamir. Argumenti për "pushtimin e ndritur" mbron idenë që, sipas qytetarit mesatar hebre në Izrael, palestinezët janë shumë më mirë nën pushtim dhe nuk kanë asnjë arsye për t'i bërë rezistencë atij, lere më me forcë. Nëse je mbështetës jokritik i Izraelit në botë, ti i pranon këto pretendime pa ngurruar.

Megjithatë, ka pjesë të shoqërisë izraelite që e pranojnë vlefshmërinë e disa prej deklarimeve të bëra këtu. Në vitet '90, me shkallë të ndryshme bindjeje, një numër i rëndësishëm akademikësh, gazetarësh dhe artistësh hebrenj shprehën dyshimin e tyre mbi përkufizimin e Izraelit si një demokraci. Të duhet shumë kurajo të sfidosh mitet themeluese të shoqërisë dhe shtetit tënd. Kjo është arsyeja se pse disa prej tyre u tërhoqën nga ky qëndrim trimëror dhe u rifutën në rradhë me të tjerët. Sidoqoftë, për një farë periudhe gjatë dekadës së fundit të shekullit të kaluar, ata krijuan vepra që sfiduan pretendimin për një Izrael demokratik. Ata e portretizuan Izraelin se i përkiste një bashkësie tjetër: asaj të kombeve jodemokratikë. Njëri prej tyre, gjeografi Oren Jiftashel (Oren Yiftachel) nga Universiteti Ben-Gurion, e përshkroi Izraelin si një etnokraci, një regjim që qeveriste një shtet të përzier etnikisht me preferencë ligjore dhe formale për një grup etnik në kurriz të të tjerëve.[150] Të tjerë shkuan akoma më larg, duke e etiketuar Izraelin si një shtet aparteidi ose një shtet kolonial ngulitës.[151] Shkurt, në asnjërin nga këta përshkrime që këta dijetarë kritikë kanë ofruar, nuk gjendet fjala "demokraci".

[149] Shih *"Torture in Israeli Prisons,"* 29 tetor 2014, në middleeastmonitor. com.
[150] Oren Yiftachel and As'ad Ghanem, *"Towards a Theory of Ethnocratic Regimes: Learning from the Judaisation of Israel/Palestine,"* në E. Kaufman (ed.), *Rethinking Ethnicity, Majority Groups and Dominant Minorities*, London and New York: Routledge, 2004, fq. 179–97.
[151] Shih Uri Davis, *Apartheid Israel: Possibilities for the Struggle from Within*, London: Zed Books, 2004.

KREU VIII

MITOLOGJITË E OSLOS

Më 13 shtator të vitit 1993, Izraeli dhe Organizata për Çlirimin e Palestinës (OÇP) nënshkruan një deklaratë parimesh, të njohur si Marrëveshja e Oslos, në lëndinën e Shtëpisë së Bardhë nën kujdesin e presidentit Bill Klinton. Udhëheqësi i OÇP-së Jaser Arafat; kryeministri izraelit Jichak Rabin dhe ministri i jashtëm izraelit Shimon Peres, më vonë do të merrnin për këtë marrëveshje çmimin Nobel për Paqe. Kjo i dha fund një periudhë të gjatë negociatash që kishin filluar në vitin 1992. Deri në atë vit, Izraeli kishte refuzuar që të negocionte drejtpërdrejt me OÇP-në në lidhje me fatin e Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës, apo për çështjen palestineze në përgjithësi. Qeveritë e njëpasnjëshme izraelite kishin preferuar të negocionin me Jordaninë, por që nga mesi i viteve ’80, ata i kishin lejuar përfaqësuesit e OÇP-së që të bënin pjesë në delegacionet jordaneze.

Ka një sërë arsyesh për ndryshimin në qëndrimin izraelit që mundësoi negociatat e drejtpërdrejta me OÇP-në. E para ishte fitorja e Partisë Laburiste në zgjedhjet e vitit 1992 (për herë të parë që nga viti 1977) dhe formimi i një qeverie që ishte më e interesuar për një zgjidhje politike se sa administratat e mëparshme të kryesuara nga Likudi. Qeveria e re e kuptoi se përpjekjet për të negociuar drejtpërdrejt me udhëheqjen vendore palestineze mbi autonominë kishin ngecur, sepse çdo vendim palestinez i përcillej shtabit qëndror të OÇP-së në Tunis, ndaj një vijë e drejtpërdrejtë ishte më e dobishme.

Arsyeja e dytë kishte të bënte me perceptimin izraelit që rridhte nga nisma paqësore e Madridit: një sipërmarrje amerikane për t’i sjellë Izraelin, palestinezët dhe botën arabe në një tryezë të përbashkët për të rënë dakord mbi një zgjidhje menjëherë pas Luftës së Parë të Gjirit. Presidenti Xhorxh Bush dhe sekretari i tij i shtetit Xhejms Bejker e kishin filluar këtë nismë që në vitin 1991. Që të dy këta politikanë deklaruan se Izraeli ishte një pengesë për paqen dhe i bënë trysni qeverisë izraelite që të binte dakord për ndalimin e ndërtimit të kolonive për t’i dhënë një shans zgjidhjes së dy shteteve. Asokohe, marrëdhëniet izraelito-amerikane ishin në një pikë të ulët të paprecedentë. Administrata e re izraelite filloi kontakte të drejtpërdrejta me vetë OÇP-në. Konferenca e Madridit dhe përpjekjet për paqe nën patronazhin e saj ishin ndoshta përpjekjet e para të sinqerta amerikane për të gjetur një zgjidhje për Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës, të bazuar mbi tërheqjen izraelite. Elita politike izraelite donte që ta pengonte këtë lëvizje, duke e mbytur atë akoma pa lindur. Ata preferonin të lançonin propozimin e tyre për paqe dhe t’i bindnin palestinezët që ta pranonin atë. Gjithashtu, Jaser Arafati ishte i pakënaqur me nismën e Madridit, sepse për të, udhëheqja vendore palestineze në territoret e pushtuara, e kryesuar nga udhëheqësi nga Gaza, Hajdar Abdush-Shafi, dhe Fejsal El-Husejni nga Jeruzalemi, kërcënonte udhëheqësinë dhe popullaritetin e tij, duke marrë kryesimin e negociatave.

Kështu, OÇP-ja në Tunis dhe ministria e jashtme izraelite në Jeruzalem filluan negociata pas kulisave, ndërkohë që vazhdonin përpjekjet për paqe në Madrid. Ata gjetën një ndërmjetës të gatshëm tek Fafo, një institut norvegjez për paqe me bazë në Oslo. Më së fundi, të dy ekipet u takuan haptas në gusht të vitit 1993 dhe me përfshirjen amerikane, ato përfunduan Deklaratën e Parimeve (DOP). Deklarata u përshëndet si fundi i konfliktit, kur u nënshkrua me shumë shtirje në lëndinën e Shtëpisë së Bardhë në shtator të vitit 1993.

Ekzistojnë dy mite të shoqëruar me procesin e Oslos. I pari është që ai ishte një proces i vërtetë paqeje dhe i dyti, që Jaser Arafati e minoi atë qëllimisht, duke nxitur Intifadën e Dytë, si një operacion terrorist

kundër Izraelit.

Miti i parë ka lindur nga dëshira e të dyja palëve në vitin 1992 për të arritur në një zgjidhje. Por kur kjo gjë dështoi, shpejt u bë një lojë se kush duhet të fajësohej për të. Përkrahësit izraelitë të vijës së ashpër e drejtojnë gishtin drejt udhëheqjes palestineze. Një version liberal sionist më me shumë nuanca i këtij deklarimi ia hedh fajin Jaser Arafatit, por edhe së djathtës izraelite, veçanërisht Beniamin Netaniahus, për ngecjen e shkaktuar pas vdekjes së udhëheqësit palestinez në vitin 2004. Në të dyja skenarët, procesi i paqes konsiderohet si i sinqertë, ndonëse i dështuar. Por e vërteta është shumë më e ndërlikuar. Kushtet e marrëveshjes ishin të pamundura për t'u realizuar. Pretendimi se Arafati refuzoi që të respektonte premtimet palestineze të bëra në marrëveshjen e vitit 1993 nuk reziston para fakteve. Ai nuk mund të zbatonte premtime që ishin të pamundura për t'u mbajtur. Për shembull, nga autoritetet palestineze pritej që të vepronin si nënkontraktor sigurie për Izraelin brenda territoreve të pushtuara dhe të siguronin se nuk do të kishte asnjë veprimtari rezistence. Më saktë, nga Arafati pritej që të pranonte pa asnjë diskutim interpretimin izraelit të zgjidhjes përfundimtare që rridhte nga marrëveshja. Izraelitët ia paraqitën këtë fakt të kryer Arafatit në verën e vitit 2000, në samitin e Kemp Dejvidit, ku udhëheqësi palestinez po negocionte marrëveshjen përfundimtare me kryeministrin izraelit Ehud Barak dhe presidentin amerikan Bill Klinton.

Baraku kërkoi një shtet palestinez të çmilitarizuar me kryeqytet në fshatin Ebu Dis pranë Jeruzalemit dhe pa pjesë të Bregut Perëndimor si Lugina e Jordanit, blloqet e mëdha të kolonive hebreje dhe zonat në Jeruzalemin e Madh. Shteti i ardhshëm nuk do të kishte një politikë të pavarur në fushën e ekonomisë dhe punëve të jashtme, duke qenë autonom vetëm disa aspekte të brendshme si sistemi arsimor, mbledhja e taksave, bashkitë, policia dhe mirëmbajtja e infrastrukturës në terren. Formalizimi i kësaj marrëveshjeje do të sinjalizonte fundin e konfliktit dhe do t'i jepte fund çdo kërkese palestineze në të ardhmen, si për shembull e drejta e kthimit të refugjatëve palestinezë të vitit 1948.

Që nga fillimi, procesi i paqes ishte një flluskë e shpuar. Për të kuptuar dështimin e Oslos, duhet që ta zgjerojmë analizën dhe t'i lidhim ngjarjet me dy parime që mbetën pa përgjigje gjatë gjithë marrëveshjes. I pari ishte parësia e ndarjes gjeografike apo territoriale si themel ekskluziv i paqes, ndërsa i dyti ishte mohimi i së drejtës së refugjatëve palestinezë për t'u kthyer dhe përjashtimi i saj nga tryeza e negociatave.

Propozimi që ndarja fizike e tokës ishte zgjidhja më e mirë e konfliktit u shfaq për të parën herë në vitin 1937 si pjesë e Komisionit Mbretëror Britanik (Peel Report). Asokohe, lëvizja sioniste sugjeronte që Jordania (në atë kohë Transjordania) duhet të aneksonte *"pjesët arabe të Palestinës"*, por idea u hodh poshtë nga palestinezët.[152] Më vonë, ajo u rimbështet si mënyra më e mirë për të shkuar përpara nga Rezoluta e Ndarjes e OKB-së e nëntorit të vitit 1947. OKB-ja caktoi një komision të posaçëm hetimor (UNSCOP) për t'u përpjekur për gjetjen e nje zgjidhjeje. Anëtarët e komisionit erdhën nga vende që kishin shumë pak interes apo njohuri mbi Palestinën. Organi përfaqësues arab, Komisioni i Lartë Arab dhe Liga Arabe e bojkotuan UNSCOP-in, duke refuzuar që të bashkëpunonin me të. Kjo krijoi një vakum që u mbush nga diplomatët dhe udhëheqja sioniste, të cilët e ushqyen UNSCOP-in me idetë e tyre për zgjidhjen. Ata sugjeruan krijimin e një shteti hebre mbi 80% të Palestinës, por komisioni e zvogëloi atë në 56%.[153] Egjipti dhe Jordania ishin të gatshëm që ta legjitimonin marrjen e Palestinës nga Izraeli në vitin 1948 në këmbim të marrëveshjeve dypalëshe me ta, që në fakt u nënshkruan nga Egjipti në vitin 1979 dhe nga Jordania në

[152] Masalha, *Expulsion of the Palestinians*, p. 107.
[153] Walid Khalidi, *"Revisiting the UNGA Partition Resolution," Journal of Palestine Studies*, 27:1 (1997), fq. 5–21.

vitin 1994.

Më pas, ideja e ndarjes u shfaq nën emra dhe referime të ndryshme në përpjekjet e kryesuara nga amerikanët pas vitit 1967. Ajo nënkuptohej në ligjërimin e ri që u shfaq, atë të "territoreve për paqe", që çdo negociator paqeje e trajtonte si një formulë të shenjtë: nga sa më shumë territore që të tërhiqej Izraeli, aq më shumë paqe do të merrte. Territori, nga i cili Izraeli mund të tërhiqej, ishte brenda 20% që nuk kishte marrë në vitin 1948. Pra, në thelb, ideja ishte që të ndërtohej paqja mbi bazën e ndarjes së 20% që kishte mbetur mes Izraelit dhe cilitdo ai që do të legjitimonte si partner paqeje (jordanezët deri nga fundi i viteve '80 dhe palestinezët më pas).

Ndaj, nuk duhet të çuditemi, që kjo u bë guri i themelit të logjikës që frymëzoi hapjen e diskutimeve në Oslo. U harrua shumë lehtë se historikisht, sa herë që ishte ofruar ndarja, ajo ishte pasuar nga më shumë gjakderdhje dhe nuk kishte rezultuar në paqen e dëshiruar. Në të vërtetë, udhëheqësit palestinezë asnjëherë nuk kishin kërkuar ndarje. Ajo kishte qenë gjithmonë një ide sioniste dhe më pas, ide izraelite. Veç kësaj, pjesa e territorit të kërkuar nga izraelitët rritej sa më shumë që shtohej fuqija e tyre. Kështu, ndërkohë që ideja e ndarjes fitonte mbështetje botërore në rritje, gjithnjë e më shumë ajo i dukej palestinezëve si një strategji ofensive. Vetëm për shkak të mungesave të alternativave, pala palestineze e pranoi këtë brenda kushteve të negocimit si të keqen më të vogël. Në fillimet e viteve '70, Fatahu e pranoi ndarjen si një mjet të nevojshëm në rrugën drejt çlirimit të plotë, por jo si një zgjidhje përfundimtare në vetvete.[154]

Në të vërtetë, pa ushtrimin e një trysnie të jashtëzakonshme, nuk ka asnjë arsye në botë që ta shtyjë një popullsi vendase të pranojë ndarjen e atdheut të saj me një popullsi koloniste. Dhe për këtë arsye, duhet ta pranojmë që procesi i Oslos nuk ishte një kërkim i drejtë dhe i barabartë për paqe, por një kompromis i pranuar nga një popull i mundur dhe i kolonizuar. Si përfundim, palestinezët u detyruan të kërkonin zgjidhje që binin ndesh me interesat e tyre dhe rrezikonin vetë ekzistencën e tyre.

I njëjti argumentim mund të bëhet për debatet në lidhje me "zgjidhjen e dy shteteve" që u ofrua në Oslo. Kjo ofertë duhet parë ashtu siç është: ndarje nën një emërtim të ri. Edhe në këtë skenar, ndonëse kushtet e debatit duken si të ndryshme, Izraeli jo vetëm që do të vendosë se sa territore do të lëshojë, por edhe se çfarë do të ndodhë me ato territore që do të lerë pas. Ndërsa premtimi për shtetformim fillimisht u duk bindës për botën dhe disa palestinezë, shpejt doli se ishte vetëm një flluskë sapuni. Megjithatë, dy nocionet e ndërthurur të tërheqjes territoriale dhe shtetformimit u paketuan me sukses si pjesë e marrëveshjes për paqe në Oslo në vitin 1993. Por brenda pak javësh nga nënshkrimi i përbashkët në lëndinën e Shtëpisë së Bardhë, marrëveshje mbeti bojë mbi letër. Nga fundi i shtatorit, tashmë parimet e turbullta të Marrëveshjes ishin përkthyer në një realitet të ri gjeopolitik në terren nën kushtet e asaj që u quajt Oslo 2 apo marrëveshja e Tabës.[155] Kjo jo vetëm që përfshinte ndarjen e Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës në zona "hebreje" dhe "palestineze", por copëtonte më tej zonat palestineze në kantone të vogla apo bantustane. Harta e paqes e vitit 1995 përbëhej nga një seri zonash të ndara palestineze, që sipas fjalëve të disa komentuesve, ngjasonte me djathin zviceran.[156]

Sapo ky program u bë i qartë, negociatat filluan të marrin me shpejtësi tatëpjetën. Përpara takimit të samitit përfundimtar në verën e vitit 2000, shumë veprimtarë, akademikë dhe politikanë palestinezë e

[154] Rrëfimi më i mirë i zhvillimeve që çuan në Marrëveshjen e Oslos është Hilde Henriksen Waage, *"Postscript to Oslo: The Mystery of Norway's Missing Files," Journal of Palestine Studies*, 38:1 (2008), fq. 54–65.
[155] Shih *"1993 Oslo Interim Agreement,"* në israelipalestinian.procon.org.
[156] Shih Ian Black, *"How the Oslo Accord Robbed the Palestinians," Guardian*, 4 shkurt 2013.

kishin kuptuar se procesi që ata kishin mbështetur nuk përfshinte asnjë tërheqje ushtarake izraelite nga territoret e pushtuara dhe as që premtonte krijimin e një shteti të vërtetë. Maskat u çorrën dhe përparimi bëri vendnumëro. Ndjenja e dëshpërimit që pasoi kontribuoi për shpërthimin e kryengritjes së dytë palestineze në vjeshtën e vitit 2000.

Procesi i paqes së Oslos nuk dështoi thjesht si pasojë të përkushtimit të tij ndaj parimit të ndarjes. Në marrëveshjen origjinale kishte një premtim izraelit, që të tre çështjet që shqetësonin më shumë palestinezët: fati i Jeruzalemit, refugjatët dhe kolonitë hebreje, do të negocioheshin sapo periudha kalimtare pesëvjeçare të mbyllej me sukses. Brenda kësaj periudhe kalimtare, palestinezët duhet të tregonin se mund të shërbenin me efikasitet si nënkontraktorë sigurie të Izraelit, duke parandaluar çdo sulm terrorist apo guerrilas kundër shtetit hebre, ushtrisë, kolonistëve dhe qytetarëve të tij. Përkundër premtimit të bërë në marrëveshjen e Oslos, kur përfundoi faza e parë prej pesë vitesh, faza e dytë, në të cilën do të diskutoheshin çështjet më thelbësore për palestinezët, nuk filloi. Qeveria Netanjahu deklaroi se nuk ishte në gjendje ta fillonte këtë fazë, për shkak të "sjelljes së keqe" palestineze, ku përfshiheshin "nxitjet në shkolla" dhe dënimin e dobët të sulmeve terroriste kundër ushtarëve, kolonëve dhe qytetarëve të tij. Por e vërteta është që procesi ngeci kryesisht nga vrasja e kryeministrit izraelit Jichak Rabin në nëntor të vitit 1995. Vrasja u pasua nga fitorja e Partisë Likud të kryesuar nga Netanjahu në zgjedhjet kombëtare të vitit 1996. Kundërshtimi i hapur i kryeministrit të ri ndaj Marrëveshjes e frenoi procesin. Edhe kur amerikanët e detyruan atë të rifillonte negociatat, përparimi ishte jashtëzakonisht i ngadaltë deri në rikthimin në pushtet të Partisë Laburiste nën Ehud Barakun. Në vitin 1999, Baraku ishte i vendosur për ta përmbyllur procesin me një marrëveshje përfundimtare paqeje, një impuls ky i mbështetur plotësisht nga administrata Klinton.

Oferta përfundimtare e Izraelit, e paraqitur gjatë diskutimeve në Kemp Dejvid në verën e vitit 2000, propozonte një shtet të vogël palestinez me kryeqytet në Ebu Dis, por pa ndonjë heqje të rëndësishme të kolonive dhe asnjë shpresë për rikthimin e refugjatëve. Pasi palestinezët e hodhën poshtë këtë ofertë, pati një përpjekje joformale nga zëvendësministri i jashtëm izraelit Josi Beilin (Yossi Beilin) për të ofruar një ujdi më të arsyeshme. Në lidhje me çështjen e refugjatëve, ai ra dakord për kthimin e tyre në një shtet të ardhshëm palestinez dhe për një riatdhesim simbolik në Izrael. Por këto kushte joformale nuk u ratifikuan kurrë nga shteti. Falë rrjedhjes së dokumentave kyç, të njohur si dokumentat e Palestinës, ne kemi tani një pasqyrë më të qartë të natyrës së negociatave dhe lexuesit, që dëshirojnë të shqyrtojnë aspektet e tjera të negociatave ndërmjet viteve 2001 dhe 2007, janë të këshilluar që të konsultohen me këtë burim në dispozicion.[157] Kur negociatat dështuan, ishte udhëheqja palestineze dhe jo politikanët izraelitë, ajo që u akuzua si intransigjente dhe që çoi në dështimin e Oslos. Kjo gjë i bën një shërbim të keq personave të përfshirë dhe mënyrës se sa seriozisht u morën mundësitë e ndarjes.

Përjashtimi nga axhenda i së drejtës palestineze të rikthimit është arsyeja e dytë se përse Marrëveshja e Oslos nuk kishte ndonjë rëndësi si proces paqeje. Ndërsa parimi i ndarjes e reduktonte "Palestinën" vetëm në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës, përjashtimi i çështjes së refugjatëve dhe pakicës palestineze brenda Izraelit, e tkurri "popullin palestinez" nga ana demografike në më pak se gjysmën e kombit palestinez. Kjo mungesë vëmendje ndaj çështjes së refugjatëve nuk ishte diçka e re. Që nga fillimi i përpjekjeve për paqe në Palestinën e pas Mandatit, refugjatët i ishin nënshtruar një fushate shtypjeje dhe neglizhence. Që nga konferenca e parë për paqe mbi Palestinën e pas vitit 1948 deri tek takimi i Lozanës i prillit të vitit 1949, problemi i refugjatëve ishte përjashtuar nga axhenda e paqes dhe ishte ndarë nga

[157] Shih *"Meeting Minutes: Taba Summit—Plenary Session,"* në thepalestinepapers.com.

koncepti i "konfliktit të Palestinës". Izraeli mori pjesë në atë konferencë vetëm sepse kjo gjë ishte parakusht për pranimin e tij si anëtar të plotë të OKB-së, i cili kërkonte prej tij që të nënshkruante një protokoll, të quajtur Protokolli i Majit, në të cilin të zotohej se do të zbatonte kushtet e Rezolutës 194, që përfshinte rikthimin pa kushte të refugjatëve palestinezë në shtëpitë e tyre ose dhënien e kompensimit. Një ditë pasi protokolli u nënshkrua në maj të vitit 1949, Izraeli u pranua në OKB dhe menjëherë tërhoqi zotimin e tij për zbatimin e atij protokolli.

Në prag të luftës së qershorit të vitit 1967, në përgjithësi bota e pranoi pretendimin e Izraelit se konflikti në Palestinë filloi me atë luftë dhe në thelb, ai ishte luftë për të ardhmen e Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës. Edhe disa regjime arabe e pranuan këtë nocion, duke i kthyer kurrizin çështjes së refugjatëve. Megjithatë, shpejt kampet e refugjatëve u bënë qendra të veprimtarive intensive politike, shoqërore dhe kulturore. Për shembull, në ato kampe rilindi lëvizja çlirimtare palestineze. Vetëm OKB-ja vazhdoi të përmendë në shumë prej rezolutave të saj detyrimin e bashkësisë ndërkombëtare për të siguruar riatdhesimin e plotë dhe pa kushte të refugjatëve palestinezë: zotimi i parë u bë në Rezolutën 194 të vitit 1948. Akoma edhe sot, në OKB gjendet një organ i quajtur *"Komiteti për të drejtat e patjetërsueshme të refugjatëve palestinezë"*, por ai pati shumë pak ndikim në procesin e paqes.

Marrëveshja e Oslos nuk ishte më ndryshe. Në këtë dokument, çështja e refugjatëve u varros në nënklauzolë, gati e padukshme në mesin e një morie fjalësh. Partnerët palestinezë në atë marrëveshje kontribuan për këtë sfumim, ndoshta më shumë nga pakujdesia se sa qëllimisht, por përfundimi ishte i njëjtë. Problemi i refugjatëve, zemra e konfliktit në Palestinë, një realitet i pranuar nga të gjithë palestinezët kudo ku ndodhen dhe të gjithë simpatizantët e çështjes palestineze, u margjinalizua në dokumentet e Oslos. Kjo çështje ju dorëzua një grupi jetëshkurtër shumëpalësh, të cilit ju kërkua që të fokusohej tek refugjatët e vitit 1967, pra palestinezët që u dëbuan apo u larguan pas luftës së qershorit. Në të vërtetë, Marrëveshja e Oslos zëvendësoi një përpjekje embrionale të lindur nga procesi i paqes së Madridit të vitit 1991 për të formuar një grup shumëpalësh që do të diskutonte çështjen e refugjatëve në bazë të Rezolutës 194 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Gjatë vitit 1994, grupi u kryesua nga kanadezët, të cilët e konsideruan të drejtën e rikthimit si një mit, kështu që ajo u shua. Sidoqoftë, pa asnjë njoftim zyrtar, grupi i ndërpreu takimet dhe fati i të paktën refugjatëve të vitit 1967, që janë më shumë se 300000 persona, u braktis.

Zbatimi i Marrëveshjes pas vitit 1993 nuk bëri gjë tjetër veçse i përkeqësoi gjërat. Rregullat e marrëveshjes kërkonin që udhëheqja palestineze të hiqte dorë nga e drejta e rikthimit. Kështu, vetëm pesë vjet pas kantonizimit të "entitetit palestinez" dhe shndërrimit të tij në një bantustan, udhëheqjes palestineze iu dha leje që të shprehte dëshirën për ta trajtuar problemin e refugjatëve si pjesë e negociatave për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Palestinës. Megjithatë, shteti izraelit ia doli që të përcaktonte kushtet e diskutimit dhe për rrjedhojë, të bënte dallim mes futjes së "problemit të refugjatëve" si një ankesë legjitime palestineze, nga njëra anë, dhe kërkesës për "të drejtën e rikthimit", nga ana tjetër, të cilën ia doli ta përshkruante si një provokim palestinez.

Në përpjekjen e fundit për të shpëtuar marrëveshjen në samitin e Kemp Dejvidit në vitin 2000, çështja e refugjatëve nuk u trajtua më mirë. Në janar të vitit 2000, qeveria e Barakut paraqiti një dokument, të mbështetur nga negociatorët amerikanë, në të cilin përcaktoheshin parametrat e negociatave. Ky ishte një diktat izraelit dhe deri në mbajtjen e samitit në verë, palestinezët nuk ja dolën të sjellin një kundërpropozim. Në thelb, "negociatat" përfundimtare ishin një përpjekje e koordinuar izraelito-amerikane për t'i detyruar palestinezët që ta pranonin dokumentin, i cili përfshinte mes të tjerave, një

kundërshtim absolut dhe kategorik të së drejtës së palestinezëve për t'u rikthyer. Ai linte të hapur për diskutim numrin e refugjatëve që mund të lejoheshin të riktheheshin në territoret e kontrolluara nga Autoriteti Palestinez, ndonëse që të gjithë e kuptonin se ato zona të stërmbushura nuk ishin në gjendje të përthithnin më shumë njerëz, ndërkohë që në pjesën tjetër të Izraelit dhe Palestinës kishte plot hapësirë për të riatdhesuar refugjatët. Kjo pjesë e diskutimit ishte një gjest i pakuptimtë i futur vetëm për t'i mbyllur gojën çdo kritike, pa ofruar asnjë zgjidhje reale.

Kështu procesi i paqes i viteve '90 nuk ishte aspak i tillë. Këmbëngulja për ndarjen dhe përjashtimi nga axhenda i çështjes së refugjatëve, në rastin më të mirë, e bënë procesin e Oslos një ridislokim ushtarak dhe një rivendosje të kontrollit izraelit mbi Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës. Në rastin më të keq, ai përuroi një sistem të ri kontrolli, që e bëri jetën e palestinezëve që jetonin në territoret e pushtuara shumë më të keq se ç'ishte më parë.

Pas vitit 1995, impakti i Marrëveshjes së Oslos si një faktor që shkatërroi shoqërinë palestineze, në vend që të sillte paqe, u bë akoma më i dukshëm. Pas vrasjes së Rabinit dhe zgjedhjes së Netaniahut në vitin 1996, Marrëveshja u bë një diskutim për paqe pa asnjë rëndësi për realitetin në terren. Gjatë periudhave të bisedimeve ndërmjet viteve 1996-1999, koloni të tjera u ndërtuan dhe palestinezët vuajtën nga shumë ndëshkime të tjera kolektive. Edhe nëse patët besuar në zgjidhjen e dy shteteve në vitin 1999, mjafton një xhiro në Bregun Perëndimor apo Rripin e Gazës për t'u bindur në vërtetësinë e fjalëve të historianit izraelit Meron Benvenisti, i cili ka shkruar se Izraeli krijoi fakte të parikthyeshme në terren: zgjidhja e dy shteteve u vra nga Izraeli.[158] Duke qenë se procesi i Oslos nuk ishte një proces i vërtetë paqeje, pjesëmarrja e palestinezëve në të dhe ngurrimi i tyre për ta vazhduar nuk është shenjë e intransigjencës së tyre të pretenduar dhe kulturës së tyre të dhunës, por një përgjigje natyrale ndaj fasadës diplomatike që forcoi dhe thelloi kontrollin izraelit mbi territoret e pushtuara.

Kjo gjë të çon drejt mitit të dytë në lidhje me procesin e Oslos: që intransigjenca e Arafatit solli dështimin e samitit të Kemp Dejvidit të vitit 2000. Këtu i duhet dhënë përgjigje dy pyetjeve. E para: çfarë ndodhi në samitin e Kemp Dejvidit në verën e vitit 2000, kush ishte përgjegjësi për dështimin e samitit? E dyta: kush ishte përgjegjës për dhunën e Intifadës së dytë? Të dyja këto pyetje do të na ndihmojnë që të merremi drejtpërdrejt me pretendimin e përhapur se Arafati ishte një luftënxitës, që erdhi në Kemp Dejvid për të shkatërruar procesin e paqes dhe u kthye në Palestinë i vendosur që të fillonte një intifadë të re.

Para se t'i japim përgjigje këtyre pyetjeve, duhet të rikujtojmë realitetin në territoret e pushtuara ditën që Arafati u nis për në Kemp Dejvid. Argumenti im kryesor këtu është që Arafati erdhi në Kemp Dejvid për ta ndryshuar atë realitet, ndërsa izraelitët dhe amerikanët erdhën të vendosur për ta ruajtur atë të pandryshuar. Procesi i Oslos i kishte shndërruar territoret e pushtuara në një gjeografi katastrofe, që do të thotë se cilësia e jetës së palestinezëve pas marrëveshjes ishte shumë më e keqe se ajo para saj. Që në vitin 1994, qeveria e Rabinit e kishte detyruar Arafatin të pranonte interpretimin e saj se si duhej zbatuar Marrëveshja në terren. Bregu Perëndimor u nda në zonat famëkeqe A, B dhe C. Zona A kontrollohej drejtpërdrejt nga Izraeli dhe përbënte gjysmën e Bregut Perëndimor. Lëvizja brenda dhe ndërmjet këtyre zonave u bë gati e pamundur dhe Bregu Perëndimor u nda nga Rripi i Gazës. Vetë Rripi i Gazës u nda mes palestinezëve dhe kolonëve hebrenj, të cilët morën nën kontroll shumicën e burimeve ujore dhe jetonin në bashkësi të mbyllura të rrethuara me tela me gjemba. Kështu, rezultati përfundimtar i këtij procesi të supozuar paqeje ishte një përkeqësim i cilësisë së jetës së palestinezëve.

[158] Meron Benvenisti, *West Bank Data Project: A Survey of Israel's Politics*, Jerusalem: AEI Press, 1984.

Ky ishte realiteti i Arafatit në verën e vitit 2000, kur ai mbërriti në Kemp Dejvid. Prej tij kërkohej që të mos i nënshkruante si një zgjidhje përfundimtare faktet e parikthyeshëm në terren që e kishin shndërruar idenë e dy shteteve në një ujdi që, në rastin më të mirë, do t'i lejonte palestinezëve të kishin dy bantustane të vegjël, ndërsa në rastin më të keq, do t'i lejonin Izraelit të aneksonte më shumë territore. Gjithashtu, marrëveshja do ta detyronte atë të hiqte dorë nga çdo kërkesë të ardhshme palestineze ose të propozonte një mënyrë për të lehtësuar disa nga vështirësitë e përditshme, nga të cilat vuanin shumica e palestinezëve.

Ne kemi një raport autentik dhe të besueshëm të asaj që ndodhi në Kemp Dejvid nga Husejn Aga (Hussein Agha) dhe Robert Mallej (Robert Malley) të Departamentit të Shtetit.[159] Rrëfimi i tyre i hollësishëm u shfaq në "New York Review of Books" dhe fillon duke hedhur poshtë pretendimin izraelit se ishte Arafati ai që e prishi samitin. Artikulli sqaron se problemi kryesor i Arafatit ishte që, në vitet pas Oslos, në territoret e pushtuara, jeta për palestinezët vetëm se ishte përkeqësuar. Me shumë të drejtë, sipas këtyre dy zyrtarëve amerikanë, ai kishte sugjeruar që në vend që të ngutej që brenda dy javësh "t'i jepnin fund konfliktit një herë e mirë", Izraeli duhej të binte dakord mbi disa masa që mund të rikthenin besimin e palestinezëve në dobinë dhe përfitimet nga procesi i paqes. Rastësisht, periudha dyjavore nuk ishte një kërkesë izraelite, por një afat kohor idiot i vënë me insistim nga Bill Klintoni, i cili po mendonte për trashëgiminë e tij.

Pati dy propozime të mëdha që Arafati i vuri në dukje si zona potenciale diskutimi, të cilat, nëse do të ishin pranuar, mund ta kishin përmirësuar realitetin në terren. I pari ishte ulja e ritmit të kolonizimit intensiv të Bregut Perëndimor që ishte rritur pas Oslos. I dyti ishte dhënia fund e brutalitetit të përditshëm ndaj jetës normale palestineze i shfaqur në kufizimet e rënda të lëvizjes, ndëshkimet e shpeshta kolektive, arrestimet pa gjyq dhe poshtërimi i vazhdueshëm në postblloqe. Që të gjitha këto praktika ndodhnin në çdo zonë ku kishte një kontakt ndërmjet ushtrisë izraelite apo administratës civile (organizmit që qeveriste territoret) dhe popullsisë vendase.

Sipas dëshmisë së zyrtarëve amerikanë, Baraku refuzoi që ta ndryshojë politikën izraelite kundrejt kolonive hebreje ose keqtrajtimin e përditshëm të palestinezëve. Ai mori një qëndrim të ashpër që nuk i la asnjë zgjedhje Arafatit. Çfarëdo gjëje që Baraku të propozonte si zgjidhje përfundimtare nuk kishte asnjë vlerë nëse nuk mund të premtonte për ndryshime të menjëhershme të realitetit në terren. Siç pritej, Arafati u fajësua nga Izraeli dhe aleatët e tij si luftënxitës, që me t'u kthyer nga Kemp Dejvidi, inkurajoi Intifadën e Dytë. Miti këtu është që Intifada e Dytë ishte një sulm terrorist i sponsorizuar dhe ndoshta edhe i planifikuar nga Jaser Arafati. E vërteta është që ajo ishte një demonstrim masiv i pakënaqësisë për tradhtinë e Oslos, i nxitur nga veprimet provokuese të Ariel Sharonit. Në shtator të vitit 2000, Sharoni shkaktoi shpërthimin e protestave, kur si udhëheqës i opozitës, ai bëri një shëtitje në Haremin e Shenjtë (Malin e Tempullit), me një prani të madhe forcash sigurimi dhe mediash.

Zemërimi fillestar palestinez u shpreh me demonstrata jo të dhunshme, të cilat u shtypën me shumë brutalitet nga Izraeli. Kjo shtypje brutale çoi në një reagim më të dëshpëruar: vetëvrasësit me bomba që u shfaqën si zgjidhja e fundit përballë fuqisë më të madhe ushtarake të rajonit. Ekzistojnë prova nga korrespondentët e gazetave izraelite që tregojnë se si raportimet e tyre mbi fazat e hershme të Intifadës si një lëvizjeje jo e dhunshme e shtypur nga ushtria izraelite, u lanë nëpër sirtare nga kryeredaktorët e tyre, sepse nuk i shkonin për shtat rrëfimit të qeverisë. Njëri prej tyre ishte zëvendës-kryeredaktori i *"Yedioth Ahronoth"*, të përditshmes kryesore të shtetit, që shkroi mbi keqinformimin e krijuar nga mediat izraelite në ditët e para të Intifadës së Dytë.[160] Propaganduesit izraelitë pretenduan se sjellja e palestinezëve veçse

[159] Robert Malley and Hussein Agha, "Camp David: The Tragedy of Errors," *New York Review of Books*, 9 gusht 2001.
[160] Daniel Dor, *The Suppression of Guilt: The Israeli Media and the Reoccupation of the West Bank*, London: PlutoPress.

konfirmonte thënien e famshme të superdiplomatit veteran izraelit Abba Eban që palestinezët nuk linin asnjë shans që t'iu shpëtonte nga dora për ta humbur shansin për paqe.

Sot, ne e kuptojmë mirë se ç'gjë e nxiti reagimin e tërbuar izraelit. Në librin e tyre *"Bumerang"*, dy nga gazetarët më të mirë izraelitë Ofer Shelah (Ofer Shelah) dhe Raviv Druker (Raviv Drucker) intervistojnë shefin e shtabit të përgjithshëm izraelit dhe strategjistë në ministrinë e mbrojtjes, duke na dhënë njohuri të brendshme mbi mënyrën se si ata zyrtarë mendonin në lidhje me atë çështje.[161] Konkluzioni i tyre është që, në verën e vitit 2000, ushtria izraelite ishte e frustruar pas disfatës poshtëruese nga ana e Hezbollahut në Liban. Ekzistonte frika se kjo disfatë mund ta bënte ushtrinë që të dukej e dobët, ndaj nevojitej një demonstrim force. Një riafirmim i dominimit të tyre brenda territoreve të pushtuara ishte tamam ajo lloj shfaqjeje e pushtetit absolut, për të cilën kishte nevojë ushtria e "pathyeshme" izraelite. Ajo u urdhërua që të kundërpërgjigjej me të gjithë fuqinë e saj dhe ashtu bëri. Kur Izraeli u hakmorr ndaj një sulmi terrorist mbi një hotel në resortin bregdetar të Netanias në prill të vitit 2002 (në të cilin u vranë 30 njerëz), ishte hera e parë që ushtria përdorte avionët luftarakë për të bombarduar qytetet dhe kampet e refugjatëve të mbipopulluara palestineze në Bregun Perëndimor. Në vend të ndjekjes së personave që kryenin sulmet, ata përdorën armët e rënda më vdekjeprurëse kundër njerëzve të pafajshëm.

Një referim i zakonshëm në lojën e hedhjes së fajit, që Izraeli dhe Shtetet e Bashkuara luajtën pas dështimit në Kemp Dejvid, ishte ai i përkujtimit të opinionit publik se udhëheqësit palestinezë vuanin nga një problem kronik: në momentin e përballjes me të vërtetën, ata shfaqnin anën e tyre luftënxitëse. Pretendimi se "në anën palestineze nuk kishte asnjë, me të cilin të mund të bisedoje" u rishfaq në këtë periudhë si një analizë e përbashkët nga komentues dhe analistë në Izrael, Evropë dhe Shtetet e Bashkuara. Pretendime të tilla ishin jashtëzakonisht cinike. Qeveria dhe ushtria izraelite ishin munduar që të imponoin me forcë versionin e tyre të Oslos: atë të përjetësimit të pushtimit, por me pëlqimin palestinez, të cilin as edhe një Arafat i dobësuar nuk mund ta pranonte. Ai dhe shumë udhëheqës të tjerë, që mund ta kishin udhëhequr popullin e tyre drejt pajtimit, u vunë në shënjestër nga izraelitët dhe shumë prej tyre, duke përfshirë ndoshta edhe vetë Arafatin, u vranë. Vrasja e shënjestruar e udhëheqësve palestinezë, duke përfshirë edhe ata që ishin të moderuar, nuk ishte një fenomen i ri në konflikt. Izraeli e kishte filluar këtë politikë që në vitin 1972 me vrasjen e Gassan Kenefanit (Ghassan Kanafanit), një poet dhe shkrimtar, që mund ta kishte udhëhequr popullin e tij drejt pajtimit. Fakti, që ai u shënjestrua si një veprimtar laik dhe majtist, është tregues simbolik i rolit që Izraeli luajti në vrasjen e atyre palestinezëve, për të cilët më vonë ai "u bë pishman" që nuk ishin asokohe partnerë për paqe.

Në maj të vitit 2001, presidenti Xhorxh Bush caktoi senatorin Robert Miçëll (Robert Mitchell) si të dërguar të posaçëm për Lindjen e Mesme. Miçëll përpiloi një raport mbi shkaqet e Intifadës së dytë, duke vendosur se: *"Nuk kemi asnjë bazë, mbi të cilën të konkludojmë se ka ekzistuar një plan i qëllimshëm nga Autoriteti Palestinez për të nxitur një fushatë dhune në rastin më të parë ose të konkludojmë se ka pasur një plan të qëllimshëm nga qeveria e Izraelit për t'u kundërpërgjigjur me forcë vdekjeprurëse."*[162] Nga ana tjetër, ai fajësoi Ariel Sharonin për provokimin e trazirave, duke vizituar dhe përdhosur shenjtërinë e Xhamisë El-Aksa dhe vendeve të shenjta të Islamit.

Shkurtimisht, edhe Arafati i pafuqishëm e kishte kuptuar se interpretimi izraelit i Oslos në vitin 2000 i jepte fund çdo shprese për një jetë normale palestineze dhe i dënonte palestinezët me më shumë vuajtje në të

[161] Raviv Drucker and Ofer Shelah, *Boomerang*, Jerusalem: Keter, 2005 (në hebraisht)

[162] Për të lexuar tekstin e plotë, shih *"Sharm El-Sheikh Fact-Finding Committee Report: 'Mitchell Report',"* 30 prill 2001, në eeas.europa.eu.

ardhmen. Ai ishte i vetëdijshëm se ky skenar, jo vetëm që ishte i gabuar nga ana morale, por do të forconte ata që e konsideronin luftën e armatosur kundër Izraelit si të vetmen rrugë për çlirimin e Palestinës. Izraeli mund ta kishte ndalur në çdo moment Intifadën e Dytë, por ushtrisë i duhej një spektakël "suksesi". Vetëm kur kjo gjë u arrit nëpërmjet operacionit barbar "Mburoja Mbrojtëse" në vitin 2002 dhe ndërtimit të famëkeqit "mur të aparteidit", atëherë ata ja dolën përkohësisht ta shuanin rebelimin.

KREU IX

MITOLOGJITË E GAZËS

Në opinionin publik ndërkombëtar, çështja e Palestinës është e lidhur ngushtë me Rripin e Gazës. Që nga sulmi i parë izraelit kundër Rripit në vitin 2006 dhe deri në bombardimin më të fundit të 1.8 milionë palestinezëve që jetojnë atje, në vitin 2014, kjo pjesë e rajonit ka mëshiruar çështjen palestineze në të gjithë botën. Në këtë kapitull, unë do të paraqes tre mite, të cilët e mashtrojnë opinionin publik në lidhje me shkaqet e dhunës që vazhdon në Gaza dhe që shpregojnë pafuqinë që ndjen çdokush që dëshiron t'i japë fund mjerimit të një populli të ngjeshur në një nga vendet me popullsinë më të dendur në botë.

Miti i parë i referohet njërit prej aktorëve më të rëndësishëm në terren: lëvizjes Hamas. Emri i saj është akronimi i *"Lëvizjes së Rezistencës Islame"* dhe gjithashtu fjala "hamas" do të thotë "entuziazëm". Ajo u rrit prej degës lokale të lëvizjes fundamentaliste islame "Vëllazërisë Muslimane" në Egjipt në gjysmën e dytë të viteve '80. Filloi si një organizatë bamirëse dhe arsimore, por u shndërrua në një lëvizje politike gjatë Intifadës së Parë në vitin 1987. Një viti më pas, ajo botoi një kartë, ku theksohej se vetëm parimet e Islamit politik kishin mundësi ta çlironin Palestinën. Se si këto parime do të zbatoheshin apo çfarë donin të thonin në realitet kurrë nuk u shpjegua apo demonstrua plotësisht. Që nga ngjizja e deri në kohën e sotme, Hamasi është përfshirë në një luftë për jetë a vdekje me Perëndimin, Izraelin, Autoritetin Kombëtar Palestinez (AKP) dhe Egjiptin.

Kur Hamasi u shfaq në fund të viteve '80, rivali i saj kryesor në Rripin e Gazës ishte lëvizja Fatah, themeluesja dhe organizata kryesore brenda Organizatës për Çlirimin e Palestinës (OÇP). Fatahu humbi ca mbështetje në mesin e popullit palestinez, kur negocioi Marrëveshjen e Oslos dhe themeloi Autoritetin Kombëtar Palestinez (ndaj kryetari i OÇP-së është gjithashtu kryetar i AKP-së dhe Fatahut). Fatahu është një lëvizje kombëtare sekulare me elementë të fortë të krahut të majtë, e frymëzuar nga ideologjitë liberale të Botës së Tretë të viteve '50-60 dhe në thelb, akoma e përkushtuar ndaj krijimit në Palestinë të një shteti demokratik dhe laik për të gjithë. Megjithatë, nga ana strategjike, Fatahu ka qenë e përkushtuar ndaj zgjidhjes së dy shteteve që nga vitet '70. Nga ana e saj, Hamasi është gati që ta lejojë Izraelin që të tërhiqet plotësisht nga territoret e pushtuara, të pasuar nga një armëpushim 10-vjeçar, përpara se të diskutohet për një zgjidhje të ardhshme.

Hamasi e ka sfiduar politikën pro-Oslo të Fatahut, mungesën e vëmendjes nga ana e saj për mirëqenien ekonomike dhe shoqërore dhe dështimin e saj për t'i dhënë fund pushtimit. Sfida u bë akoma më e madhe, kur në mesin e viteve 2000, Hamasi vendosi të garonte si një parti politike në zgjedhjet bashkiake dhe kombëtare. Popullariteti i Hamasit në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës është rritur falë rolit të spikatur që luajti në Intifadën e Dytë në vitin 2000, në të cilën anëtarë të saj ishin gati të bëheshin bomba njerëzore ose së paku të merrnin një rol më aktiv në rezistencën kundër pushtimit (duhet të kemi parasysh se edhe anëtarët e rinj të Fatahut treguan të njëjtën këmbëngulje dhe përkushtim, bile Mervan Barguthi, udhëheqësi i tyre, është akoma i burgosur në burgjet izraelite për rolin e tij në këtë kryengritje).

Vdekja e Jaser Arafatit në vitin 2004 krijoi një vakum politik në udhëheqje dhe në përputhje me kushtetutën, Autoritetit Palestinez ju desh të mbante zgjedhje presidenciale. Hamasi i bojkotoi ato zgjedhje, duke pretenduar se ato do të ishin shumë të lidhura me procesin e Oslos dhe aq më pak me demokracinë. Megjithatë, në të njëjtin vit 2005, Hamasi mori pjesë në zgjedhjet bashkiake, në të cilat doli shumë mirë, duke marrë kontrollin e një të tretës së bashkive në territoret e pushtuara. Ai doli shumë më

mirë në zgjedhjet e vitit 2006 për parlamentin, siç quhet organi legjislativ i AKP-së. Lëvizja fitoi një shumicë të rehatshme në asamble, ndaj kishte të drejtën e formimit të qeverisë, të cilën e udhëhoqi për pak kohë, përpara se të përplasej me Fatahun dhe Izraelin. Në luftën që pasoi, ajo u dëbua nga pushteti zyrtar politik në Bregun Perëndimor, por mori nën kontroll Rripin e Gazës. Mungesa e dëshirës nga ana e Hamasit për të pranuar Marrëveshjen e Oslos, kundërshtimi për të njohur Izraelin dhe përkushtimi i tij ndaj luftës së armatosur përbëjnë sfondin e mitit të parë që do të shqyrtoj këtu. Qoftë në media, ashtu edhe në legjislacion, Hamasi është etiketuar si një organizatë terroriste. Unë do të deklaroj se ajo është një lëvizje çlirimtare, bile e ligjshme.

Miti i dytë që do të shqyrtoj ka të bëjë me vendimin e Izraelit, i cili krijoi vakum në Rripin e Gazës, që i mundësoi Hamasit jo vetëm që të fitonte zgjedhjet e vitit 2006, por edhe ta dëbonte me forcë Fatahun po atë vit. Ajo ishte tërheqja e njëanshme izraelite e vitit 2005 nga Rripi, pas gati 40 vitesh pushtimi. Miti i dytë është që kjo tërheqje ishte një gjest paqeje apo pajtimi, e cila u prit me armiqësi dhe dhunë. Është me rëndësi që të debatohet, siç po bëj në këtë kapitull, origjina e vendimit izraelit dhe të shqyrtohet nga afër impakti që ka pasur mbi Gazën që nga ajo kohë. Në fakt, unë deklaroj se vendimi ishte pjesë e një strategjie, e cila kishte për qëllim forcimin e kontrollit të Izraelit mbi Bregun Perëndimor dhe kthimin e Gazës në një burg të stërmadh që mund të ruhet dhe të mbikqyret nga jashtë. Izraeli, jo vetëm që tërhoqi ushtrinë dhe shërbimet e fshehta nga Rripi, por tërhoqi, në një proces shumë të dhimbshëm, edhe mijërat e kolonëve hebrenj që qeveria kishte dërguar atje që nga viti 1969. Kështu, unë do të deklaroj se shikimi i këtij vendimi si një gjest paqeje është një mit. Ai ishte më shumë një dislokim strategjik forcash, që i mundësoi Izraelit t'i kundërpërgjigjej ashpër fitores së Hamasit, me pasoja shkatërrimtare për popullsinë e Gazës.

Miti i tretë dhe i fundit që unë do të shqyrtoj është pretendimi i Izraelit se veprimet e tij, që nga viti 2006, kanë qenë pjesë e një lufte vetëmbrojtjeje kundër terrorit. Unë do të guxoj ta quaj atë, siç kam bërë edhe gjetkë, një genocid gjithnjë e në rritje kundër popullit të Gazës.

Hamasi është organizatë terroriste.

Fitorja e Hamasit në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2006 shkaktoi një valë reagimesh islamofobike në Izrael. Që nga ai moment dhe në vazhdim, demonizimi i palestinezëve si "arabë të neveritshëm" u rrit në një etiketim të ri: "muslimanë fanatikë". Gjuha e urrejtjes u shoqërua nga politika të reja agresive antipalestineze që e rënduan situatën në territoret e pushtuara përtej gjendjes së mjerueshme dhe të dëshpëruar aktuale.

Në të kaluarën, në Izrael ka patur shpërthime të tjera të islamofobisë. E para ishte në fund të viteve '80, kur një numër shumë i vogël i punëtorëve palestinezë, 40 individë nga një bashkësi prej 150000 njerëzish, u përfshinë në incidente plagosjesh me thikë kundër punëdhënësve të tyre hebrenj dhe kalimtarëve. Menjëherë pas këtyre sulmeve, akademikët, gazetarët dhe politikanët izraelitë ja mveshën këtë gjë Islamit si fe dhe kulturë, pa e përmendur fare pushtimin apo tregun skllavëror të punës që ishte zhvilluar në skajet e tij.[163] Një valë akoma më e egër islamofobike shpërtheu gjatë Intifadës së Dytë në tetor të vitit 2000. Duke qenë se kryengritja e militarizuar kryesisht bëhej nga grupimet islame, veçanërisht vetëvrasësit me bomba, ishte shumë e lehtë për elitën politike dhe mediatike izraelite që ta demonizonte Islamin në sytë

[163] Ilan Pappe, *"The Loner Desparado: Oppression, Nationalism and Islam in Occupied Palestine,"* në Marco Demchiles (ed.), *A Struggle to Define a Nation* (Gorgias Press).

e shumë izraelitëve.[164] Një valë e tretë filloi në vitin 2006, në prag të fitores së Hamasit në zgjedhjet për parlamentin palestinez. Edhe në këtë rast u shfaqën të njëjtat karakteristika si në dy valët e mëparshme. Tipari më i spikatur është shikimi reduksionist i çdo gjëje muslimane si të shoqëruar me dhunën, terrorin dhe natyrën çnjerëzore.

Siç e kam treguar në librin tim *"Ideja e Izraelit"*, [165] ndërmjet viteve 1948 dhe 1982, palestinezët demonizoheshin duke i krahasuar me nazistët.[166] I njëjti proces i nazifikimit të palestinezëve tani i mvishet Islamit, në përgjithësi dhe veprimtarëve në emër të tij, në veçanti. Kjo gjë ka vazhduar për aq kohë sa Hamasi dhe simotra e tij Xhihadi Islam, janë angazhuar në veprimtari ushtarake, guerrile dhe terroriste. Në fakt, retorika e ekstremizmit fshiu historinë e pasur të Islamit politik në Palestinë, si dhe veprimtaritë e gjëra shoqërore dhe kulturore që Hamasi ka kryer që nga krijimi i tij.

Një analizë më asnjanëse tregon se sa larg realitetit është imazhi i demonizuar i Hamasit si një grup fanatikësh të çmendur dhe të pamëshirshëm.[167] Ashtu si edhe lëvizje të tjera brenda Islamit politik, Hamasi reflektonte reagimin kompleks vendas ndaj realiteteve të ashpra të pushtimit dhe një përgjigje ndaj shtigjeve të çorientuara të ofruara në të kaluarën nga forcat sekulare dhe socialiste palestineze. Ata që e kishin analizuar më në thellësi situatën ishin të përgatitur për triumfin e Hamasit në zgjedhjet e vitit 2006, ndryshe nga qeveritë izraelite, amerikane dhe evropiane. Është ironike që ishin ekspertët dhe orientalistët, për të mos folur për politikanët dhe shefat e shërbimeve të fshehta izraelite, ata që u zunë në befasi më shumë se askush tjetër nga rezultatet e zgjedhjeve. Ajo që i shtangu veçanërisht ekspertët e mëdhenj të Islamit në Izrael ishte natyra demokratike e fitores. Në analizat e tyre kolektive, muslimanët fanatikë nuk pritej të ishin demokratikë apo popullorë. Po këta ekspertë shfaqën një keqkuptim të ngjashëm të së shkuarës. Që nga ngritja e Islamit politik në Iran dhe në botën arabe, bashkësia e ekspertëve në Izrael ishte sjellë sikur para syve të tyre po shpalosej e pamundura.

Keqkuptimet dhe për pasojë edhe parashikimet e gabuara, e kanë karakterizuar për një kohë të gjatë vlerësimin izraelit të palestinezëve, veçanërisht për sa i përket forcave të Islamit politik brenda Palestinës. Në vitin 1976, qeveria e parë e Rabinit lejoi mbajtjen e zgjedhjeve bashkiake në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës. Gabimisht ata kishin llogaritur se në Bregun Perëndimor do të zgjidhej garda e vjetër e politikanëve projordanezë dhe në Rripin e Gazës, ata proegjiptianë. Elektorati votoi në shumicë për kandidatët e OÇP-së.[168] Kjo i zuri në befasi izraelitët, por në fakt nuk duhej të ishin zënë. Në fund të fundit, zgjerimi i pushtetit dhe popullaritetit të OÇP-së shkonte paralel me një përpjekje të koncertuar nga Izraeli për të frenuar, nëse jo edhe për t'i eliminuar, lëvizjet laike dhe socialiste brenda shoqërisë palestineze, qoftë në kampet e refugjatëve, ashtu edhe brenda territoreve të pushtuara. Në fakt, Hamasi u bë një lojtar i rëndësishëm në terren pjesërisht falë politikës izraelite të inkurajimit të ndërtimit të një infrastrukture arsimore islame në Gaza si një kundërpeshë ndaj ndikimit të lëvizjes laike Fatah në popullsinë vendase.

Në vitin 2009, Avner Kohen (Avner Cohen), i cili ka shërbyer në Rripin e Gazës rreth kohës kur Hamasi filloi të fitojë pushtet në fund të viteve '80 dhe ishte përgjegjës për çështjet fetare në territoret e pushtuara, i ka treguar gazetës "Wall Street Journal" se *"Hamasi, për fatin tim të keq, është krijim i Izraelit."*[169] Koheni

[164] Pappe, *The Idea of Israel*, fq. 27–47.
[165] Po aty, fq. 153-178.
[166] Një këndvështrim më i plotë mbi Hamasin mund të gjendet tek Sara Roy, *Hamas and Civil Society in Gaza: Engaging the Islamist Social Sector*, Princeton: Princeton University Press, 2011.
[167] Yehuda Lukacs, *Israel, Jordan, and the Peace Process*, Albany: Syracuse University Press, 1999, fq. 141.
[168] Cituar në Andrew Higgins, "How Israel Helped to Spawn Hamas," *Wall Street Journal*, 24 janar 2009.
[169] Shlomi Eldar, *To Know the Hamas*, Tel Aviv: Keter, 2012 (në hebraisht).

shpjegon se si Izraeli ndihmoi shoqatën bamirëse "El-Muxhema' El-Islami" (Shoqata Islame), të themeluar nga shejh Ahmed Jasini në vitin 1979, që të bëhej një lëvizje e fuqishme politike, nga e cila lindi lëvizja Hamas në vitin 1987. Shejh Jasini, një klerik islam i paralizuar dhe gjysëm i verbër, themeloi Hamasin dhe ishte udhëheqësi i tij shpirtëror deri në vrasjen e tij në vitin 2004. Fillimisht, Izraeli ju afrua tij me një ofertë për ndihmë dhe me premtimin e një lejeje për t'u zgjeruar. Izraelitët shpresonin që, nëpërmjet punës së tij bamirëse dhe arsimore, ky udhëheqës karizmatik do të kundërbalanconte pushtetin e Fatahut laik në Rripin e Gazës dhe më gjërë. Vlen të përmendet se nga fundi i viteve '70, Izraeli, ashtu si edhe Shtetet e Bashkuara dhe Britania, i shihnin lëvizjet kombëtare laike (mungesën e të cilave sot e vajtojnë) si armikun më të madh të Perëndimit.

Në librin e tij *"Të njihemi me Hamasin"*, gazetari izraelit Shlomi Eldar rrëfen një histori të ngjashme për sa i përket lidhjeve të forta mes Jasinit dhe Izraelit.[170] Me bekimin dhe mbështetjen e Izraelit, Shoqata hapi një universitet në vitin 1979, një sistem të pavarur shkollor dhe një rrjet klubesh dhe xhamish. Në vitin 2004, "Washington Post" arriti në të njëjtin konkluzion në lidhje me marrëdhëniet e ngushta mes Izraelit dhe Shoqatës deri në shndërrimin e saj në Hamas në vitin 1988. Në vitin 1993, Hamasi u bë kundërshtari kryesor i Marrëveshjes së Oslos. Ndonëse akoma kishte mbështetje për Oslon, popullariteti i saj filloi të binte. Meqenëse Izraeli filloi të tërhiqej nga gati të gjitha zotimet e tij të bëra gjatë negociatave, mbështetja për Hamasin u rrit përsëri. Veçanërisht e rëndësishme ishte politika izraelite e kolonizimit dhe përdorimi i tepruar i forcës kundër popullsisë civile në territoret e pushtuara.

Por popullariteti i Hamasit në mesin e palestinezëve nuk varej vetëm në suksesin apo dështimin e Marrëveshjes së Oslos. Ai fitoi zemrat dhe mendjet e shumë muslimanëve, të cilët përbëjnë shumicën në territoret e pushtuara, për shkak të dështimit të modernizmit laik për t'i dhënë zgjidhje vështirësive të përditshme të jetës nën pushtim. Ashtu si me lëvizjet e tjera islame në të gjithë botën arabe, dështimi i lëvizjeve laike për të ofruar punësim, mirëqenie dhe siguri ekonomike i shtyu shumë njerëz drejt fesë, e cila ofronte ngushëllim si dhe rrjete të ngritura solidariteti dhe bamirësie. Si në Lindjen e Mesme, ashtu edhe në të gjithë botën, modernizimi dhe laicizimi u solli përfitime vetëm pak njerëzve, duke i lënë të tjerët të varfër, të dëshpëruar dhe të hidhëruar. Feja dukej si ilaç i kësaj gjendjeje dhe disa herë, edhe një opcion politik.

Hamasi u mundua shumë që të fitonte një pjesë të madhe të mbështetjes publike që kur Arafati ishte gjallë, por vdekja e tij në vitin 2004 krijoi një vakum, të cilin ai nuk qe në gjendje që ta mbushte menjëherë. Pasardhësi i Arafatit, Mahmud Abbasi (Ebu Mazini), nuk gëzonte të njëjtin legjitimitet dhe respekt si paraardhësi i tij. Fakti që Arafati u deligjitimua nga Izraeli dhe Perëndimi, ndërkohë që Ebu Mazini u pranua prej tyre si president palestinez, e uli popullaritetin e tij në mesin e brezit të ri në zonat rurale të pazhvilluara dhe në kampet e varfëra të refugjatëve. Metodat e reja izraelite të shtypjes të vëna në përdorim gjatë Intifadës së Dytë, veçanërisht ndërtimi i murit, postblloqet dhe vrasjet e shënjestruara, e rritën popullaritetin dhe prestigjin e Hamasit. Do të ishte e drejtë të konkludonin që qeveritë e njëpasnjëshme izraelite bënë gjithçka që kishin në dorë për t'i lënë palestinezët pa asnjë opcion tjetër veçse t'i besonin dhe të votonin për një grup të përgatitur për t'i rezistuar pushtimit, i përshkruar nga autori i famshëm amerikan Majkëll Çabon (Michael Chabon) si *"padrejtësia më e rëndë që kam parë në jetë."*[171]

[170] Ishaan Tharoor, *"How Israel Helped to Create Hamas," Washington Post*, 30 korrik 2014.

[171] Për një analizë nga një student universitar të mënyrës se si Netanjahu e përdor "përplasjen e qytetërimeve", shih Joshua R. Fattal, *"Israel vs. Hamas: A Clash of Civilizations?," The World Post*, 22 gusht 2014, në huffingtonpost.com.

I vetmi shpjegim për rritjen e Hamasit i ofruar nga shumica e "ekspertëve" izraelitë të çështjeve palestineze, brenda dhe jashtë establishmentit, përfshinte referimin ndaj modelit neokonservator të "përplasjes së qytetërimeve" të Samuel Hantingtonit si një mënyrë e të kuptuarit se si funksionon historia. Hantingtoni e ndau botën në dy kultura: racionale dhe iracionale, të cilët, në mënyrë të pashmagshme, konfliktohen. Duke votuar për Hamasin, me sa duket, palestinezët paskan treguar se qenkan në anën "iracionale" të historisë, një pozicion i pashmangshëm për shkak të fesë dhe kulturës së tyre. Benjamin Netanjahu përdori për të shprehur këtë gjë terma akoma më të ashpër, kur foli për hendekun kulturor dhe moral që ndan të dy popujt.[172]

Dështimi i qartë i grupimeve dhe individëve palestinezë, që kishin dalë në skenë me premtimin e negociatave me Izraelin, tregoi qartë se dukej se kishte shumë pak alternativa. Në këtë situatë, suksesi i dukshëm i grupimeve militante islame në dëbimin e izraelitëve nga Rripi i Gazës ofroi ca shpresa. Megjithatë, ka më shumë se kaq. Tani Hamasi është i ngulitur thellë në shoqërinë palestineze falë përpjekjeve të tij të sinqerta për të lehtësuar vuajtjet e njerëzve të thjeshtë, duke ju ofruar shkollim, mjekim dhe mirëqenie. Jo më pak i rëndësishëm është qëndrimi i Hamasit ndaj së drejtës së refugjatëve të vitit 1948 për t'u rikthyer, i cili, ndryshe nga ai i Autoritetit Palestinez, është i qartë. Hamasi e ka mbështetur haptas këtë të drejtë, ndërsa Autoriteti ka dërguar mesazhe të paqarta, duke përfshirë një fjalim të Ebu Mazinit, në të cilin ai hiqte dorë nga e drejta e tij për t'u rikthyer në qytetin e tij të lindjes Safed.

Tërheqja izraelite ishte një gjest paqeje.

Rripi i Gazës përbën pak më shumë se 2% të sipërfaqes së Palestinës. Ky detaj i vogël nuk përmendet kurrë, sa herë që Rripi është në lajme dhe as që është përmendur në mbulimin mediatik perëndimor të ngjarjeve dramatike të Gazës të verës së vitit 2014. Në të vërtetë, ai është një pjesë kaq e vogël e vendit sa që kurrë nuk ka ekzistuar si një rajon i ndarë në të shkuarën. Përpara sionistizimit të Palestinës në vitin 1948, historia e Gazës nuk ishte e veçantë apo e ndryshme nga ajo e pjesës tjetër të Palestinës dhe ajo ka qenë gjithmonë e lidhur nga ana administrative dhe politike me pjesën tjetër të vendit. Si një nga portat kryesore tokësore dhe detare të Palestinës me botën, ajo prirej që të zhvillonte një mënyrë jetese më fleksibël dhe më kozmopolitane, jo të ndryshme nga shoqëritë e tjera porta hyrëse në Mesdheun Lindor në kohët moderne. Vendndodhja e saj në bregdet dhe në Via Maris nga Egjipti deri lart në Liban i solli asaj begati dhe qëndrueshmëri, derisa kjo gjë u ndërpre dhe gati u shkatërrua nga spastrimi etnik i Palestinës në vitin 1948.

Rripi u krijua në ditët e fundit të luftës së vitit 1948. Ai ishte një zonë, drejt së cilit Izraeli shtyu qindra mijëra palestinezë nga qyteti i Jafas dhe rajonet e tij jugore deri në qytetin e Bir-Sebas (Beershebas së sotme). Të tjerë u dëbuan në atë zonë nga qytete si Mexhdel (Ashkelon) deri vonë në vitin 1950, në fazat përfundimtare të spastrimit etnik. Kështu, një pjesë e vogël dhe pastorale e Palestinës u bë kampi më i madh i refugjatëve mbi tokë dhe akoma vazhdon të jetë edhe sot. Ndërmjet viteve 1948 dhe 1967, ky kamp gjigand refugjatësh u përvijua dhe u kufizua rreptësisht nga politikat izraelite dhe egjiptiane. Që të dy shtetet nuk lejonin asnjë lëvizje jashtë Rripit dhe për rrjedhojë, kushtet e jetesës u bënë gjithnjë e më të vështira, ndërkohë që numri i banorëve u dyfishua. Në prag të pushtimit izraelit të vitit 1967, natyra katastrofike e këtij shndërrimi të detyruar demografik u shfaq qartë. Brenda dy dhjetëvjeçarëve, kjo pjesë bregdetare e Palestinës Jugore, dikur pastorale, u bë një nga zonat me popullsinë më të dendur në botë, pa një infrastrukturë ekonomike dhe punësuese që ta mbështesë.

[172] *"Hamas Accuses Fatah over Attack,"* Al Jazeera, 15 dhjetor 2006.

Gjatë njëzet viteve të para të pushtimit, Izraeli lejoi një farë lëvizje brenda rajonit, i cili ishte i rrethuar me një gardh. Dhjetëra mijëra palestinezë u lejuan t'i bashkoheshin tregut izraelit të punës si punëtorë të pakualifikuar dhe të nënpaguar. Çmimi që Izraeli kërkonte për këtë ishte dorëzimi i plotë. Kur kjo gjë nuk u bë, lëvizja e lirë e punëtorëve u ndalua. Në periudhën që i parapriu Marrëveshjes së Oslos në vitin 1993, Izraeli u mundua ta reklamonte Rripin si një enklavë, të cilën kampi i paqes shpresonte që ta bënte autonome apo pjesë e Egjiptit. Ndërkohë, kampi nacionalist i krahut të djathtë dëshironte ta përfshinte në "Erec Izraelin" që ëndërronin të ngrinin në vend të Palestinës.

Marrëveshja e Oslos ju mundësoi izraelitëve që të riafirmonin statusin e Rripit si një entitet i ndarë gjeopolitik, jo vetëm jashtë Palestinës si një e tërë, por edhe e ndarë nga Bregu Perëndimor. Të dyja ishin gjoja nën kontrollin e Autoritetit Palestinez, por çdo lëvizje njerëzore ndërmjet tyre varej nga vullneti i mirë i Izraelit. Ky ishte një tipar i rrallë në ato rrethana, por që gati u zhduk fare kur Netaniahu erdhi në pushtet në vitin 1996. Në të njëjtën kohë, Izraeli kontrollonte, ashtu si edhe sot, infrastrukturën e ujit dhe elektricitetit. Që nga viti 1993, ai e ka përdorur këtë kontroll për të siguruar mirëqenien e bashkësisë së kolonëve hebrenj, nga njëra anë dhe për të shantazhuar popullsinë palestineze që të nënshtrohet, nga ana tjetër. Gjatë 50 viteve të fundit, popullit të Rripit të Gazës i është dashur të zgjedhë ndërmjet të qenit i internuar, peng apo i burgosur në një hapësirë njerëzore të pamundur.

Pikërisht në këtë kontekst historik duhet t'i shikojmë përplasjet e dhunshme ndërmjet Izraelit dhe Hamasit që nga viti 2006. Nën dritën e këtij konteksti, ne duhet të hedhim poshtë përshkrimin e veprimeve izraelite si "luftë kundër terrorit" ose si "luftë vetëmbrojtjeje". Nuk duhet ta pranojmë as përshkrimin e Hamasit si një zgjatim i Al-Kaedas, si pjesë e rrjetit të Shtetit Islamik apo thjesht si një vegël në një komplot turbullues iranian për të kontrolluar rajonin. Nëse ka një anë të shëmtuar në praninë e Hamasit në Gaza janë veprimet e hershme të grupimit kundër fraksioneve të tjera palestineze ndërmjet viteve 2005 dhe 2007. Përplasja kryesore ishte me Fatahun në Rripin e Gazës dhe që të dy palët kontribuan në fërkimet që më pas shpërthyen në një luftë të hapur civile. Përplasjet shpërthyen pasi Hamasi fitoi zgjedhjet legjislative në vitin 2006 dhe formoi qeverinë, e cila përfshinte një ministër të Hamasit përgjegjës për forcat e sigurisë. Në përpjekje për ta dobësuar Hamasin, presidenti Abbas ia transferoi këtë përgjegjësi kreut të shërbimit të fshehtë palestinez, një anëtar i Fatahut. Hamasi u përgjigj duke ngritur forcat e tij të sigurisë në Rrip.

Në dhjetor të vitit 2006, një përballje e dhunshme në pikën e kalimit kufitar të Rafahut ndërmjet Gardës Presidenciale dhe forcave të sigurisë së Hamasit shkaktoi një konflikt që do të zgjaste deri në verën e vitit 2007. Garda Presidenciale ishte një njësi ushtarake e Fatahut me një efektiv prej 3000 individësh dhe përbëhej kryesisht nga trupa besnikë të Abbasit. Ajo ishte stërvitur nga këshilltarë amerikanë në Egjipt dhe Jordani (Uashingtoni kishte caktuar gati 60 milionë dollarë për mbajtjen e saj). Incidenti u shkaktua nga kundërshtimi i Izraelit për të lejuar Ismail Henijen, kryeministrin e Hamasit, që të futej në Rrip. Ai transportonte me vete donacione në para nga bota arabe, që mendohet se ishin dhjetëra milionë dollarë. Atëherë forcat e Hamasit u futën me forcë në pikën e kontrollit kufitar, që kontrollohej nga Garda Presidenciale dhe shpërthyen luftimet.[173]

Situata u përkeqësua shpejt pas kësaj. Makina e Henijes u sulmua, pasi ai kaloi në Rrip. Hamasi fajësoi Fatahun për këto sulme. Përleshjet shpërthyen si në Rrip, ashtu edhe në Bregun Perëndimor. Në të njëjtin muaj, Autoriteti Palestinez vendosi ta shkarkonte qeverinë e udhëhequr nga Hamasi dhe ta zëvendësonte me një kabinet emergjence. Kjo bëri që të shpërthenin përleshjet më serioze ndërmjet dy palëve, që

[173] Ibrahim Razzaq, *"Reporter's Family Was Caught in the Gunfire," Boston Globe*, 17 maj 2007—një nga rrëfimet e shumë dëshmitarëve okularë të atyre ditëve të vështira.

zgjatën deri në fund të majit të vitit 2007, duke lënë dhjetëra të vrarë dhe shumë të plagosur (vlerësohet se 120 njerëz vdiqën). Konflikti përfundoi vetëm kur qeveria e Palestinës u nda më dysh: një në Ramallah dhe një në Gaza.[174]

Ndërkohë që të dy palët janë përgjegjës për kasaphanën, ka pasur (siç kemi mësuar nga "Palestine Papers", të rrjedhura në Al Jazeera në vitin 2007) edhe një faktor të jashtëm që vuri Fatahun përballë Hamasit. Ideja e parandalimit të krijimit të një bastioni të mundshëm të Hamasit në Rripin e Gazës, sapo izraelitët të tërhiqeshin, ju sugjerua Fatahut që në vitin 2004 nga MI6, agjencia britanike e inteligjencës, e cila hartoi një plan sigurie që kishte për qëllim *"të inkurajojë dhe t'i mundësojë Autoritetit Palestinez që të përmbushë plotësisht detyrimet e saj në fushën e sigurisë... duke zvogëluar aftësitë e kundërshtarëve* (të cilët më poshtë në dokument përmenden si Hamas)."[175] Kryeministri britanik i asaj kohe Toni Bler kishte shfaqur një interesim të posaçëm për çështjen e Palestinës, duke shpresuar të kishte një ndikim që do të mund të përligjte apo shfajësonte aventurën e tij katastrofike në Irak. *"The Guardian"* e ka përmbledhur përfshirjen e tij si inkurajim për Fatahun që të shtypte Hamasin.[176] Një këshillë e njëjtë ju dha Fatahut nga Izraeli dhe Shtetet e Bashkuara, në përpjekje për ta ndaluar Hamasin që të merrte Rripin e Gazës. Megjithatë, gjërat shkuan mbrapsht dhe plani parandalues dështoi në shumë mënyra.

Pjesërisht, kjo ishte një luftë ndërmjet politikanëve të zgjedhur demokratikisht dhe atyre që akoma e kanë të vështirë të pranojnë verdiktin e popullit. Por kjo nuk është historia e plotë. Ajo që u shpalos në Gaza ishte një betejë ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe veglave vendase të Izraelit, kryesisht Fatahut dhe anëtarëve të Autoritetit Palestinez, shumë prej të cilëve u bënë padashur vegla, por që sidoqoftë hodhën valle nën ritmin e Izraelit, dhe atyre që i kundërshtuan ata. Mënyra se si Hamasi veproi kundër grupimeve të tjera pati të njëjtën kundërpërgjigje me veprimet që Autoriteti Palestinez ndërmori kundër tyre në Bregun Perëndimor. Është e vështirë të dënosh apo të përkrahësh secilin prej atyre veprimeve. Sidoqoftë, mund të kuptohet shumë mirë se përse palestinezët laikë do ta kundërshtonin krijimin e një teokracie dhe që, si në shumë pjesë të tjera të Lindjes së Mesme, lufta në lidhje me rolin e fesë dhe traditës në shoqëri do të vazhdojë përsëri në Palestinë. Megjithatë, për momentin, Hamasi gëzon mbështetjen dhe në shumë mënyra, edhe admirimin e shumë palestinezëve laikë për vrullin e luftës së tij kundër Izraelit. Në të vërtetë, ajo luftë është problemi kryesor. Sipas rrëfimit zyrtar, Hamasi është një organizatë terroriste e përfshirë në veprime barbare të kryera kundër një Izraeli paqësor që është tërhequr nga Rripi i Gazës. Por, a u tërhoq Izraeli për hir të paqes? Përgjigja është një "Jo" e fortë.

Për ta kuptuar më mirë këtë çështje, duhet të kthehemi pas në kohë, në 18 prill të vitit 2004, kur u vra udhëheqësi i Hamasit Abdulaziz Er-Rentisi. Atë ditë, Juval Shtajnici (Yuval Steinitz), kryetari i komisionit të punëve të jashtme dhe mbrojtjes në Kneset, si dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Beniamin Netaniahut, u intervistua nga radioja izraelite. Përpara se të bëhej politikan, ai kishte lekturuar filozofinë perëndimore në universitetin e Hajfas. Shtajnici pretendonte se këndvështrimi i tij për botën ishte përvijuar nga Dekarti (Descartes), por duket se si politikan, ai është ndikuar më shumë nga nacionalistë romantikë si Gobino (Gobineau) dhe Fihte (Fichte), të cilët e vinin theksin mbi pastërtinë e racës si një parakusht për përsosmërinë kombëtare.[177] Përkthimi i atyre nocioneve evropiane mbi epërsinë racore në kontekstin izraelit u shfaq, sapo intervistuesi e pyeti atë për planet e qeverisë në lidhje me udhëheqësit e tjerë

[174] *"Palestine Papers: UK's MI6 'tried to Weaken Hamas,'"* BBC News, 25 janar 2011, në bbc.co.uk.
[175] Ian Black, *"Palestine Papers Reveal MI6 Drew up Plan for Crackdown on Hamas," Guardian*, 25 janar 2011.
[176] Për t'u njohur me pikëpamjet e tij, shih Yuval Steinitz, *"How Palestinian Hate Prevents Peace," New York Times*, 15 tetor 2013.
[177] Reshet Bet, Israel Broadcast, 18 prill 2004.

palestinezë. Intervistuesi dhe i intervistuari qeshnin nën hundë, sepse ata ishin të një mendimi se ajo politikë duhej të përfshinte vrasjen apo dëbimin e të gjithë udhëheqjes aktuale, pra të gjithë anëtarëve të Autoritetit Palestinez, rreth 40000 persona. *"Jam shumë i lumtur,"* tha Shtajnici, *"që amerikanët më në fund e kuptuan dhe po i mbështesin plotësisht politikat tona."*[178] Po në të njëjtën ditë, Beni Morris (Benny Morris) i Universitetit Ben-Gurion përsëriti mbështetjen e tij për spastrimin etnik të palestinezëve, duke deklaruar se kjo ishte mënyra më e mirë për ta zgjidhur konfliktin.[179]

Opinione që, në rastin më të mirë, mund të konsiderohen të padobishëm dhe në atë më të keq, si të çmendur, tani ishin në zemër të konsensusit izraelit dhe hebre, të mbjellë nga akademikët e establishmentit në televizionet më të ndjekur si e vetmja e vërtetë. Në vitin 2004, Izraeli ishte një shoqëri paranojake, e vendosur t'i jepte fund konfliktit me forcë dhe shkatërrim, pa marrë parasysh koston ndaj shoqërisë apo viktimat e mundshme. Shpesh kjo elitë mbështetej vetëm nga administrata amerikane dhe elitat politike perëndimore, ndërsa vëzhguesit e ndërgjegjshëm në pjesën tjetër të botës vështronin të pafuqishëm dhe të hutuar. Izraeli ishte si një aeroplan që fluturonte me autopilot; rruga ishte e planifikuar që më parë dhe shpejtësia ishte e paracaktuar. Destinacioni ishte krijimi i një Izraeli të Madh, që do të përfshinte gjysmën e Bregut Perëndimor dhe një pjesë të vogël të Rripit të Gazës, pra gati 90% të Palestinës historike. Një Izrael i Madh pa një prani palestineze, me mure të lartë që e ndajnë atë nga popullsia vendase, që do të ngjeshej në dy burgje të mëdhenj: në Gaza dhe atë që do të mbetej nga Bregu Perëndimor. Në këtë vizion, palestinezët në Izrael mund t'i bashkoheshin miliona refugjatëve që dergjen nëpër kampe, ose t'i nënshtroheshin një sistemi aparteidi diskriminimi dhe abuzimi.

Po në vitin 2004, amerikanët mbikqyrën atë që ata e quajtën "Road Map" (Harta e Rrugës) drejt paqes. Kjo ishte një ide absurde, që fillimisht ishte paraqitur në verën e vitit 2002 nga presidenti Bush dhe më e paarritshme se sa Marrëveshja e Oslos. Ideja ishte që palestinezëve do t'iu ofrohej një plan rimëkëmbjeje ekonomike dhe një zvogëlim i pranisë ushtarake izraelite në pjesë të territoreve të pushtuara, për rreth tre vjet. Pas kësaj periudhe, në një farë mënyre, një samit tjetër do t'i jepte fund konfliktit një herë e përgjithmonë.

Në shumë pjesë të botës perëndimore, media e mori "Road Map-in" dhe vizionin izraelit të një Izraeli të Madh si një dhe të njëjtin, duke i paraqitur që të dy sikur ofronin të vetmen rrugë të sigurtë drejt paqes dhe qëndrueshmërisë. Misioni i shndërrimit të këtij vizioni në një realitet ju besua "Kuartetit" (të njohur ndryshe si Kuarteti i Lindjes së Mesme apo në disa raste si Kuarteti i Madridit), të ngritur në vitin 2002 për t'i lejuar OKB-së, Shteteve të Bashkuara, Rusisë dhe Bashkimit Evropian që të punonin së bashku për paqen në Izrael-Palestinë. Fillimisht një organ koordinues i përbërë nga ministrat e jashtëm të katër anëtarëve, Kuarteti u bë më aktiv në vitin 2007, kur caktoi Toni Blerin si të dërguarin e tij të posaçëm në Lindjen e Mesme. Bleri mori me qira të gjithë krahun e ri të hotelit legjendar "American Colony" në Jeruzalem, duke ngritur aty shtabin e tij. Kjo gjë, si dhe paga e Blerit, ishte një operacion i shtrenjtë që nuk prodhoi asgjë.

Zëdhënësit e Kuartetit përdorën një diskurs paqeje që përfshinte referenca për një tërheqje të plotë izraelite, dhënien fund të kolonive hebreje dhe një zgjidhje me dy shtete. Kjo gjë ngjalli shpresë tek disa vëzhgues, që besonin akoma se ky kurs kishte kuptim. Megjithatë, në terren, "Road Map-i", ashtu si Marrëveshja e Oslos, i lejoi Izraelit vazhdimin e zbatimit të planit të tij të njëanshëm për krijimin e Izraelit të Madh. Ndryshimi ishte që, kësaj here, arkitekt ishte Ariel Sharoni, një politikan shumë më i fokusuar

[178] Benny Morris, Channel One, 18 prill 2004, dhe shih Joel Beinin, *"No More Tears: Benny Morris and the Road Back from Liberal Zionism,"* MERIP, 230 (pranverë 2004).
[179] Pappe, *"Revisiting 1967."*

dhe më i vendosur se Rabini, Peresi apo Netaniahu. Ai bëri një gambit surprizues që shumë pak e parashikuan: ofroi që të evakuonte ngulimet izraelite nga Rripi i Gazës. Sharoni e hodhi këtë propozim në ajër në vitin 2003 dhe më pas, i bëri trysni kolegëve të tij që ta pranonin dhe ata e pranuan atë një vit e gjysmë më vonë. Në vitin 2005, ushtria u dërgua për të evakuar me forcë kolonët kokëfortë. Çfarë fshihet pas këtij vendimi?

Qeveritë e njëpasnjëshme izraelite kanë qenë shumë të qarta në lidhje me të ardhmen e Bregut Perëndimor, por jo edhe aq të qarta se ç'duhej të ndodhte me Rripin e Gazës.[180] Strategjia për Bregun Perëndimor ishte që të sigurohej qëndrimi i tij nën sundimin izraelit, të drejtpërdrejtë apo jo. Që nga viti 1967, shumë qeveri, duke përfshirë edhe atë të Sharonit, shpresuan se ky sundim do të organizohej si pjesë e një "procesi paqeje". Në këtë vizion, Bregu Perëndimor mund të bëhej një shtet, nëse mbetej një bantustan. Kjo ishte ideja e vjetër e Jigal Alonit dhe Moshe Dajanit që nga viti 1967, që zonat me popullsi të dendur palestineze duhet të kontrollohen nga jashtë. Por gjërat ishin ndryshe kur bëhej fjalë për Rripin e Gazës. Sharoni kishte rënë dakord me vendimin origjinal të qeverive të mëparshme, shumë nga të cilat laburiste, për të dërguar kolonë në zemër të Rripit të Gazës, ashtu siç kishte mbështetur ndërtimin e kolonive në gadishullin e Sinait, të cilat u evakuan deri tek e fundit nën marrëveshjen dypalëshe të paqes me Egjiptin. Në shekullin e XXI, ai pranoi pikëpamjet pragmatike të anëtarëve udhëheqës të dy partive: Likudit dhe Laburistes, mbi mundësinë e lënies së Gazës për hir të mbajtjes së Bregut Perëndimor.[181]

Përpara procesit të Oslos, prania e kolonëve hebrenj në Rrip nuk i kishte ndërlikuar gjërat, por sapo doli ideja e re e një Autoriteti Palestinez, ajo u bë më shumë barrë për Izraelin se sa një aset. Për pasojë, shumë politikanë izraelitë, bile edhe ata që fillimisht nuk e përtypën idenë e evakuimit, po kërkonin rrugë për ta nxjerrë Rripin nga mendja dhe zemra e tyre. Kjo u bë e qartë kur, pas nënshkrimit të Marrëveshjes, Rripi u rrethua me një gardh me tela me gjemba dhe lëvizja e punëtorëve nga Gaza në Izrael dhe Bregun Perëndimor u kufizua rreptësisht. Nga ana strategjike, në organizimin e ri, ishte më e lehtë që Gaza të kontrollohej nga jashtë, por kjo nuk ishte krejt e mundur për aq kohë sa bashkësia e kolonëve mbetej brenda.

Një zgjidhje ishte të ndahej Rripi në një zonë hebreje me akses të drejtpërdrejtë në Izrael dhe një zonë palestineze. Kjo funksionoi mirë deri në shpërthimin e Intifadës së Dytë. Rruga që lidhte kolonitë, që quheshin si blloku Gush Katif, ishte një objektiv i lehtë për kryengritësit. Kolonët ishin tepër të ekspozuar nga rrezikut. Gjatë këtij konflikti, taktikat e ushtrisë izraelite përfshinë bombardimet masive dhe shkatërrimin e xhepave të rezistencës palestineze, gjë që në prill të vitit 2002 çoi në masakrën e palestinezëve të pafajshëm në kampin e refugjatëve në Xhenin. Këto taktika nuk u zbatuan lehtë në Rripin e dendur të Gazës për shkak të pranisë së kolonëve hebrenj. Ndaj, nuk duhet të habitemi, që një vit pas sulmit më brutal ushtarak në Bregun Perëndimor, operacionit "Mburoja Mbrojtëse", Sharoni filloi të merrte në shqyrtim heqjen e kolonëve nga Gaza për të lehtësuar politikën hakmarrëse. Megjithatë, në vitin 2004, duke mos qenë në gjendje që të impononte vullnetin e tij politik në Gaza, ai bëri thirrje për një seri vrasjesh së udhëheqësve të Hamasit. Sharoni shpresonte se do të ndikonte në të ardhmen me vrasjet politike të dy udhëheqësve kryesorë: Abdulaziz Er-Rentisit dhe shejhut Ahmed Jasin (të vrarë më 17 mars 2004). Edhe një burim i matur si *"Haaretz"* pandehte se pas këtyre vrasjeve, Hamasi do të humbiste bazën e fuqisë së tij në Rripin e Gazës dhe do të shndërrohej vetëm në një prani joefikase në Damask, ku mund të sulmohej nga Izraeli, nëse lindte nevoja. Gjithashtu, gazeta ishte e impresionuar nga mbështetja e

[180] Ari Shavit, *"PM Aide: Gaza Plan Aims to Freeze the Peace Process," Haaretz*, 6 tetor 2004.
[181] *Haaretz*, 17 prill 2004.

Shteteve të Bashkuara për vrasjet politike (ndonëse që të dy, si gazeta, ashtu edhe amerikanët, nuk do ta mbështesnin aq fort atë politikë më pas).[182]

Këto vrasje ndodhën përpara se Hamasi të fitonte zgjedhjet e vitit 2006 dhe të merrte Rripin e Gazës. Me fjalë të tjera, politika izraelite nuk e minoi Hamasin, përkundrazi, ajo bëri që t'i rritej popullariteti dhe fuqia. Sharoni donte që Autoriteti Palestinez ta merrte nën kontroll Gazën dhe ta trajtonte atë si Zonën A në Bregun Perëndimor, por ky synim nuk u realizua. Kështu, Sharonit i duhej të sillej me Gazën me njërën prej dy mënyrave: ose t'i hiqte nga atje kolonët që të mund të hakmerrej ndaj Hamasit pa rrezikuar jetët e qytetarëve izraelitë ose të largohej krejt nga rajoni me qëllim që t'i rifokusonte përpjekjet e tij për aneksimin e Bregut Perëndimor apo disa pjesëve të tij. Me qëllim që të ishte i sigurtë se alternativa e dytë do të kuptohej ndërkombëtarisht, Sharoni orkestroi një maskaradë që çdokush e pëlqente. Ndërkohë që filloi të bënte zhurmë në lidhje me evakuimin e kolonëve nga Rripi, Gush Emunimi e krahasoi atë veprim me Holokaustin dhe inskenoi një shou të vërtetë për televizionin, kur po nxirreshin me forcë nga shtëpitë. Dukej sikur në Izrael po zhvillohej një luftë e vërtetë civile ndërmjet atyre që mbështetnin kolonët dhe atyre të krahut të majtë, ku përfshiheshin armiq të mëdhenj të Sharonit në të shkuarën, të cilët mbështesnin planin e tij për një nismë paqeje.[183]

Brenda Izraelit, kjo lëvizje dobësoi dhe në disa raste, zhduku zërat kundërshtues. Sharoni propozoi që, me tërheqjen nga Gaza dhe me rritjen e Hamasit atje, nuk kishte kuptim që të vazhdoheshin ide të mëdha si Marrëveshja e Oslos. Ai sugjeroi dhe Ehud Olmert, pasardhësi i tij pas sëmundjes së tij terminale në vitin 2007, ra dakord që statukuoja të mbahej për momentin. Duhej që të frenohej Hamasi në Gaza, por nuk kishte pse të nxitohej për të gjetur një zgjidhje për Bregun Perëndimor. Olmerti e quajti këtë politikë "njëanshmëri": duke qenë se në të ardhmen e afërt nuk do të kishte negociata të rëndësishme me palestinezët, Izraeli duhet të vendoste në mënyrë të njëanshme se cilat pjesë të Bregut Perëndimor dëshironte të aneksonte dhe cilat pjesë mund të administroheshin në mënyrë autonome nga Autoriteti Palestinez. Në mesin e politikanëve izraelitë ekzistonte një ndjenjë se, nëse jo në deklarata publike, të paktën si një realitet në terren, kjo rrjedhë veprimi do të ishte e pranueshme si për Kuartetin, ashtu edhe për Autoritetin Palestinez. Deri tani duket se kjo gjë ka funksionuar.

Pa një trysni të fortë ndërkombëtare dhe me një Autoritet Palestinez të dobët si fqinj, shumë izraelitë nuk e mendonin strategjinë ndaj Bregut Perëndimor si një çështje me shumë interes. Siç kanë treguar fushatat zgjedhore që nga viti 2005, shoqëria hebreje ka preferuar të debatojë rreth problemeve social-ekonomike, rolit të fesë në shoqëri dhe luftës kundër Hamasit dhe Hezbollahut. Partia Laburiste, partia kryesore e opozitës, pak a shumë ka ndarë të njëjtin vizion të qeverisë së koalicionit, prandaj që nga viti 2005, ka qenë si brenda, ashtu edhe jashtë qeverisë. Kur vjen puna për Bregun Perëndimor apo zgjidhjen e çështjes së Palestinës, shoqëria izraelite duket se ka arritur në një konsensus. Ajo që e përforcoi atë ndjenjë konsensusi ishte evakuimi i kolonëve të Gazës nga administrata e krahut të djathtë të Sharonit. Për ata që e konsiderojnë veten në të majtë të Likudit, lëvizja e Sharonit ishte një gjest paqeje dhe një përballje trimërore me kolonët. Ai u bë heroi i së majtës, siç u bë edhe i qendrës dhe së djathtës së moderuar, tamam si De Goli që i nxorri kolonët francezë nga Algjeria për hir të paqes. Reagimi palestinez në Rripin e Gazës dhe kritikat nga Autoriteti Palestinez ndaj politikave izraelite, që nga ajo kohë, janë parë si provë e mungesës së ndonjë partneri të fuqishëm apo të besueshëm palestinez për paqe.

[182] Pappe, *"Revisiting 1967."*

[183] Për një analizë të shkëlqyer të shkruar po atë ditë, shih Ali Abunimah, *"Why All the Fuss About the Bush–Sharon Meeting," Electronic Intifada*, 14 prill 2014.

Me përjashtim të disa gazetarëve trima si Gideon Levi (Gideon Levy) dhe Amira Has (Amira Hass) të gazetës "Haaretz", pak anëtarëve të partisë së vogël sioniste të krahut të majtë Merec (Meretz) dhe disa grupimeve antisioniste, shoqëria hebreje në Izrael hesht, duke i hapur qeverive, që nga viti 2005, dritën jeshile për të ndjekur ndaj palestinezëve çdo politikë që ata e konsiderojnë të drejtë. Kjo ishte arsyeja se përse, në lëvizjen e protestave të vitit 2011 që bashkoi gjysëm milioni izraelitë (nga një popullsi prej 7 milionësh) kundër politikave të qeverisë, në axhendë nuk u zu fare në gojë pushtimi dhe tmerret e tij. Kjo mungesë e çdo diskursi apo kritikash publike i lejoi Sharonit që në vitin 2005, vitin e tij të fundit në pushtet, të autorizonte më shumë vrasje të palestinezëve të parmatosur dhe nëpërmjet ndalim-qarkullimeve dhe periudhave të gjata të mbylljes, ta çonte drejt urisë shoqërinë palestineze nën pushtim. Dhe kur palestinezët në territoret e pushtuara ngrinin krye, qeveria kishte dorë të lirë të reagonte me një forcë dhe vendosmëri gjithnjë e më të madhe.

Qeveritë e mëparshme amerikane i kishin mbështetur politikat izraelite, pa e çarë fare kokën se si ndikonin apo priteshin ato nga palestinezët. Megjithatë, kjo mbështetje zakonisht kërkonte negocime dhe disa lëshime të dyanshme. Edhe pas shpërthimit të Intifadës së Dytë në tetor të vitit 2000, disa në Uashington u munduan t'i distanconin Shtetet e Bashkuara nga reagimi i Izraelit ndaj kryengritjes. Për një farë kohe, amerikanët dukeshin të merakosur për faktin se çdo ditë vriteshin disa palestinezë dhe se një numër i madh viktimash ishin fëmijë. Gjithashtu, pati edhe një farë shqetësimi për përdorimin nga Izraeli të ndëshkimeve kolektive, shembjeve të shtëpive dhe arrestimeve pa gjyq. Por ata u mësuan me këto gjëra dhe kur konsensusi izraelito-hebre sanksionoi sulmin kundër Bregut Perëndimor në prill të vitit 2002, një episod i paprecedent mizorie në një histori të mbrapshtë pushtimi, administrata amerikane protestoi vetëm kundër veprimeve të njëanshme të aneksimit dhe kolonizimit, të cilat ndaloheshin në "Road Map-in" e sponsorizuar nga amerikanët dhe BE-ja.

Në vitin 2004, Sharoni kërkoi mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe Britanisë së Madhe për kolonizimin në Bregun Perëndimor në këmbim të tërheqjes nga Rripi i Gazës dhe e mori. Plani i tij, i cili në Izrael u kalua si një plan konsensual paqeje, fillimisht u kundërshtua nga amerikanët si joproduktiv (pjesa tjetër e botës e dënoi atë fuqimisht). Megjithatë, izraelitët shpresonin se ngjashmëria ndërmjet sjelljes së amerikanëve dhe britanikëve në Irak dhe politikave të Izraelit në Palestinë do ta detyronin SHBA-në që të ndërronte qëndrim dhe kishin të drejtë. Vlen të përmendet se, deri në çastin e fundit, Uashingtoni hezitoi që t'i jepte Sharonit dritën jeshile për tërheqjen nga Gaza. Më 13 prill të vitit 2004, një skenë e çuditshme ndodhi në pistën e aeroportit Ben-Gurion. Avioni i kryeministrit qëndroi i palëvizur për disa orë pas nisjes së tij të planifikuar. Brenda tij, Sharoni kundërshtonte që ai të ngrihej nga pista drejt Uashingtonit pa marrë më parë miratimin amerikan për planin e tij të ri të të ashtuquajturës shkëputje. Presidenti Bush e mbështeti atë. Ajo që këshilltarët e tij e panë të vështirë për t'u përtypur ishte letra, të cilën Sharoni kërkonte nga Bushi që ta nënshkruante si pjesë të mbështetjes amerikane. Ajo përmbante një premtim amerikan për të mos i bërë trysni Izraelit në të ardhmen në lidhje me përparimin në procesin e paqes dhe për ta përjashtuar të drejtën e kthimit të refugjatëve nga çdo negociatë të ardhshme. Sharoni i bindi ndihmësit e Bushit se ai nuk do të ishte në gjendje ta bashkonte publikun izraelit pas programit të tij të shkëputjes pa mbështetje amerikane.[184]

Në të shkuarën, zyrtarëve amerikanë ju ishte dashur një farë kohe për t'iu nënshtruar nevojës së politikanëve izraelitë për një konsensus. Kësaj here, u deshën vetëm tre orë. Tani ne e dimë se kishte një arsye tjetër për këtë ngutje të Sharonit: e dimë se ai po hetohej nga policia për një sërë akuzash për

[184] Cituar në *Yediot Ahronoth*, 22 prill 2014.

korrupsion dhe atij i duhej ta bindte publikun izraelit që të kishte besim tek ai në rast se dilte përpara gjyqit. *"Sa më i gjërë që të jetë hetimi, aq më e gjërë do të jetë shkëputja,"* tha Josi Sarid (Yossi Sarid) anëtar i majtë i Knesetit, duke ju referuar lidhjes mes problemeve të Sharonit me gjykatën dhe përkushtimit të tij ndaj tërheqjes. Administrata amerikane duhet të kishte harxhuar më shumë kohë për të arritur në një vendim. Në thelb, Sharoni po i kërkonte presidentit Bush që të hiqte dorë nga të gjitha zotimet që amerikanët kishin bërë për Palestinën. Plani ofronte një tërheqje izraelite nga Gaza dhe mbylljen e kolonive atje, si dhe disa të tjerave në Bregun Perëndimor, në këmbim të aneksimit nga Izraeli të shumicës së kolonive të Bregut Perëndimor. Gjithashtu, amerikanët e dinin shumë mirë se në këtë rebus fshihej një copëz shumë e rëndësishme. Për Sharonin, aneksimi i atyre pjesëve të Bregut Perëndimor që ai lakmonte mund të realizohej vetëm me përfundimin e murit, që Izraeli kishte filluar të ndërtonte në vitin 2003 dhe që ndante në dysh pjesët palestineze të Bregut Perëndimor. Ai nuk e kishte parashikuar kundërshtimin ndërkombëtar. Muri u bë simboli më ikonik i pushtimit, aq sa Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dha verdikt që ai përbënte një shkelje të të drejtave të njeriut. Vetëm koha do të tregojë nëse kjo ishte apo jo një pikë referimi e rëndësishme.[185]

Ndërkohë që Sharoni priste në avionin e tij, Uashingtoni dha mbështetjen e tij për një skemë që e la shumicën e Bregut Perëndimor në duart e izraelitëve dhe të gjithë refugjatët në mërgim, si dhe shprehu miratimin e tij të heshtur për murin. Sharoni zgjodhi si aleat potencial për planet e tij të reja presidentin ideal amerikan. Presidenti Xhorxh Bush ishte i ndikuar shumë nga sionistët e krishterë dhe ndoshta ndante të njëjtën pikëpamje si ata se prania e hebrenjve në Tokën e Shenjtë ishte pjesë e përmbushjes së një skenari apokaliptik që mund të përuronte Ardhjen e Dytë të Krishtit. Këshilltarët neokonservatorë më laikë të Bushit ishin të fiksuar pas luftës kundër Hamasit, që shoqëronte premtimet izraelite për evakuim dhe paqe. Operacionet dukshëm të suksesshëm izraelitë, kryesisht vrasjet politike të shënjeshtruara të vitit 2004, ishin një provë që "lufta kundër terrorit" e Amerikës ishte e destinuar të triumfonte. Në të vërtetë, "suksesi" i Izraelit ishte një shtrembërim cinik i fakteve në terren. Rënia relative e veprimtarisë guerrilase dhe terroriste palestineze u arrit nëpërmjet shtetrrethimeve dhe mbylljeve, duke kufizuar më shumë së dy milionë njerëz brenda shtëpive të tyre pa punë apo ushqim për periudha të gjata kohore. Bile edhe neokonservatorët duhet të kenë qenë në gjendje që ta kuptonin se kjo nuk ishte një zgjidhje afatgjatë për armiqësinë dhe dhunën e shkaktuar nga një fuqi pushtuese, si në Irak, ashtu edhe në Palestinë.

Plani i Sharonit u miratua nga "spin doktorët" e Bushit, që e paraqitën atë si një hap tjetër drejt paqes dhe e përdorën atë për të tërhequr vëmendjen nga dështimi gjithnjë e në rritje në Irak. Ndoshta ai ishte i pranueshëm edhe për këshilltarët e paanshëm, që ishin kaq të dëshpëruar për të parë pak progres sa që bindën vetveten që ky plan ofronte një shans për paqe dhe për një të ardhme më të mirë. Këta njerëz e kishin harruar prej kohësh se si të bënin dallimin ndërmjet fuqisë hipnotizuese të gjuhës dhe realitetit që mendohet të shprehë. Për sa kohë që plani përfshinte termin "tërheqje", ai shihej si një gjë e mirë edhe nga disa gazetarë zakonisht kokëftohtë në Shtetet e Bashkuara, nga udhëheqësit e Partisë Laburiste izraelite (që prirej të bënte pjesë në qeverinë e Sharonit në emër të konsensusit të shenjtë) dhe nga Josi Beilin, udhëheqësi i sapozgjedhur i partisë së majtë izraelite Merec.[186]

Nga fundi i vitit 2004, Sharoni e kuptoi se nuk kishte asnjë arsye që t'i trembej trysnisë së jashtme. Qeveritë e Evropës dhe Shteteve të Bashkuara nuk kishin dëshirë apo ishin të pazonja që ta ndalonin pushtimin dhe

[185] Shih *"Legal Consequences of the Construction of a Wall in the Occupied Palestinian Territory,"* në faqen në internet të ICJ: icj-cij.org.

[186] Fillimisht, në mars të vitit 2004, Beilini ishte kundër tërheqjes, por nga korriku i vitit 2004, e mbështeti hapur atë (Intervista në Channel One, 4 korrik 2004).

të parandalonin shkatërrimin e mëtejshëm të palestinezëve. Ata izraelitë që kishin dëshirë të merrnin pjesë në lëvizjet kundër pushtimit ishin të pakët në numër dhe të demoralizuar përballë konsensusit të ri. Nuk është për t'u çuditur që, pikërisht në atë kohë, shoqëritë civile në Evropë dhe SHBA u ndërgjegjësuan për mundësinë e luajtjes së një roli të rëndësishëm në konflikt dhe u bashkuan rreth idesë së lëvizjes BDS (Boycott, Divestments and Sanctions). Shumë pak organizata, sindikata dhe individë u përkushtuan ndaj një përpjekje të re publike, duke u betuar që të bënin gjithçka që kishin në dorë për t'i bërë izraelitët të kuptonin që politika të tilla si ato të Sharonit kishin një çmim të madh.

Që nga ajo kohë, në Perëndim u provua çdo mjet i mundshëm, që nga bojkotimi akademik deri tek sanksionet ekonomike. Mesazhi brenda ishte i qartë: qeveritë e tyre nuk ishin më pak përgjegjëse se Izraeli për katastrofat e shkuara, të sotme dhe të ardhme të popullit palestinez. Lëvizja BDS kërkoi një politikë të re për t'iu kundërvënë strategjisë së njëanshme të Sharonit, jo vetëm për arsye morale apo historike, por edhe për hir të sigurisë së Perëndimit, bile edhe mbijetesës së tij. Siç e kishte treguar dhuna që nga ngjarjet e 11 shtatorit, konflikti palestinez minonte strukturën multikulturore të shoqërisë perëndimore, sepse po i shtynte gjithnjë e më larg Shtetet e Bashkuara nga bota islame drejt një marrëdhënieje makthore. Trysnia ndaj Izraelit dukej si një çmim i vogël që duhej paguar për hir të paqes globale, stabilitetit rajonal dhe pajtimit në Palestinë.

Kështu, tërheqja izraelite nga Gaza nuk ishte pjesë e një plani paqeje. Sipas rrëfimit zyrtar, ajo ishte një gjest paqeje, të cilit palestinezët mosmirënjohës ju përgjigjën fillimisht, duke votuar për Hamasin dhe më pas, duke hedhur raketa kundër Izraelit. Për pasojë, nuk kishte asnjë kuptim që Izraeli të vazhdonte të tërhiqej nga asnjë territor i pushtuar palestinez. Gjithçka që Izraeli duhej të bënte ishte të vetëmbrohej. Për më tepër, "trauma" që "për pak çoi në një luftë civile" ishte planifikuar që ta bindte shoqërinë izraelite se nuk ishte diçka që duhej përsëritur.

A ishte lufta kundër Gazës një luftë vetëmbrojtjeje?

Ndonëse kam shkruar një libër bashkë me Noam Çomskin me titull *"Lufta kundër Gazës"*, nuk jam i sigurtë se termi "luftë" është termi i duhur për të përshkruar atë që ndodhi në sulmet e shumta izraelite kundër Rripit, duke filluar nga viti 2006. Në fakt, pas fillimit të operacionit "Plumbi i Shkrirë" në vitin 2009, unë kam vendosur që ta quaj politikën izraelite si një genocid në rritje. Kam hezituar përpara se ta përdor këtë term shumë të ngarkuar dhe akoma nuk kam gjetur një tjetër që të përshkruajë saktësisht atë që ka ndodhur. Duke qenë se përgjigjet që mora, mes të tjerash nga disa veprimtarë të rëndësishëm të të drejtave të njeriut, treguan se përdorimi i këtij termi shkakton një farë shqetësimi, u prira ta rimendoj atë për ca kohë, por e përdora atë përsëri kohët e fundit me një bindje akoma më të fuqishme: është e vetmja mënyrë e duhur për të përshkruar atë që ushtria izraelite ka bërë në Rripin e Gazës që nga viti 2006.

Më 28 dhjetor të vitit 2006, organizata izraelite për të drejtat e njeriut B'Tselem botoi raportin e saj vjetor mbi mizoritë e kryera në territoret e pushtuara. Atë vit, forcat izraelite vranë 660 qytetarë, më shumë se trefishin e një viti më parë, kur u vranë rreth 200 palestinezë. Sipas B'Tselemit, në vitin 2006, mes të vrarëve ishin 141 fëmijë. Shumica e viktimave ishin nga Rripi i Gazës, ku forcat izraelite shembën gati 300 shtëpi dhe zunë përfund familje të tëra. Kjo do të thotë se që nga viti 2000, gati 4000 palestinezë janë vrarë nga forcat izraelite, gjysma e të cilave janë fëmijë, si dhe janë plagosur më shumë se 20000 të tjerë.[187]

B'Tselem është një organizatë konservatore dhe shifrat e të vrarëve dhe të plagosurve mund të jenë më të larta. Megjithatë, çështja nuk është vetëm tek përshkallëzimi i vrasjeve të qëllimshme, por tek strategjia

[187] Shih statistikat e viktimave në faqen e B'Tselemit: btselem.org.

që qëndron pas veprimeve të tilla. Gjatë gjithë dhjetëvjeçarit të fundit, politikanët izraelitë janë përballur me dy realitete shumë të ndryshëm në Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës. Në të parin, ata kanë qenë më afër se kurrë përfundimit të ndërtimit të murit të tyre lindor. Debati i brendshëm ideologjik kishte përfunduar dhe masterplani për aneksimin e gjysmës së Bregut Perëndimor po zbatohej me hapa të përshpejtuar. Faza e fundit u vonua për shkak të premtimeve të bëra nga Izraeli, nën termat e Road Map-it, për të mos ndërtuar koloni të reja. Por politikanët gjetën shpejt dy mënyra për ta shmangur një ndalim të tillë. Së pari, ata e emërtuan një të tretën e Bregut Perëndimor si pjesë të Jeruzalemit të Madh, gjë që i lejoi ata të ndërtojnë qytete dhe qendra komunitare brenda kësaj zone të sapoaneksuar. Së dyti, ata i zgjeruan kolonitë e vjetra në proporcione të tilla që nuk kishte më nevojë për ndërtim kolonish të reja.

Në përgjithësi, kolonitë, bazat ushtarake, rrugët dhe muri e vunë Izraelin në një pozitë që të aneksonte zyrtarisht gati gjysmën e Bregut Perëndimor, kur ta shihte këtë gjë të nevojshme. Brenda këtyre territoreve kishte një numër të konsiderueshëm palestinezësh, kundër të cilëve autoritetet izraelite do të vazhdonin të zbatonin politika transferimi të ngadalta dhe të vazhdueshme. Kjo ishte një temë shumë e mërzitshme për mediat perëndimore që të merreshin me të dhe shumë bishtnuese për organizatat e të drejtave të njeriut që ta trajtonin. Izraelitët nuk kishin përse të nguteshin, sepse kishin gjithçka në dorë: abuzimi i përditshëm dhe çnjerëzimi i ushtruar nga mekanizmi i dyfishtë i ushtrisë dhe burokracisë ishte më efikas se kurrë në procesin e shpronësimit.

Mendimi strategjik i Sharonit u pranua nga të gjithë ata që u futën në qeverinë e tij të fundit, si edhe atë të pasardhësit të tij Ehud Olmert. Bile Sharoni u largua nga Likudi dhe themeloi një parti të qendrës, Kadima-n, që pasqyronte konsensusin e tij mbi politikën kundrejt territoreve të pushtuara.[188] Nga ana tjetër, as Sharoni, as ndonjë nga ata që e ndoqën, nuk mundën të ofronin një strategji të qartë izraelite në lidhje me Rripin e Gazës. Për izraelitët, Rripi është një entitet gjeopolitik shumë më i ndryshëm nga ai i Bregut Perëndimor. Ai qëndron në duart e Hamasit, ndërsa Autoriteti Palestinez duket se administron Bregun e copëtuar Perëndimor me bekimin izraelit dhe amerikan. Nuk ka asnjë copë toke në Rrip që Izraeli e lakmon dhe në të nuk ka asnjë hinterland, si Jordania, ku ai të mund të dëbojë palestinezët. Spastrimi etnik, si një mjet zgjidhjeje, është i padobishëm atje.

Strategjia më e hershme e zbatuar në Rrip ka qenë getoizimi i palestinezëve, por ai nuk funksionoi. Bashkësia e rrethuar e shprehu dëshirën e saj për jetë duke hedhur raketa primitive mbi Izrael. Sulmi pasues mbi këtë bashkësi shpesh ishte shumë më i tmerrshëm dhe barbar. Më 12 shtator të vitit 2005, forcat izraelite u larguan nga Rripi i Gazës. Në të njëjtën kohë, ushtria izraelite u fut me forcë në qytetin e Tul-Keremit, bëri arrestime në shkallë të gjërë, veçanërisht veprimtarë të Xhihadit Islam, një aleati të Hamasit, dhe vrau disa prej tyre. Organizata hodhi nëntë raketa që nuk vranë asnjë njeri. Izraeli u përgjigj me operacionin "Shiu i Parë".[189] Ja vlen të ndalemi për një çast tek natyra e atij operacioni. I frymëzuar nga masa ndëshkuese të zbatuara së pari nga fuqitë kolonialiste dhe më pas, nga diktaturat kundër bashkësive të syrgjynosura apo të burgosura që ngrinin krye, "Shiu i Parë" filloi me avionët supersonikë që fluturuan mbi Gaza me qëllim terrorizimin e të gjithë popullsisë. Kjo u pasua nga bombardimi i rëndë i zonave të gjëra nga deti, qielli dhe toka. Zëdhënësit e ushtrisë izraelite shpjegonin se logjika që qëndronte pas këtyre veprimeve ishte krijimi i një trysnie që do të dobësonte mbështetjen e bashkësisë për hedhësit e raketave.[190] Siç duhej pritur, por jo nga izraelitët, operacioni vetëm se rriti mbështetjen për luftëtarët dhe

[188] Leslie Susser, *"The Rise and Fall of the Kadima Party," Jerusalem Post*, 8 gusht 2012.
[189] John Dugard, *Report of the Special Rapporteur on the Situation of the Human Rights in the Palestinian Territories Occupied by Israel since 1967*, UN Commission on Human Rights, Geneva, 3 mars 2005.
[190] Shih analizën e Roni Sofer në *Ma'ariv*, 27 shtator 2005.

i dha një shtysë atyre për përpjekje të mëtejshme. Qëllimi i vërtetë i atij operacioni ishte eksperimental. Gjeneralët izraelitë donin të dinin se si operacione të tilla mund të priteshin brenda në Izrael, në rajon dhe në botën mbarë. Kur u pa se dënimi ndërkombëtar qe shumë i kufizuar dhe jetëshkurtër, ata mbetën të kënaqur nga rezultati.

Që nga "Shiu i Parë", të gjitha operacionet që pasuan kanë ndjekur një model të ngjashëm. Dallimi ka qenë vetëm tek përshkallëzimi: sa më shumë fuqi zjarri, viktima dhe dëme kolaterale, aq më shumë raketa Kassam si kundërpërgjigje, siç pritej. Pas vitit 2006, u shtua një përmasë tjetër, kur izraelitët përdorën mjete më fatale për të imponuar një rrethim të hekurt ndaj popullit të Gazës nëpërmjet bojkotimit dhe bllokadës. Rrëmbimi i ushtarit izraelit Gilad Shalit në qershor të vitit 2006 nuk e ndryshoi balancën e fuqisë ndërmjet Hamasit dhe Izraelit, por i dha një shans izraelitëve që t'i përshkallëzonin akoma më shumë misionet e tyre taktike dhe ndëshkuese. Në fund të fundit, nuk kishte asnjë qartësi strategjike në lidhje me atë që duhej bërë përtej vazhdimit të ciklit të pafund të veprimeve ndëshkuese.

Izraelitët vazhduan t'i vinin emra absurdë, bile ogurzinj, operacioneve të tyre. "Shiu i Parë" u pasua nga "Shirat e Verës", emri që ju vu operacioneve ndëshkuese që filluan në qershor të vitit 2006. "Shirat e Verës" sollën një përbërës të ri: invazionin tokësor në disa pjesë të Rripit të Gazës. Kjo i mundësoi ushtrisë që të vriste qytetarë në një mënyrë më efikase dhe ta paraqiste këtë si një pasojë e luftimeve të ashpra brenda zonave me popullsi të dendur, pra një rezultat i pashmangshëm i rrethanave dhe jo një politikë izraelite. Nga fundi i verës, erdhi operacioni "Retë e Vjeshtës", i cili ishte akoma më efikas: më 1 nëntor të vitit 2006, 70 civilë u vranë në më pak se 48 orë. Nga fundi i atij muaji, ishin vrarë gati 200 vetë, gjysma e të cilëve fëmijë dhe gra. Një pjesë e këtij aktiviteti vazhdonte paralel me sulmet izraelite kundër Libanit, duke e bërë më të lehtë përfundimin e atyre operacioneve pa shumë vëmendje të jashtme, për të mos folur më për kritika.

Nga "Shiu i Parë" deri tek "Retë e Vjeshtës" mund të vihet re përshkallëzimi në çdo zonë. Së pari, ishte zhdukja e dallimit ndërmjet objektivave "civilë" dhe atyre "jo civilë": vrasjet e pakuptimta e kishin shndërruar krejt popullsinë në objektivin kryesor të operacionit. Së dyti, pati një përshkallëzim në përdorimin e çdo mekanizmi të mundshëm vrasës që zotëronte ushtria izraelite. Së treti, ishte rritja e spikatur e numrit të viktimave. Së fundmi, dhe ajo që është më e rëndësishmja, operacionet dalëngadalë u kristalizuan në një strategji, që tregonte mënyrën se si Izraeli kishte ndërmend ta zgjidhte problemin e Rripit të Gazës në të ardhmen: nëpërmjet një politike të matur genocidi. Megjithatë, populli i Gazës vazhdoi të rezistojë. Kjo çoi në operacione të mëtejshme genocidi izraelit, por, akoma edhe sot e kësaj dite, në një dështim për ta ripushtuar atë rajon.

Në vitin 2008, operacionet "Vera" dhe "Vjeshta" u pasuan nga operacioni "Dimri i Nxehtë". Ashtu siç pritej, një valë e re sulmesh shkaktoi akoma më shumë viktima civile, më shumë se 100 në Rripin e Gazës, i cili u bombardua sërish nga ajri, deti dhe toka, si dhe u invadua. Të paktën, kësaj here, u duk për një çast se bashkësia ndërkombëtare po i kushtonte vëmendje. BE-ja dhe OKB-ja e dënuan Izraelin për "përdorimin e tepruar të forcës" dhe e akuzuan atë se po shkelte ligjin ndërmombëtar, ndërkohë që kritikat amerikane ishin "të ekuilibruara". Megjithatë, kjo mjaftoi që të shkohej në një armëpushim, një nga të shumtët, që herë pas here do të shkelej nga ndonjë sulm tjetër izraelit.[191] Hamasi u shpreh i gatshëm për ta zgjatur armëpushimin dhe e autorizoi strategjinë bazuar në terma fetarë, duke e quajtur "tehdieh", që në arabisht do të thotë "qetësim" dhe ideologjikisht do të thotë një periudhë shumë e gjatë paqeje. Ai ja doli t'i bindë shumicën e grupimeve që ta ndalnin hedhjen e raketave mbi Izrael. Mark Regevi, zëdhënësi i qeverisë

[191] Anne Penketh, *"US and Arab States Clash at the UN Security Council," Independent*, 3 mars 2008.

izraelite, e ka pranuar vetë këtë gjë.[192]

Suksesi i armëpushimit mund të ishte siguruar nëse do të kishte pasur një lehtësim të vërtetë të rrethimit izraelit. Praktikisht kjo do të thonte rritje e sasisë së mallrave që lejoheshin të hyjnë në Rrip dhe lehtësim i lëvizjes së njerëzve brenda dhe jashtë. Por Izraeli nuk ju përmbajt premtimeve të tij për këtë gjë. Zyrtarët izraelitë ishin shumë të çiltër kur i tregonin homologëve të tyre amerikanë se plani ishte që ekonomia e Gazës të mbahej "në buzë të kolapsit".[193] Ekzistonte një lidhje reciproke e drejtpërdrejtë ndërmjet intensitetit të rrethimit dhe atij të hedhjes së raketave mbi Izrael, siç e ilustron shumë mirë diagrama shoqëruese e përgatitur nga Qendra Karter për Paqe (Carter Peace Center).

Importi i mallrave në Gaza – Raketat dhe mortajat e lëshuara nga Gaza



Burimi: Qendra Karter, "Gaza Timeline Analysis: Movement and Fatalities", 2009

Izraeli e prishi armëpushimin më 4 nëntor të vitit 2008 me pretekstin se kishte zbuluar një tunel të gërrmuar nga Hamasi, sipas tyre, të planifikuar për një operacion tjetër rrëmbimi. Hamasi kishte ndërtuar tunele që dilnin jashtë getos së Gazës me qëllim që të sillte ushqim, të nxirrte njerëz jashtë si dhe si pjesë e strategjisë së tij të rezistencës. Përdorimi i një tuneli si pretekst për shkeljen e armëpushimit ishte njëlloj sikur Hamasi të vendoste ta shkelte atë, sepse Izraeli kishte baza ushtarake pranë kufirit. Zyrtarët e Hamasit deklaruan se tuneli në fjalë ishte ndërtuar me qëllime mbrojtëse. Në raste të tjera, ata nuk ishin trembur ta pranonin funksionin e tij të ndryshëm, ndaj kjo gjë mund të jetë e vërtetë. Grupi i solidaritetit irlandezo-palestinez Sadaka publikoi një raport shumë të hollësishëm me prova që tregonin se oficerët izraelitë e dinin mirë se nga tuneli nuk vinte asnjë lloj rreziku. Qeverisë thjesht i nevojitej një pretekst për një përpjekje tjetër për ta shkatërruar Hamasin.[194]

Hamasi ju përgjigj sulmit izraelit me një breshëri raketash që nuk plagosën apo vranë asnjë njeri. Izraeli e

[192] David Morrison, *"The Israel-Hamas Ceasefire," Sadaka*, 2nd edition, mars 2010, në web.archive.org.
[193] *"WikiLeaks: Israel Aimed to Keep Gaza Economy on the Brink of Collapse," Reuters*, 5 janar 2011.
[194] Morrison, *"The Israel-Hamas Ceasefire."*

ndaloi sulmin për një periudhë të shkurtër, duke kërkuar që Hamasi të binte dakord mbi një armëpushim sipas kushteve të tij. Refuzimi i Hamasit çoi në operacionin famëkeq "Plumb i Shkrirë" në fund të vitit 2008 (emrat e koduar tashmë ishin zëvendësuar me emra akoma më ogurzinj). Bombardimi paraprak kësaj here ishte i paprecedent dhe të kujtonte shumë bombardime tapet në Irakun e vitit 2003. Objektivi kryesor ishte infrastruktura civile. Asgjë nuk u kursye: spitalet, shkollat, xhamitë. Çdo gjë u godit dhe u shkatërrua. Hamasi u kundërpërgjigj duke hedhur raketa mbi qytete izraelite të pashënjestruar më parë si Beersheba dhe Ashdod. Pati pak viktima civile, por shumica e izraelitëve të vrarë, gjithsej 13, ishin ushtarë të vrarë nga zjarri mik. Në kontrast të theksuar, 1500 palestinezë humbën jetën në këtë operacion.[195]

Një përmasë e re cinike u shtua: donatorët ndërkombëtarë dhe arabë premtuan ndihma që shkonin në miliarda për të rindërtuar atë që Izraeli do ta shkatërronte përsëri në të ardhmen. Edhe fatkeqësia më e keqe mund të jetë fitimprurëse.

Raundi i ri erdhi në vitin 2012 me dy operacionet: "Jehona e Kthyer", e cila ishte më e vogël se sulmet e mëparshme dhe më e rëndësishmja "Shtylla e Mbrojtjes" në korrik të vitit 2012, e cila i dha fund lëvizjes së protestave shoqërore të asaj vere, që kishte mundësi ta rrëzonte qeverinë për shkak të dështimit të politikave të saj ekonomike dhe shoqërore. Nuk kishte asgjë më të mirë se një luftë në jug për t'i bindur izraelitët e rinj që të hiqnin dorë nga protestat dhe të dilnin në mbrojtje të atdheut. Kjo gjë kishte funksionuar më parë dhe funksionoi edhe kësaj rradhe.

Në vitin 2012, për herë të parë, Hamasi arriti të godasë Tel Avivin me raketa që shkaktuan pak dëme dhe asnjë viktimë. Ndërkohë, 200 palestinezë u vranë, përfshirë edhe dhjetëra fëmijë. Ky nuk ishte një vit i keq për Izraelin. Qeveritë e lodhura të BE-së dhe SHBA-së nuk i dënuan fare sulmet e vitit 2012. Në fakt, ato vazhdimisht e kishin mbrojtur "të drejtën e Izraelit për t'u vetëmbrojtur". Nuk duhet të çuditemi që dy vite më vonë izraelitët e kuptuan se mund të shkonin akoma më tej. Operacioni "Qoshja Mbrojtëse" në verën e vitit 2014 kishte dy vjet që po planifikohej dhe rrëmbimi dhe vrasja e tre kolonëve në Bregun Perëndimor ofroi pretekstin për zbatimin e tij, gjatë së cilit 2200 palestinezë u vranë. Vetë Izraeli u paralizua për ca kohë, sepse raketat e Hamasit mbërritën deri në aeroportin Ben-Gurion.

Për herë të parë, ushtria izraelite luftoi ballë për ballë me guerrilasit palestinezë në Rrip dhe humbi 66 ushtarë. Në këtë betejë ndërmjet palestinezëve të dëshpëruar, të vënë me shpatulla pas murit dhe të zemëruar nga një rrethim i gjatë dhe mizor, dhe ushtrisë izraelite, kjo e fundit pati epërsi. Situata i ngjante hyrjes së një force policie në një burg të sigurisë së lartë, të cilin e kishte kontrolluar kryesisht nga jashtë, për t'u përballur me dëshpërimin dhe vendosmërinë e të burgosurve, që sistematikisht kishin vuajtur nga uria dhe shtrëngimi. Është e frikshme të mendosh se si do të jetë rezultati i operacionit izraelit pas përplasjes me luftëtarët trima të Hamasit.

Lufta në Siri dhe kriza e refugjatëve që pasoi nuk lanë shumë hapësirë për veprim ndërkombëtar apo interesim për Gazën. Megjithatë, gjithçka duket se po shkon drejt një raundi tjetër sulmesh kundër popullit të Rripit. OKB-ja kishte parashikuar që, me shkallën aktuale të shkatërrimit, nga viti 2020 Rripi do të bëhej krejtësisht i pabanueshëm. Kjo nuk do të realizohet vetëm nga forca ushtarake, por edhe nga ajo që OKB-ja e quan "jozhvillim", një gjendje ku zhvillimi kthehet përmbys:

Tre operacione ushtarake izraelite në gjashtë vitet e fundit, plus dhjetë vjet bllokadë ekonomike, e kanë rrënuar infrastrukturën e dobësuar të Gazës, kanë prishur bazën e saj prodhuese, nuk kanë lënë kohë për një rindërtim apo rimëkëmbje të arsyeshme ekonomike dhe e kanë varfëruar popullsinë palestineze të

[195] Shih raportin e B'Tselemit *"Fatalities during Operation Cast Lead,"* në btselem. org.

Gazës, duke bërë që mirëqenia e tyre ekonomike të jetë më e keqe se ç'ishte dy dhjetëvjeçarë më parë.[196]

Ky dënim me vdekje është bërë akoma më i afërt që nga grushti ushtarak i shtetit në Egjipt. Regjimi i ri atje ka mbyllur të vetmen pikë kufitare që Gaza ka jashtë Izraelit. Që nga viti 2010, organizatat e shoqërisë civile kanë dërguar flotilje për të treguar solidaritet dhe për të çarë rrethimin. Njëra prej tyre u sulmua pabesisht nga komandot izraelitë, që vranë nëntë pasagjerë në bordin e anijes "Mavi Marmara" dhe arrestuan të tjerët. Flotiljet e tjera u trajtuan më mirë. Megjithatë, prospekti i vitit 2020 është akoma i pranishëm dhe duket se për ta parandaluar këtë vdekje të ngadaltë, populli i Gazës do të ketë nevojë më shumë se për flotiljet paqësore për ta bindur Izraelin që të ndalet.

[196] *"Gaza Could Become Uninhabitable in Less Than Five Years Due to Ongoing 'Dedevelopment',"* UN News Centre, 1 shtator 2015, në un.org.

PJESA III

SHIKIMI PËRPARA

KREU 10

ZGJIDHJA ME DY SHTETE ËSHTË E VETMJA RRUGËDALJE

Ky mit i njohur zakonisht thuhet në një mënyrë pohuese sikur gjoja ekziston një zgjidhje për konfliktin izraelito-palestinez dhe se ajo na pret atje pas asaj qoshes. Por realiteti i kolonizimit aktual të pjesëve të gjëra të Bregut Perëndimor nga Izraeli e bën zgjidhjen me dy shtete një vizion të pamundur. Në rastin më të mirë, maksimumi që mund të shpresohet është një Bantustan palestinez. Por një marrëveshje e tillë politike do të krijonte një shtet pa një sovranitet të vetin, të ndarë në disa kantone dhe pa mjete për t'u mbrojtur apo ruajtur pavarësinë e tij nga Izraeli. Çdo shpresë për një entitet më të pavarur, nëse do të ndodhte një ndërrim i mrekullueshëm mendjeje nga ana e Izraelit, nuk e shndërron zgjidhjen me dy shtete në një akt përfundimtar në atë konflikt. Është e paimagjinueshme që një luftë kombëtare për çlirim, tashmë 150 vjeçare, të përfundojë me një qeverisje të kushtëzuar autonome mbi vetëm 20% të atdheut. Për më tepër që asnjë marrëveshje apo dokument diplomatik nuk mund të përcaktojë kurrë se kush është dhe kush nuk është pjesë e marrëveshjes. Për shembull: do të ishte e pamundur që të shpalleshin si palestinezë të gjithë ata që jetojnë Bregun Perëndimor, por jo ata që jetojnë në Rripin e Gazës. Kështu është gjendja e tanishme, sepse si Gaza, ashtu edhe shumë pjesë të Jeruzalemit duket që janë përjashtuar nga negociatat dhe nuk janë të përfshirë në shtetin e imagjinuar.

Siç kam shkruar më herët, zgjidhja me dy shtete është një shpikje izraelite e bërë qëllimisht që të jetë e pamundur për t'u realizuar. Ajo i shkon përshtat planit se si të mbahet Bregu Perëndimor nën kontrollin izraelit, por pa përfshirë popullsinë që jeton në të. Për këtë arsye u sugjerua që pjesë të Bregut Perëndimor të ishte autonome, një gjysëm-shtet. Në këmbim të saj, palestinezët duhet të hiqnin dorë nga çdo shpresë për t'u rikthyer, për të drejta të barabarta për palestinezët në Izrael, për fatin e Jeruzalemit dhe për të bërë një jetë normale si qenie njerëzore në atdheun e tyre.

Çdo kritikë ndaj këtij miti shpesh damkoset si antisemitizëm. Por, në plot raste, e kundërta e saj është e vërtetë: ka një lidhje ndërmjet antisemitizmit të ri dhe vetë mitit. Zgjidhja me dy shtete është e bazuar mbi idenë që një shtet hebre është zgjidhja më e mirë për problemin hebre, pra që hebrenjtë duhet të jetojnë në Palestinë dhe jo gjetkë. Ky nocion është i dashur edhe për antisemitët. Duhet thënë se zgjidhja me dy shtete është e bazuar në pretendimin se Izraeli dhe judaizmi janë e njëjta gjë. Kështu, Izraeli ngul këmbë që çdo gjë që bën, e bën në emër të judaizmit dhe kur veprimet e tij kundërshtohen nga të gjithë njerëzit anembanë botës, atëherë kjo kritikë është e drejtuar jo vetëm kundër Izraelit, por gjithashtu edhe kundër judaizmit. Udhëheqësi i partisë laburiste britanike Xheremi Korbin (Jeremy Corbyn) tërhoqi shumë kritika kur shpjegoi, për mendimin tim në mënyrë të saktë, se të fajësosh judaizmin për politikat e Netaniahut është njëlloj sikur të fajësosh Islamin për veprimet e Shtetit Islamik. Ky është një krahasim i drejtë, ndonëse prek ndjenjat e disa njerëzve.[197]

Zgjidhja me dy shtete është si një kufomë që nxirret nga morgu herë pas herë, vishet bukur dhe paraqitet si një qenie e gjallë. Kur provohet se në të nuk ka mbetur fare jetë, rikthehet në morg. Në të ardhmen, gjëja e vetme që mund të ndryshojë është prania i Palestinës në Kombet e Bashkuara si një anëtar me të drejta të plota. Në të njëjtën kohë, mund të shohim edhe përfundimin nga Izraeli të aneksimit të Zonës C, që përbën më shumë se 50% të Bregut Perëndimor. Tensioni ndërmjet aktit simbolik në Këshillin e

[197] Daniel Clinton, *"Jeremy Corbyn Appears to Compare Supporters of Israel with ISIS at Release of Anti-Semitism Report," Jerusalem Post*, 30 qershor 2016.

Sigurimit të OKB-së dhe realitetit në terren mund të jetë shumë i madh për t'u duruar nga bashkësia ndërkombëtare. Skenari më i mirë i imagjinueshëm mund të jetë që rrethana të tilla të mund t'i detyrojnë të gjithë që t'i rikthehen tabelës së zezë dhe të mendojnë përsëri për një zgjidhje parimore të këtij konflikti.

Maskarada do të përfundojë shpejt, paqësisht apo dhunshëm, por si do që të jetë, do të jetë e dhimbshme. Duket se asgjë nuk do ta ndalë Izraelin tani nga plotësimi i kolonizimit nga ana e tij të Bregut Perëndimor dhe vazhdimi i rrethimit ndaj Gazës. Kjo mund të arrihet me bekimin ndërkombëtar, por në Izrael ka mjaft politikanë që duket se janë të gatshëm të vazhdojnë përpara edhe pa atë bekim. Në cilindo rast, Izraelit do t'i duhet të përdorë forcën brutale për të zbatuar vizionin e tij të një "zgjidhjeje", duke aneksuar gjysmën e Bregut Perëndimor, duke getoizuar gjysmën tjetër si dhe Rripin e Gazës, dhe duke vendosur një lloj regjimi aparteidi ndaj qytetarëve palestinezë. Një situatë e tillë do ta bëjë çdo fjalim për zgjidhjen me dy shtete të kotë dhe të dalë mode.

Në kohët e lashta, të vdekurit varroseshin së bashku me sendet e tyre të dashura. Ky funeral i pritshëm, me sa duket, do të ndjekë të njëjtin ritual. Gjëja më e rëndësishme që do të varroset dy metra nën dhè është fjalori i iluzionit dhe mashtrimit me shprehjet të tilla të famshme si "procesi i paqes", "demokracia e vetme në Lindjen e Mesme", "një komb paqëdashës", "barazi dhe reciprocitet" dhe "një zgjidhje humane për problemin e refugjatëve". Prej vitesh po përgatitet një fjalor zëvendësues, që e ripërcakton sionizmin si kolonializëm, Izraelin si një shtet aparteidi dhe Nekban si spastrim etnik. Do të jetë shumë më e lehtë për t'u futur në përdorimin e përditshëm sapo zgjidhja me dy shtete të shpallet e vdekur.[198]

Pranë trupit do të prehen edhe hartat e zgjidhjes së vdekur. Harta që e reduktoi Palestinën në një të dhjetën e madhësisë së saj historike dhe e cila u paraqit si një hartë paqeje, shpresoj që të zhduket përgjithmonë. Nuk ka nevojë që të përgatitet një hartë alternative. Që nga viti 1967, gjeografia e konfliktit në realitet nuk ka ndryshuar aspak, ndonëse ka ndryshuar në mënyrë konstante në diskursin e politikanëve liberalë sionistë, gazetarëve dhe akademikëve. Palestina ka qenë gjithmonë vendi ndërmjet lumit dhe detit. Akoma është e tillë. Ndryshimi i fateve të saj karakterizohet jo nga gjeografia, por nga demografia. Lëvizja e kolonëve që mbërritën atje nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë tani llogaritet të jetë sa gjysma e popullsisë dhe kontrollon gjysmën tjetër nëpërmjet një rrjeti ideologjie raciste dhe politikash aparteidi. Paqja nuk është çështje ndryshimi demografik dhe as ribërjeje të hartave, por është zhdukja e atyre ideologjive dhe politikave. Kush e di, ndoshta tani mund të jetë më e lehtë se kurrë për ta bërë atë.

Funerali do të zbulojë gabimet e lëvizjes së protestave masive izraelite të vitit 2012, ndërsa në të njëjtën kohë, do të nxjerrë në pah potencialin e saj pozitiv. Për shtatë javë gjatë asaj vere, hebrenjtë e klasës së mesme protestuan në masë kundër politikave shoqërore dhe ekonomike të qeverisë. Për të siguruar një protestë sa më të madhe, udhëheqësit dhe koordinuesit e saj nuk guxuan të përmendin pushtimin, kolonizimin apo aparteidin. Sipas tyre, burimi i çdo të keqeje ishin politikat brutale kapitaliste të qeverisë. Në një farë mënyre, ata kishin të drejtë. Ato politika po e pengonin racën pronare të Izraelit nga gëzimi i plotë dhe i barabartë i fryteve të përdhunimit dhe shpronësimit të Palestinës. Megjithatë, një ndarje më e drejtë e plaçkës së luftës nuk do t'u sigurojë një jetë normale as hebrenjve dhe as palestinezëve. Këtë gjë mund ta sigurojë vetëm dhënia fund e plaçkitjes dhe grabitjes. Demonstruesit shprehën gjithashtu skepticizmin dhe mosbesimin e tyre në lidhje me atë që mediat dhe politikanët u thonë në lidhje me realitetin ekonomiko-shoqëror. Kjo mund të hapë rrugën për një kuptim më të mirë të gënjeshtrave, me të cilat janë ushqyer në lidhje më "konfliktin" dhe "sigurinë e tyre kombëtarë" për kaq shumë vjet.

[198] Për fjalorin, shih Noam Chomsky and Ilan Pappe, *On Palestine*, London: Penguin, 2016.

Funerali duhet të na japë të gjithëve forcë që të ndjekim të njëjtën shpërndarje të barrës si më parë. Palestinezët duhet të zgjidhin sa më urgjentisht çështjen e përfaqësimit. Forcat përparimtare hebreje në botë duhet të rekrutohen sa më intensivisht në fushatat e solidaritetit dhe në BDS. Në Palestinë, ka ardhur koha që diskursi i zgjidhjes me një shtet të vihet në veprim politik dhe ndoshta të ndiqet një fjalor i ri. Duke qenë se shpronësimi është kudo, ripronësimi dhe pajtimi duhet të ndodhë kudo. Nëse marrëdhëniet ndërmjet hebrenjve dhe palestinezëve duhet të ristrukturohen mbi baza të drejta dhe demokratike, atëherë nuk mund ta pranojmë as hartën e vjetër dhe të varrosur të zgjidhjes me dy shtete, por as logjikën e ndarjes. Kjo do të thotë që edhe dallimi i paprekshëm ndërmjet kolonive hebreje në Izrael (përpara vitit 1967) dhe atyre në Bregun Perëndimor (pas vitit 1967) duhet të përcillet në varr. Dallimi duhet bërë ndërmjet atyre hebrenjve që janë të gatshëm të diskutojnë një riformulim të marrëdhënieve, një ndryshim të regjimit dhe status të barabartë, dhe atyre që nuk janë, pa marrë parasysh se ku jetojnë tani.

Nëse studion strukturën njerëzore dhe politike të Izrael-Palestinës bashkëkohore zbulon disa fenomene të çuditshëm: gatishmëria për të hyrë në dialog, disa herë është më e dukshme përtej vijës së gjelbër se sa brenda saj. Dialogët e brendshëm në lidhje me ndryshimin e sistemit, çështjen e përfaqësimit dhe fushatën e BDS-së janë të gjitha pjesë e së njëjtës përpjekje për të sjellë drejtësi dhe paqe në Palestinë. Sapo zgjidhja e dy shteteve të varroset, do të jetë hequr një pengesë e madhe për një paqe të drejtë në Izrael dhe Palestinë.

PËRFUNDIMI

SHTETI NGULITËS KOLONIAL I IZRAELIT NË SHEKULLIN XXI

Në vitin 2017, pushtimi izraelit i Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës do të ketë zgjatur për 50 vjet. Pas një periudhe kaq të gjatë, termi "pushtim" bëhet disi i tepërt dhe i parëndësishëm. Dy breza palestinezësh kanë jetuar tashmë nën këtë regjim. Ndonëse ata vetë do ta quajnë atë akoma pushtim, ajo që ata kanë përjetuar është e rrënjosur në diçka tjetër shumë më të vështirë për t'u mundur apo ndryshuar: kolonizimin. Termi kolonizim, siç e kam përmendur në kapitujt e hyrjes, nuk përdoret lehtë për të tashmen. Ai më shumë shoqërohet me ngjarjet e së shkuarës. Kjo është arsyeja se përse, me ndihmën e hulumtimeve interesante të sotme, historianët që shkruajnë për Izraelin po përdorin gjithnjë e më shpesh një term tjetër: kolonializmi ngulitës.

Kolonializmi mund të përshkruhet si lëvizja e evropianëve në pjesë të ndryshme të botës dhe krijimi i kombeve të reja "të bardha" atje ku popujt vendas kishin një herë mbretëritë e tyre. Këto kombe mund të krijohen vetëm nëse kolonët përdorin dy logjika: logjikën e eliminimit, duke hequr qafe me çdo mjet të mundshëm popullsinë vendase, përfshirë këtu edhe genocidin, dhe logjikën e çnjerëzimit, duke i konsideruar joevropianët si inferiorë dhe që nuk meritojnë të kenë të njëjtët të drejta si kolonët. Në Afrikën e Jugut, këto logjika binjake çuan në krijimin e sistemit të aparteidit, të themeluar zyrtarisht në vitin 1948, në të njëjtin vit kur lëvizja sioniste i përktheu të njëjtat logjika në një operacion spastrimi etnik në Palestinë.

Siç mundohet të tregojë ky libër, nga një perspektivë kolonizimi ngulitës, ngjarje të tilla si pushtimi i Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës, Procesi i Oslos dhe shkëputja nga Gaza në vitin 2005 janë që të gjitha pjesë e së njëjtës strategji izraelite të marrjes sa më shumë që të jetë e mundur nga Palestina me sa më pak palestinezë që të jetë e mundur. Mjetet e arritjes së këtij objektivi kanë ndryshuar me kalimin e kohës dhe ai ka mbetur i papërfunduar. Megjithatë, ai është karburanti kryesor që ushqen zjarrin e konfliktit.

Në këtë mënyrë, lidhja e tmerrshme ndërmjet logjikës së çnjerëzimit dhe eliminimit, kaq e dukshme në përhapjen e kolonializmit ngulitës evropian në të gjithë botën, së pari e gjeti rrugën në shtetet autoritare të Lindjes së Mesme. Ajo u shfaq pamëshirshëm, ndërmjet shumë shembujve të tjerë, në shkatërrimin e kurdëve nga Saddam Husejni si edhe në veprimet ndëshkuese të kryera nga regjimi i Esedit në vitin 2012. Gjithashtu, ajo u përdor edhe nga grupimet që e kundërshtonin atë regjim: shembulli më i keq ishin politikat genocidale të Shtetit Islamik.

Ky barbarizim i lidhjeve njerëzore në Lindjen e Mesme mund të ndalet vetëm nga vetë popujt e rajonit. Por ata duhen ndihmuar edhe nga bota e jashtme. I gjithë rajoni duhet të kthehet në të kaluarën e tij jo edhe aq të largët, kur parimet udhëzuese ishin "jeto dhe ler të jetojnë". Asnjë diskutim serioz në lidhje me dhënien fund të shkeljeve të të drejtave të njeriut në të gjithë rajonin nuk mund të anashkalojë një bisedim mbi 100 vjet shkelje të të drejtave të njeriut në Palestinë. Që të dy janë të lidhur ngushtë. Përjashtimi që po gëzon Izraeli dhe para tij lëvizja sioniste, është një tallje ndaj çdo kritike perëndimore për shkelje të të drejtave të njeriut në botën arabe. Çdo diskutim mbi shkeljen e të drejtave njerëzore të palestinezëve duhet të përfshijë njohjen e rezultatit të pashmangshëm të projekteve koloniale ngulitëse si sionizmi. Kolonët hebrenj tani janë një pjesë organike dhe integrale e vendit. Ata nuk munden dhe nuk do të dëbohen. Ata duhet të jenë pjesë e së ardhmes, por jo mbi bazën e shtypjes konstante dhe shpronësimit të palestinezëve vendas.

Kemi humbur shumë vite duke folur për zgjidhjen me dy shtete sikur të kishte ndonjë rëndësi për çështjen

e mësipërme. Por ajo kohë na është dashur që të bindim si hebrenjtë izraelitë, ashtu edhe botën mbarë, se kur themelon një shtet, qoftë edhe një me kulturë të lulëzuar, industri të suksesshme të teknologjisë së lartë dhe ushtri të fuqishme, mbi bazën e shpronësimit të një populli tjetër, legjitimiteti yt moral do të jetë gjithmonë në pikëpyetje. Kufizimi i çështjes së legjitimitetit vetëm tek territoret që Izraeli i pushtoi në vitin 1967 nuk do ta zgjidhë kurrë çështjen që ndodhet në thelb të problemit. Natyrisht që do të ndihmojë, nëse Izraeli tërhiqet nga Bregu Perëndimor, por ekziston mundësia që ai do ta monitorojë atë rajon në të njëjtën mënyrë siç ka bërë me Rripin e Gazës që nga viti 2006. Kjo gjë nuk do ta shpejtojë fundin e konfliktit, por vetëm do ta shndërrojë atë në një konflikt të një lloji tjetër.

Ekzistojnë shtresa të thella të historisë që duhen marrë në shqyrtim nëse bëhet një përpjekje e sinqertë për të arritur në një zgjidhje. Pas Luftës së Dytë Botërore, sionizmi u lejua që të bëhej një projekt kolonialist në një kohë kur kolonializmi po hidhej poshtë nga bota e qytetëruar, sepse krijimi i një shteti hebre i jepte Evropës dhe Gjermanisë Perëndimore në veçanti, një rrugëdalje të lehtë nga ekseset më të këqija të antisemitizmit që janë parë ndonjëherë. Izraeli ishte i pari që shpalli njohjen e "një Gjermanie të re" dhe në shkëmbim mori shumë para, por ç'është më e rëndësishmja, një karta bianka për të shndërruar krejt Palestinën në Izrael. Sionizmi u vetëofrua si një zgjidhje ndaj antisemitizmit, por u bë shkaku kryesor për vazhdimin e praninë së tij. "Ujdia" nuk ja doli të çrrënjosë racizmin dhe ksenofobinë që akoma prehet në zemër të Evropës dhe e cila prodhoi nazizmin në kontinent dhe kolonializmin brutal jashtë tij. Ai racizëm dhe ajo ksenofobi tani është kthyer kundër muslimanëve dhe Islamit. Duke qenë i lidhur ngushtë me çështjen Izrael-Palestinë, ai mund të pakësohet sapo të gjendet një përgjigje e sinqertë për atë problem.

Që të gjithë ne meritojmë një fund më të mirë të historisë së Holokaustit. Kjo gjë mund të përfshijë një Gjermani të fortë multikulturore që do t'i tregojë rrugën pjesës tjetër të Evropës; një shoqëri amerikane që i trajton me guxim krimet racore të së shkuarës së saj që akoma vazhdojnë të jehojnë; një botë arabe që flak tej barbarizmin dhe çnjerëzimin...

Asgjë e tillë nuk mund të ndodhë nëse vazhdojmë të biem në kurthin e trajtimit të mitologjive si të vërteta. Palestina nuk ishte bosh dhe populli hebre kishte atdhe; Palestina u kolonizua, nuk u "rikthye" dhe populli i saj u shpronësua në vitin 1948, nuk u largua vullnetarisht. Edhe në kartën e OKB-së, popujt e kolonizuar kanë të drejtë të luftojnë për çlirimin e tyre, qoftë edhe me ushtri, dhe fundi i suksesshëm i një lufte të tillë është krijimi i një shteti demokratik, që përfshin të gjithë banorët e tij. Një diskutim i së ardhmes, i çliruar nga dhjetë mitet mbi Izraelin, shpresoj që jo vetëm do të ndihmojë në sjelljen e paqes në Izrael dhe Palestinë, por edhe do ta ndihmojë Evropën që të arrijë të mbyllë siç duhet tmerret e Luftës së Dytë Botërore dhe epokën e errët të kolonializmit.

SHTRIRJA KOHORE

1881 Valët e pogromeve ruse që zgjatën deri në vitin 1884. Lëvizja sioniste shfaqet në Evropë.

1882 Alijah e Parë (1882-1904). Themelimi i Rishon LeZion, Zichron Yaacov dhe Rosh Pina ne Palestinë.

1897 Kongresi i Parë Sionist në Bazel. Themelimi i Kongresit Botëror Sionist.

1898 Kongresi i Dytë Sionist.

1899 Kongresi i Tretë Sionist.

1901 Themelohet Fondi Kombëtar Hebre (JNF).

1904 Alijah e Dytë (1904-1914).

1908 Ngrihet Zyra e Palestinës (në vitin 1929 bëhet Agjencia Hebreje).

1909 Themelohet Degania (Kvutzat Degania), kibuci i parë. Themelimi i Tel Avivit. Themelohet Hashomer.

1915-16 Korrespondenca Husejn-McMahon

1916 Marrëveshja Sajks-Piko (Sykes-Picot)

1917 Deklarata e Balfurit. Britania pushton Palestinën dhe e qeveris atë nëpërmjet një administrate ushtarake (deri në vitin 1920).

1920 Themelohet Haganah. Themelohet Histadrut. Konferenca e San Remos i jep Britanisë Mandatin mbi Palestinën.

1922 Britania njeh Transjordaninë si një entitet të veçantë politik dhe emirin Abdullah si sundimtarin e saj. Kongresi i SHBA-së mbështet Deklaratën e Balfurit.

1923 Mandati Britanik mbi Palestinën dhe Transjordaninë autorizohet së pari nga Lidhja e Kombeve dhe më pas nga Traktati i Lozanës.

1931 Irguni ndahet nga Haganah.

1936 Shpërthen Revolta Arabe që do të zgjasë deri në vitin 1939

1937 Komisioni Mbretëror Peel

1940 “Lehi” (banda Stern) ndahet nga Irguni. Fillon Projekti i Dosjeve të Fshatrave (Villages Files Project).

1946 Komisioni Anglo-Amerikan i Hetimit

1947 Britania shpall fundin e Mandatit dhe ja transferon OKB-së çështjen e Palestinës. OKB-ja formon një komision të posaçëm, UNSCOP-in, i cili rekomandon ndarjen. Kjo miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (Rezoluta 181).

1948 Spastrimi etnik i Palestinës: mbaron Mandati Britanik, shpallet Shteti i Izraelit dhe njihet nga

Shtetet e Bashkuara dhe BRSS. Izraeli në luftë me trupat që hyjnë në Palestinë nga vendet arabe fqinjë, ndërkohë përfundon dëbimin e gjysmës së popullsisë së Palestinës, shkatërron gjysmën e fshatrave të saj dhe boshatis dhe shkatërron 11 nga 12 qytetet e saj.

1949 Rezoluta 194 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, që bën thirrje për rikthimin e refugjatëve palestinezë. Marrëveshje armëpushimi ndërmjet Izraelit, Egjiptit dhe Libanit. Vendoset regjimi ushtarak ndaj qytetarëve të mbetur palestinezë brenda në Izrael, i cili do të qëndrojë në fuqi deri në vitin 1966.

1950 Fillon emigrimi i hebrenjve nga vendet arabe.

1956 Izraeli i bashkohet Britanisë dhe Francës në një luftë kundër Egjiptit të Naserit, duke pushtuar gadishullin e Sinait dhe Rripin e Gazës. Masakra e Kefr Kasimit.

1959 Trazirat e Uadi Salib (trazirat Mizrahi në Hajfa kundër diskriminimit).

1963 Fundi i epokës Ben-Gurion.

1967 Lufta e Gjashtë Ditëve: Izraeli pushton Sinain, Rripin e Gazës, Lartësitë Golan, Jeruzalemin Lindor dhe Bregun Perëndimor. Rezoluta 242 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së i bën thirrje Izraelit që të tërhiqet nga të gjitha territoret e pushtuara. Fillon projekti kolonizues izraelit në Bregun Perëndimor dhe Gaza.

1973 Lufta e Tetorit: Izraeli pushton pjesë të vetë Egjiptit dhe ruan kontrollin mbi Lartësitë Golan, pas një konflikti të përgjakshëm që e kapi shtetin në befasi.

1974 Rezoluta 338 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së riafirmon të drejtën e palestinezëve për vetëvendosje dhe pavarësi kombëtare.

1976 Protestat palestineze të Ditës së Tokës në Izrael kundër hebraizimit të Galilesë.

1977 Likudi nën udhëheqjen e Mehahem Beginit fiton zgjedhjet kombëtare pas 30 vitesh sundim të laburistëve. Presidenti i Egjiptit Enver Sadat viziton Jeruzalemin dhe fillon bisedime dypalëshe me Izraelin.

1978 Nënshkruhet marrëveshja e paqes ndërmjet Izraelit dhe Egjiptit. Sundimi i OÇP-së mbi Tel Aviv pasohet nga operacioni “Litani”. Izraeli pushton pjesë të Libanit të Jugut.

1981 Aneksimi i Lartësive Golan nga Izraeli.

1982 Sinai i rikthehet Egjiptit. Operacioni “Paqe për Galilenë”, në të cilin Izraeli invadon Libanin në përpjekje për të shkatërruar OÇP-në.

1987 Intifada e Parë Palestineze

1989 Kolapsi i BRSS-së dhe emigrimi masiv i hebrenjve dhe johebrenjve nga i gjithë Blloku Lindor në Izrael.

1991 Lufta e Parë e Gjirit. SHBA-ja mbledh konferencën ndërkombëtare mbi Palestinën në Madrid.

1992 Laburistët rikthehen në pushtet dhe Jichak Rabini bëhet kryeministër për herë të dytë.

1993 OÇP-ja dhe Izraeli nënshkruajnë Deklaratën e Parimeve të Oslos në Shtëpinë e Bardhë.

1994 Formohet Autoriteti Kombëtar Palestinez dhe Jaser Arafati, kryetari i OÇP-së, mbërrin në territoret e pushtuara për t'u bërë president i AKP-së. Izraeli dhe Jordania nënshkruajnë marrëveshje paqeje.

1995 Nënshkruhet Oslo II, marrëveshja e përkohshme për kontrollin palestinez mbi pjesë të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës. Vritet Jichak Rabini.

1996 Likudi rikthehet në pushtet dhe formohet qeveria e parë e Benjamin Netanjahut.

1999 Laburisti Ehud Barak zgjidhet si kryeministër.

2000 Ariel Sharoni, udhëheqësi i Likudit, zgjidhet si kryeministër. Më vonë formon partinë e tij (Kadima) dhe fiton zgjedhjet e vitit 2005.

2002 Miratohet projekti i Murit të Bregut Perëndimor. Zbatimi fillon në vitin 2003.

2005 Sharoni rizgjidhet. Fillon lëvizja BDS. Izraeli evakuon kolonitë dhe bazat ushtarake nga Gaza.

2006 Hamasi fiton zgjedhjet për legjislaturën e dytë të Këshillit Legjislativ Palestinez. Izraeli, Kuarteti i Lindjes së Mesme (SHBA-ja, Rusia, OKB-ja dhe BE-ja), disa vende perëndimore dhe shtetet arabe vendosin sanksione ndaj Autoritetit Palestinez, duke pezulluar të gjitha ndihmat e huaja. Fillon rrethimi i Gazës. Lufta e Dytë kundër Libanit dhe sulmi izraelit kundër Rripit të Gazës.

2006 Ehud Olmert zgjidhet si kryeministër (në shkurt të vitit 2016 Olmerti filloi vuajtjen e dënimit me 19 muaj burg për ryshfet dhe pengim të drejtësisë).

2008 Lufta e Gazës, operacioni "Plumb i Shkrirë". OKB-ja dhe organizatat e të drejtave të njeriut numërojnë më shumë se 1400 palestinezë të vrarë, nga të cilët 926 civilë të paarmatosur. U vranë tre civilë izraelitë dhe gjashtë ushtarë.

2009-13 Qeveria e dytë Netanjahu

2011 Protesta shoqërore në të gjithë Izraelin (Lëvizja e Çadrës).

2012 Operacioni "Shtylla e Resë". Katër civilë izraelitë dhe dy ushtarë vriten nga sulmet raketore palestineze. Sipas OKB-së, 174 palestinezë u vranë, nga të cilët 107 civilë.

2013-15 Qeveria e tretë Netanjahu

2014 Operacioni "Qoshja Mbrojtëse". Sipas vlerësimeve, u vranë rreth 2125 deri 2310 palestinezë (1492 civilë, ku përfshihen 551 fëmijë dhe 299 gra) dhe u plagosën rreth 10626 deri 10894 (duke përfshirë 3374 fëmijë, nga të cilët më shumë se 1000 mbetën të gjymtuar përjetë). U vranë 66 ushtarë izraelitë, pesë civilë (përfshirë një fëmijë) dhe një civil tajlandez. U plagosën 469 ushtarë dhe 261 civilë izraelitë. Izraeli shkatërroi plotësisht rreth 17000 shtëpi dhe pjesërisht 30000 të tjera.

2015 Qeveria e katërt Netanjahu

Dëshiroj të falenderoj mikun tim Marselo Svirski (Marcelo Svirsky) për përpilimin e kësaj kronologjie.